



POLIS NR 5/2008
Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale

Adresa:

Bulevardi "Gjergj Fishta"
 UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
 TIRANË

Bordi Editorial

Prof. As. Dr. Romeo Gurakuqi
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Dr. Ermal Hasimja
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Lea Ypi
 European University Institute, Firenze, Itali

Enis Sulstarova
 Universiteti i Durrësit

Kryeredaktor

Blendi Kajsiu
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Redaktor

Henri Çili
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Elda Papa
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Asistent-Redaktor

Blerjana Bino
 Universiteti Europian i Tiranës (JET)

PËRMBAJTA

Vdekje Politikës, Liri Popullit! - Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri Blendi Kajsiu	5
Qytetaret e Padukshme në Politikë: Gratë në Zonat Rurale Sonila Danaj.....	26
Përfaqësimi Anonim: Këshillat Bashkiakë në Pushtetin Vendor Shqiptar Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN)	37
Në Kërkim të Kimerës: Në Kufinj të Teorive të Përfaqësimit Dr. Ermal Hasimja	54
Diktatura Pa Humor – Ose Mungesa e Barsoletave Shqiptare mbi Socializmin Dr. Shannon Woodcock	65
Nga “Revolucioni i Kadifentë” tek “Restaurimi i Kadifentë”: Trashëgimia Komuniste në Poloni dhe Shqipëri Gëzim Krasniqi	77
Midis Iluminizmit dhe Romantizmit: Mendimi Politik i Rilindjes Shqiptare Lea Ypi	89
Përdorimi Instrumental i Kufijve midis Kategorive Fetare dhe Metaforave Gjinore në Ballkan Dr. Albert Doja	101
Rishikimi i Irredentizimit: Ndikimi i Faktorëve Shoqërorë dhe Ndërhyrja e Jashtme në Rastin e Irredentizimit Serb Ilir Kalemaj	109

Teori Politike

Përfaqësimi Politik Hanna Fenichel Pitkin	127
---	-----

VDEKJE POLITIKËS, LIRI POPULLIT! - KRIZA E PËRFAQËSIMIT NË SHQIPËRI

BLENDI KAJSIU*

Abstrakt. Në këtë ese argumentohet se në pamundësi për të ndërtuar dhe përfaqësuar identitete pozitive (përmbajtësore) secila nga dy partitë politike kryesore e artikulon “popullin” përkundër një kërcënimi që përfaqësohet nga kundërshtari i saj politik. Pra, në vend që të theksojnë karakteristikat pozitive të grupeve apo shtresave të caktuara sociale, partitë politike i kanë artikuluar këto grupime në raport me një kërcënim të jashtëm si komunizmi, berishizmi, korrupsioni apo politika e vjetër që përfaqësohet nga kundërshtari politik. Kjo prodhon një konfliktualitet të lartë politik që tëhuajëson qytetarët, duke e bërë edhe më të vështirë për partitë politike përfaqësimin e subjekteve sociale ekzistuese apo artikulimin e subjekteve të reja. Sa më pak përfaqësuese bëhen partitë politike aq më shumë shoqëria në tërësi dhe grupe të veçanta brenda saj e përcaktojnë vetveten jo nëpërmjet por në kundërshtim me partitë politike duke prodhuar diskurin anti-politik.

Hyrje

Po të më pyesnit mua, do preferoja një moratorium dyvjeçar, që ndalon funksionimin e partive politike dhe shtetin ta marrin nën kontroll specialistët, njerëz pa inate, që nuk janë karrieristë, nuk merren me trafiqe dhe që nuk kërkojnë të pasurohen. Ata do ta nxjerrin vendin nga situata, sepse ky vend vuan nga politika e keqe.¹

Prof. Dr. Ylli Popa

Ish - kryetar i Akademisë së Shkencave

Skena politike shqiptare ka qenë arenë e konflikteve të ashpra dhe të tejzgjatura midis Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste, dy protagonistëve kryesorë të saj. Një nga pasojat e përplasjeve të ashpra mes këtyre dy aktorëve ka qenë pakënaqësia në rritje e elektoratit ndaj procesit politik në vend. Sot në Shqipëri politika në tërësi fajësohet nga pothuajse të gjithë për pothuajse gjithçka. Politika shikohet si e keqja më e madhe që e ka zënë Shqipërinë, si sëmundja nga e cila ajo nuk mund të çlirohet për t'u bërë e begatë. Citati i mësipërm është vetëm një nga shembujt e shumtë të një ligjërimi të tillë që është simptomë

* Blendi Kajsio është pedagog në Universitetin Europian të Tiranës (UET) si dhe student në programin e doktoraturës, Ideology and Discourse Analysis (IDA) të Universitetit të Esekstit. Ai është diplomuar në Ekonomi dhe në Shkenca Politike nga Universiteti Amerikan në Bullgari (AUBG). Më pas ka kryer një Master në Studimet Ndërkombëtare të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin Notre Dame, SHBA, si dhe një Master në Analizën e Ideologjisë dhe Diskurit nga Universiteti i Esekstit, në Britaninë e Madhe.

e një krize të thellë përfaqësimi. Gjithnjë e më shumë qytetarët ndihen të pakënaqur dhe të papërfaqësuar nga partitë politike, të cilat shikohen si shkaku dhe jo zgjidhja e krizave politike, sociale apo ekonomike që kanë ngërthyer vendin.

Paradigmat kryesore në fushën e demokratizimit që fokusohen në procesin e tranzicionit dhe të konsolidimit demokratik i shpjegojnë dështimet e politikës post-komuniste shqiptare duke iu referuar trashëgimisë historike dhe kulturore, dobësisë së shoqërisë civile dhe institucioneve apo faktorëve strukturorë dhe socialë. Emëruesi i përbashkët i qasjeve të tilla është ose injorimi i politikës si kategori analitike ose reduktimi i saj tek ndërveprimi i aktorëve, institucioneve apo trashëgimive. Politika shtjellohet thjesht si reflektim i realiteteve më të “thella” sociale. Për pasojë, qasje të tilla nuk arrijnë të fiksojnë dinamikën politike nëpërmjet të cilës faktorët “e thellë” socialë sendërtohen politikisht, nga ku buron edhe kriza e përfaqësimit në Shqipëri. Për ta kuptuar një krizë të tillë në dimensionin e saj politik, është e rëndësishme që t’i kushtohet prioritet analitik *politikes* si akti i formësimit të *sociales*. Për këtë arsye, në analizën time politika gëzon statusin e *ontologjisë* së sociale dhe jo atë të një reflektimi sipërfaqësor të elementëve të saj bazë. Praktikisht kjo do të thotë që në vend që të përqendrohemi në “thellësinë” e realitetit social, ne do të fokusohemi në diskutet politike dominuese në Shqipëri për të kuptuar mënyrën se si ato përpiqen të ravijëzojnë kategorinë “popull” apo të fiksojnë sistemin simbolik nëpërmjet të cilit merr formë shoqëria shqiptare.

Argumenti kryesor i këtij artikulli është se kriza e përfaqësimit në Shqipëri buron nga fakti se asnjëra nga dy partitë kryesore nuk ka arritur të ndërtojë një identitet pozitiv (përmbajtësor) të elektoratit të saj dhe për pasojë e ka artikulluar këtë elektorat dhe “popullin” në përgjithësi përkundër një kërcënimi të përfaqësuar nga kundërshtari i saj politik. Kështu, secila nga forcat politike në ligjërimin e saj ka përdorur herë “komunizmin”, herë “berishizmin”, herë “korrupsionin” dhe së fundi “politikën e vjetër”, si kërcënime në raport me të cilat është artikulluar elektorati i saj dhe “populli” në përgjithësi. Kështu që në vend që të theksojnë dhe artikulojnë pozitivitetin (përmbajtjen) e identitete të caktuara sociale dhe politike (urbane apo rurale, liberale apo konservatore, kozmopolitane apo nacionaliste, e kështu me radhë), partitë e kanë mobilizuar elektoratin kryesisht duke i mëshuar një kërcënimi që përfaqësohet nga pala kundërshtare. Nga këtu ka buruar konfliktualiteti i lartë politik mes dy forcave kryesore.

Ky konfliktualitet ka alienuar qytetarët duke e bërë edhe më të vështirë për partitë politike artikulumin dhe përfaqësimin e subjekteve sociale ekzistuese apo artikulumin e subjekteve të reja. Sa më pak përfaqësuese bëhen partitë politike aq më shumë shoqëria në tërësi dhe grupe të veçanta brenda saj e përcaktojnë vetveten jo nëpërmjet por në kundërshtim me partitë politike; ja pra nga buron diskursi anti-politik. Kjo nuk do të thotë se identitetet individuale apo sociale nuk mund apo nuk duhet të ekzistojnë jashtë politikave partiake. Ama artikulumin i tyre në procesin politik si grupe interesi apo kategori sociale është një akt politik. “Interesi i përbashkët” i një grupi social nuk ekziston *apriori*, por sendërtohet në mënyrë diskursive, pra politikisht. Kjo do të thotë që nëse partitë politike i artikulojnë grupet sociale në kundërshtim me një kërcënim që përfaqësohet nga kundërshtari politik, ato janë të paafta t’i artikulojnë dhe përfaqësojnë këto grupe sociale në vetvete.

Për ta nxjerrë në pah këtë dinamikë gjatë post-komunizmit shqiptar, kjo ese është organizuar në pesë pjesë. Në pjesën e parë parashtrahet kuadri teorik dhe metodologjik që bën të mundur analizimin e dinamikës politike post-komuniste nëpërmjet qasjes së analizës së diskutit të zhvilluar nga Ernesto Laclau dhe Chantal Mouffe. Në pjesën e dytë shqyrtohet rënia e komunizmit dhe shfaqja e rendit të ri simbolik post-komunist. Në pjesën e tretë analizohet lindja dhe konsolidimi i diskutit anti-komunist, si ligjërimi dominues në vitet e para të tranzicionit. Në pjesën e katërt analizohet konsolidimi dhe dështimi i diskutit evropianizues, që i hap rrugën konsolidimit të diskutit anti-politik, në të cilin politika bëhet “tjetri” përkundër të cilit formësohen shoqëria dhe populli shqiptar. Ky proces analizohet në pjesën e pestë të artikullit.

Kuadri teorik dhe metodologjik

Qasjet kryesore në fushën e demokratizimit, pavarësisht ndryshimeve, bëjnë pjesë në atë që mund të quhet “pradigma e tranzicionit”. Kjo do të thotë që në të gjitha këto qasje, në mënyrë implicite apo eksplicite, presupozohet një tranzicion nga një stad shoqëror inferior tek një stad shoqëror më superior. Ndonëse në qasjet e demokratizimit tranzicioni drejt demokracisë u servir si një koncept i ri, në fakt ky koncept ekzistonte në vendet post-komuniste prej kohësh. Vetë socializmi ishte në fakt një stad tranzitor drejt komunizmit. Partia ishte grupi *avant-gard*, që zotëronte projektin dhe hartën drejt një rendi të ri. Për pasojë politika u reduktua tek zbatimi i këtij projekti, duke u kthyer në administrim. Produkti i teorive të demokratizimit është i ngjashëm, ndonëse tranzicioni tashmë është nga kahu i kundërt. Partia *avant-gard* u zëvendësua nga “eksperti” me projektin dhe hartën drejt rendit të ri demokratik. Është ironik fakti që në të dyja rastet teorizimi i tranzicionit bëhet nëpërmjet një strukture konceptuale që u zhvillua brenda Marksizmit, veçanërisht pas Revolucionit të Tetorit 1917, dhe që u përdor për të konceptuar teorikisht tranzicionin nga kapitalizmi në komunizëm.²

Në këtë përjasje ka pak hapësirë për të kuptuar dhe analizuar politikën si kategori analitike. Për faktin e thjeshtë sepse politika reduktohet tek aplikimi i një projekti të caktuar, në vend që të konsiderohet si procesi që në fakt formëson projektin në fjalë. Kështu që procesi politik më shumë sesa në vetvete analizohet në funksion të implementimit të një rendi të caktuar shoqëror. Prandaj politika analizohet nëpërmjet qasjeve deskriptive që fokusohen tek statistika mbi partitë politike, përqindje votash dhe vendesh në legjislaturë.³ Por theksi nuk është mbi atë që ndodh politikisht në një vend të caktuar post-komunist, e rëndësishme është të theksohet ajo që duhet të ndodhë në mënyrë që demokratizimi të jetë i suksesshëm. Jo rastësisht shumë pak nga ekspertët e demokratizimit “zotërojnë ndonjë nga gjuhët e rajonit apo përdorin literaturën lokale mbi historinë, politikën dhe kulturën e rajonit.”⁴ Kjo është e panevojshme për sa kohë theksi është tek ajo që duhet bërë dhe jo tek kuptimi i asaj që po ndodh. Kështu që qasjet kryesore të demokratizimit maksimalisht na thonë se përse gjërat nuk ecin ashtu siç duhet të ecnin, por nuk na thonë se përse ndodhin ashtu siç ndodhin.⁵

Për të kuptuar diçka të tillë na duhet një qasje në të cilën theksohet *politikja* si procesi nëpërmjet të cilit formësohen subjektet sociale dhe vetë shoqëria. Kjo do të thotë se për të kuptuar zhvillimet shoqërore nuk bazohemi tek qasje esencialiste, që e kërkojnë shpjegimin tek një esencë e caktuar, qoftë kjo struktura, kultura apo institucionet. Ndonëse të rëndësishëm, të gjithë këta elementë nuk janë thjesht burim i politikës, por para së gjithash prodhim i saj, çka do të thotë që në qasjen tonë analitike politika duhet të ketë prioritet absolut. Analiza e diskutit e zhvilluar nga Laclau dhe Mouffe është një qasje ku theksohet prioriteti i politikës. Në të theksohet “prioriteti i politikës mbi të gjitha versionet e ekonomizmit apo sociologjizmit”.⁶

Politika është një kategori qendrore në qasjen e Laclau dhe Mouffe, pasi për ta shoqëria nuk gëzon një identitet të dhënë. “*E vërteta e shoqërisë është se identiteti i saj nuk ekziston*”.⁷ Si rrjedhojë e mungesës së një esence pozitive rreth së cilës do mund të formësohej, shoqërisë i duhen “shënjesit bosh” për të formësuar identitetin e saj. Shenjuesit bosh janë simbole të zbrazura nga një kuptim i vetëm në raport me të cilët shoqëria krijon identitetin e saj. Të tillë mund të jenë koncepte si “liria”, “demokracia”, “barazia”, “uniteti”, që të gjitha koncepte që kanë një shumësi kuptimesh në kontekste dhe momente të ndryshme. Shenjuesit bosh përfaqësojnë një sërë kërkesash të ndryshme, prandaj ato janë të zbrazur nga kuptimi i tyre fillestar. Nëpërmjet shenjuesve bosh, një kërkesë e veçantë “pa e braktisur tërësisht veçantësinë e saj, fillon të funksionojë si një shënjes që përfaqëson” një tërësi kërkesash të ndryshme.⁸ Për shembull, kërkesa e shqiptarëve për t’u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian nuk shënon thjesht aktin formal të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Përkundrazi, ajo shënon dhe përfaqëson një sërë kërkesash, si kërkesën për punësim, zhvillim, modernizim, krenari, etj., etj. Pra, ky është një rast tipik, ku një kërkesë e veçantë (anëtarësimi i Shqipërisë në BE) është zbrazur nga kuptimi i saj i ngushtë fillestar (procedura e anëtarësimit), por pa e braktisur atë tërësisht, dhe

funksionon si një element që shënon një sërë kërkesash jo domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën, si punësim, lëvizje e lirë, krenari kombëtare, liri seksuale, kthimi pronës, etj., etj. Në këtë mënyrë, BE-ja është kthyer në një shenjues bosh, që përfaqëson një sërë kërkesash, që përndryshe nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Pra, kur themi integrimi në BE në fakt kemi thënë zhvillim, modernizim, punësim, energji elektrike 24 orë, jetë cilësore, liri, zbatimje, e kështu me radhë.

Në pamundësi për të pasur një esencë pozitive, shoqëria sendërtohet rreth një boshllëku apo mungese, prandaj “sfida e politikës është institucionalizimi i sociale, që do të thotë përkufizimi dhe artikulimi i marrëdhënieve sociale”.⁹ Kjo nuk do të thotë se kushtet sociale, kulturore, individuale apo historike nuk janë të rëndësishëm. Do të thotë që “politika në kuptimin e praktikës së krijimit, riprodhimit dhe transformimit të marrëdhënieve sociale nuk mund të lokalizohet në një nivel të caktuar shoqëror”.¹⁰ Nëse fati i një rendi social do të lexohej në esencën e strukturës, veprimit, kulturës apo proceseve historike, atëherë politika do të reduktohej në manifestimin e një esence bazë në të cilën është gdhendur dinamika e rendit në fjalë. Kjo lloj politike nuk do të ishte veçse efekti rudimentar i një shoqërie të sendërtuar apriori. “Politika është e mundur sepse pamundësia e konstituimit të plotë të shoqërisë shprehet nëpërmjet shenjuesve bosh”.¹¹ Pra, politika është mënyra se si shoqëria përballon pamundësinë e saj, me faktin që ajo nuk ekziston.

Rrjedhimisht, “politika, jo vetëm që nuk kufizohet tek superstruktura, por luan rolin e asaj që ne mund ta quajmë *ontologjia e sociale*”.¹² Për këtë arsye instalimi i një rendi shoqëror është një akt politik. Është një proces në të cilin një diskur bëhet hegjemon në fushën shoqërore, duke artikulluar shenjues bosh nëpërmjet të cilëve shoqëria apo “populli” sendërtohen si objekte. “Sendërtimi i ‘popullit’ është një akt politik *par excellance* – ndryshe nga administrimi i pastër brenda një kuadri të përcaktuar institucional”.¹³ Një këndvështrim i tillë ndaj politikës e zgjeron fushën e aplikimit të saj, pasi e konsideron politikën si një proces që nuk ka të bëjë thjesht me marrëdhënien midis apo brenda institucioneve dhe subjekteve politike. Nga kjo pikëpamje theksohet fakti se “politikja, si momenti ku kontestohen hapësirat kuptimore të konsoliduara socio-ekonomike, është e pareduktueshme”.¹⁴ Kjo nuk do të thotë që në demokraci nuk mund të ekzistojë një hapësirë shoqërore jashtë një procesi politik të përkufizuar ngushtësisht si politika mes partive. Megjithatë, një hapësirë e tillë, edhe nëse jashtë veprimtarisë aktive politike, nuk është apolitike. Ajo thjesht është një hapësirë nga ku janë fshirë apo fshehur gjurmët e pushtetit që e ka krijuar.¹⁵ Është pra, një sferë që është formësuar politikisht, ndonëse ka arritur t’i fshijë gjurmët politike të këtij formësimi.

Nga pikëpamja metodologjike, pasoja e parë e kësaj strukture teorike është se në vend që të gjurmojmë një esencë në thellësi të shoqërisë shqiptare, do të përqendrohemi tek diskuret politike që e kanë formësuar shoqërinë shqiptare si të tillë. Natyrisht ka një pafundësi diskursesh që ndërthuren dhe ndërveprojnë në sendërtimin e shoqërisë shqiptare dhe subjekteve brenda saj. Megjithatë, ne do të përqendrohemi tek diskurset politike dominuese, që kanë instaluar rendin simbolik brenda të cilit është përkufizuar dhe formësuar shoqëria shqiptare pas rënies së komunizmit. Rrjedhimisht do të fokusohemi në ligjërimin e dy partive politike kryesore gjatë tranzicionit, PD dhe PS. Më konkretisht do të bazohemi tek ligjërimi, fjalimet, intervistat dhe deklaratat e “liderëve historikë” të këtyre partive që kanë përcaktuar dhe përfaqësuar në një masë të madhe diskurin politik të tranzicionit. Gjithashtu do të shqyrtojmë edhe ligjërimet e aktorëve të tjerë, si opinionistë, gazetarë, shkrimtarë apo përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar.

Rënia e Komunizmit: Ribërja e kombit

Zgjedhjet e para pluraliste në Shqipërinë postkomuniste u mbajtën më 31 Mars 1991. Nën presionin e studentëve që protestonin në Universitetin e Tiranës, Partia e Punës shpalli pluralizmin politik më 11 Dhjetor 1990. Një ditë më pas, më 12 Dhjetor 1990, u formua Partia

Demokratike nga një grup intelektualësh që kishin mbështetur protestat studentore si dhe nga disa prej studentëve udhëheqës të këtyre protestave. Fushata elektorale që u parapriu zgjedhjeve parlamentare të 1991-shit ishte tejet e tensionuar dhe shpesh dukej sikur po e çonte vendin në prag të luftës civile. Popullata ishte e ndarë thellë midis kundërshtarëve dhe mbështetësve të regjimit komunist, të parët kryesisht në zonat urbane, ndërsa të dytët kryesisht në ato rurale.

Ajo që po luhej në 1991-shin nuk ishte thjesht fati i një rotacioni politik, por e ardhmja e të gjithë rendit simbolik, brenda të cilit ishte formësuar shoqëria shqiptare. Komunizmi në Shqipëri nuk ishte thjesht një ideologji, por edhe një projekt kombformues. Partia e Punës pretendonte se ishte themeluesja e kombit modern shqiptar. Lideri i saj historik, Enver Hoxha, konsiderohej si arkitekt i Shqipërisë moderne dhe përshkruhej “nga shumë albanologë si kampion i nacionalizmit shqiptar.”¹⁶ Identiteti komunist dhe ai shqiptar ishin të ndërthurur që në ngjizje, çka shpjegon edhe identifikimin me intensitet të lartë të popullatës me regjimin komunist dhe liderin historik Enver Hoxha.¹⁷ Ligjërimi anti-komunist i Partisë Demokratike sfidonte një rend simbolik brenda të cilit ishin formësuar një sërë identitetesh dhe subjektesh sociale, që për pasojë ndiheshin të rrezikuar nga eliminimi i tij. Këtu e kish burimin nivelin e lartë të polarizimit dhe i antagonizmit mes dy kampeve.

Rendi i ri simbolik që Partia Demokratike po përpiquej të instalonte përqendrohej tek shënjesht bosh si “Demokracia”, “Liria” apo “Evropa”, që artikulohej si të kundërtat e komunizmit që në këtë mënyrë shënonte diktaturën, izolimin apo mungesën e zhvillimit. Në zgjedhjet e para pluraliste Partia Demokratike i bëri thirrje popullatës të votonte për ta, sepse ata dëshironin ta “shpëtojmë Shqipërinë nga diktatura bolshevike komuniste... për t’u bashkuar me dinjtet me Evropën e qytetëruar”.¹⁸ Fillimisht ky ligjërim tërhoqi vetëm votuesit e zonave urbane, kurse në zonat rurale me popullsi më të lartë, ku politikanët dhe shtypi i opozitës nuk kishin hyrë ende, Partia e Punës korri një fitore të thellë, që i dha asaj 56% të votave në rang kombëtar, duke mbetur kështu në pushtet.¹⁹

Kjo ishte një fitore jetëshkurtër. Zhvillimet në vendet e tjera të Evropës Lindore si dhe ndjenjat e forta anti-komuniste në zonat urbane, ironkisht, sidomos në radhët e klasës punëtore nga ku Partia e Punës kish marrë edhe emrin, ishin shenja të qarta se rendi simbolik i komunizmit po jepte shpirt. Për këtë arsye, vetë Partia e Punës po përpiquej të distancohej nga e kaluara, duke e ndryshuar emrin e saj në Partia Socialiste në Qershor të vitit 1991, duke tradhtuar kështu moton e saj elektorale “siguri dhe vazhdimësi”²⁰. Partia “e re” Socialiste u përball menjëherë me protesta dhe greva të përgjithshme në zonat kryesore urbane të vendit, duke u detyruar që në fund të vitit 1991 të shpallte zgjedhjet e parakohshme, që u mbajtën më 22 Mars 1992.

Tashmë rendi simbolik që e projektonte Shqipërinë si vend komunist ishte shkërmoqur. Thirrjet e turmave “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa” tashmë kishin mbështetje të gjerë. “Perëndimi” gradualisht e zëvendësoi tërësisht komunizmin si utopia e re rreth së cilës sendërtohej identiteti shqiptar. Vizita e James Baker (Xhejms Beiker), sekretar i Shtetit i SHBA-së, u përshëndet nga një turmë që “ia kalonte edhe mitingjeve masive që organizoheshin nga Enver Hoxha në vitet 1960 dhe 1970. Pamja ngjasonte me një grumbullim besimtarësh në Mekë. Disa puthnin makinën e Beikerit, ndërsa të tjerët plagoseshin nga turma që i shtypte”.²¹ Kështu, Perëndimi dhe Evropa u bënë shenjuesit bosh, nëpërmjet të cilëve kuptohej një e tashme e dhimbshme dhe shpresohet tek një ardhme e begatë. “Gara mes partive kryesore politike nuk bazohej tek premtimet që ato bënin apo në aftësinë e tyre për t’i mbajtur ato, aq sa bazohej tek fakti se kush kish më shumë mbështetje nga Perëndimi”.²² Në këto kushte Partia Demokratike shumë shpejt u bë trupëzimi i rendit të ri simbolik. Në vizitën e tij James Baker doli përpara turmës me liderin e opozitës, Sali Berisha, në krah. Ky i fundit gëzonte hapur mbështetjen e Perëndimit. Për këtë arsye, në zgjedhjet e 22 Marsit 1992, Partia Demokratike, që një vit më parë kish marrë vetëm 38% të votës, tashmë shënoi një fitore të thellë, duke marrë 68% të votave.²³

Qeverisja e Partisë Demokratike: Politika e Anti-komunizmit

Zgjedhja e Partisë Demokratike (PD) në vitin 1992 u përshëndet si brenda dhe jashtë vendit si fitorja e demokracisë mbi komunizmin në Shqipëri. Në këtë moment Partia Demokratike ishte trupëzimi politik i horizontit të ri të “demokracisë, “Evropës” dhe “Perëndimit”, brenda të cilit shoqëria shqiptare e ripërkufizonte vetveten. Si e tillë PD-ja të krijonte përshtypjen “se do përfaqësonte interesat e të gjithë shoqërisë”.²⁴ Më shumë sesa një parti me një axhendë të qartë ideologjike apo një bazë të qartë sociale, Partia Demokratike ishte “një front anti-diktaturë që mbledhte bashkë forca të ndryshme opozitare kundër komunizmit”.²⁵ Kjo reflektohet edhe në faktin që emri që u sugjerua në fillim për këtë parti ishte “Partia e Rinisë dhe Intelektualëve”.²⁶ Kështu që grupet që e mbështetën ardhjen e PD-së në pushtet nuk kishin shumë gjëra të përbashkëta dhe shpesh kishin interesa diametrikisht të kundërta. Për më tepër dy vjet pas krizave të vazhdueshme politike dhe ekonomike që shoqëruan kolapsin e komunizmit, ekonomia dhe rendi publik ishin në kolaps dhe shteti përballej me një sërë kërkesash që nuk i përballonte dot. “E thënë shkurt, Partia Demokratike në vitin 1992 trashëgoi një vend që ndodhej në një situatë shthurjeje apokaliptike.”²⁷

Në këtë kontekst duhet kuptuar lindja e diskurit anti-komunist. Partia Demokratike kishte një vështirësi të dyfishtë për të kënaqur grupe të ndryshme sociale që synonte të përfaqësonte. Së pari, kolapsi i rendit simbolik të komunizmit shënoi një numër gjithnjë e në rritje të antagonizmave sociale teksa subjektet sociale të së shkuarës zhdukeshin dhe subjekte të reja sociale formësoheshin. Shpesh ato kishin interesa të kundërta dhe rrezikonin kohezionin social, pasi formësoheshin në kundërshtim me njëri-tjetrin, p.sh. veri–jug, fshat–qytet, pronar–fshatar, e kështu me radhë. Së dyti, me të ardhur në pushtet, Partia Demokratike ndërmori reforma të thella neoliberales sipas terapisë së shokut.²⁸ Kjo bëri që shteti të tërhiqej me nxitim ndërsa trauma sociale thellohej duke reduktuar mundësinë e qeverisë për të kënaqur kërkesa të ndryshme shoqërore. Kombinimi i këtyre faktorëve mund ta shpërbënte mjaft lehtë shoqërinë shqiptare. Përballë këtij rreziku Partia Demokratike gjithnjë e më shumë theksoi rrezikun komunist ndaj demokracisë dhe lirisë si një kërcënim përkundër të cilit shoqëria, kombi dhe baza elektorale e PD-së mund të mbahej bashkë. Le t’i shikojmë të dy këta faktorë.

E nesërmja e komunizmit: Subjektivitete në konflikt

Rënia e komunizmit shënoi shumëfishimin e antagonizmave teksa identitetet krijoheshin apo rikrijoheshin shpesh në përplasje me njëri-tjetrin. “Qytetari” gjithnjë e më tepër filloi ta përcaktonte vetveten si e kundërta e “fshatarit” apo e “të ardhurve” në qytet dhe zonat e tij periferike. “Jugori” gjithnjë e më tepër përcaktohej si e kundërta e “veriorit” e kështu me radhë. Kështu, teksa jugorët e kritikonin Berishën për lejimin e vendosjes së mijëra veriorëve në zonat bregdetare, disa veriorë argumentonin se komunizmi kish zbatuar politikën e një “kolonializmi të brendshëm” kundër veriut, prandaj më shumë investime duhej të bëheshin për zhvillimin e veriut.²⁹ Disa shkuan edhe një hap më tutje duke kërkuar një rishikim të gjuhës shqipe për të krijuar më shumë hapësirë për dialektin verior.³⁰ Grupe si të persekutuarit politik kërkonin më shumë trajtim të veçantë nga qeveria. Ndërsa ata ankoheshin se qeveria po bënte shumë pak për ta, të tjerë protestonin kundër trajtimit preferencial të persekutuarve, sepse për ta kjo përbënte dhunim “të garancive kushtetuese për mbrojtje të barabartë para ligjit”.³¹

Në rritje ishte edhe konflikti mes dy grupeve të sapokrijuara pas rënies së komunizmit; ish-pronarëve dhe fermerëve. Të dyja këto ishin grupime të rëndësishme për Partinë Demokratike. Fermerët për nga numri (55% e forcës së punës në vitin 1990 jetonte në zonat rurale)³², ndërsa ish-pronarët si shtresë anti-komuniste. Partia Demokratike u përpoq t’i kënaqte të dyja grupimet. Nga njëra anë ajo nuk e abrogoi reformën agrare të vitit 1991, që i bëri kooperativistët pronarë të tokës bujqësore. Nga ana tjetër, më 15 prill 1993 ajo miratoi Ligjin 7689 Mbi rikthimin

dhe kompensimin e pronës, që kompensonte pjesërisht ish-pronarët. Kjo bëri që një fraksion i djathtë i PD-së të shkëputej dhe të formonte Partinë e Djathtë Demokratike në verë të 1993-shit, me synimin për të kërkuar “kthim të plotë të tokës ish-pronarëve të mëdhenj të shpronësuar nga Komunistët pas Luftës së Dytë Botërore”.³³ Pra, në fund, si fermerët ashtu edhe ish-pronarët mbetën të pakënaqur.³⁴ “Të parët pretendonin se ligji i shpronësonte ata në mënyrë arbitrare..., ndërsa të dytët e cilësuan atë “një ligj neokomunist”, që mbante gjallë komunizmin nën emrin e demokracisë”.³⁵

Neoliberalizmi: Mbështetja e demokracisë para mbështetjes popullore

Reformat neoliberale u konsideruan një domosdoshmëri nga ana e Partisë Demokratike. “Administrata Berisha ishte ‘studenti më i bindur i FMN-së’ në Evropën Lindore në zbatimin e politikave ekonomike neoliberale”.³⁶ Këto shikoheshin si “kosto e pashmangshme e reformave të tranzicionit post-komunist”.³⁷ Por shpejtësia me të cilën u kryen këto reforma bëri që qeveria e re të irritonte disa nga grupet sociale që e sollën atë në pushtet, si klasa punëtore në zonat urbane, e cila kish ndërmarrë një sërë protestash dhe grevash kundër Partisë Socialiste në vitin 1991. *Terapia e shokut*, që u zbatua nga PD-ja, solli mbylljen apo privatizimin e shpejtë e shumë ndërmarrjeve shtetërore. “Në mesin e viteve 1996 Shqipëria dukej se ishte një nga vendet në tranzicion me prodhimin më të lartë nga sektori privat”.³⁸ Sektori publik, që ishte edhe sektori kryesor i punësimit në zonat urbane ku Partia Demokratike gëzonte mbështetjen më të madhe, u reduktua ndjeshëm. Në vitin 1995 vetëm 276 000 njerëz ishin të punësuar në këtë sektor, përkundër 615 000 në vitin 1992 dhe 889 000 në vitin 1989.³⁹ Midis vitit 1991 dhe 1993 “të ardhurat reale në zonat urbane ranë mesatarisht me 30%, ndërsa në të njëjtën periudhë të ardhurat në zonat rurale u rritën me 50%”.⁴⁰ Papunësia u rrit ndjeshëm duke nxitur emigracionin. “Midis 1990-ës dhe 1996-ës u larguan rreth gjysmë milion shqiptarë, shumica të rinj”.⁴¹

Pas daljes nga një prej regjimeve komuniste më të egra në botë, populli shqiptar u përball me një nga tranzicionet më tronditës drejt kapitalizmit. Futja e kapitalizmit nëpërmjet terapisë së shokut bëri që popullsia të përballlej me “papunësi masive, lëvizje të pakontrolluara demografike dhe një masë *laissez faire* qeveritare, që vështirë se mund të dallohej nga anarkia ekonomike dhe juridike”.⁴² Ruajtja e unitetit të një shoqërie në fragmentim nga një shtet në tërheqje ishte një mision i pamundur. Tashmë individit ishte vetëm përballë tregut, ndryshe nga e kaluara komuniste kur ai ose ajo sendërtohej në një subjekt social nëpërmjet politikave shtetërore.¹ Reformat neoliberale edhe sikur mos ta fragmentizonin shoqërinë, nuk përbënin një univers ideologjik të përshtatshëm për të prodhuar një diskur rreth të cilit shoqëria mund të bashkohej. Shumica e shqiptarëve e mbështesnin ekonominë e tregut si të domosdoshme për demokracinë apo “Evropën”, por njëkohësisht ata dëshironin që shteti të ndërhynte më shumë dhe jo më pak në shoqëri. Sipas një sondazhi të kryer nga US Information Agency në vitin 1991, ndërsa shumica dërrmuese e shqiptarëve (90%) ishin pro ekonomisë së tregut, “më shumë se gjysma e të intervistuarve u shprehën se shteti duhet të kishte më shumë përgjegjësi për të siguruar jetesën e gjithkujt”.⁴³ Për pasojë, reformat e shpejta neoliberale bënë që “shtresa të gjera sociale të ndiheshin të zhgënjyera nga politika të tilla”.⁴⁴

¹ Kjo shpjegon gjithashtu nivelet e larta të individualizimit që shumë autorë perceptonin pas rënies së komunizmit në Shqipëri, shiko për shembull Shqipëria ç’ mund të jetë nga Ardian Klosi, (Tirana: Botime Përpjekja), 1997, sidomos faqet 7–10. Nga njëra anë e tashmja post-komuniste u artikulua si e kundërta e të kaluarës kolektivistë komuniste, që këtu buronte dhe ndjenja anti-kolektivistë. Nga ana tjetër tërheqja e shtetit nga shoqëria do të thoshte që grupet sociale apo kolektivitetet tashmë nuk formësoheshin më nëpërmjet politikave sociale, çka i linte individët të atomizuar ose të identifikuar ngushtë me rrethin familjar.

Rreziku komunist ose bashkimi i shoqërisë

Sa më shumë PD-ja ia dilte të kryente reforma të thella dhe gjithëpërfshirëse, aq më shumë ajo përballej me një pakënaqësi në rritje në popullatë. Pikërisht këtu fillon diskursi antikomunist. Duke theksuar rrezikun anti-komunist, ky diskurs zbeh ndarje të tjera sociale, që rrezikonin jo vetëm shoqërinë në tërësi, por edhe elektoratin e PD-së në veçanti. Anti-komunizmi shërbeu si një shënjes bosh përkundër të cilit PD-ja artikulonte “popullin. “Shënjes të tjerë bosh, si “Evropa”, dolën në plan të dytë pasi realiteti post-komunist ishte shumë larg ëndrrës shqiptare për t’u bërë si Evropa sapo të vinte në pushtet PD-ja. Për më tepër theksimi i shtypjes, vuajtjes dhe totalitarizmit të së kaluarës komuniste zbehte vështirësitë e së tashmes demokrate. Kritikat që vinin nga opozita socialiste mbi vështirësitë e reformave cilësoheshin nga qeveria e PD-së si synim i “një opozite monstruoze që mendon si e si të kthejë me çdo kusht diktaturën komuniste, kooperativat, radhët e gjata të bukës e kështu me radhë”.⁴⁵ PD-ja besonte sinqerisht se opozita socialiste po manipulonte elektoratin. “Sipas saj, vështirësitë ekonomike dhe sociale të tranzicionit nuk ishin pasojë e politikave të gabuara, por ishte kosto e pashmangshme e reformave të post-komunizmit”.⁴⁶ Në këtë aspekt PD-ja mbështetej edhe tek vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe institucioneve ekonomike si Banka Botërore, që shprehte “admirim për rezultatet ‘e mrekullueshme’ të terapisë së shokut dhe politikave të liberalizimit në Shqipëri”.⁴⁷ Përballë një mrekullie që po e shpërbënte shoqërinë, Partia Demokratike filloi të theksonte rrezikun komunist që simbolizohej nga opozita. Pikërisht për këtë arsye disa ekonomistë vunë re se që nga viti 1993, vit në të cilin shumica e reformave liberalizuese ishin kryer, “sjellja e qeverisë tregon se atë nuk e shqetësojnë grevat dhe protestat ekonomike, por kundërshtarët politikë”.⁴⁸ Përkundrazi, pikërisht sepse qeveria ishte e shqetësuar nga këto antagonizma, ajo theksonte rrezikun anti-komunist për t’i tejkaluar ato.

Sa më shumë rritej pakënaqësia me qeverisjen e PD-së, çka reflektohej në rënien e mbështetjes së saj elektorale, aq më shumë ajo theksonte rrezikun e komunistëve të rinj (apo neokomunistëve, siç e quante ajo opozitën socialiste), të cilët “verbimi dhe histeria pas humbjes së pushtetit po i bën më të këqij se paraardhësit e tyre”.⁴⁹ Pas zgjedhjeve lokale të vitit 1992, ku vota pro PD-së ra ndjeshëm, arrestohet lideri i opozitës socialiste, Fatos Nano, dhe në 1993-shin dënohet me 12 vjet burg për korrupsion. Midis viteve 1993 dhe 1994 lideri i fundit komunist Ramiz Alia dhe nëntë anëtarë të tjerë të nomenklaturës komuniste arrestohen dhe dënohen për korrupsion dhe abuzim me detyrën. Dënimet e tyre u reduktuan si pasojë e moshës së thyer dhe shëndetit të keq, derisa u liruan në qershor të 1995-ës. Por pasi PD-ja humb referendumin për kushtetutën në vitin 1994 dhe teksa zgjedhjet e 1996-ës afroheshin, fushata anti-komuniste merr një vull të ri. Në qershor 1995 *Tribuna Demokratike* boton “listat e vdekjes”, që supozohej të ishin hartuar nga autoritetet komuniste për të likuiduar pa gjyq kundërshtarët e regjimit komunist.⁵⁰ Tashmë komunizmi ishte sinonim me genocidin.

Për pasojë, në vjeshtën e vitit 1995 miratohet një ligj kundër genocidit gjatë komunizmit, që “përfshinte nga pjesëmarrja në zgjedhje deri në vitin 2002 këdo që kish pozicion drejtues para marsit 1991”.⁵¹ Në fund të vitit 1995 dhe në fillim të 1996-ës, Ramiz Alia dhe disa ish-zyrtarë të lartë komunistë arrestohen përsëri, por tashmë ata akuzohen për krime kundër njerëzimit dhe dënohen me shumë vite burg.⁵² Ndonëse është e qartë që veprime të tilla bëheshin për të mbajtur PD-në në pushtet, ato ishin pasojë e diskurrit anti-komunist dhe mund të bëheshin vetëm brenda kontekstit të prodhuar nga ky diskurs që e portretizonte opozitën si rrezik ndaj kombit dhe demokracisë. Një nga titujt kryesorë tipikë të *Rilindjes Demokratike* para zgjedhjeve lokale të 1992-shit deklaronte me gërma të mëdha: “Alternativa e Partisë Socialiste – SHKATERRIMI I PUSHTETIT DEMOKRATIK”.⁵³ Ndërsa ambicia e liderit të opozitës për të ardhur në pushtet përshkruhej si një skemë “thellësisht antikombëtare”.⁵⁴

Si përfundim, Partia Demokratike nuk mund të sendërtonte “popullin” duke artikuluar identitete sociale pozitive (d.m.th. përmbajtësore) apo duke përdorur universin ideologjik të neoliberalizmit. Me rënien e komunizmit dhe si pasojë e reformave drastike neoliberale grupe

të tëra sociale u zhdukën, u tëhujësuan ose u sendërtuan në kundërshtim me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, neoliberalizmi duke e vënë theksin tek tërheqja e shtetit nga shoqëria, e bënte të pamundur formësimin e grupimeve sociale nëpërmjet politikave shtetërore. Për pasojë PD-ja e sendërtoi “popullin” përkundër rrezikut komunist që trupëzohej nga opozita. Kjo e bëri akoma më të vështirë për PD-në të artikulonte identitete specifike sociale, si fermerët, punëtorët apo intelektualët, pasi këto humbnin në kategorinë “popull”. Ky është rrethi vicioz brenda të cilit zhvillohet diskursi anti-komunist i PD-së deri në vetëshkatërrim. Sa më pak është e aftë të përfaqësojë dhe sendërtojë grupe specifike sociale apo ta sendërtojë “popullin” nëpërmjet një rendi ideologjik, aq më shumë PD-ja e artikulon “popullin” apo kombin në përgjithësi në raport me kërcënimin anti-komunist.

Në këtë pikë është e kuptueshme tendenca e shumë analistëve apo politologëve për ta shpjeguar sjelljen e PD-së si produkt i trashëgimisë komuniste.⁵⁵ Përpyekja për të përfaqësuar kombin apo shoqërinë në tërësi dhe persekutimi i opozitës e bënin PD-në në shumë aspekte të ngjashme me Partinë e Punës. Për më tepër diskursin e saj PD-ja e ngriti pjesërisht mbi një fjalor dhe univers simbolesh të trashëguara nga socializmi. Megjithatë, “ato që mund të duket si “rikthim” i praktikave socialiste janë diçka krejt tjetër; reagime të drejtpërdrejta ndaj nismave të reja të tregut, që prodhohen prej tyre, më shumë sesa mbetjet e një mentaliteti të vjetër”.⁵⁶ Natyrisht këto reagime të kujtojnë të kaluarën socialiste, por kjo ndodh sepse njerëzit përdorin universin diskursiv që njohin.⁵⁷ Me fjalë të tjera, ndonëse sjellja e PD-së krijonte reminishencat e të kaluarës komuniste, ajo ishte produkt i reagimit të saj ndaj kushteve të reja politiko-ekonomiko-sociale, më shumë sesa i trashëgimisë komuniste. Ta shpjegosh këtë sjellje thjesht me paradigmen e “mentalitetit komunist” do të thotë të injorosh dinamikën politike së cilës ajo i përgjigjej. Do të thotë të injorosh edhe ato momente ku liderët me mentalitet apo edhe bindje komuniste janë sjellë në mënyrë mjaft demokratike dhe pluraliste.

Kriza e 1997-ës: Rënia e piramidave dhe e anti-komunizmit

Pas rënies së skemave piramidale në janar 1997, Shqipëria përfshihet nga një valë protestash, që filluan në jug dhe u përhapën në të gjithë vendin. Situata shumë shpejt përfundoi në anarki, teksa turmat u armatosën pasi sulmuan depot e municioneve të ushtrisë, ndërsa kjo e fundit dezertoi ose u shpërbë përballë turmave të egërsuara. Kriza shqiptare e 1997-ës ishte e papritur për komunitetin ndërkombëtar. Në rrethet neoliberale Shqipëria ishte një “histori suksesi”. Shqipëria “përjetoj rritje ekonomike me ritmet e “Azisë Lindore” për katër vite. Promovuesit e *terapisë së shokut* si receta më e mirë për të kaluar tek ekonomia e tregut mund të merrnin si shembull Shqipërinë”.⁵⁷ Paradoksi shqiptar për ekonomistët ishte se “populli shqiptar që i ishte nënshtruar me durim tronditjes dhe fragmentimit të një liberalizimi tejet të shpejtë, u ngrit me zemërim dhe përkohësisht e çmontoi shtetin e vet, gjatë një buri të ekonomisë reale.”⁵⁸

⁵⁵ Kjo nuk do të thotë se kultura apo institucionet politike nuk janë të rëndësishëm. Disa autorë kanë argumentuar bindshëm se nivelet e larta të konfliktit politik në Shqipërinë post-komuniste mund të shpjegohen si pasojë e natyrës kryesisht mazhoritare të sistemit elektoral, shiko p.sh. Shumica që na mund, nga Henri Çili, (Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare). Sikurse përcaktohet edhe nga ‘ligji’ i Duverger një sistem i tillë favorizon një skenë politike bi-polare, çka mundëson diskursin që shohim në skenën politike shqiptare midis ‘ne’ dhe ‘ata’, dhe përpjekjen e partive politike për të përfaqësuar shoqërinë në përgjithësi. Një sistem i pastër proporcional nga ana tjetër mund të prodhonte parti që synojnë të përfaqësojnë grupe më të ngushta në shoqëri. Megjithatë, sistemi elektoral nuk mund të konsiderohet si shkaku i diskursit anti-komunist, ndonëse mund të ketë kontribuar në ash-përsinë e këtij diskursi. Fokusimi thjesht tek sistemi elektoral do injoronte realitetin kompleks dhe shumësinë e antagonistëve që u çliruan me rënien e komunizmit. Edhe sikur diskursi anti-komunist (‘ne’ dhe ‘ata’) të ishte tërësisht pasojë e sistemit elektoral kryesisht mazhoritar, fokusimi tek sistemi elektoral nuk na ndihmon për të kuptuar përmbajtjen dhe dinamikën e këtij diskursi. Prandaj është me më interes të shohim se si ‘shkaqet e thella’ të anti-komunizmit sendërtohen tek sipërfaqja e cekët e diskursit.

Për të kuptuar pikëpyetjen shqiptare është e rëndësishme të kuptojmë se tronditja dhe fragmentizimi që solli liberalizimi i shpejtë u menaxhuan politikisht nëpërmjet diskursit anti-komunist. Pjesërisht kjo trondite u amortizua nga remitancat e emigracionit që në 1994-1995 përbënte 20 për qind të PPB-së.⁵⁹ Burime të tjera informale si trafiket apo kontrabanda e naftës me ish-Jugosllavinë ishin gjithashtu të rëndësishme. Megjithatë, në vitin 1996 firmat piramidale me interesat e larta që ofronin u bënë një burim i rëndësishëm të ardhurash dhe shprese. Më në fund dukej se ekonomia demokratike e tregut ish bërë realitet, kushdo mund të bëhej i pasur. Nuk është rastësi që njëra nga firmat piramidale më popullore quhej Demokracia Popullore. Ethet për të futur para në këto skema ishin si sëmundje ngjitëse, veçanërisht tek një popullatë që përpiqej të mbijetonte një tranzicion të vështirë. “Ideja se mund të humbje duke marrë pjesë ishte më pak torturuese se ideja që mund të humbje duke mos marrë pjesë”.⁶⁰

Me rënien e skemave piramidale protestat dhe dhuna filloi të shpërndahej në të gjithë vendin. Por ky shpërthim antagonizmesh nuk ishte thjesht një reagim ndaj humbjes së parave në firmat piramidale. “Në fakt, *laissez faire* i qeverisë, korrupsioni dhe injorimi i parimeve demokratike kishin akumuluar zemërimin publik për shumë më tepër kohë sesa jetëgjatësia e këtyre skemave”.⁶¹ Problemi ishte se rënia e piramidave nxiti një zemëratë që nuk mund të menaxhohej politikisht nga PD-ja, e cila ishte e bllokuar në diskurin e saj anti-komunist. Në sytë e publikut qeverisja e PD-së njehsoj me skemat piramidale. Përveç anti-komunizmit, parulla e saj elektorale për zgjedhjet parlamentare të 1996-ës ishte: “Me ne fitojnë të gjithë”, çka në mënyrë implicite i referohej edhe interesave të larta nga ku qytetarët fitonin shumë para. Prandaj rënia e firmave piramidale shënoi edhe zbehjen e diskurit anti-komunist dhe për pasojë çlirimin e antagonizmave që kontrolloheshin nëpërmjet këtij diskuri.ⁱⁱⁱ Për këtë arsye reagimi i dhunshëm ndaj kolapsit të firmave piramidale kaloi të gjitha caqet e imagjinatës së ekonomistëve, të cilët pyesnin të çuditur: “përse një reagim kaq destruktiv?”⁶²

Ndërkohë, një zgjidhje politike bëhej gjithnjë e më e vështirë teksa Partia Demokratike iu kthye diskurit të saj anti-komunist për të menaxhuar proliferimin e antagonizmave që shkaktoi rënia e firmave piramidale. PD-ja filloi të akuzonte “frontin e kuq” si nxitës të trazirave në bashkëpunim me shërbimet e huaja sekrete për të përmbysur demokracinë.⁶³ Nga ana tjetër, opozita tejet e inatosur me PD-në për masakrën elektorale të 1996-ës, me shumë dëshirë e kanalizoi zemëratën popullore kundër presidentit Berisha, i cili shumë shpejt u bë simboli i humbjes dhe vjedhjes së parave të popullit dhe “e keqja e kombit”.⁶⁴ Më 30 janar 1997 forca të ndryshme opozitare u bashkuan në një koalicion të gjerë Forumi për Demokraci, që “bashkoi aleatë të çuditshëm si socialistët dhe Shoqatën e ish-të Persekutuarve Politikë dhe Partinë e Djathtë Demokratike”.⁶⁵ Këto grupe kishin pak ose aspak gjëra të përbashkëta përtej “rrezikut Berisha”.

Pasi vendi u përfshi nga anarkia dhe pothuajse tërësisht jashtë kontrollit të qeverisë, në mars 1997 u krijua Qeveria e Pajtimit Kombëtar me pjesëmarrjen e të dy kampeve politike. Synimi i saj kryesor përtej stabilizimit të situatës ishte organizmi i zgjedhjeve të parakohshme që u mbajtën në qershor 1997. Këto zgjedhje u fituan nga Partia Socialiste me 52.7 % të votës, ndërsa PD-ja mori vetëm 25.8%.⁶⁶ Koalicioni qeverisës përballëj me një vend të rrënuar. Në opozitë ai mbahej i bashkuar përballë rrezikut “Berisha”, por pasi ky rrezik u margjinalizua përkohësisht koalicioni filloi të humbiste unitetin. Dhe sa më shumë koalicioni qeverisës kalonte në krizë aq më shumë demonizohej dhe sulmohej Berisha si “e keqja më e madhe e Shqipërisë,

ⁱⁱⁱ Në një histori tejet tërheqëse të ngjarjeve të 1997-ës në Tiranë (“Uncivil War (Lufta jovicile)”, Tirana: Dita, 1998, pp 18-19), Preç Zogaj tregon historinë e fqinjët të tij, që nuk kish humbur para tek firmat piramidale por megjithatë iu bashkua turmave që plaçkitën depot e armëve. Pasi e armatosi veten me një mitraloz të rëndë, municione dhe helmetë ai filloi ti gjuante armikut imagjinar nga ballkoni i pallatit ku banonte. Dikur ai kish qenë oficer në divizionin e mitralierëve në ushtrinë shqiptare, divizion që ishte shkruirë në kuadrin e reformës, çka e kish transformuar atë në murator.

Ballkanit dhe rajonit”.⁶⁷ Kjo situatë e polarizuar precipiton lehtësisht në krizën e 1998 – ë pas vrasjes së Azem Hajdarit.

Socialistët: Nga Socializmi, drejt Evropës, tek korrupsioni

Partia Socialiste qëndroi në pushtet për mëse tetë vjet, 1997–2005. Aspekti kyç që duhet theksuar për të kuptuar zhvillimin e krizës së përfaqësimit gjatë qeverisjes socialiste është humbja totale e identitetit të majtë nga Partia Socialiste me të ardhur në pushtet në 1997. Në opozitë Partia Socialiste ruajti një identitet deri diku qartësisht të majtë, duke kërkuar “një ekonomi tregu me një dimension social... ku shtresat sociale do të gëzojnë mbrojtjen e nevojshme sociale për mos t’u ndjerë të marginalizuar dhe të braktisur nga shoqëria”.⁶⁸ Përsa i përket kategorive sociale Partia Socialiste synonte të përfaqësonte “shtresat në nevojë, punëtorët, fermerët, rininë, intelektualët, e vetëdijshme se nuk mund të përfaqësojë të gjithë shoqërinë”.⁶⁹ Ajo u pozicionua “kundër reformave liberalizuese në mënyrën që ato janë ndërmarrë nga Partia Demokratike”.⁷⁰ Socialistët në opozitë ishin kundër privatizimit të shpejtë dhe terapisë së shokut, të cilat sipas tyre krijuan nivele të larta papunësie. Ata ishin kundër privatizimit të pronës publike me ankande në favor të kapitalit të huaj, pasi kërkonin një demokraci ekonomike ku çdokush të bëhej pronar.⁷¹ Gazeta e PS-së *Zëri i Popullit* e cilësonte privatizimin e shpejtë të ndërmarrë nga Partia Demokratike me kryetituj të tipit: “Privatizimi, një grabitje e madhe”.⁷²

Megjithatë, me të ardhur në pushtet në 1997-ën, Partia Socialiste dhe aleatët e saj vazhduan dhe madje thelluan reformat neoliberalë që kishin kritikuar në opozitë. Nën udhëheqjen e institucioneve ekonomike ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore, Partia Socialiste vazhdoi të hap tregun shqiptar ndaj mallrave të huaja, tërhoqi shtetin nga shumë aspekte të jetës ekonomike dhe sociale, dhe “privatizoi ndërmarrjet shtetërore me ankande në favor të kapitalit të huaj”.⁷³ Në programin e Qeverisë Socialiste të 2002-shit prioriteti i reformës ekonomike ishte “përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i klimës që zgjeron ndërmarrjet private”.⁷⁴ Ndërsa për sektorin publik synohej “ristrukturimi, komercializimi dhe privatizimi i shërbimeve dhe aseteve publike”.⁷⁵ Që në vitin 1999 në aspektin ideologjik u bë e qartë që e djathta në opozitë, PD-ja, dhe e majta në pushtet, PS-ja, ndryshonin pak ose aspak. Jo rastësisht një editorial i 1999-ës në gazetën *Shekulli* titullohej “Majtas, djathtas apo bashkë?”⁷⁶ Por nuk ishte thjesht një çështje ideologjike, por edhe përfaqësimi social. “Tashmë ne kemi përfaqësues të së majtës, që janë nga njerëzit më të pasur në këtë vend [Shqipëri] dhe nga ana tjetër, kemi djathtistë të betuar, që nuk kanë pronë ndërkohë që përdorin metoda të së majtës klasike”.⁷⁷

Pasi erdhi në pushtet, Partia Socialiste nuk mund t’i drejtohej shtresave sociale që pretendonte se përfaqësonte në fillim të viteve ’90, për të paktën dy arsye të ndërlidhura mes tyre. Së pari, në vitin 1997 grupet sociale që PS-ja synonte të përfaqësonte, si klasa punëtore apo të paprivileguarit, ose ishin zhdukur ose ishin transformuar duke u afruar pranë PD-së në opozitë.^{iv} Elektorati i PS-së bazohej tek jugu me mirëqenie relativisht të lartë në raport me veriuin e varfër. Për më tepër, shumë anëtarë të elitës socialiste vinin nga shtresat e privileguara të regjimit komunist, prandaj ishin të edukuar mirë, njohës të gjuhëve të huaja dhe në përgjithësi më të aftë të mbijetonin në një ekonomi tregu. Pa përmendur faktin që klasa e re e biznesit shpesh përbëhej nga ish-drejtorë ndërmarrjesh, “të cilët kishin përfituar nga politikat e liberalizimit të viteve ‘90 – ‘91 për të filluar biznese private duke shfrytëzuar ndërmarrjet që ata drejtonin”.⁷⁸ Në fakt, shumë nga bizneset kryesore jo vetëm ishin mbështetës të Partisë Socialiste, por edhe të përfaqësuar në kabinetet socialiste. Prandaj nuk është çudi që një ministër socialist i

^{iv} Reformat e shpejta neoliberalë e kishin fshirë me kohë klasën punëtore si kategori sociale, një pjesë ishin kthyer në emigrantë, pjesa tjetër në biznese të vogla ose të papunë. Ndërsa shtresat në nevojë ishin kryesisht ato që lëviznin nga zonat rurale në periferi të zonave urbane, që kryesisht vinin nga veriu anti-komunist dhe ishin më shumë simpatizantë të PD-së sesa PS-së.

ekonomisë krenohej me faktin që ministria e tij “dinte të ishte avokate e biznesit në qeveri.”⁷⁹

Së dyti, doktrina neoliberales ishte jo vetëm doktrina sunduese, por edhe u përqaftua me zell nga socialistët, të cilët më padurim kërkonin të distancoheshin nga e kaluara e tyre komuniste teksa synonin edhe mbështetje ndërkombëtare duke punuar ngushtë me Bankën Botërore dhe FMN-në.⁸⁰ Natyrisht PS-ja duhet ta fshihte humbjen e identitetit të saj të majtë. Rrjedhimisht, në artikullimin e politikave qeverisëse PS-ja prodhoi një diskurs apolitik që theksonte aspektin teknik të reformave për instalimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut dhe për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Theksi ishte tek ato që Fatos Nano i quante “reformat standarde”. Në rolin e kryeministrit dhe kryetarit të PS-së, në vitin 2003 ai argumentonte se nuk duhet “humbur kohë dhe energji me diskutime të doktrinave partiake apo në konflikte përfaqësimi. Ne nuk na lejohet të shpikim zgjidhje specifike kombëtare për reformat standarde të integrimit në BE dhe NATO”.⁸¹ Edhe në këtë rast “populli” sendërtohej në raport me të ardhmen e tij evropiane më shumë sesa mbi shtresa të caktuara sociale, apo në kuadrin e ndonjë universi ideologjik.

Drejt Evropës: Udhëtimi i pafund

Formësimi i “popullit” si një e tërë në raport me të ardhmen evropiane reflektonte edhe dinamikën e integrimit në BE që pas krizave të viteve ‘97-‘98 u bë konteksti parësor në kuadrin e të cilit Shqipëria presupozohej të demokratizohej. Deri diku kjo nuk ishte ndonjë risi pasi politikanët shqiptarë “që në fillim të ‘90-ës predikonin “kthimin në Evropë” si një mjet kundër regjimit komunist”.⁸² Megjithatë, në vitin 2000 BE-ja hartoi një plan të quajtur *The Stabilization and Association Process* (SAP), që përcaktonte kushtet specifike që Shqipëria duhej të përmbushte për t’u futur në BE. Kjo ishte paradigma e kushtëzimit (conditionality paradigm), sipas së cilës Shqipëria do të demokratizohej duke përmbushur kushtet për anëtarësim në BE; një proces në të cilin “BE-ja paraqit një listë prioritetesh që duhen përmbushur gjatë një viti ose gjatë një periudhe më të gjatë kohore”.⁸³ Në skenën politike shqiptare raportet, kritikën dhe vlerësimet e BE-së “u bënë epiqendra e debatit dhe diskutimit mbi arritjet, sfidat dhe vendimet e së ardhmes”.⁸⁴ Në thelb kushtet që u parashtruan nga Brukseli përqendroheshin në fusha si “parandalimi i krimit të organizuar... zbatimi i ligjit; lufta kundër korrupsionit; dialogu mes forcave politike; zbatimet e rekomandimeve të OSBE-së për reformën zgjedhore; zhvillimi shoqërisë civile”.⁸⁵

Pradigma e kushtëzimit u fokusua tek teknologjia e demokratizimit, që nuk ishte e majtë apo djathtë, por e drejtë apo e gabuar, të paktën sipas qeverive socialiste. Në cilësinë e kryeministrit, Nano në një leksion në lidhje me integrimin në BE deklaronte se “nuk duhet të humbasim kohë me debate doktrinale apo ideologjish”.⁸⁶ Në fund të fundit, gjithmonë sipas Nanos, “edhe modelet e institucioneve legjislativë, procedurat për administrimin dhe organizimin e tregut, bankave, kompanive të sigurimit... janë modele standarde”.⁸⁷ Çështja ishte thjesht tek implementimi. Natyrisht këto modele standarde kishin koston e tyre, por kjo ishte e paevitueshme nëse Shqipëria do të bëhej “po aq e begatë dhe e jetueshme sa Evropa moderne”.⁸⁸ Ishte përgjegjësi e prodhuesve shqiptarë që të përfitonin nga integrimi evropian. “Evropa ofron hapësira... por nëse bizneset shqiptare nuk i kuptojnë tregjet evropiane, preferencat dhe kapriçot e konsumatorëve evropianë, ekziston rreziku që hapësira për produktet tona të jetë minimale”.⁸⁹

Diskuri socialist e artikuloi shoqërinë shqiptare si një të tërë në raport me të ardhmen e saj evropiane më shumë sesa duke u nisur nga shtresa apo grupime të caktuara brenda saj. Kategori të tilla si fermerët, rinia, intelektualët dhe bizneset u artikuluan thjesht si momente në kuadrin e një shoqërie të ardhshme evropiane, më shumë sesa piketat mbi të cilat kjo shoqëri do të ngrihej. Për pasojë, interesat e tyre të veçanta iu nënshtruan emergjencave të integrimit evropian. Kjo shpjegon përse qeveritë socialiste nënshkruanin me shumë zell Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me fqinjët në kuadrin e integrimit evropian, edhe pse këto marrëveshje dëmtonin

dukshëm prodhuesit dhe fermerët lokalë. Për disa kërkues të huaj ishte “befasuese që vetëm pas përfundimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Maqedoninë biznesmenët shqiptarë filluan të kuptojnë që ata nuk mund të konkurronin me produktet maqedonase. E si do arrijnë të konkurrojnë me prodhuesit evropianë?”⁹⁰ Këtu nuk ka asgjë befasuese, po të kemi parasysh se vetë prodhuesit shqiptarë artikuloleshin në raport me të ardhmen evropiane më shumë sesa duke u nisur nga karakteristika apo interesa konkrete të këtij grupimi. Prandaj marrëveshjet e tregtisë së lirë propagandoheshin si suksese të mëdha nga qeveria socialiste. Ato ishin hapa që afronin Shqipërinë me Evropën dhe për pasojë në dobi të çdo grupimi social, duke përfshirë edhe prodhuesit lokalë. Grupimet sociale kuptoheshin në raport me të ardhmen evropiane dhe jo anasjelltas.

Kjo nuk do të thotë se qeveria nuk ishte e ndërgjegjshme mbi kostot që kishte liberalizimi i tregtisë mbi grupe të ndryshme shoqërore. Edhe në vitin 2005 kryeministri Nano deklaronte se eksportet shqiptare “nuk janë as 1/5 e importeve dhe për prodhimin bujqësor ky raport është 1/10, që do të thotë se përfitimet nga hapja dhe zgjerimi i tregut kanë qenë të ngadalta”.⁹¹ Megjithatë, integrimi në BE shikohej si një proces nga i cili përfitonte shoqëria në përgjithësi më shumë sesa grupe të veçanta brenda saj. Sipas kryeministrit Nano, për shqiptarët integrimi në BE do të thotë “akses pa diskriminim në tregun e punës [të BE]... akses pa diskriminim në sistemin evropian të edukimit, në sistemin e shërbimeve evropiane, duke përfshirë shërbimet sociale dhe të shëndetit, dhe së fundi akses pa diskriminim në tregun e prodhimeve dhe shërbimeve evropiane”.⁹² Me fjalë të tjera, ato që shqiptarët nuk i gëzonin në Shqipëri, punësim, shërbime cilësore shëndetësore, edukim cilësor, do t’i gëzonin në të ardhmen nga BE-ja, sapo Shqipëria të bëhej anëtare. Jo rastësisht një sondazh në lidhje me perceptimet e grupeve të ndryshme shoqërore mbi BE-në arriti në konkluzionin që “integrimi është bërë qëllim në vetvete”.⁹³ Për sa kohë shoqëria shqiptare sendërtohej nëpërmjet të ardhmes së saj evropiane ishte e logjikshme që integrimi në BE, që simbolizonte pikërisht këtë të ardhme, do të kthehej në qëllim në vetvete.

Në praktikë progresi i Shqipërisë drejt BE-së ishte shumë i ngadaltë derisa pothuajse ndaloi tërësisht në vitin 2005. Në një deklaratë për shtyp në vitin 2003, BE-ja e paralajmëronte qeverinë shqiptare se “ritmi i ngadaltë i reformave po rrezikon negociatat për MSA-në”.⁹⁴ Në vitin 2004, BE-ja haptazi e kritikoi qeverinë shqiptare, pasi ndonëse ajo e ka shpallur prioritet integrimin në BE, “veprimet e saj nuk e reflektojnë këtë”.⁹⁵ Integrimi në BE dhe zhvillimi i Shqipërisë trajtoheshin nga BE si dy procese që ndihmonin njëri-tjetrin, ndonëse sikurse e kanë theksuar disa kërkues, vështirë se “përgatitjet për t’u anëtarësuar në Bashkimin [Evropian] janë e njëjta gjë si objektivat për zhvillim”.⁹⁶ Për pasojë, dështimi i procesit të integritit iu faturua zbatimit të keq të reformave dhe korrupsionit. Sipas BE-së, problemi ishte se shumë reforma “nuk janë zbatuar... këto përfshijnë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”.⁹⁷ Tashmë qeveria socialiste perceptohej si brenda edhe jashtë vendit si shumë e korruptuar.

Antikorrupsioni si dimension i ri i konfliktit politik

Politikat neo-liberale dhe orientimi i fuqishëm pro BE-së i Partisë Socialiste paralizoi “aksionin politik dhe propagandën e Partisë Demokratike [opozitës], rivalit të saj kryesor”.⁹⁸ Socialistët po zbatonin të njëjtat politika ekonomike që “demokratët kishin filluar kur ishin në pushtet”.⁹⁹ Ishte shumë e vështirë të gjeje ndryshime themelore në ideologji, politika ekonomike apo në politikën e jashtme mes dy partive. Kjo është një nga arsyet përse Partia Demokratike pas vitit 1998 filloi të theksonte diskursin anti-korrupsion, duke i akuzuar socialistët për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar.¹⁰⁰ Sa më pak PD-ja ndryshonte me PS-në në politika apo ideologji, aq më shumë e demonizonte kundërshtarin e saj politik si simbol të krimin dhe korrupsionit. Për opozitën pothuajse çdo problem social shikohej si pasojë e korrupsionit. Korrupsioni socialist pengonte zhvillimin e fermerëve, hapjen e vendeve të punës, përmirësimin e sistemit të edukimit, e kështu pa fund.¹⁰¹ Në këtë aspekt PD-ja mbështetej tek raportet e BE-së, epiqendra

e debatit në vend, të cilët gjatë periudhës 2001–2005 theksonin nevojën urgjente “për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe trafiket” si pengesa të integritetit të Shqipërisë në BE.¹⁰² Ashtu sikurse edhe BE-ja, PD-ja theksonte problemet në zbatim, si pasojë e korrupsionit, më shumë sesa mangësitë e reformave në parim. Pra, kritikën e PD-së nuk i drejtoheshin politikave të PS-së në vetvete, por zbatimit të korruptuar të tyre.

Në këto kushte u bë gjithnjë e më e pamundur për socialistët ta artikulonin shoqërinë shqiptare në raport me të ardhmen e saj evropiane. Në të njëjtën kohë diskursi socialist nuk mund ta artikulonte shoqërinë si një të tërë duke u nisur nga pozitiviteti (përmbajtja) i kategorive të caktuara sociale, pasi këto kategori ishin artikuluar thjesht si momente të veçanta të së ardhmes evropiane. E thënë ndryshe, kategori sociale si klasa punëtore, fermerët, apo biznesmenët e vegjël apo të mëdhenj nuk ishin artikuluar si kategori sociale në vetvete, por në kuadrin e një të ardhmeje evropiane. Për pasojë, Partia Socialiste në zgjedhjet e vitit 2005 u përqendrua tek lideri i opozitës, Sali Berisha, dhe kriza e 1997-ës, si kërcënim përballë të cilit ajo mund të artikulonte shoqërinë dhe të mobilizonte bazën e saj elektorale. Jo rastësisht moto e saj elektorale ishte “Mburo të ardhmen”. Spotet televizive të PS-së kombinonin imazhe nga varrimi i viktimave të 1997-ës me pjesë nga një fjalim i Berishës president teksa thoshte: “Ky është vetëm fillimi”. Të gjitha investimet e bëra gjatë qeverisjes socialiste tregoheshin përbri godinave të djegura nga 1997-a. Kështu i gjithë investimi elektorale i PS-së në fushatën e 2005-ës “bazohet në atë që mund të përmblihet tek “rreziku Berisha””.¹⁰³

Këtu përsëri shohim një fenomen që e hasëm edhe më parë, gjatë qeverisjes së parë të PD-së, 1992-1996. Në pamundësi për të ndërtuar një vizion të shoqërisë që nisët nga grupe apo shtresa të caktuara shoqërore, apo duke u bazuar tek një univers ideologjik, partitë politike shqiptare e ndërtojnë vizionin e shoqërisë në raport me një kërcënim, që simbolizohet nga partia kundërshtarë. Pikërisht përballë këtij kërcënimi ato artikulojnë dhe përfaqësojnë “popullin”. Kundërshtari politik është negativiteti (ose mungesa) që nuk e lejon shoqërinë të bëhet ashtu siç e imagjinojnë vetveten. Për këtë arsye, kërkues të tjerë që kanë analizuar diskursin e dy partive politike kanë arritur në konkluzionin se në këtë diskur “dy antagonistët [socialistët dhe demokratët] synojnë asgjësimin total të njëri-tjetrit”.¹⁰⁴ Pikërisht këtu qëndrojnë nivelet e larta të polarizimit, konfliktualitetit dhe përjashtimit në politikën shqiptare, më shumë sesa tek esenca e një kulture anti-demokratike apo tek psikologjia e politikanëve të veçantë.^v

Shfaqja e “politikës” dhe e “anti-politikës”

Menjëherë pas krizës së 1997-ës, një poet i kthyer në politikan, me mprehtësi vërente se: “Politika tek ne krijon palë aty ku nuk ka palë, krijon konflikt edhe kur nuk ka konflikt. Politika jonë nuk rri dot pa përplasje. Pala më e madhe është kombi. Pjesa tjetër ka dy mundësi; të largohet ose të bashkohet me kombin, që do të thotë të adaptohet”.¹⁰⁵ Konflikti i stërzgatur politik, që dy herë degjeneroi në dhunë dhe anarki, prodhoi një audiencë që filloi të dilte jashtë tij dhe njëkohësisht të ndihej e viktimizuar nga ky konflikt. Në sondazhin e Sigurisë Njerëzore (Human Security Survey) të 2003-shit, 67% e të intervistuarve mendonin se Shqipëria vuante nga konflikti politik.¹⁰⁶ I njëjti opinion konfirmohet në një tjetër sondazh, dy vjet më vonë, në vitin 2005, ku të intervistuarit për nga rëndësia e “renditën mungesën e stabilitetit politik (cilësuar si “zënka mes politikanëve”)... në të njëjtin nivel me mungesën e ujit dhe të energjisë elektrike”.¹⁰⁷ Partitë politike perceptohen gjithnjë e më tepër nga qytetarët se më shumë merren

^v Shpjegime të tilla nuk arrijnë të shpjegojnë lehtësinë me të cilën politikanë që duket se janë armiq të betuar shpesh bashkëpunojnë. Në vitin 2002, Nano dhe Berisha ranë dakord të bashkëpunojnë në lidhje me disa reforma politike kyçe. Një klimë e ngrohtë, miqësie midis dy liderëve hutoi dhe acaroi shumë analistë politikë, që mendonin se konflikti mes këtyre dy personave ishte edhe burimi i konfliktualitetit në Shqipëri. Natyrisht pas një periudhe të shkurtër paqeje, dy liderët filluan ta demonizojnë njëri-tjetrin si kërcënim më i madh për shoqërinë.

me sherret mes tyre sesa i shërbejnë interesit publik. Për këtë arsye, në Sondazhin e Sigurisë Njerëzore (Human Security Survey) 2003, 69.9% e të intervistuarve mendonin se partitë politike i shërbenin pak ose aspak interesit publik.¹⁰⁸ Një tjetër sondazh i kryer që në vitin 2000 dhe që pati mbulimin mediatik të gazetës kryesore të kohës, *Shekulli*, arriti në “konkluzionin e trishtueshëm se politika ka pak lidhje me popullin. Madje më shumë se 60% e qytetarëve mendojnë se nuk janë të përfaqësuar nga lidhshipi dhe partitë politike”.¹⁰⁹ Ajo që na intereson në lidhje me këtë sondazh, më shumë sesa besueshmëria statistikore, është se ky sondazh i titulluar “Imazhi i Politikës në Universitetet Shqiptare” ishte “i pari i këtij lloji [në Shqipëri]”.¹¹⁰ Kështu, pas vitit 2000 ndërtohen pyetje dhe sondazhe të veçanta për të hulumtuar “politikën”. Politika, që përfshin partitë politike, politikanët dhe procesin politik në përgjithësi, bëhet objekt i vlefshëm analize, duke fituar kështu një pozitivitet (përmbajtje) të caktuar.

Pas vitit 2000 në Shqipëri politika gjithnjë e më tepër konceptohet si një objekt më vete, si një sferë e aktiviteti e ndarë nga sfera të tjera. Kjo u shfaq fillimisht me daljen e shtypit të pavarur, kryesisht gazetave. Nëse në vitet e para të tranzicionit gazetat partiake, si *Rilindja Demokratike*, ishin më të lexuarat, në vitin 1994 gazeta e pavarur *Koha Jonë* ishte bërë gazeta më e madhe në vend për nga tirazhi. Pas vitit 2000 u krijuan edhe një sërë televizionesh private, shpesh të financuara nga biznese, që pretendonin se ishin të pavarur nga politika. Këto kanale informacioni e përcaktuan politikën si një sferë të veçantë aktiviteti, një proces që kish filluar qysh në 1 shkurt të vitit 1995, kur gazeta më e madhe, *Koha Jonë*, për herë të parë krijoi rubrikën “Politikë”. Në vitin 2000, çdo gazetë serioze kishte një rubrikë të tillë, ku mbulohehin zhvillimet politike.

Lindja e politikës si një sferë e veçantë aktiviteti prodhon edhe analistin apo komentatorin politik, i cili që nga viti 2000 “pothuaj ka zëvendësuar rolin që dikur rezervohej për intelektualët”.¹¹¹ Ndryshe nga intelektual i publik, analisti nuk është i angazhuar politikisht dhe as nuk përfaqëson ndonjë ideologji të caktuar. Pavarësia e tij (pasi pothuajse gjithmonë analisti është mashkull) nuk garantohet në raport me ndonjë ideologji apo ideal të caktuar, si socializmi, liberalizmi, nacionalizmi, liria apo tradita, por në raport me distancën që mban ndaj partive politike. “Analistit i jepet licenca e veçantë për zhvillimin e një metadiskursi politik (që do të thotë se përmes këtij diskursi analisti pretendon të vendoset mbi politikën)”.¹¹² Tashmë që shoqëria dhe politika janë dy sfera gjithnjë e më të ndryshme, kjo e fundit i duhet deshifruar, shpjeguar dhe analizuar publikut amator nga komentatori politik. Në të njëjtën mënyrë si komentatori sportiv analizon, shpjegon dhe deshifron një ndeshje futbollit. Analisti politik është njëkohësisht edhe ekspert i politikës, por edhe përfaqësues i pazgjedhur i popullit për sa kohë ai e kritikon, demaskon apo i bën thirrje politikës në emër të popullit. Domosdoshmëria e analistit rezulton nga vetë fakti që politika dhe populli janë gjithnjë e më larg njëri-tjetrit. Një fakt, që analistët nuk reshtin së theksuari. Siç vë në dukje një nga analistët më të famshëm shqiptarë, “partia e shumicës në Shqipëri janë shqiptarët, janë ata që qëndrojnë larg nga kjo politikë, politikanë... që nuk kanë asnjë lidhje me tufën e ujërve brenda partive të mëdha”.¹¹³ Në këto kushte bëhet e nevojshme që dikush të flasë për këta shqiptarë, për t’ia bërë prezente politikës shqetësimet e “ne, shqiptarëve të tjerë” larg politikës.¹¹⁴ Pasi shqetësimet e militantëve politikë nuk kanë nevojë të artikulohej nga analisti.

Ky moment shënon një transformim të rëndësishëm të konceptit të politikës që reflekton funksionin e saj të ri si Tjetri në raport me të cilin formësohen “populli” apo “shoqëria”. Politika tashmë personifikohet me përemra si “ajo” apo “ata”, ajo është një entitet i përcaktuar qartë, që ka një ekzistencë të vetën dhe madje ndonjëherë edhe të drejta. Kështu një konstitucionalist i njohur shkruante se “rishikimi i Kushtetutës është një e drejtë e pamohueshme e politikës”.¹¹⁵ Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2003, një qytetar shkruante në rubrikën “Letra nga lexuesi”, se “politika i humbi zgjedhjet... Prandaj, politika duhet t’i vërë gishtin kokës”.¹¹⁶ Një tjetër artikull nga një profesor filozofie titullohej “Politika dhe Mendësia rreth saj”.¹¹⁷ Por ndërsa në titull politika është “ajo”, në tekst bëhet “ata”; “Politika e sotme harron se ata patën një mbështetje të fortë popullore, për hir të premtimit se do të jetonin më mirë nga regjimi i mëparshëm”.¹¹⁸

Tashmë politika ishte një hapësirë ekskluzive për partitë politike dhe politikanët, më shumë sesa një proces ku mund të përfshihej gjithkush, sikurse shikohej në fillimet e tranzicionit. Në vitin 1993, një gazetar i njohur ankohej se “tani të gjithë njerëzit merren me atë që duhet të merreshin politikanët: me politikë”.¹¹⁹ Dikur pas vitit 2000 me konsolidimin e politikës si kategori, njerëzit nuk merren më me të si në fillimet e tranzicionit.

Politika e anti-politikës

Veçanërisht nga viti 2000 (por dhe më parë) politika shikohet si vetë djalli që pengon zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë. Politika e keqe vonon integrimin e Shqipërisë në BE, nuk prodhon zhvillim dhe shkakton vuajtje në popull. Presidenti Moisiu e quajti politikën shqiptare “të ndyrë”, pasi ajo “po e lë Shqipërinë jashtë integritimit evropian”.¹²⁰ Kadare, nga ana tjetër, vëren se ai nuk di “ndonjë vend tjetër në Evropë, ku klasa politike të jetë në kundërshtim me vendin e vet dhe kundër tij”.¹²¹ Gradualisht politika dhe politikanët bëhen e keqja themelore, negativiteti total, përballë të cilit shoqëria shqiptare sendërtohet. Sikurse vëren një analist i mirënjohur në shtypin shqiptar, politikanët janë gati të bëhen “mashtrues, bastardë, prostituta, banditë, servilë, kameleonë, kllounë, idiotë, grindavecë, etj., etj”.¹²² Politika perceptohet si e korruptuar për nga vetë natyra e saj, apo sikurse thotë një tjetër gazetar i njohur: “politika ka brenda saj imoralitetin, ose siç thonë, ajo është “kurvë”.¹²³ Politika tashmë shihet si kërcënimi kryesor ndaj shoqërisë, si terrorizuese e saj; “politika ka shpërndarë terror kudo nëpër biznese, administratë dhe në gjithë shoqërinë”.¹²⁴ Kundër këtij kërcënimi shoqëria duhet të mbetet e bashkuar.^{vi}

Zhvillimi i diskursit anti-politik duhet kuptuar si rezultat i dy faktorëve të ndërlidhur, sedimentimi i identiteteve në horizontin post-komunist dhe paaftësia e partive politike të artikulojnë identitetin e tyre pozitiv (përmbajtësor). Sedimentimi është procesi nëpërmjet të cilit eliminohen gjurmët e formësimit politik të një identiteti të caktuar shoqëror. Me t’u konsoliduar horizonti simbolik post-komunist kategori si “emigranti” apo “biznesmeni” bëhen kategori të “natyrshme” sociale, ashtu si dikur “kooperativisti” apo “punëtori” dukeshin kategori të natyrshme shoqërore dhe jo të prodhuara politikisht. Por, sikurse thamë më sipër, partitë politike nuk i artikulojnë kategori të tilla, duke theksuar identitetin e tyre pozitiv por si momente të veçanta përballë një kërcënimi që simbolizohet nga partia kundërshtarë. Por sa më të paafta bëhen partitë politike për t’i artikuluar kategori të tilla përballë një rreziku të caktuar, aq më shumë këto kategori formësohen në kundërshtim me partitë politike dhe politikën në përgjithësi. Pikërisht këtu lind edhe diskursi anti-politikë. Është politika ajo që e pengon fermerin, biznesmenin apo studentin.^{vii} Është politika ajo që pengon zhvillimin dhe integrimin në Evropë të popullit shqiptar. Anti-politika është një diskurs politik *par excellence*, pasi shërben për të sendërtuar “popullin”.

Për këtë arsye, ky diskurs sot është përvetësuar nga opozita socialiste. Lideri i saj, Rama, u fut në politikë me një diskurs të qartë anti-politik, kundër partive politike dhe klasës politike. Por, pasi u bë kryetar i Partisë Socialiste në vitin 2006, pra një politikan tipik, Rama, e ndryshon ligjërimin e tij nga një sulm ndaj politikës në përgjithësi, tek një sulm ndaj politikës

^{vi} Natyrisht anti-politika nuk është diskursi i vetëm në skenën publike. Diskurse të tjera si anti-korrupsioni apo anti-komunizmi vazhdojnë të ekzistojnë. Megjithatë, gradualisht këto diskurse bëhen momente të brendshme të diskursit anti-komunist. Kështu, diskursi anti-korrupsion e ndan shoqërinë më dysh, nga njëra anë politikanët e korruptuar dhe nga ana tjetër populli viktimë. Diskursi anti-komunist e ndan shoqërinë në “ata-politikanët, pjellat e komunizmit” dhe “ne – populli viktimë”. Pra, këto diskurse transformohen në funksion të diskursit të përgjithshëm anti-politik me të cilin ndërveprojnë.

^{vii} Në një nga rubrikat kryesore të gazetës *Shekulli* pas vitit 2000, me titull “Letra nga Lexuesi” ka shumë e shumë artikuj ku lexuesit ankohen dhe shajnë politikanët për të këqijat që i kanë sjellë Shqipërisë. Shiko *Shekulli* 2001 – 2005.

së vjetër në veçanti, në emër të një politike të re. “Politika e vjetër e së kaluarës i ka bërë shumë dëme Shqipërisë dhe shqiptarëve... ka helmuar gjakun e shoqërisë shqiptare, ka ndaluar atë dhe zhvillimin e saj”.¹²⁵ Politika e re, nga ana tjetër, është gjithçka që politika e vjetër nuk është; zhvillim, transparencë, integritet në BE e kështu me radhë. “Politika e re e kthen politikën në duart e qytetarëve, vë në qendër të saj njeriun dhe nevojën e tij për më shumë liri, të drejta dhe mundësi”.¹²⁶

Pesëmbëdhjetë vite më parë, në vitin 1992, Sali Berisha, në fjalimin e tij të parë si President i Republikës para Parlamentit, deklaroi gjithashtu “dimensionin njerëzor si dimensionin themelor të politikës së re shqiptare”.¹²⁷ Ajo që kanë të përbashkët këto dy ligjërime, pavarësisht distancës prej 15 vitesh, është se të dy synojnë mobilizimin e elektoratit rreth një projekti që nuk është as i majtë dhe as i djathtë, por që përcaktohet në raport me një kërcënim; komunizmi pesëmbëdhjetë vite më parë, politika e vjetër pesëmbëdhjetë vite më vonë. Jo më kot Rama do të deklaronte se “përtej të majtës dhe të djathtës është Shqipëria”.¹²⁸ Këto projekte politike nuk ndërtohen mbi pozitivitetin e një elektorati të caktuar, çka shpjegon përdorimin e koncepteve si “njeriu” apo “dimension njerëzor” që janë të vlefshëm për çdo kategori sociale. Të dy projektet politike e ndërtojnë identitetin e elektoratit të tyre në raport me një kërcënim që simbolizohet nga kundërshtari. Në raport me këtë kërcënim ata artikulojnë “popullin”^{viii}. Teksa partitë politike ishin gjithnjë e më të paafta për të artikuluar dhe sendërtuar kategori të ndryshme sociale që filluan të sedimentoheshin në horizontin e ri post-komunist, këto kategori gjithnjë e më shumë u përcaktuan në raport me kërcënimin që përbënte politika për ekzistencën e tyre. Në këtë mënyrë sot politika është shënjeshti bosh më i rëndësishëm përkundër të cilit formësohen shoqëria dhe kategoritë sociale brenda saj.

Konkluzion

Kriza e përfaqësimit në Shqipëri nuk mund të kuptohet thjesht si paaftësia e partive politike për të përfaqësuar kategori ekzistuese sociale. Mbi të gjitha kjo krizë ka të bëjë me faktin që kategoritë sociale formësohen si momente brenda shoqërisë në përgjithësi dhe në raport me një kërcënim të caktuar. Përfaqësimi është një proces në të cilin përfaqësuesi jo vetëm e përfaqëson por edhe e formëson të përfaqësuarin.¹²⁹ Për këtë arsye, ekzistenca e kategorive të caktuara sociale duhet konsideruar si një realitet diskursiv dhe jo thjesht empirik. Në Shqipëri ka një konsensus të gjerë se mungon shtresa e mesme, dhe në fakt një kategori e tillë nuk artikullohet as politikisht, asnjë parti nuk i drejtohet një shtrese të tillë. Por kjo nuk do të thotë se ka një mungesë “objektive” të shtresës së mesme në Shqipëri, që në fund të fundit është një çështje përkufizimi. Nëse një kategori e tillë do të artikulohej politikisht, nëse grupe të ndryshme sociale do të identifikohej me këtë kategori, p.sh. nëpërmjet politikave konkrete që i drejtohen “shtresës së mesme”, atëherë natyrisht që do krijohesh një shtresë e tillë sociale me një identitet pozitiv (përmbajtësor). Kjo nuk është aspak e pamundur, po të kemi parasysh që në vende si Shqipëria, por edhe gjetkë, janë zhvilluar lëvizje apo revolucione politike në emër të një klase punëtore që nuk ekzistonte, por që u krijua më vonë. Prandaj mungesa e

^{viii} Natyrisht këtu kemi të bëjmë me një përgjithësim paksa të sforcuar, pasi PD dhe PS kanë baza të ndryshme elektorale. Nga të dyja, PD-ja është partia që ka një bazë elektorale më të paqartë dhe të paqëndrueshme përse i përket një identiteti të fortë dhe të qartë historik. PS-ja, nga ana tjetër, gëzon mbështetjen e disa grupeve të mirëpërcaktuara sociale si Veteranët e Luftës dhe familjet e tyre që identifikohej me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Megjithatë, asnjëra nga dy partitë kryesore nuk ka një bazë të qartë elektorale që bazohet tek ndarjet aktuale të tipit, fshat-qytet, biznes – punëtorë etj. Duhet theksuar se PS-ja gëzon një identitet më të qartë politik, për vetë historinë e saj. Pra, mund të themi se PS-ja ka më shumë identitet pozitiv (përmbajtësor) se PD-ja. Kjo mund të shpjegojë edhe arsyet përse diskursi i saj politik ka qenë më pak i ashpër dhe “anti” se ai i PD-së, ndonëse nuk kanë munguar edhe momentet kur PS-së i është dashur të theksojë një kërcënim të caktuar në raport me të cilin ka artikuluar shoqërinë dhe elektoratin e saj, siç ishte rasti i zgjedhjeve të 2005.

një shtrese të mesme në Shqipëri më shumë sesa një fenomen empirik duhet kuptuar si një fenomen diskursiv, që buron nga mënyra se si “populli” artikullohet në raport me një kërcënim të caktuar (komunizmi, korrupsioni, etj) çka bën që kategoritë sociale ekzistuese apo potenciale të reduktohen në momente që janë pasojë e këtij artikulimi dhe jo pikënisja e tij.

Pikërisht nga kjo mënyrë specifike e artikulimit të “popullit” burojnë disa nga handikapet themelore të politikës post-komuniste shqiptare. Në momentin që “populli” artikullohet në raport me një kërcënim që simbolizohet nga kundërshtari politik, konflikti politik bëhet tejet i ashpër dhe pa kompromis. Në mungesë të diferencave ideologjike, politika detyrimisht fokusohet në aspekte personale dhe jo ato ideore. Emri i liderit kthehet në shënjesin bosh, rreth të cilit homogjenizohet një realitet heterogjen.¹³⁰ Në pamundësi për t’u mbështetur në një univers ideologjik, çdo parti politike bashkohet rreth liderit të saj dhe kundër liderit të kundërshtarit politik. Sidomos kur politika reduktohet thjesht tek zbatimi i një projekti të dhënë drejt demokracisë apo Evropës.

Megjithatë, niveli i lartë i konfliktualitetit në Shqipëri nuk duhet parë si i pashmangshëm. Burimi i këtij konflikti, formësimi i “popullit” në raport me një kërcënim të caktuar, është vetëm një nga mënyrat e shumta se si mund të formësohet “populli”. Kjo mund të ndodhë edhe nëpërmjet shënjesve bosh “pozitivë”, siç ishte rasti i viti 1992, kur “populli” nuk artikullohej në raport me një kërcënim të caktuar sesa nëpërmjet shënjesve “pozitivë” si “Evropa” apo “Demokracia”. Natyrisht për çdo shënjes “pozitiv” ka një të kundërt, një shënjes “negativ”, se ku bie theksi varet nga kushtet historike dhe sociale që në vetvete janë realitetet diskursive. Në rastin e Shqipërisë, një nga këto kushte ishte epoka e “fundit të ideologjisë”, ideja që politikën janë mirë ose keq dhe jo majtas apo djathtas.

Shënime

¹ Ylli Popa, “Vendi Vuan nga Politika e Keqe”, Shekulli, 10 Korrik, 2000.

² Guilhot, N. (2002) “‘The Transition to the Human World of Democracy’: Notes for a History of the Concept of Transition, from the Early Marxism to 1989”, *European Journal of Social Theory*, 5:2, pp 238-39.

³ Henderson, K. and Robinson, N. (1997), *Post-Communist Politics: An Introduction*, (London: Prentice Hall). pp 270-271.

⁴ Tokes, R. (2000) “‘Transitology’: Global Dreams and Post-Communist Realities”, *Central Europe Review*, 2:10, available at <http://www.ce-review.org/00/10/tokes10.html> last accessed, April 20, 2007.

⁵ Krastev, I. (2002), “The Balkans: Democracy Without Choices” *Journal of Democracy*, 13:3, p 45.

⁶ Yanarella, Ernest, J. (1993) “Whither Hegemony?: Between Gramsci and Derrida”, in Jones, J.P. et al. (ed) *Postmodern Contentions. Epochs, Politics, Space* (New York: Guildford Press), p 86.

⁷ Brockelman, T. “The Failure of the Radical Democratic Imaginary: Zizek versus Laclau and Mouffe on Vestigial Utopia”, *Philosophy & Social Criticism*. 29:2, 2003, p 189.

⁸ Laclau, E. *Populism: What’s In A Name?*, Centre for Theoretical Studies, Online Papers, University of Essex, p 6. Available at <http://www.essex.ac.uk/centres/TheoStud/papers/Populism%20What%20in%20a%20name.doc> Accessed last on 25 March 2007.

⁹ Laclau and Mouffe (1996). *Hegemony and Socialist Strategy: Towards a Radical Democratic Politics*, (London-New York: Verso), p 153.

¹⁰ Ibid, p 153.

¹¹ Laclau, E. (1996) *Emancipation(s)*, (London-New York: Verso), p 44.

¹² Ibid, p 103.

¹³ Laclau, E. (2005) *On Populist Reason*, (London – New York: Verso), p 154.

¹⁴ Critchley, S. (1999) *Ethics Politics Subjectivity*, (London: Verso), p 149.

¹⁵ Laclau, E. (1996) *Emancipation(s)*, (London-New York: Verso), p 103.

¹⁶ Kola, P. (2003) *The Search for Greater Albania*, (London: Hurst & Company), p x.

¹⁷ Woodcock, S. (2007) *The Absence of Albanian Jokes About Socialism: Or Why Some Dictatorships Are Not Funny in Caroline Hamilton, Michelle Kelly, Elaine Minor and Will Noonan (eds.) The Politics and Aesthetics Of Refusal* Cambridge Scholars Publishing; Cambridge.

¹⁸ Sali Berisha, “Pranvera e Demokracisë Po Vjen: Mesazh drejtuar popullit shqiptar me rastin e zgjedhjeve të 31 Marsit.”, *Rilindja Demokratike*, 29 March, 1991, p 1.

- ¹⁹ Zoto, N. (2004) "The Electoral Behaviour of Albanian Voters", in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), p 91.
- ²⁰ Lubonja, F. (2004) "The Introduction of Political Pluralism in Albania", in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), p 38.
- ²¹ Lubonja, F. (2004) "Albania after Isolation: The Transformation of Public Perceptions of the West", in Hammond, A. (ed.) *The Balkans and the West: Constructing the European Other, 1945-2003*, (London: Ashgate), f 132.
- ²² Ibid, f 132.
- ²³ Zoto, N. (2004) "The Electoral Behaviour of Albanian Voters", in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), p 91.
- ²⁴ Lubonja, F. (2004) "The Introduction of Political Pluralism in Albania", in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), p 42.
- ²⁵ Neritan Ceka, "Shqipëria mes Lindjes dhe Perëndimit – demokraci e shitur", *Koha Jonë*, 8 August, 1992, p 1.
- ²⁶ Vickers, M. and Pettifer, J. (1997) *Albania: From Anarchy to a Balkan Identity*, (London: Hurst & Company), p 36.
- ²⁷ Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: WestviewPress), p 5.
- ²⁸ Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*, (Aldershot: Ashgate), pp 7 - 30.
- ²⁹ Alfons Zeneli, "Veriu nën Thundren e Jugut (The North under the South's Iron Heel)", *Koha Jone*, 11 October 1991, p 3.
- ³⁰ Bahri Beci, "Gjuha letrare shqipe dhe themelet e saj dialektike", *Albania*, November 3rd, 1995, f 5.
- ³¹ Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: WestviewPress), f 204.
- ³² World Development Report 1997, World Bank, Washington DC, p 220, cited in Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*, (Aldershot: Ashgate), f 7.
- ³³ Barjaba, K. and Leka, M. (2004) "Directory of Political Parties in Albania" in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), f 13.
- ³⁴ Fuga, A. (2004) *Shoqëria Periferike*, (Tirana: Ora), f 78.
- ³⁵ Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: WestviewPress), f 193.
- ³⁶ Trimcev, E. (2005) *Democracy, Intellectuals and the State: The Case of Albania*, (Tirana: Albanian Institute for International Studies), f 126.
- ³⁷ Fuga, A. (2004), *Shoqëria periferike*, (Tirana: Botime Ora), f 233.
- ³⁸ European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), *Transition Report*, London 1996, f 11.
- ³⁹ Albanian National Institute of Statistics (INSTAT), *Albanian Human Development Report 1996*, (Tirana: INSTAT), f 49.
- ⁴⁰ United Nations Development Program, *Human Development Report: Albania 1995*, (Tirana: UNDP), 1995, f 18.
- ⁴¹ Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: WestviewPress), p 74.
- ⁴² Waal, De, C. (2005) *Albania Today: A Portrait of Post-Communist Turbulence*, (London: I.B. TAURIS), p 5.
- ⁴³ United States Information Agency, *Albanians Speak Out on Political Issues*, (Washington, D.C.), Report M-99-91, 15 July 1991, cited in Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: West), f 72.
- ⁴⁴ Fuga, A. (2004), *Shoqëria Periferike*, (Tirana: Botime Ora), f 232.
- ⁴⁵ Zogaj, P. (1998) *Uncivil War (Luftë jocijvile)* (Tiranë: Dita), f 59.
- ⁴⁶ Fuga, A. (2004), *Shoqëria Periferike*, (Tirana: Botime Ora), f 233.
- ⁴⁷ Waal, De, C. (2005) *Albania Today: A Portrait of Post-Communist Turbulence*, (London: I.B. TAURIS), f 4.
- ⁴⁸ Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*, (Aldershot: Ashgate), f. 65.
- ⁴⁹ Eduard Selami, "Socialkomunistet lusin varfërimin: Deklaratë rreth njoftimit të "të dërguarit të posacëm" të "ZP" ", *Rilindja Demokratike*, 22 Prill 1992, p 1.
- ⁵⁰ *Tribuna Demokratike*, 16 Qershor 1995, pp 4-5
- ⁵¹ Elbasani, A. (2004) "Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms", *Southeast European Politics*, 5:1, p 35.
- ⁵² Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition*, p 180.
- ⁵³ "Alternativa e PS - SHKATERRIM I PUSHTETIT DEMOKRATIK ", *Rilindja Demokratike*, 17 September, 1992, p 1.
- ⁵⁴ "KUJDES NGA NEOKOMUNIZMI! Pjellat e diktatures nuk mund te pajtohen me demokracine", *Rilindja Demokratike*, 30 July 1992, p 1.
- ⁵⁵ Vickers, M. and Pettifer, J. (2000). *Albania: From Anarchy to a Balkan Identity*, (New York: New York University Press), p 266.
- ⁵⁶ Burawoy, M. and Verdery, K. (eds. 1999) *Uncertain Transitions: Ethnographies of Change in the Postsocialist World*, (New York: Rowman & Littlefield Publishers, Inc.), pp 1-2.
- ⁵⁷ Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*, (Aldershot:

- Ashgate), f 1.
- ⁵⁸ Ibid. f 30.
- ⁵⁹ Ibid. f 16.
- ⁶⁰ Zogaj, P. (1998) *Uncivil War (Lufte jovicile)* (Tiranë: Dita), ff 146 - 47.
- ⁶¹ Waal, De, C. (2005) *Albania Today: A Portrait of Post-Communist Turbulence*, (London: I.B. TAURIS), p 13.
- ⁶² Clunies-Ross, A. and Sudar, P. (1998) *Albania's Economy in Transition and Turmoil, 1990-1997*, (Aldershot: Ashgate), p 27.
- ⁶³ Ibid. pp 58-59.
- ⁶⁴ Zoto, N. (2004) "The Electoral Behaviour of Albanian Voters" , in Barjaba, K. (ed.) *Albania's Democratic Elections: Analysis, Documents and Data*, (Berlin: Edition Sigma), p. 92.
- ⁶⁵ Biberaj, E. (1998) *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, (Colorado: WestviewPress), p 320.
- ⁶⁶ Ibid. p 91.
- ⁶⁷ Zogaj, P. (2001), *Paradhoma e nje presidenti*, (Tirana: Ora), p 173.
- ⁶⁸ Fatos Nano, "Konferencë shtypi e Kryetarit të PS, shokut Fatos Nano", *Zëri i Popullit*, 9 February 1992, p 1.
- ⁶⁹ Ibid. p 1.
- ⁷⁰ Fuga, A. (2003) *Majtas Jo Djathtas*, (Tiranë: Ora), p 110.
- ⁷¹ "Njerëzit Presin Demokracinë Ekonomike" *Zëri i Popullit*, 19 May 1992, p 1.
- ⁷² "Privatizimi Një Grabitje E Madhe" *Zëri i Popullit*, 25 September 1993, p 1.
- ⁷³ Fuga, A. (2003) *Majtas Jo Djathtas*, (Tiranë: Ora), p 106.
- ⁷⁴ Fatos Nano, "Konkurrencë, jo monopol në tregun kombëtar, *Ekonomia*, July 31st, 2002, cituar tek Fuga, A. (2003) *Majtas Jo Djathtas*, (Tiranë: Ora), p 132.
- ⁷⁵ Ibid. p 132.
- ⁷⁶ Fatos Baxhaku, "Majtas, Djathtas, Apo Bashkë?", *Shekulli*, 19 October 1999, p 6.
- ⁷⁷ Ibid. p 6.
- ⁷⁸ Fuga, A. (2003) *Majtas Jo Djathtas*, (Tiranë: Ora), p 113.
- ⁷⁹ Ibid. p 24.
- ⁸⁰ Ibid. p 112.
- ⁸¹ Fatos Nano, "Fjalim i Kryeministrit dhe Kryetarit te Partise Socialiste Fatos Nano ne Kongresin e 6 te Partise Socialiste te Shqiperise, Tirana, 12 December 2003.
- ⁸² Elbasani, A. (2004) "Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms", *Southeast European Politics*, 5:1, p 40.
- ⁸³ Grabbe, H. (2003), "Europeanization Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process". in *Politics of Europeanization*, eds. Featherstone and Radaelli, (Oxford University Press), p 315.
- ⁸⁴ Elbasani, A. (2004) "Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms", *Southeast European Politics*, 5:1, p 41.
- ⁸⁵ European Commission 2003. *Albania: Stabilisation and Association Report*. http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/sap/rep2/com03_339_en.pdf.
- ⁸⁶ Fatos Nano, "Sfidat e Integritimit Europian te Shqiperise – Leksion me Studentet e Universitetit te Vlores, University of Vlora, Vlora, 3 December 2004.
- ⁸⁷ Ibid.
- ⁸⁸ Fatos Nano, "Kryeministri Fatos Nano përuron përfundimin e punimeve të segmentit rrugor Tapizë-Fushë Krujë", 19 July 2003
- ⁸⁹ Fatos Nano, "Kryeministri Fatos Nano takon pedagogë dhe studentë të Universitetit të Tiranës", University of Tirana, Tirana, 1 September 2003.
- ⁹⁰ Hoffmann, J. (2005) "Integrating Albania: the Role of the European Union in the Democratization Process" *Albanian Journal of Politics*, 1:1, p 69.
- ⁹¹ Fatos Nano, "Fjala e Kryeministrit Nano në Analizën Vjetore te Qeverise per Vitin 2004", Tirana, 24 January 2005.
- ⁹² Fatos Nano, "Kryeministri Fatos Nano takon pedagogë dhe studentë të Universitetit të Tiranës", University of Tirana, Tirana, 1 September 2003.
- ⁹³ Albanian Institute for International Studies (2002) *Albania and European Union: Perceptions and Realities*, (Tirana: Albanian Institute for International Studies (AIIS)), p 6. Available at http://www.aiis-albania.org/Perceptimet_2002_eng.pdf Last accessed, August 30th, 2007.
- ⁹⁴ European Union (2003). Press release, 7 November 2003, Delegation of the European Commission in Albania, Tirana.
- ⁹⁵ Commission of the European Communities (2004). *Commission Staff Working Paper. Albania. Stabilisation and Association Report 2004*, SEC (2004) 374/2. Brussels, p 3.
- ⁹⁶ Grabbe, H. (2002) "European Union Conditionality and the Acquis Communautaire", *International Political Science Review*, 23:3, p 253.
- ⁹⁷ Commission of the European Communities (2004). *Commission Staff Working Paper. Albania. Stabilisation and Association Report 2004*, SEC (2004) 374/2. Brussels, pp 3.

- ⁹⁸ Fuga, A. (2003) *Majtas Jo Djathtas*, (Tiranë: Ora), p 114.
- ⁹⁹ Ibid. p 114.
- ¹⁰⁰ Kajsiu, B. (2007) *The Birth of Corruption in Albania: Or Why Corruption Grows Stronger the More We Fight It*. Paper presented at the 8th Essex Graduate Conference in Political Theory, University of Essex, 22 June, 2007, pp 10- 11.
- ¹⁰¹ Ibid. p 8.
- ¹⁰² Kajsiu, B. (2006) "Politicing Democratization: A Local Perspective", Working Papers, No 29, (Rome: Centro Studi di Politica Internazionale – CeSPI), p 11. Available at http://www.cespi.it/WP/WP29_Kajsiu.pdf Last accessed, 31 August, 2007.
- ¹⁰³ Fatos Lubonja, "Rreziku Berisha", *Korrieri* June 19th, 2005, p 1.
- ¹⁰⁴ Fuga, A. (2001), *Shtigje drejt Guves se Gjarprit*, (Tirana: Ora), pp 143-45, cited in Trimcevi, E. (2005) *Democracy, Intellectuals and the State: The Case of Albania*, (Tirana: Albanian Institute for International Studies), p 70.
- ¹⁰⁵ Zogaj, P.(1997) *Renia e Zgjedhjeve*, (Dita: Tiranë), p 241.
- ¹⁰⁶ *Human Security Survey 2003, Human Security in Albania*, Prepared for the United Nations Development Program (UNDP) by the Institute for Contemporary Studies (ISB) and The Centre for Rural Studies (CRS), December 2003, p 68.
- ¹⁰⁷ Ilirjani, A. (2005) "Political Choice in Albania: The 2005 Albanian Parliamentary Election", *Albanian Journal of Politics*, 1:1, p 81.
- ¹⁰⁸ *Human Security Survey 2003, Human Security in Albania*, Prepared for the United Nations Development Program (UNDP) by the Institute for Contemporary Studies (ISB) and The Centre for Rural Studies (CRS), December 2003, p 67.
- ¹⁰⁹ Arben Hasani, "Dilema e Votës", *Shekulli*, 12 July, 2000.
- ¹¹⁰ Prec Zogaj, "Një Thirrje Për Të Parë Të Vërtetën Drejt Një Sy Dhe Për Të Ndryshuar", *Shekulli*, 14 Korrik, 2000.
- ¹¹¹ Pula, B. (2007) "Analiza e Analistëve: Shënime për një Sociologji Kritike të Rolit të Analistit", *Polis*, no 2, p 48. Shiko www.revistapolis.com
- ¹¹² Ibid. p 47.
- ¹¹³ Mustafa Nano, "Kush është partia e shumicës", *Shekulli*, 2 Tetor, 1999, f 13.
- ¹¹⁴ Mustafa Nano, "Cfarë kongresi problematik", *Shekulli*, 10 Tetor, 1999, f 13.
- ¹¹⁵ Mentor Nazarko, "Mbi zëvendësimin e prokurorit të përgjithshëm", *Gazeta Shqip*, 9 Korrik, 2007, f 5.
- ¹¹⁶ Julian Hifizi, "Bojkotimi, formë e emancipuar e kontestimit", *Shekulli*, 30 Tetor, 2003, f 12.
- ¹¹⁷ Gjergj Sinani, "Politika dhe mendësia rreth saj", *Shekulli*, 24 Maj, 2002, f 15.
- ¹¹⁸ Ibid. f 15.
- ¹¹⁹ Frrok Cupi, "Politika, si një gur i rëndë, hidhet në detin popull", *Koha Jone*, 3 Korrik, 1993, f 3.
- ¹²⁰ "Fajtoje e ndyre!", *Korrieri*, 5 June, 2007, f 1.
- ¹²¹ "Kadare: Përcarja, veprimtari antikombëtare", *Shekulli*, 7 Mars, 2003, f 1.
- ¹²² Mustafa Nano, "Të luash pa rregulla etiko-moral në një fushë të hapur", *Gazeta Shqip*, 10 Korrik, 2007, f 1.
- ¹²³ Martin Leka. "Lajme e politikë gastronomike...", *Panorama*, 2 Korrik, 2007, f 1.
- ¹²⁴ Mentor Kikia, "Shoqëria e ndarë më dysh", *Gazeta Shqip*, 27 Prill, 2007, f 1.
- ¹²⁵ Edi Rama, *Fjalim i mbajtur në Kongresin e 11- të të Partisë Socialiste*, 26 Maj, 2007. Shiko <http://www.ps.al/fjalimi.aspx>
- ¹²⁶ Ibid.
- ¹²⁷ Sali Berisha, "Do të rri mes jush sepse ndjehem më i fortë se vetëm ashtu do të mund të ruaj dimensionin njerëzor.", *Rilindja Demokratike*, 22 Prill, 1992, f 1.
- ¹²⁸ Edi Rama, *Fjalim i mbajtur në Kongresin e 11- të të Partisë Socialiste*, 26 Maj, 2007. Shiko <http://www.ps.al/fjalimi.aspx>.
- ¹²⁹ Laclau, E. (1996) *Emancipation(s)*, (London-New York: Verso), pp 101-102.
- ¹³⁰ Laclau, E. *Populism: What's In A Name?*, Centre for Theoretical Studies, Online Papers, University of Essex, p 7. Available at <http://www.essex.ac.uk/centres/TheoStud/papers/Populism%20What's%20in%20a%20name.doc>

QYTETARET E PADUKSHME NË POLITIKË: GRATË NË ZONAT RURALE

SONILA DANAJ*

Abstrakt. Teorikisht gratë në zonat rurale përbëjnë më shumë se 25 % të elektoratit shqiptar. Praktikisht ky grup është inekzistent në hapësirën publike dhe për pasojë i padukshëm në procesin politik. Për një sërë arsyes, që variojnë nga struktura patriarkale e shoqërisë shqiptare deri tek pasojat e tranzicionit, gratë në zonat rurale kanë pak ose aspak zë dhe janë të papërfaqësuar në procesin politik. Në hapësirën e ngushtë publike në zonat rurale vendimet politike merren nga meshkujt, ndërsa gratë janë të ngërthyera në intensitetin e jetës private duke humbur kështu çdo dimension publik dhe politik. Gratë e fshatit, të rikthyera në jetën shtëpiake pas rënies së regjimit komunist, për shkaqe si privatizimi i tokës, papunësia, heqja e kontributit vullnetar dhe aktivizimi i detyruar politik e shoqëror, e kanë pakësuar pjesëmarrjen e tyre politike deri në atë pikë sa të bëhen apatike dhe të konsiderohen si të parëndësishme për t'u adresuar nga partitë politike e politikanët në nivelet e ndryshme të vendimmarrjes, duke u bërë me pak fjalë të padukshme për ta. Një situatë e tillë është e papranueshme dhe tregon se procesi i demokratizimit është i papërfunduar dhe përsa kohë grupe të caktuara qytetarësh do të mbeten të paangazhuar politikisht e për rrjedhojë të papërfaqësuar, nuk mund të flasim për një rend demokratik në Shqipëri.

Hyrje

Ndërtimi i një rendi demokratik pas vitit 1990 i ka vënë qytetarët shqiptarë përballë sfidës së ndërtimit të një demokracie liberale me institucione funksionale, që do të thotë se përveç ndërtimit formal të strukturave dhe kornizës ligjore, qytetarët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në proces. Mirëpo vëmë re se pjesëmarrja në formën e përfaqësimit të një pjese të shoqërisë nuk përkon me standardet demokratike. Në grupin e qytetarëve që nuk janë të përfshirë aktivisht në politikë bëjnë pjesë dhe gratë, përfaqësimi i të cilave në parlamentin shqiptar, si edhe në postet e tjera në nivel lokal është shumë i ulët. Mirëpo, edhe brenda këtij grupi vëmë re se gratë në zonat rurale janë edhe më të marxhinalizuara duke u pozicionuar në periferinë e periferisë së vendit. Gratë e fshatit, të rikthyera në jetën shtëpiake pas rënies së regjimit komunist, për shkaqe si privatizimi i tokës, papunësia, heqja e kontributit vullnetar dhe aktivizimi i detyruar politik e shoqëror, e kanë pakësuar pjesëmarrjen e tyre politike deri në atë pikë sa të bëhen apatike dhe të konsiderohen si të parëndësishme për t'u adresuar nga partitë politike e politikanët në nivelet e ndryshme të vendimmarrjes, duke u bërë me pak

* Sonila Danaj është lektore në Universitetin Europian të Tiranës për lëndët Teori Feministe dhe Shkrim Akademik. Ajo ka një diplomë MA në Studime Evropiane Bashkëkohore nga Universiteti i Sussex-it në Mbretërinë e Bashkuar dhe fushat e saj të interesit akademik janë kryesisht migracioni dhe pjesëmarrja e grave në politikë.

fjalë të padukshme për ta. Një situatë e tillë është e papranueshme dhe tregon se procesi i demokratizimit është i papërfunduar dhe përsa kohë grupe të caktuara qytetarësh do të mbeten të paangazhuar politikisht e për rrjedhojë të papërfaqësuar, nuk mund të flasim për një rend demokratik në Shqipëri. Përveç kësaj, gratë e zonave rurale përllongariten diku midis 25 deri në 30 për qind të gjithë popullsisë së vendit (shih INSTAT, 2004). Për rrjedhojë, ky shkrim ngre një shqetësim që prek mbi ¼ e elektoratit shqiptar, i cili sot për sot është i papërfaqësuar dhe i papranishëm në qeverisje.

Shkaqet e mospjesëmarrjes së grave rurale në politikë janë të njëjtat me ato të mospjesëmarrjes së grave në përgjithësi, por gratë fshatare gjenden në një pozicion ku këta faktorë janë dhe më vendimtarë, dhe madje shkas edhe për pengesa të tjera të cilat ose nuk ekzistojnë ose janë më pak kërcënuese për gratë në zonat urbane. Duke pasur parasysh mangësitë e theksuara në të dhëna që përqendrohen tek gratë e fshatit, ky shkrim është bazuar në një numër të kufizuar studimesh, të cilat me përjashtime të rralla, kanë pasur tjetër qëllim parësor, por fatmirësisht për ne kanë përfshirë disa të dhëna në lidhje me fshatin në përgjithësi dhe gratë në fshat në veçanti. Për rrjedhojë, këtu synojmë vetëm të ngremë një shqetësim, siç është pozicionimi periferik i grave në zonat rurale në politikën publike dhe të analizojmë shkaqet e kësaj situatë.

Në këtë shkrim periferia do të kuptohet jo vetëm si ajo pjesë e shoqërisë e cila gjeografikisht qëndron në distancë prej qendrës urbane, por edhe si pozicioni shoqëror e politik më i largët nga qendra vendimmarrëse dhe politikëbërëse. Fuga në veprën “Shoqëria Periferike” e shpjegon ekzistencën e periferisë si të pandashme nga ajo e qendrës dhe për rastin e Shqipërisë paskomuniste flet për një proces përqendrimi të popullsisë urbane në disa (pak) qendra të mëdha urbane ndërkohë që “pjesa tjetër e vendit është kthyer në një “periferi” domethënë në një hapësirë ekonomike, shoqërore dhe kulturore që nuk ka asnjë kuptim më vete, por që jeton, mbijeton apo “përpëlitet” gjithmonë në varësi të qyteteve të mëdha të vendit” (Fuga, 2004: 13). Në këtë ekuacion, gratë e zonave rurale gjenden brenda periferisë politike. Mirëpo, edhe në atë pozicion tashmë periferik, ato janë një grup i skajshëm i politikëbërjes dhe i vendimmarrjes në periferi, duke u pozicionuar në periferinë e periferisë rurale shqiptare. Për shkak të mungesës së traditës pjesëmarrëse të gruas në politikë, trashëgimisë komuniste, fenomenit të migrimit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, zhgënjimit me të gjitha politikat, mungesës së aksesit ndaj informacionit, mungesës së shkollimit, mungesës së hapësirës për shoqërim që ofron punësimi me pagesë jashtë shtëpisë dhe jeta e aktiviteti personal shoqëror, varfërisë, strukturës tradicionale të familjes shqiptare rurale që e sheh gruan si të përulur ndaj vullnetit të burrit të shtëpisë, e cila njëkohësisht shpjegon fenomenin e votës familjare të përhapur në zonën rurale shqiptare, gratë e zonave rurale janë të padukshme dhe të papërfaqësuar.

Shqetësimi i ngritur në këtë shkrim vjen prej faktit se, siç na thonë dhe Guidry dhe Sawyer, pavarësisht prej pohimit të teorisë mbi demokracinë se regjimet liberale ndryshe nga sistemet e tjera, i hapin hapësirat për njerëzit e zakonshëm dhe grupet pa pushtet, kjo nuk përkon me përvojën e njerëzve që kanë jetuar në rende demokratike për rreth 200 vjet, pasi asnjë prej tyre nuk ka lindur si një politi tërësisht përfshirëse. Nuk gjejmë asnjë histori demokracie pa ndonjë luftë kundër përjashtimit shoqëror prej njerëzve që nuk kanë vëmendjen e politikës publike. Teoria priret të nënvlerësojë, ose të lërë mënjanë, vështirësitë për kapërcimin e barrierave insitucionale e strukturore, dhe faktin se pushteti ekonomik shpesh marxhinalizon dhe i hesht personat që kanë pak mjete për ta sfiduar atë. Nëpërmjet formave të pushtetit dhe dominimit të bazuara në gjini, racë, moshë, etnicitet, fe, klasë shoqërore e të tjera, arrihet të kufizohet veprimtaria e aktorëve të marxhinalizuar. Pra, “hapësira për politikën publike nuk është njëlloj në dispozicion për gjithë njerëzit, edhe në demokracitë e zhvilluara” (shih Guidry & Sawyer, 2003: 273-5). Kjo është e vërtetë sidomos për grupet e paorganizuar e të harruara, të cilat lihen të vuajnë në heshtje (shih Olson, 1971: 165 sipas Hyman & Shingler, 1999: 381). E megjithatë duke pasur parasysh se demokracitë kanë krijuar mundësi për të riparuar vetveten, ne marrim përsipër të analizojmë përjashtimin e grave të zonave rurale nga pjesëmarrja në

politikën publike sepse siç vënë re Hiskey dhe Bowler (2005) demokratizimi tranzicional nuk ka për të përfunduar nëse demokratizimi nuk perceptohet në nivel lokal. Pra, qëllimi ynë është të ngacmojmë vëmendjen e këtij grupi, por edhe publikut më të gjerë se përfshirja e grave fshatare është një nga elementet që duhen ndryshuar në mënyrën se si bëhet politika shqiptare, duke pasur gjithnjë parasysh se ndërtimi i një sfere publike përfshirëse si kusht i domosdoshëm për demokracinë (Guidry & Sawyer, 2003: 274) nënkupton se mungesa e saj, pengon arritjen e demokracisë së konsoliduar sipas kuptimit liberal.

Shumica e studiuesve të shkencave shoqërore bien dakord se qëndrimet dhe opinionet politike formohen nëpërmjet ndërveprimit shoqëror, diskutimit politik dhe reflektimit personal, dhe këto procese kanë cilësi më të lartë kur njerëzit përballen me perspektiva të ndryshme nga të tyret (shih Mutz & Martin, 2001: 97). Mirëpo gratë në zonat rurale gjenden para një situatë ku mundësia e të dalurit jashtë shtëpisë dhe tutelës familjare është shumë e kufizuar. Fakti që ato kanë pak mundësi për të dalë jashtë shtëpisë vetëm dhe për të pasur përvoja të pavarura si: të udhëtuarit vetëm, të shkolluarit dhe punësuar jashtë shtëpisë, ka ndikuar drejtpërsëdrejti në nivelin e ndërgjegjësimit të tyre në lidhje me rolin që duhet të kenë në shoqëri, e për rrjedhojë i ka kthyer në qytetare apatike përsa i përket pjesëmarrjes në politikë. Pra, në këtë shkrim do të zhvillohet një parashtrim i arsyeve që i kanë bërë gratë në zonat rurale të mos marrin pjesë dhe të jenë të padukshme për politikën shqiptare.

Faktorët kulturorë e historikë kanë luajtur rolin e tyre në krijimin e kushteve që pjesëmarrja e grave në jetën publike para periudhës komuniste, në përgjithësi të ishte e varfër dhe e cinguar. Gratë jo vetëm që nuk kishin të drejtën e votës në Shqipëri deri në 1945-n, por përjashto disa shoqata në zona qytetare si Tirana apo Korça, ka munguar dukshëm organizimi i tyre shoqëror dhe aktivizimi politik (shih Qirjako & Dhimitri, 2000: 136). Rastet e rralla të grave të emancipuara kufizoheshin në rolin e mësueseve apo ndonjë mjekeje. Një nga këto përjashtime është Musine Kokalari, e cila u angazhua në jetën shoqërore politike të vendit, arsye për të cilën edhe u burgos e u persekutua nga drejtuesit e regjimit komunist. Me pak fjalë, “elementët e një jete të hapur dhe të emancipuar ekzistonin vetëm në disa grupe shumë të kufizuara shoqërore, kryesisht në qytete,” (po aty), gjë që dëshmon për mungesën e traditës së pjesëmarrjes së grave shqiptare në politikë.

Gjithsesi, periudha komuniste pati ndikimin e saj në ndryshimin e angazhimit politik të gruas, përfshi edhe asaj në fshat. Gruaja shqiptare fitoi të drejtën e votës që në vitin 1945, asaj iu dha mundësia e shkollimit deri në nivel universitar dhe u angazhua tërësisht në ndërtimin e rendit socialist. Kjo periudhë u shoqërua me fushata kolektivizimi të cilat teksa shtetëzonin elementet e private si prona apo bagëti, e ekspozuan tërësisht gruan në sferën publike. Pra, jo vetëm që e nxorrën gruan nga shtëpia dhe e angazhuan atë në punët e kooperativës dhe në jetën politike të vendit, por ndikuan në strukturën shoqërore dhe sjelljen politike të jetës së fshatit. Sipas Lulushit “ajo që bëri regjimi, ishte hapja e derës së shfrytëzimit të dyfishtë të gruas. Në se më parë ajo shfrytëzohej nga patriarkalizmi në familje, tani filloi të shfrytëzohej edhe nga patriarkalizmi komunist. (Alb-shkenca, 24 nëntor 2006 sipas Ekonomi et. al. 2006). Mirëpo sjellja e drejtuesve komunistë ishte e njëjtë kundrejt burrave dhe grave, përsa i përket sferës publike, edhe pse ata nuk ndikuan në ndarjen e punëve brenda sferës private, që në atë periudhë u kufizua në punët e shtëpisë, kujdesi për familjen dhe rritja e fëmijëve. Ky element na ndihmon të kuptojmë se emancipimi i periudhës komuniste ishte sipërfaqësor dhe nuk arriti të ngulitej e të përbrendësohej në ndërgjegjen e njerëzve, dhe si kundërpërgjigje ndaj karakterit të tij shtrëngues të heqin dorë prej arritjeve të përmendura më lart, gjë që e tregon shkëputja nga aktivizimi publik dhe ndryshimi i sjelljes së njerëzve drejt formave tradicionale, fill pas ndryshimit të regjimit.

Në këtë linjë mendimi, mund të spekulojmë se fakti që komunistët ia dhanë të drejtën e votës të gjithë popullsisë që në vitin 1945, ndikoi në mosvlerësimin e këtij pushteti nga ana e grave, të cilat ende nuk ishin ndërgjegjësuar në masë për rëndësinë e kësaj të drejte. Ky qëndrim indiferent ndaj të drejtës së votës dhe të drejtës së përfaqësimit u përforcua gjatë

periudhës komuniste për shkak të formalitetit të këtij procesi, në të cilin njerëzit nuk kishin pushtet vendimmarrës dhe mundësi zgjedhjeje të përfaqësuesve të vet. Me pak fjalë, trashëgimia historike e kulturore para periudhës së demokratizimit të vendit ka ndikuar negativisht në aktivizimin politik të grave shqiptare në veçanti atyre në fshat.

Periudha pas komunizmit në Shqipëri u shoqërua me një ndryshim shoqëror e politik, e cila në fjalët e Fugës quhet “ribërje e zonave rurale” dhe që përfshin “transformimet e bëra përgjatë gjithë kësaj periudhe në zonat rurale të vendit, duke përfshirë këtu edhe ato që prekin marrëdhëniet e reja pronësore në fshat, popullsinë fshatare, strukturën e familjes rurale, pejsazhin, aspekte kulturore e arsimore, formësimin e grupeve shoqërore rurale, punën, përmasat e ekonomive bujqësore, strukturën e prodhimeve bujqësore, të ardhurat, etj” (Fuga, 2004: 31-2). Të njëjtët faktorë ndikojnë në apatinë e fshatit si periferik ndaj politikës kombëtare.

Gjithsesi, ndryshimi i regjimit nuk u shoqërua me rënie të menjëhershme të numrit të votuesve, dhe kjo jo vetëm sepse njerëzit të mësuar në periudhën e socializmit të kryenin “detyrën e tyre qytetare” duke votuar, përndryshe do të vuanin përndjekjen dhe stigmatizimin shoqëror të nxitur nga udhëheqja partiake e kohës, vazhduan t’i binden rregullit të votimit, por edhe sepse ata për herë të parë kishin mundësinë të zgjidhnin realisht. Kështu që rënia në vitet pasues të numrit të atyre që votojnë mund të shpjegohet nëpërmjet elementëve si migrimi dhe zhgënjimi me të gjitha politikat qeveritare.

Periudha pas komunizmit dhe vështirësimi i gjendjes ekonomike i shtyu shumë njerëz, fillimisht burra e më pas dhe gratë e tyre, sidomos në fshat, të emigrojnë në mënyrë të ligjshme ose jo, në vende të ndryshme perëndimore, si edhe të zhvendosen në zonat urbane të vendit apo në periferi të tyre (Ekonomi, Muço dhe Rama, 1999: 74; De Soto et. al., 2002: 40). Ky lloj elektorati është i përjashtuar nga votimi për shkak të mospranisë fizike në zonën zgjedhore, si edhe për shkak të mangësive në procedurat zgjedhore, të cilat nuk ofrojnë mundësi votimi në distancë, me postë apo pranë përfaqësive diplomatike shqiptare. Nëse për emigrantët jashtë Shqipërisë mungonte mundësia ligjore për të votuar, në rastin e migrantëve të brendshëm, shpesh ata nuk janë të regjistruar në gjendjet civile të vendbanimeve të tyre, e për rrjedhojë nuk mund të votojnë në zonën ku banojnë. Në rastin e Shqipërisë, De Soto et. al. na thonë se rreth 15 për qind e anëtarëve të familjeve fshatare punojnë në një qytet a fshat tjetër, dhe nga këta 60 për qind punojnë në një qytet a fshat tjetër të Shqipërisë (2002: 40). Edhe pse na mungojnë të dhënat për Shqipërinë, Niemi dhe Barkan duke na sjellë shembujt e migrantëve të brendshëm në Turqi dhe Kenia, thonë se migrantë të tillë rrallë herë bëhen residentë të përhershëm të zonave ku kanë migruar, dhe nuk ka të ngjarë që ata të mund të votojnë në zonat e tyre të origjinës teksa ndodhen larg tyre (1987: 586-7). Në rastin e Shqipërisë kjo situatë ka bërë që këto grupe njerëzish nga njëra anë të humbasin mundësinë formale të përfaqësimit politik, dhe nga ana tjetër, falë parregullsive në regjistrim, disa prej tyre të mund të votojnë në më shumë se një zonë elektorale. Edhe pse mund të themi se zhvendosjet e popullsisë që prej 1990-s e në vijim dhe parregullsitë ligjore kanë ndikuar në procesin e votimit dhe në pjesëmarrjen në votim të njerëzve, përfshi dhe gratë, duke i bërë ato të humbasin interes në këtë proces, problemet teknike të sistemit të regjistrimit të popullsisë e për rrjedhojë të mundësisë së tyre për votim nuk janë në fokusin e këtij artikulli, e për rrjedhojë nuk do të shqyrtohen më tej.

Ndërkohë zhgënjimi me të gjitha politikat qeverisëse është një faktor i shumëfishtë. Disa nga elementët përbërës të tij janë: marxhinalizimi i fshatarëve për shkak të distancës fizike dhe vështirësisë për të udhëtuar nga qendra në periferi dhe anasjellas, në mënyrë që të angazhohen më tepër në politikë; varfëria e cila çon në riformulimin e prioriteteve, dhe përjashtimi i politikës dhe përfaqësuesve të saj si zgjidhës të problemeve që lidhen me varfërinë apo me jetën e tyre në përgjithësi. Edhe braktisja e fshatit për të shkuar jashtë shtetit apo në zona të tjera urbane brenda vendit, ka bërë që pjesa që mbetet, shpesh e vogël në numër të injorohet tërësisht nga politika qendrore dhe lokale. Mjafton të përmendim se në shumë fshatra të largët tashmë me pak banorë prej vitesh nuk kanë më energji elektrike si në rastin e Hotovës në Përmet, e plot shembuj të tjerë.

Kështu duke qenë se një shoqëri rurale shpesh është këmbësore, ata kanë mjete të kufizuara transporti, duke bërë që fshatari të jetë kryesisht i pamobilizuar dhe lëvizja jashtë zonës së banimit të përbëjë një përpjekje të madhe (shih Miller, 1970: 561). Në kontekstin shqiptar kjo vështirësohet edhe nga probleme të tilla si mungesa e rrugëve dhe e transportit të shpeshtë. Udhëtimi për në fshat, dhe ndonjëherë dhe jashtë tij është i paorganizuar dhe i rastësishëm. Vështirësia e udhëtimit është pasojë jo vetëm e mungesës së sigurisë të perceptuar pas rënies së regjimit, por edhe gjatë dhe pas rrënujave të 1997-s.

Në fakt, shumica e popullsisë shqiptare në zonat urbane, gjysëm-urbane dhe rurale mendojnë se siguria publike është përkeqësuar shumë që prej viteve 1990 (De Soto, et. al., 2002: 107). Edhe pse këtu mund të kemi të bëjmë me një perceptim që nuk përkon me realitetin e vendit, kjo pasiguri ka çuar në përforcimin e masave mbrojtëse për vajzat dhe gratë, shpesh duke i mbyllur ato brenda shtëpisë. Frika për sigurinë e jetës dhe ndaj trafikimit të mundshëm, si dhe masat për mbrojtjen e tyre mund të kthehen dhe janë kthyer ironikisht dhe në masa parandaluese të pjesëmarrjes së grave në sferën publike. Në një situatë kur udhëtimi është kaq i vështirë dhe i pasigurtë, gruaja nuk mund të lëvizë lirshëm, e për rrjedhojë të mos angazhohet në jetën publike a politike të lokalitetit të vet, apo dhe më gjerë.

Tranzicioni gjithashtu rezultoi në shpërbërjen e kooperativave, fermave dhe një sërë punësh të tjera me pagesë në të cilat gruaja e fshatit ishte e përfshirë. Natyrisht një pjesë e mirë e tyre përfituan tokë dhe u bënë bashkëpronare të saj, gjë që nënkuptoi dhe një valë vetëpunësimi. Nga studimi i Ekonomit, Muços dhe Ramës del se sektori i punësimit në ferma ka qenë i konsoliduar dhe ka përbërë 69%, dhe mbi 50% e tyre janë gra, për shkak të emigrimit mashkullor (1999: 74-75). Por edhe pse nuk mund të flasim për një papunësi në fshat, është e qartë se vetëpunësimi ndryshe nga punësimi me pagesë gjetkë është një aktivitet që ndodh brenda territorit të familjes apo tokës së zotëruar nga kjo familje. Për rrjedhojë, përfshirja në punët e bujqësisë siç e përmendëm më lart pakëson mundësitë e grave për të qenë në një ambient interaktiv, i cili stimulon njohjen e zhvillimeve politike dhe angazhimin në to.

Nga ana tjetër, privatizimi i tokës bujqësore dhe emigrimi i burrave ka bërë që gratë e fshatit të kenë një ngarkesë të madhe fizike mbi supë. Ato janë të përfshira në të gjitha veprimtaritë si në bujqësi, blegtori, në përpunimin e prodhimeve blegtorale, në administrimin e punëve shtëpiake, krahas angazhimit të tyre në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Për më tepër, të ardhurat e ulta, copëzimi i tokës, mjetet e kufizuara mekanike që përdoren në bujqësi dhe mungesa e specialistëve, të cilët u larguan pas ndryshimit të regjimit, çuan në një primitivizim të punëve në bujqësi dhe në rritjen e ngarkesës së punës, sidomos për gratë. Jeta e gruas fshatare u vështirësua edhe nga mbyllja e kopshteve për fëmijë, infermierive dhe spitaleve të vegjël nëpër fshatra, duke qenë se ajo është personi përgjegjës për kujdesjen dhe rritjen e fëmijëve. Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit ka shtuar një barrë të re si mbushja e ujit në burime të largëta për gratë. Në rastin e grave burrat e të cilëve kanë emigruar apo kanë ndërruar jetë, barra është edhe më e rëndë (shih Ekonomi, Muço dhe Rama, 1999: 75-6). Në mënyrë më të detajuar ndarja e punëve në fshat midis burrave dhe grave është:

Tabela 1 Ngarkesa e Punës dhe Ndarja Gjimore

Aktiviteti në fermë	Totali Burra	Totali Gra	Së bashku
1. Puna bujqësore			
Blerja e mjeteve bujqësore	83.4%	2.7%	13.8%
Përgatitja e tokës	48.7%	6.6%	44.7%
Farëzimi/mbjellja	25.1%	39.9%	35.0%
Prashitja	10.4%	34.1%	55.6%
Pastrimi i barërave të këqija	17.9%	47.4%	34.6%
Plehërimi	44.3%	36.9%	18.8%
Spërkatja me pesticid	84.3%	5.1%	10.5%
Vaditja	47.0%	21.3%	31.7%
Korrja	12.0%	11.9%	76.1%
Procesi pas korrjes	17.0%	16.0%	67.0%
Përzgjedhja e farërave	59.2%	22.0%	18.8%
Transporti	66.2%	6.1%	27.7%
Kujdesi për kopshtin e perimeve	13.6%	70.9%	15.5%
2. Kujdesi për kafshët			
Procesi i të ushqyerit	30.7%	35.2%	34.1%
Kullotja	60.9%	23.9%	15.1%
Mjelja	19.1%	72.6%	8.3%
Shitja/Blerja	86.8%	4.8%	8.4%
Administrimi blegtoral	88.7%	4.0%	7.3%
3. Punët shtëpiake			
Përgatitja e vakteve	4.0%	94.6%	1.4%
Kujdesi për fëmijët	7.9%	74.5%	17.6%
Pazari për javën	55.7%	25.1%	19.2%
Administrimi i buxhetit familjar	52.9%	21.1%	26.1%

Burimi: E përshtatur prej Qendrës së Gruas në Raportin Mbi Gjininë e Bujqësinë, 2003 bazuar në MADA Program Area Baseline Study të kryer nga ACER, 2003.

Të dhënat më sipër tregojnë se ngarkesa e gruas është shumë e madhe dhe zë pothuaj çdo moment të ditës së saj, gjë që i ka shtyrë ato t'i formulojnë prioritetet e tyre në mënyrë të tillë që i bën gratë në zonat rurale të shqetësohen më shumë për veprimtaritë e dukshme të së përditshmes, duke anashkaluar apo dhe injoruar tërësisht veprimtari të tjera si angazhimi politik.

Përveç ngarkesës duhet të përmendim se edhe pse bujqësia përfaqëson 50-55 për qind të GDP-së së Shqipërisë, shumica e fermerëve shqiptarë prodhojnë për konsum personal dhe pjesërisht për të shitur. Mirëpo të dhënat tregojnë se një pjesë e mirë e fshatarëve (50 deri në 70 për qind) i plotësojnë të adhurat e tyre nga burime të tjera përveç prodhimit dhe shitjes së produkteve bujqësore e blegtorale (De Soto et al., 2002: 19). Po kështu, sipas *Raportit mbi Gjininë dhe Bujqësinë* të kryer nga Qendra e Gruas 4 nga 5 persona në fshat janë të varfër, rreth 48 për qind e atyre që punojnë në bujqësi janë të varfër, dhe 28 për qind të njerëzve që banojnë në zonat rurale kanë nivelin më të ulët të të ardhurave në vend. Gratë dhe vajzat e këtyre zonave janë ndër më të prekurat (Qendra e Gruas, 2003: 46). Mungesa e të ardhurave të mjaftueshme ndikon në formulimin e prioriteteve të njerëzve, të cilët të përfshirë në problemet e të përditshmes dhe njëkohësisht të zhgënjyer me përgjigjet që kanë marrë nga politikatat, rezultojnë në një tërheqje edhe më të madhe prej aktivizimit dhe interesimit në lidhje me politikën në tërësi. Gratë nuk bëjnë përjashtim prej këtij grupi.

Kushtet e vështira fizike si mungesa e energjisë dhe vështirësia e udhëtimit drejt dhe jashtë fshatit sjellin pasoja të tjera të drejtpërdrejta si mungesa e informacionit në lidhje me politikën dhe me mundësitë që kanë gratë për t'u angazhuar politikisht. Nëse kësaj i shtojmë dhe

mungesën e kohës fizike për t'u marrë me këto punë, për shkak të impenjimeve të përditshme të lartpërmendura dhe varfërisë, gruaja e fshatit nuk mundet dhe nuk ka kohë të informohet në lidhje me politikën, e aq më pak të përfshihet në të drejtpërsëdrejti.

Për rrjedhojë, gratë nuk mendojnë si aktore autonome se pjesëmarrja politike është e rëndësishme dhe duke ndjekur të njëjtin arsyetim nuk mendojnë se përfshirja në politikë do t'u sjellë ndonjë përfitim (Chhibber, 2002: 410). Të dhënat e një studimi mbi pjesëmarrjen e grave në politikë në Shqipëri tregojnë se 25.3 për qind prej tyre, në qytet e në fshat, zgjedhën të mos votojnë në 2005-n, përkundrajt 24.4 për qind të meshkujve që nuk kishin votuar. Edhe pse përqindja e femrave dhe meshkujve që nuk kanë votuar nuk ndryshon shumë, arsyet e tyre janë të ndryshme. Kështu nëse 30 për qind e grave nuk votuan sepse nuk iu interesonte politika, vetëm 19.7 për qind e burrave dhanë të njëjtën përgjigje; nëse 26.9 për qind e grave nuk votuan sepse mendonin se vota e tyre nuk do të ndryshonte gjë, pothuaj i njëjti numër burrash dha këtë përgjigje (26.5%); nëse 12.4 për qind e grave nuk votuan sepse nuk ishin në Shqipëri, përqindja e burrave që nuk ishin në vend ishte 17.1 për qind; ata që nuk kishin emrin në listë ishin pothuaj njëjloj me 11.2 për qind për gratë dhe 11.1 për qind për burrat; nëse 3.4 për qind e grave nuk i pëlqyen kandidatët për deputet, 4.3 për qind e burrave dhanë këtë përgjigje; dhe arsye të tjera ishte përgjigja e 16.1 për qind të grave dhe 21.3 për qind e meshkujve (Ekonomi, et. al., 2006: 145). Këto të dhëna dëshmojnë se 56.9 për qind e grave që nuk votuan ose janë tërësisht të paimteresuara në politikë, ose janë të bindura se vota e tyre nuk mjafton për t'i ndryshuar gjërat, përkundrajt 46.2 për qind e meshkujve që e mendojnë kështu.

Përveç mospjesëmarrjes tërësisht në politikë, vëmë re se edhe ato ndër gratë fshatare që vendosin të marrin pjesë, janë nën tutelën e familjes patriarkale, e për rrjedhojë nuk mendojnë e veprojnë në mënyrë autonome e individuale. Pra, fshatarët mund të mbeten të izoluar nga ana kulturore e gjeografike, dhe në një mënyrë a një tjetër të jenë ende të përfshirë në komunitetin politik (shih Tarrow, 1971: 341), që dëshmohet nga qëndrimi elektoral tradicional i votuesit fshatar. Me bindje politike të konsoliduara, fshati falë natyrës së vet sedentare dhe pedestriane voton në të njëjtën mënyrë siç kanë votuar të parët e vet, duke përcjellë modele votimi me pak ndryshime. Me pak fjalë, dhe këtu flasim për ata fshatarë që nuk kanë migruar, "shumica e fshatarëve jetojnë, punojnë, votojnë dhe vdesin pothuaj në të njëjtën mënyrë si prindërit dhe gjyshërit e tyre" (Wright, 1953: 526). Një sjellje e tillë përforcohet prej faktit se marrëdhëniet politike bazohen në lidhjet farefisnore, anëtarësimi në një klan, si edhe prej ndërveprimit ballë për ballë e të përditshëm me njerëzit e familjes së zgjeruar. Lokaliteti, të banuarit pranë pjesëtarëve të tjerë të fisit, dhe diktati i një shoqërie agrare ndikojnë mjaft në jetën politike të këtyre njerëzve (shih Miller, 1970: 561).

Pra, mospjesëmarrja e grave në politikë ndodh për shkak të mungesës së traditës në zonat rurale, ku gruaja të mund të shprehë një mendim individual, ku politika nuk është punë për gra, dhe këtu do të shtonim edhe frikën e shprehjes së një mendimi ndryshe për shkak të dëshirës për të ruajtur marrëdhëniet ndërpersonale të paprekura. Për rrjedhojë, homogjeniteti i mendimit politik brenda familjes, si edhe shpesh në nivel klani apo fisi, kanë çuar në një tjetër fenomen negativ të shoqërisë shqiptare sikurse votimi si familje. Në studimin e përmendur më lart 22.6 për qind e grave u përgjigjën se ndikoheshin nga burrat e tyre në lidhje me votimin, përkundrajt 6.9 për qind të meshkujve (Ekonomi et. al. 2006: 98-9). Votimi familjar është një situatë në të cilën gratë nuk kanë asnjë zë dhe nuk mund të votojnë veçmas familjes së tyre, madje në shumë raste as edhe fizikisht nuk lejohen ta hedhin vetë votën e tyre, si një mënyrë për të vërtetuar nga ana e kryetarit mashkull të familjes se kush komandon, për t'u siguruar se nuk ka lajthitje në sjelljen e anëtarëve të familjes, por edhe si një shenjë besimi nga ana e këtyre të fundit për kryetarin, i cili "e di se ç'është më e mira për familjen e tij".

Përforcimi i roleve gjinore në këtë rast nuk ndodh vetëm prej meshkujve patriarkalë të fshatit, por në raste të tilla janë vetë gratë që i ruajnë traditat sipas të cilave gruaja nuk mund të vendosë vetë. Një shembull ilustrues, është rasti i grave të Rrajcës, afër Përrenjasit, të cilat gjatë intervistimit për një studim mbi sjelljen e votuesit të organizuar nga Altin Iliriani pas zgjedhjeve

të korrikut 2005 kërkuan lejen e burrave që nuk ishin të pranishëm për shkak të punësimit të tyre sezonal jashtë fshatit (kryesisht në Maqedoni), nëpërmjet telefonit celular, në mënyrë që t'i përgjigjeshin pyetjeve në lidhje me politikën. Ajo që shqetëson në këtë shembull është fakti se fshati ishte i banuar vetëm nga gratë dhe fëmijët, pasi të gjithë burrat ishin emigrantë sezonalë. Nevoja e tyre e brendshme për të marrë leje, edhe në situatën kur ata ishin fizikisht të pafuqishëm për t'i penguar, tregon për masën e përbrendësimit të këtij modeli sjelljeje ndër këto gra fshatare.

Pra, vëmë re se mospjesëmarrja e grave fshatare në politikë nuk shkaktohet vetëm nga pengesat që i krijon jeta e vështirë e fshatit, mentaliteti dhe burrat e jetës së tyre, por vjen edhe prej vetë tyre. Sjellja e tyre pasive veçse e përforcon këtë situatë mospjesëmarrjeje. Shumë studime tregojnë se njerëzit i përqafojnë më shumë objektivat feministe, apo tregojnë nivele të larta ndërgjegjeje feministe, nëse ata kanë shkollim të lartë, janë pak të përfshirë nga ana fetare, dhe jetojnë në familje, ku gratë punojnë me pagesë (shih Banaszak & Plutzer, 1993: 147-57). Për rrjedhojë mungesa e këtyre elementeve do të sillte një ndërgjegjësim më të vogël për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së grave të fshatit në politikë. Gratë në fshat pas 1990-s u përballën me një analfabetizëm në rritje, rikthim në praktikat fetare dhe mungesës së punësimit jashtë shtëpisë dhe me pagesë.

Pra, gjatë viteve të tranzicionit, që u shoqëruan me privatizimin e tokës, papunësinë, varfërinë, luftën për ekzistencë, zvogëlimin e kontrollit të shtetit, lëvizjen e pakontrolluar të popullsisë, është vënë re dhe rritja e numrit të braktisjeve të shkollës 8-vjeçare nga vajzat dhe angazhimi i tyre në punët e bujqësisë. Analfabetizmi i grave dhe vajzave në zonat rurale ka qenë 15.84% në 1998-n. Përveç largimit për shkak të kushteve, vëmë re se numri i shkollave të mesme ka rënë gjithashtu. Nga 428 të tilla në fshatin e 1992-shit, ka pasur vetëm 252 në 1998-n. Rënia e numrit të shkollave të mesme është shoqëruar dhe me rënien e numrit të vajzave që shkojnë në shkollë të mesme. Gjithashtu ka rënë në mënyrë drastike dhe numri i studenteve nga fshati dhe shifrat e 1998-s tregojnë se ato përbënin 11% të të gjitha vajzave studente (Ekonomi, Muço dhe Rama, 1999: 78-9). Studime të mëvonshme përforcojnë shqetësimin e përcjellë nga shifrat më lart. Të dhënat e INSTAT-it për vitin 2001 tregojnë se nëse grupmosha 25-29 ka 45.5 për qind të femrave në zonat rurale me arsim të mesëm dhe të lartë, për grupmoshën 15-19, përqindja është vetëm 14.7 (INSTAT, 2005: 24), gjë që dëshmon se femrat në fshat janë gjithnjë e më pak të shkolluara. Në të njëjtin përfundim arrin dhe një studim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe UNDP-sw në 2005-n, sipas të cilit 20.48 për qind e tyre janë pa diplomë, 68.15 për qind me shkollë fillore, 10.60 për qind me shkollë të mesme dhe 0.77 për qind me universitet (2005: 41-2). De Soto et. al. argumentojnë se përveç mbylljes së shkollave dhe infrastrukturës së keqe, fëmijët nuk po shkojnë në shkollë kryesisht për shkaqe si vështirësia ekonomike, shtimi i pasigurisë dhe rënia e vlerësimit të rëndësisë së shkollës në jetën e njerëzve. Nëse ekonomia e keqe bën që djemtë të braktisin shkollën për t'u punësuar, për vajzat janë faktorë si preferencat kulturore të prindërve, të cilët e vlerësojnë si të panevojshëm shkollimin për vajzat, vështirësitë ekonomike dhe pamundësia për ta përballuar shkollimin e tyre, si edhe frika për sigurinë e tyre (2002: 59-61). Për pasojë, rënia e nivelit të shkollimit ndikon jo vetëm në përgatitjen e vajzave dhe grave në fshat, por edhe në pritshmëritë e tyre për jetën dhe në përfytyrimin e rolit dhe të drejtave të tyre në shoqëri, e për rrjedhojë ndikon negativisht në ndërgjegjësimin e tyre për domosdoshmërinë e angazhimit dhe përfaqësimit të tyre politik.

Përfundime

Periudha e tranzicionit pas komunizmit u shoqërua me një ribërje të zonave rurale, e cila ndikoi në sjelljen politike të banorëve të zonave rurale. Demokratizimi i një vendi matet me nivelin e përfaqësimit të grupeve të ndryshme të shoqërisë dhe në shoqërinë shqiptare vëmë re se gratë e zonave rurale janë të papërfaqësuara politikisht. Pavarësisht rënies së numrit të popullsisë fshatare në vend për shkak të migrimit, gratë në zonat rurale ende përbëjnë një të katërtën e shoqërisë shqiptare, e për rrjedhojë një pjesë të konsiderueshme të elektoratit. Mirëpo ato përsëri nuk janë të pranishme në sferën politike të vendit. Faktorët që kanë ndikuar janë: vështirësitë fizike të shkaktuara nga largësia e fshatit nga qendra ku zhvillohet politika, mungesa e informacionit për shkak të mungesës së energjisë, apo kohës fizike për të ndjekur zhvillimet politike, ngarkesa e madhe e përditshme me punë, zhgënjimi me të gjitha politikat, mungesa e shkollimit, varfëria dhe mungesa e punësimit jashtë shtëpisë si mundësi për socializim. Këto faktorë përforcohen nga mentaliteti patriarkal sipas të cilit gruaja nuk merret dhe nuk ka aftësi për t'u marrë me politikë, e për rrjedhojë vendimet merren në vend të saj në forma të ndryshme, përfshi dhe fenomenin e votimit familjar. Në këtë proces edhe vetë gruaja fshatare është e përfshirë nëpërmjet bindjes dhe përforcimit të këtyre roleve gjinore, edhe kur burrat nuk janë fizikisht pranë. Si rrjedhim, gruaja fshatare është pozicionuar në skajin më periferik të periferisë, pozicion në të cilin është tërësisht e padukshme për vendimmarrësit, të cilët nga ana e tyre nuk iu përgjigjen atyre si qytetare të republikës. Mospërfshirja e tyre është një tregues i mosfunksionimit të rendit demokratik në Shqipëri dhe i faktit se procesi i demokratizimit është i papërfunduar. Përsa kohë një pjesë e shoqërisë nuk do të angazhohet në sferën publike, e veçanërisht atë politike, nuk mund të flasim për një rend demokratik të konsoliduar në Shqipëri.

Bibliografi

- Banaczak, L. A. & Plutzer, E. "Contextual Determinants of Feminist Attitudes: National and Subnational Influences in Western Europe" in *The American Political Science Review*. Vol. 87. Nr. 1. March 1993.
- Chhibber, P. "Why are some women political active? The household, public space, and political participation in India" in *International Journal of Comparative Sociology*. 2002.
- Çuli, D. *Ese për Gruan Shqiptare*. Tiranë: FPGSH "Dora D'Istria", 2000.
- De Soto, H. Gordon, P. Gedeshi, I. Sinoimeri, Z. *Poverty in Albania*. Washington DC: World Bank, 2002.
- Ekonomi, M. Sokoli, L. Danaj, S. & Picari, B. *Përfaqësimi dhe Cilësia e Demokracisë në Shqipëri: Një Perspektivë Gjinore*. Tiranë: Pegi, 2006.
- Ekonomi, M. Muço, M. & Rama, F. "Gruaja dhe Ekonomia në Tranzicionin Shqiptar" në *Studim mbi Kontributin e Shkruar të Lëvizjes së Gruas në Shqipëri 1990-1998*. Pogradec: D.I.J.A.-Poradeci, 2000.
- Fuga, A. *Shoqëria Periferike*. Tiranë: Ora, 2004.
- Guidry, J. & Sawyer, M. "Contentious Pluralism: The Public Sphere and Democracy" in *Perspectives on Politics*. Vol. 1. Nr. 2. June 2003.
- Hiskey, J. & Bowler, Sh. "Local Context and Democratization in Mexico" in *American Journal of Political Science*. Vol. 49. Nr.1 January 2005.
- Hyman, D. & Shingler, J. "The Hierarchy of Consumer Participation and Patterns of Economic, Social and Political Participation" in *Journal of Consumer Affairs*. Vol. 33. Issue: 2. 1999.
- Illirjani, A. 2005. "Political Choice in Albania. The 2005 Albanian Parliamentary Election." *Albanian Journal of Politics*, I (1): 75-86.
- INSTAT. *Të Ndjehesh i Rritur në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT, 2005.
- INSTAT. *Gender Perspectives in Albania*. Tiranë: INSTAT, 2004.
- Miller, N. "The Rural African Party: Political Participation in Tanzania" in *The American Political Science Review*. Vol. 64. Nr. 2 June 1970.
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta & UNDP. *Analiza Gjinore e Politikave në Sektorin e Punësimit në Shqipëri*. Tiranë. 2005.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës. *Analiza Gjinore e Politikave në Sektorin e Arsimit në Shqipëri*. Tiranë. 2005.
- Misja, V. *Emigracioni Ndërkombëtar në Shqipëri gjatë Periudhës së Tranzicionit*. Tiranë: Marin Barleti, 1998.
- Mutz, D. & Martin, P. "Facilitating Communication across Lines of Political Difference: The Role of Mass Media" in *The American Political Science Review*. Vol. 95. Nr. 1. March 2001.
- Niemi, R. & Barkan, J. "Age and Turnout in New Electorates and Peasant Societies" in *American Political Science Review*. Vol. 81. Nr. 2. June 1987.
- Qendra e Gruas, *Reporting on Gender and Agriculture*. Tiranë. 2003.
- Qirjako, S. & Dhimitri, R. "Shoqëria Civile dhe Lëvizja Asociative e Lirë e Gruas" në *Studim mbi Kontributin e Shkruar të Lëvizjes së Gruas në Shqipëri 1990-1998*. Pogradec: D.I.J.A.-Poradeci, 2000.
- Tarrow, S. "The Urban-Rural Cleavage in Political Involvement: The Case of France" in *The American Political Science Review*. Vol. 65. Nr. 2. June 1971.
- UNDP Albania. *A Survey on the Status of Women in Politics in Albania*. Tiranë: UNDP Albania, 2003.
- Wright, G. "Catholics and Peasantry in France" in *Political Science Quarterly*. Vol. 68. Nr. 4. December 1953.

PËRFAQËSIMI ANONIM: KËSHILLAT BASHKIAKË NË PUSHTETIN VENDOR SHQIPTAR*

INSTITUTI I STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE (ISN)*

Abstrakt. Pushteti vendor është një nga hallkat kyçe të qeverisjes, veçanërisht përsa i përket thellimit të demokracisë. Organi themelor në këtë drejtim është këshilli bashkiak, i cili, sipas ligjit, duhet të përfaqësojë interesat e komunitetit në pushtetin vendor. Fatkeqësisht, diçka e tillë nuk ka ndodhur kryesisht si pasojë e një sistemi të pastër proporcional me lista të mbyllura, me anë të të cilit zgjidhen këshilltarët bashkiakë. Kjo ka bërë që këshilli bashkiak të jetë më shumë një zgjatim i partive politike në nivelin qendror sesa një forum ku përfaqësohen interesat e komunitetit. Sondazhi i kryer nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) tregon se qytetarët e njohin pak ose aspak këshillin bashkiak dhe anëtarët e tij. Në kushtet kur këshilli bashkiak është pothuajse anonim për qytetarët, është e vështirë të mendosh se ai mund të përfaqësojë interesat e tyre. Për këtë qëllim në këtë studim argumentohet se një sistem mazhoritar do të prodhonte një këshill bashkiak më përfaqësues.

Hyrje

Pushteti vendor është një nga hallkat kyçe të qeverisjes, veçanërisht përsa i përket thellimit të demokracisë. Ai përbën një nga hapësirat më të përshtatshme ku mund të takohen dhe ndërveprojnë qeverisësit dhe të qeverisurit, në mënyrë që të përmirësohet qeverisja. Organet e pushtetit vendor janë më pranë qytetarëve dhe si rrjedhojë ato mund të kenë më shumë informacion mbi nevojat e qytetarëve dhe tu ofrojnë atyre shërbime që u përgjigjen më mirë këtyre nevojave. Pikërisht mbi këtë presupozim ngrihen edhe tre argumentet bazë mbi domosdoshmërinë e decentralizimit; argumenti politik, ai ekonomik dhe argumenti mbi efikasitetin e shërbimeve.¹ Por që ky presupozim të materializohet në realitet, kërkohet që organet përfaqësuese në pushtetin vendor, siç janë këshillat bashkiakë, të reflektojnë prioritetet e qytetarëve dhe t'u përgjigjen nevojave të tyre.

Kjo ishte një nga arsytet që ne vendosëm të përqendroheshim tek këshilli bashkiak. Së

* Ky artikull është një përmbledhje e studimit më të zgjeruar me titull "Demokracia Lokale: Rasti i Shqipërisë" botuar nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) në Tiranë në vitin 2003. Ndonëse ky studim është kryer pothuajse 5 vite më parë, disa nga konkluzionet e tij themelore mbeten të vlefshme edhe për pushtetin vendor sot.

** Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) është një nga institutet kërkimore më në zë në Shqipëri. I themeluar në vitin 1999 nga një grup akademikësh dhe diplomatësh, ISN-ja ka një eksperiencë të gjatë dhe të pasur kërkimore në lidhje me çështjet e sigurisë dhe demokratizimit. ISN-ja ka botuar një sërë librash, studimesh, analizash dhe raportesh në lidhje me çështjet e sigurisë rajonale, demokratizimit dhe integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

¹ Instituti i Bankës Botërore. Decentralizimi Shënime Përmbledhëse. Washington DC, 1999. fq. 6.

pari, atij i kushtohet shumë pak vëmendje, ndonëse ligjërisht është institucioni më i rëndësishëm në qeverisjen vendore. Këshilli bashkiak është parlamenti i qytetit, pra organi legjislativ, që duhet të reflektojë dhe mbrojë interesat e komunitetit. Së dyti, nuk mund të flitet për qeverisje demokratike në pushtetin vendor pa një këshill përfaqësues dhe funksional. Për nga vetë natyra dhe misioni që ka, këshilli është institucioni ideal, nëpërmjet të cilit mund të rritet pjesëmarrja qytetare, transparenca dhe përgjegjshmëria në vendimmarrje. Në këtë institucion duhet të zhvillohet dhe institucionalizohet marrëdhënia midis qytetarëve dhe pushtetit vendor. Fatkeqësisht kjo nuk po ndodh në Shqipëri dhe për më tepër ka shumë pak shanse që të ndodhë në të ardhmen, nëse disa nga mangësitë ekzistuese nuk eliminohen. Për këtë arsye qëllimi ynë ishte të identifikonim disa nga mangësitë themelore në punën e këshillave bashkiakë dhe veçanërisht në marrëdhënien e tyre me qytetarët.

Për këtë qëllim u organizuan një sërë tryezash të rrumbullakëta, *focus groups*, dhe intervista në të gjithë vendin, kryesisht me anëtarë të këshillit bashkiak, por edhe me qytetarë, përfaqësues të partive politike, ekspertë të qeverisë lokale dhe punonjës të pushtetit vendor në përgjithësi. Kërkimet në terren u pasuruan edhe nga dy anketime që u bënë në rang kombëtar, por vetëm për bashkitë. Anketimi i parë u bë me qytetarët dhe synonte të vlerësonte përshtypjet e qytetarëve mbi pushtetin vendor si dhe vlerësimin që ata i bënin punës së bashkive ku banonin. Në të njëjtën kohë anketimi kishte për qëllim vlerësimin e nivelit të njohurive që kanë qytetarët mbi pushtetin vendor në përgjithësi dhe mbi këshillin bashkiak në veçanti. Anketimi me qytetarët u bazua në një pyetësor me 35 pyetje dhe 57 varjable. Dhjetë bashki u zgjodhën në veri, qendër dhe jug të Shqipërisë, po ashtu nga perëndimi dhe nga lindja, të mëdha, mesatare dhe të vogla. Kampioni i bashkive u zgjodh në mënyrë që të ishte përfaqësues i tërë popullatës bashkiake aq sa ishte e mundur. Kur mostra për çdo bashki u zgjodh, numri i intervistave të zhvilluara u caktua në përpjesëtim me popullatën e bashkisë. Në total 1142 intervista u zhvilluan në 10 bashki nëpër Shqipëri. Numri i intervistave në çdo bashki ishte në proporcion të drejtë me përqindjen e popullatës së bashkisë në fjalë në raport me popullatën totale të kampionit.

Anketa e dytë u zhvillua me këshilltarë bashkiakë në po të njëjtat bashki ku u krye edhe anketa me qytetarët. Synimi i kësaj ankete ishte të hidhte dritë mbi dinamikën e vendimmarrjes brenda këshillit bashkiak. E njëjta logjikë metodologjike u përdor edhe në këtë anketim. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak që u intervistuan në çdo këshill bashkiak ishte në proporcion të drejtë me përqindjen e numrit të këshilltarëve në fjalë në raport me popullatën totale të kampionit. Në ndryshim nga anketa me qytetarët, pyetëtori për anëtarët e këshillit bashkiak u plotësua nga vetë këshilltarët dhe jo nëpërmjet intervistuesve. Kjo u bë në mënyrë që të merreshin përgjigje sa më të sinqerta nga këshilltarët. Në total u intervistuan 100 këshilltarë bashkiakë në të dhjetë bashkitë e përzgjedhura.

Nga rezultatet e sondazhit me qytetarët rezultoi se megjithë decentralizimin e konsiderueshëm, ekziston një hendek i madh midis qytetarëve dhe organeve të pushtetit vendor. Qytetarët nuk i njohin mirë autoritetet lokale në përgjithësi dhe këshillin bashkiak në veçanti. Sikurse pritej, autoriteti më i njohur në pushtetin vendor është kryebashkiaku. Ndërkohë që njohuritë mbi këshillin bashkiak ishin minimale. Rreth 24% e të anketuarve nuk kishin dëgjuar aspak për këtë organ dhe vetëm 35% e dinin se këshilltarët zgjidhen nga qytetarët. Një pjesë e mirë mendonin se këshilltarët emëroheshin nga kryebashkiaku ose nga kryeministri. Mungesa e informacionit në lidhje me këshillin bashkiak pasqyrohej edhe në faktin se vetëm 16% e të intervistuarve e dinin emrin e kryetarit të këshillit bashkiak. Shpesh ai ngatërrohej me kryetarin e bashkisë. Gjithashtu qytetarët njihnin shumë pak funksionet e këshillit bashkiak. Vetëm 33% e të intervistuarve që kishin dëgjuar për këtë institucion e dinin se këshilli bashkiak miraton buxhetin lokal. Këto shifra janë me të vërtetë shqetësuese, po të kihet parasysh se këshilli bashkiak është organi që përfaqëson interesat e komunitetit.

Nga ana tjetër, këshilltarët bashkiakë më shumë sesa me prioritetet e qytetarëve përkujdesen për prioritetet e partive politike që i kanë emëruar ata në këshill. Kjo reflektohej edhe në sondazh, ku dilte qartë se këshilltarët bashkiakë shpenzonin më shumë kohë në aktivitetet

partiake sesa në ato të këshillit bashkiak. Ndonëse jo gjithmonë, prioritetet e partive politike dhe ato të komunitetit përplasen, shpesh ato nuk përputhen. Problemi qëndron në faktin se midis luajalitetit ndaj komunitetit të qytetit dhe luajalitetit ndaj partisë së cilës i përkasin, këshilltarët gravitojnë më shumë nga kjo e dyta. Kjo vjen si pasojë e faktit se këshilltarët bashkiakë zgjidhen me lista të mbyllura nëpërmjet një sistemi proporcional të pastër. Çka bën që shpesh kryesitë e degës së partive të zhvendosen në këshillin bashkiak.

Sistemi proporcional me listë të mbyllur shpjegon edhe mungesën e njohurive të qytetarëve në lidhje me anëtarët e këshillit bashkiak, si dhe mungesën e një marrëdhënieje të institucionalizuar mes tyre. Për sa kohë këshilltarët bashkiakë nuk përfaqësojnë zona të caktuara në qytet dhe renditen në listën e mbyllur nga partitë politike, ata nuk kanë asnjë interes elektoral apo politik që të ndërveprojnë me qytetarët. Për këtë arsye, ky studim arrin në konkluzionin se për ta bërë këshillin bashkiak më përfaqësues, ai duhet të zgjidhet nëpërmjet një sistemi më mazhoritar, apo nëpërmjet një proporcionali rajonal me listë të hapur, ku qytetarët të votojnë jo vetëm për partitë por edhe për kandidatët, dhe ku këshilltarë apo grupe këshilltarësh të përfaqësojnë zona të caktuara të qytetit në këshillin bashkiak.

Studimi është i ndarë në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë jepen rezultatet kryesore të sondazhit të kryer me qytetarët, që tregojnë nivelin e ulët të njohurive në lidhje me këshillin bashkiak si dhe pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në aktivitetet e këshillit bashkiak. Në pjesën e dytë shtjellohet dimensionin politik i funksionimit të këshillit bashkiak, duke theksuar disa nga mangësitë themelore të këtij dimensionin. Në pjesën e tretë analizohet ndikimi i sistemit elektoral në funksionimin e këshillit bashkiak, si dhe efektet e mundshme të kalimit nga një sistem elektoral proporcional në një sistem mazhoritar. Studimi mbyllet me konkluzionin ku argumentohet se një sistem mazhoritar do të ishte më i përshtatshëm për të ngushtuar hendekun midis qytetarëve dhe pushtetit vendor.

Njohuritë e qytetarëve mbi këshillin bashkiak

Ligji në fuqi përcakton dy funksione kryesore për këshillin bashkiak. Këshilli miraton vendimet e ekzekutivit dhe mbikëqyr aktivitetet e ekzekutivit dhe administratës. Ai përcakton strukturën organizative dhe administrative të komunave dhe bashkive, strukturën e institucioneve buxhetore nën autoritetin e bashkisë apo komunës, si dhe numrin e punonjësve dhe kriteret e punësimit të tyre. Këshilli, ndër të tjera, vendos taksat dhe tarifatat lokale, miraton dhe amendon buxhetin e bashkisë. Gjithashtu ai përcakton rregulloret, procedurat dhe mënyrën e kryerjes së funksioneve të deleguara në përputhje me ligjin që përcakton delegimin e kompetencave drejt komunës apo bashkisë.²

Ka një sërë kompetencash të tjera të këshillit bashkiak që mbeten më së shumti në planin teorik, si pasojë e një decentralizimi të pamjaftueshëm. Sidoqoftë, kompetencat aktuale tregojnë qartë se këshilli bashkiak është dhe duhet të jetë organi më i rëndësishëm i qeverisë vendore, dhe për më tepër rëndësia tij do vijë duke u rritur si rrjedhojë e decentralizimit të mëtejshëm. Arsyeja kryesore ku mbështetet qenësia e këshillit bashkiak është mbrojtja dhe garantimi i interesave të komunitetit që e ka zgjedhur atë. Në fund të fundit këshilli bashkiak është një organ legjislativ, që duhet të përfaqësojë komunitetin në qeverinë vendore. Megjithatë mund të argumentohet se këshilli bashkiak duhet të luajë një rol më të gjerë, këshillat e tanishëm nuk i kryejnë ashtu siç duhet edhe funksionet që kanë aktualisht. Kjo pasqyrohet si në rezultatet e sondazhit, ashtu edhe në intervistat dhe *focus group*-et me këshilltarët bashkiakë.

Rreth 24% të anketuarve nuk kishin dëgjuar aspak për këshillin bashkiak. Kjo është një përqindje mjaft e lartë, duke pasur parasysh se të anketuarit u pyetën thjesht nëse ata kishin

² Shih Nenin 32 të Ligjit mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverive Vendore në Shqipëri.

dëgjuar për organin e këshillit bashkiak.³ Kjo njohuri e kufizuar u pasqyrua gjithashtu edhe në faktin se shumë pak të anketuar e dinin emrin e kryetarit të këshillit, 16%, ndërsa shumica, 62%, u përgjigjën se nuk e dinin. Është interesant fakti se 14% e të anketuarve ngatërruan emrin e kryetarit të këshillit me atë të kryetarit të bashkisë, i cili sipas rezultateve të paraqitura më parë, është një institucion i njohur, gjë që pritet duke pasur parasysh funksionet e tij ekzekutive si dhe zgjedhjen e tij direkt nga popullata.⁴

Është ende më shqetësues fakti që vetëm 45% e atyre që kishin dëgjuar për këshillin bashkiak e dinin se ishin qytetarët vetë ata që zgjidhnin këshilltarët. *Kjo përqindje është në fakt edhe më e vogël nëse kihet parasysh se kjo pyetje iu bë vetëm atyre që kishin dëgjuar për këshillin bashkiak.* Në fakt vetëm 35% e numrit total të të anketuarve ishin në dijeni të faktit se janë qytetarët ata që zgjedhin këshilltarët bashkiakë. Një përqindje e madhe, 34%, mendonin se këshilltarët zgjidhen nga kryetari i bashkisë, gjë që tregon edhe njëherë vizibilitetin dhe rëndësinë e këtij të fundit. Në këto rrethana është e vështirë të flitet për funksion përfaqësues të këshillit bashkiak, përgjegjshmëri të këshilltarëve përballë qytetarëve dhe aq më pak për familjaritet me funksionet e këshillit.

Sidoqoftë, ata qytetarë të cilët kishin dëgjuar për këshillin bashkiak njihnin deri në një farë mase edhe disa funksione të këtij këshilli. Kështu, përkatësisht 71% dhe 60% e tyre e dinin se këshilli është përgjegjës për të emëruar rrugët e qytetit dhe për të aprovuar taksat lokale. Pavarësisht nga sa më sipër, disa funksione themelore të këshillit bashkiak njihen shumë pak nga qytetarët, vetëm 36% ishin të informuar se këshilli miraton rrogat bashkë me numrin e punonjësve të bashkisë dhe vetëm dhe 33% e dinin se këshilli bashkiak miraton buxhetin lokal. Ndërsa këto janë aspekte disi teknike, qytetarët ishin shumë më të informuar mbi kompetencat e qeverisë qendrore, p.sh. një shumicë domethënëse, 79%, e dinin se pushteti qendror emëron prefektin. Ky fakt tregon se këshilli bashkiak është shumë më pak i njohur sesa kryetari i bashkisë apo qeveria qendrore, megjithë rolin e tij të rëndësishëm në qeverinë vendore.

Njohuria mbi punën dhe funksionet e këshillit bashkiak është e rëndësishme, sepse lehtëson dhe nxit pjesëmarrjen. Një kusht për pjesëmarrje është informimi mbi të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, informacion që mungon tek shumica e të intervistuarve. Vetëm 51% e atyre që kishin dëgjuar për këshillin bashkiak e dinin se kishin të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e tij. Kjo përqindje është edhe më dekurajuese kur bashkohet me përqindjen e atyre që kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak. Vetëm 8% e atyre që kishin dijeni për të drejtën e tyre për pjesëmarrje u përgjigjën se kishin marrë pjesë në këto mbledhje, të tjerët, 92%, u përgjigjën se nuk kishin qenë asnjëherë në një mbledhje të këshillit bashkiak.

Është e vështirë të identifikohen të gjithë faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhjet e këshillit bashkiak. Pa dyshim të qenit i informuar mbi të drejtën për pjesëmarrje është kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, siç duket edhe nga rezultatet e sondazhit. Kështu, vetëm 9% e të informuarve mbi të drejtën për pjesëmarrje u përgjigjën se ishin përpjekur, por nuk kishin mundur të ndiqnin këto mbledhje. Një nga arsytet e mospjesëmarrjes që u përmend më shpesh ishte mungesa e informacionit mbi vendin dhe kohën e mbledhjes. Sidoqoftë, është e pamundur të përcaktosh me këtë pyetje nëse shumica nuk ishin fare të interesuar të ndiqnin mbledhjet apo hasnin pengesa që nuk i lejonin të marrin pjesë në këto mbledhje. Mungesa e interesit duket si arsyeja më e pranueshme e mospjesëmarrjes, po të kihet parasysh përqindja e atyre që kanë ndjekur mbledhjet e këshillit bashkiak (8%).

Interesimi mbi vendimet e këshillit ishte disi më i lartë sesa pjesëmarrja në mbledhjet e

³ Ky numër mund të jetë disi i fryrë, sepse pyetjen “A keni dëgjuar për këshillin bashkiak të qytetit tuaj?” të anketuarit e kuptuan në shumë raste si “A dini ndonjë gjë rreth këshillit bashkiak të qytetit tuaj?” dhe në këto raste ata u përgjigjën “jo”, edhe pse mund të kishin dëgjuar për këshillin bashkiak.

⁴ Këto shifra janë përqindje të atyre të anketuarve që kishin dëgjuar për këshillin bashkiak, kështu që si përqindje e totalit të të anketuarve këto shifra janë më të vogla.

këshillit. Rreth 9% e të anketuarve ishin përpjekur të gjenin vendime të këshillit bashkiak, por e kishin parë të pamundur një gjë të tillë. Ky fakt është një tregues domethënës për transparencën e qeverive vendore. Megjithëse është e vështirë të përcaktosh me këtë pyetje nëse njerëzit thjesht nuk janë të interesuar mbi vendimet e këshillit bashkiak apo ata e kanë të pamundur t'i gjejnë ato. Gjithsesi, mbetet shqetësues fakti se 1/10 e të anketuarve nuk kishin mundur t'i gjenin këto vendime. Sipas të anketuarve, arsytet janë një kombinim mes pengesave personale dhe institucionale, ku mungesa e vullnetit nga ana e institucioneve vendore për të dhënë informacion mbetet një faktor i rëndësishëm.

Një arsye tjetër pse publiku i gjerë nuk është i informuar mbi punën e këshillit bashkiak është buxheti i kufizuar i qeverive vendore në të kaluarën. Në vitet 1998-1999 rreth 95% e të ardhurave të qeverive vendore vinin nëpërmjet transfertave pa kushte të bëra nga qeveria qendrore tek ajo vendore. Si rrjedhim, pavarësisht nga të drejtat legislative që këshilli bashkiak gëzonte në teori, ai nuk kishte rëndësi praktike për sa kohë administronte më pak se 5% të të ardhurave vendore dhe përderisa mund të mblidhte vetëm sasi shumë të vogla parash nëpërmjet taksave lokale.⁵ Decentralizimi ka filluar të sjellë ndryshime pozitive në këtë drejtim nëpërmjet delegimit të kompetencave dhe fleksibilitetit më të lartë në vendosjen e taksave.

Bashkia dhe puna e saj janë më së shumti njësuar me kryetarin e bashkisë, që do të thotë më pak vizibilitet për këshillin bashkiak. Kryetari i bashkisë është më i dukshëm dhe më lehtësisht i identifikueshëm sesa këshilli bashkiak dhe anëtarët e tij të shumtë e pak të njohur. Kjo është arsyeja pse një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve, 34%, mendonin se kryetari i bashkisë emëronte këshilltarët. Sipas sondazhit me këshilltarët shumica e qytetarëve përpigën të takojnë direkt kryetarin e bashkisë, sepse kështu mund të ndikojnë vendimmarrjen në nivelin e qeverisë vendore. Ky fakt është tregues i një figure të fuqishme dhe të dukshme ekzekutive dhe një strukture të dobët dhe të padukshme legislative. Kjo është marrëdhënia reale ndërmjet këtyre dy institucioneve në shumicën e bashkive.

Njohuria e kufizuar mbi këshillin bashkiak mund të shpjegojë edhe nivelin e ulët të pjesëmarrjes, që nga ana e tij mbështet mungesën e informacionit. Siç vërejnë shumica e këshilltarëve, qytetarët marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak vetëm në ato raste kur janë në lojë interesat e tyre imediate si strehimi apo mbështetja financiare.⁶ Organizatat lokale të shoqërisë civile nuk janë të organizuara ose nuk ekzistojnë dhe nuk mund të ngrenë zërin për interesat lokale. Media bën përjashtim në këtë rast, sepse ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi punën e këshillit bashkiak në veçanti dhe mbi atë të autoriteteve vendore në përgjithësi. Informimi mbi këshillin bashkiak mungon ndërsa qytetarët shfaqen indiferentë ndaj organit që i përfaqëson ata në qeverinë vendore.

Sidoqoftë, niveli pjesëmarrjes në vetvete nuk është dukuria më shqetësuese këtu. Në fund të fundit nuk mund të pretendohet që qytetarët të marrin pjesë nëpër mbledhje, kur nuk preken nga çështjet që janë për t'u diskutuar. Pjesëmarrja gjithashtu nuk mund të nxitet vetëm me fushata ndërgjegjësimi apo informimi, sado të rëndësishme që janë këto. Në fakt, rezultatet tona tregojnë se më shumë informacion nuk do të thotë domosdoshmërisht pjesëmarrje më e lartë. Kështu të anketuarit me më shumë shkollë ishin edhe më të informuar mbi strukturat e qeverisë vendore në përgjithësi. Megjithatë, niveli i interesimit të tyre mbi vendimet e këshillit bashkiak si dhe pjesëmarrja e tyre në mbledhjet e këshillit nuk ishin më të larta se ato të të anketuarve të tjerë me më pak shkollë dhe si rrjedhim më pak të informuar. Përkundrazi, këta të fundit kanë pjesëmarrje më të lartë. Kështu, pjesëmarrja më e lartë nuk vjen thjesht si një rrjedhim i fushatave informuese apo ndërgjegjësuese.

Problemi qëndron (është brendësuar) në vetë sistemin elektoral. Këshilltarët zgjidhen

⁵ Hoxha, Artan. Qeveritë Vendore në Evropën Qendrore dhe Lindore "Stabilizimi i Qeverive Vendore: Qeveria Vendore në Shqipëri" f.68-70. Volumi II

⁶ Tryezë e rumbullakët me këshilltarë bashkiakë në Elbasan, 22 Prill 2003

nëpërmjet një sistemi proporcional direkt nga listat e partive, për rrjedhojë zgjedhësit votojnë për partinë dhe jo për individin. Kjo nënkupton gjithashtu se individ (këshilltari) ka përgjegjësi para partisë politike dhe jo para zonës që përfaqëson. Ky sistem e bën shumë të vështirë njohjen e këshilltarit nga qytetari si dhe të qenit e këshilltarit i përgjegjshëm para qytetarit. Megjithëse sipas ligjit mbi funksionimin dhe organizimin e qeverive vendore, “këshilltarët janë përgjegjës ndaj qytetarëve”, realisht ata janë përgjegjës vetëm ndaj forcës politike që i kandidon. Një sistem mazhoritar ku këshilltarët zgjidhen direkt nga qytetarët në zona të caktuara të qytetit do ta shmangte problemin e mësipërm, por do të krijonte probleme të tjera, të cilat do t’i shqyrtojmë më poshtë.

Në fakt, të pyetur nëse preferonin t’i zgjidhnin këshilltarët sipas sistemit të tanishëm proporcional, apo nëse preferonin të votonin për një këshilltar të vetëm, i cili do të përfaqësonte zonën/lagjen e tyre në këshillin bashkiak, shumica e të anketuarve, rreth 70%, zgjedhën mundësinë e dytë. Megjithëse është e pamundur të deduktosh prej kësaj pyetjeje domosdoshmërinë e zhvendosjes në një sistem elektoral mazhoritar, përgjigjet e të anketuarve tregojnë qartë dëshirën e tyre për t’u përfaqësuar në mënyrë më direkte në këshillin bashkiak dhe për t’i njohur përfaqësuesit e tyre. Në këtë mënyrë këshilltarët do të ishin edhe më përgjegjës ndaj qytetarëve.

Fakti që këshilltarët përgjigjen përballë partisë politike që i propozon nuk është shqetësues në vetvete. Partia politike duhet të jetë një pjesëmarrëse e rëndësishme në qeverinë vendore. Partitë politike janë ato që prodhojnë vizione për qeverisje dhe ato që, kur janë në pushtet, janë përgjegjëse për t’i implementuar këto vizione si dhe për t’i analizuar ato me hollësi, sidomos kur janë në opozitë. Është e pamundur dhe e panevojshme të depolitizohet krejtësisht qeveria vendore. Sidoqoftë, shkalla e politizimit e qeverisë vendore mbetet një çështje e hapur. Politizimi i qeverisë vendore krijon nevojën e respektimit të përpiktë të kufizimeve ligjore, rregullave dhe procedurave, në mënyrë që sistemi të funksionojë. Edhe në rastin më të mirë, kur sa më sipër ndodh, ekzistojnë hapësira ligjore dhe procedurale që e vështirësojnë funksionimin normal të këshillit, sidomos duke pasur parasysh se këshillat bashkiakë janë një dukuri krahasimisht e re në eksperimentin shqiptar me demokracinë. Kjo do të thotë se vullneti politik është një element përcaktues për funksionimin eficient të këshillave bashkiakë. Për të shqyrtuar më mirë elementët e mësipërm, le të shohim më nga afër funksionimin e brendshëm të këshillit bashkiak.

Funksionimi i këshillit bashkiak

Megjithëse nga pikëpamja ligjore këshilli është institucioni vendimmarrës më i fuqishëm dhe më i rëndësishëm i qeverisë vendore, *de facto* nuk ndodh kështu. Në praktikë kryetari i bashkisë është institucioni më i rëndësishëm në nivel bashkiak. Ai jo vetëm njihet më shumë nga popullsia, por, si pasojë e dinamikave politike, fuqitë e tij ekzekutive janë më pak të kufizuara në praktikë sesa në teori.⁷ Kjo është akoma më e vërtetë në këshilla që janë të dobët apo mbizotërohen nga një parti e vetme politike. Në fakt, është kryetari i bashkisë ai që vendos ritmin e punës së bashkisë, përderisa ai përcakton marrëdhënien mes këshillit dhe administratës. Në qoftë se administrata nuk i përgjigjet nevojave të këshilltarëve për të qenë të informuar, duke raportuar rregullisht dhe duke i siguruar atyre informacionet e duhura, këshilli nuk mund të punojë ashtu siç duhet. Kështu, ndeshet *de facto* një varësi nga dega ekzekutive, një varësi që mund të rëndohet në mungesë të rregullave, procedurave dhe ligjeve të qarta dhe sidomos nga ndryshimet e klimës politike.

⁷ Kjo është e vërtetë për sa kohë partia e kryetarit të bashkisë gëzon edhe shumicën në këshill. Sistemi zgjedhor në fuqi e lë të hapur mundësinë që një parti politike të gëzojë shumicën në këshill, ndërsa kryetari i bashkisë përfaqëson një tjetër parti politike. Ky rast mund të jetë problematik për procesin e vendimmarrjes, megjithëse mund të çojë drejt një bashkëpunimi më të madh.

Klima politike ka rëndësi të veçantë për punën e këshillit bashkiak. Janë partitë politike ato që krijojnë strategji, mbajnë qëndrime dhe motivojnë këshilltarët në punën e përditshme të këshillit. Ato janë faktor përcaktues në dinamikën e punës të këshillit bashkiak. Është e vështirë të mbivlerësohet rëndësia e tyre. Zhvillimet ndërmjet dhe brenda partive politike përcaktojnë më së shumti se si funksionon këshilli bashkiak, ashtu siç përcaktojnë klimën politike në përgjithësi. Qëndrimet politike e bëjnë më vështirë ose më të lehtë marrëveshjen apo punën edhe mbi çështje teknike në dukje, të cilat zënë zakonisht pjesën më të madhe të punës së qeverisë vendore. Kjo ndodh sepse këshilltarët janë përfaqësues politikë, sipas ligjit zgjedhor në fuqi, dhe legjitimiteti i tyre varet nga partia që i ka propozuar. Sondazhi ynë tregon se shumica, n.q.s. jo të gjithë, ishin propozuar nga partitë politike. Shumë pak këshilltarë mund të mbahen si “te pavarur”, sepse është tejet e vështirë që ata të zgjidhen me sistemin zgjedhor në fuqi.

Përpara se të rreshtojmë disa nga mangësitë politike në këshillat bashkiakë, është domosdoshme të theksojmë rëndësinë e partive politike. Siç u përmend edhe më parë këshillat nuk kanë aftësitë e nevojshme për të inspektuar punën e administratës lokale, veçanërisht duke ditur që ata nuk mbështeten në ekspertizë të jashtme. Partitë politike mbushin pjesën më të madhe të këtij boshllëku. Ato kanë departamentet dhe ekspertizën e nevojshme për të analizuar e inspektuar politikat e qeverisë vendore, dhe pikërisht këtu shqyrtohen gjerësisht politikat e qeverisë vendore. Sa më sipër është veçanërisht e vërtetë në rastin kur partia politike nuk është në pushtet. Për më tepër, duke pasur parasysh strukturën e tanishme të këshillave bashkiakë, partitë politike janë ato që motivojnë dhe disiplinojnë këshilltarët. Dedikimi në punë dhe përmbushja e misionit të këshilltarëve mbeten të dyshimtë në mungesë të partive politike.⁸ Edhe në rastin ideal kur këshilltarët janë të motivuar dhe të dedikuar, zëri dhe shqetësimet e tyre do të kalonin pa u dëgjuar pa mbështetjen e një partie politike të madhe. Partitë politike zotërojnë strukturat dhe organizimin e nevojshëm për të ndikuar vendim-marrjen.

Sidoqoftë, qëllimi ynë këtu nuk është të nënvlerësojmë rëndësinë e partive politike, por të shquajmë disa nga mangësitë e tyre në mënyrë që të gjejmë rrugë përmes të cilave këto mangësi të shmangen. Ndërsa prania gjithëpërfshirëse e partive politike në qeverinë vendore ka disa përparësi, ajo sjell edhe kufizimet e veta. Para së gjithash këshilltarët janë përfaqësues politikë dhe jo përfaqësues të komuniteteve apo zonave zgjedhore lokale. Siç duket nga rezultatet e sondazhit këshilltarët shpenzojnë mesatarisht më shumë kohë në aktivitetet e partisë së tyre politike sesa duke u përgatitur për mbledhjet e këshillit apo duke punuar nëpër komisione. Kjo pasqyrohet edhe në faktin se partia politike është faktor vendimtar në procesin e vendim-marrjes të këshillit bashkiak, edhe më vendimtar se bizneset lokale apo qytetarët.⁹ Megjithëse është e vështirë të ndahet puna e këshilltarëve vendor në partitë politike nga ajo në qeverinë vendore, përgjigjet tregojnë qartë se këshilltarët e rendisin punën në partitë politike më lart për nga rëndësia. Kjo bëhet shqetësuese në rastet kur interesat e partive politike nuk përputhen me ato të komuniteteve, siç ka ndodhur në të kaluarën e afërt.¹⁰

Puna në partitë politike renditet e para, sepse në shumicën e bashkive zakonisht udhëheqësit e degëve lokale të partisë politike të hyjnë në këshillin bashkiak. Ndërsa diçka e tillë nuk është veçanërisht e dëmshme në vetvete duke pasur parasysh sistemin zgjedhor proporcional, ajo dëmton përfaqësimin gjeografik. Përfaqësimi gjeografik nuk ndeshet në këshillat bashkiakë, dhe madje herë pas here shihet si i panevojshëm. Këshilltarët në poste

⁸ Shumica e këshilltarëve, rreth 59%, mendojnë se nuk paguhen siç duhet për dedikimin dhe postin. Kështu është e lehtë të arrish në përfundimin se partitë politike janë burimi kryesor i disiplinimit dhe motivimit për ta. Shih rezultatet e sondazhit Aneksi III: Sondazhi me këshilltarët.

⁹ Shih Aneksin III: Sondazhi me këshilltarët.

¹⁰ Këshilltarët e Partisë Demokratike bojkotuan këshillat bashkiakë pas zgjedhjeve të vitit 2000, të cilat PD i konsideroi të manipuluar nga Qeveria Socialiste. Kjo lëvizje, pavarësisht nga shkaku, dëmtoi punën e këshillave bashkiakë në të gjithë vendin dhe la rrugën hapur për abuzim nga ana e këshilltarëve dhe kryetarëve të bashkive të Partisë Socialiste.

udhëheqëse nuk e shohin përfaqësimin gjeografik si të nevojshëm.¹¹ Duke pasur parasysh se sipas sistemit zgjedhor në fuqi këshilltarët zgjidhen nga listat e partive, zgjedhja e kandidatëve nuk ndikohet nga çështje gjeografike. Në shumicën e rasteve, kur ndeshet përfaqësim gjeografik, ky i fundit ndodh si pasojë e strukturave partiake. Organizmat e partive propozojnë kandidatët për këshilltarë dhe duke qenë se ato mbulojnë gjeografikisht të gjitha zonat e qytetit, mund të ndodhë që të ketë këshilltarë nga të gjitha këto zona. Sidoqoftë, kjo mbetet në shumicën e rasteve rastësi dhe nuk është një proces i rregullt. Në disa raste të gjithë këshilltarët janë nga e njëjta pjesë e qytetit, ndërsa pjesët periferike të qytetit përfaqësohen shumë pak.

Kjo pasqyrohet edhe në faktin që shumica e investimeve bashkiake përqendrohen përpjestimisht më shumë në zonat e qendrës në krahasim me zonat në periferi. Këtu është e rëndësishme të theksojmë se elementët buxhetorë luajnë gjithashtu rol të rëndësishëm. Buxhetet e bashkive janë të vegjël dhe shumë qytete dhe qendrat e tyre kanë shumë nevojë për investime. Përqendrimi i investimeve në zonat e qendrës është gjithashtu pjesë e filozofisë së qeverisjes qendrore, që ka si ide t'i fillojë investimet nga qendër e më pas të përhapet drejt zonave në periferi dhe jo nga e kundërta. Një filozofi e tillë mund të përcaktohet edhe nga shqetësimet zgjedhore, përderisa investimet në qendër janë më të dukshme për publikun. Për arsyet e mësipërme mund të argumentohet se një përfaqësim më gjeografik do të ndikonte shpërndarjen e investimeve dhe do të ndryshonte prioritetet e tyre.

Prania në masë e partive politike në nivel vendor është problematike edhe sepse klima politike në nivel qendror pasqyrohet menjëherë në nivelin vendor. Kjo e bën qeverisjen vendore politikisht të varur nga qendra, një varësi kjo që dëmton autonominë e qeverisjes vendore. Decentralizimi është në fund të fundit një proces që synon të rrisë autonominë vendimmarrëse të qeverisjes vendore. Si rrjedhim, ka nevojë për një lloj decentralizimi politik, në mënyrë që qeveria vendore të fitojë pavarësi të vërtetë nga autoritetet qendrore. Ka disa rrugë që të ndodhë ky decentralizim, qoftë duke ruajtur të njëjtin sistem zgjedhor, qoftë duke e ndryshuar atë. Në rastin e fundit, një sistem zgjedhor mazhoritar do të sillte më shumë decentralizim politik.

Në të gjitha rastet e mësipërme, qëllimi nuk është të shmangen partitë politike nga politikat vendore. Kjo është sa e pamundur aq edhe e padëshirueshme. Shqetësimi madhor këtu është që të gjenden rrugë nëpërmjet të cilave prania e tyre të jetë shtysë sa më e fortë drejt demokratizimit vendor që të jetë e mundur. Qëllimi është që partitë politike të përfaqësojnë sa më mirë interesat vendore, duke rritur në të njëjtën kohë përgjegjshmërinë e përfaqësuesve të zgjedhur. Siç duket nga mangësitë e mësipërme, shumica e tyre janë rrjedhojë e sistemit zgjedhor proporcional në fuqi. Mënyra se si zgjidhen këshilltarët; varësia e tyre nga partia politike, para së cilës ata janë përgjegjës, është në fund të fundit pasojë e sistemit proporcional. Kjo është arsyeja pse tani do të shqyrtojmë çështje të lidhura me sistemin zgjedhor.

Ndikimet e sistemit zgjedhor proporcional në qeverinë vendore

Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, mandatet e këshillave vendorë jepen në bazë të sistemit proporcional, sipas të cilit kandidatët e partive apo koalicioneve zgjidhen në këshillat vendorë sipas renditjes përkatëse në listat shumëmemërore në përpjesëtim me përqindjen e votave të fituara në zgjedhjet vendore nga koalicioni apo partia politike.¹² Me fjalë të tjera, qytetarët votojnë në zgjedhjet vendore për partinë, e cila, nga ana e saj, paraqet një listë shumëmemërore kandidatësh dhe në të njëjtën kohë qytetarët votojnë për kryetarin e bashkisë në mënyrë direkte, përmes një sistemi mazhoritar. Kështu, ndërsa në rastin e këshilltarëve bashkiakë zgjedhësit

¹¹ Intervistë me Njazi Kosovrastin. Kryetar i grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike në këshillin bashkiak të Tiranës.

¹² Shih Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Ligji Nr. 8609, Datë 8 Maj 2000, Neni 75

votojnë për partinë politike, për të zgjedhur kryetarin e bashkisë ata zgjedhin nga një listë me emra të paraqitur nga subjekte të ndryshme politike.

Ky sistem votimi është një nga faktorët më të rëndësishëm që shpjegon se pse qytetarët i njohin kaq pak përfaqësuesit e tyre në këshillin bashkiak, sidomos në bashkitë e mëdha. Në këto të fundit numri i këshilltarëve është 45 dhe çdo parti politike, në varësi të madhësisë, paraqet listën e vet me 45 ose më pak kandidatë. Kështu, qytetarët përballen me një numër të madh emrash, nga të cilët nuk mund të zgjedhin dhe për të cilët nuk mund të votojnë direkt, përse kohë që listat janë të mbyllura dhe vota hidhet për partinë politike. E bashkuar me famën e vogël të këshillit bashkiak në përgjithësi dhe famën edhe më të vogël të këshilltarëve në veçanti, sistemi i jep jetë dhe mbështet anonimitetin e këshilltarëve para qytetarëve.

Megjithatë, ky anonimitet dhe mungesë njohjeje nuk është problemi i vetëm. Situata përkeqësohet edhe më tej, sepse si pasojë e mënyrës së zgjedhjes së këshilltarëve, ata nuk përfaqësojnë zona të caktuara, por të tërë qytetin. Kjo do të thotë se ata nuk kanë nxitje që të komunikojnë me zgjedhësit. Megjithëse kur marrin detyrën, këshilltarët betohen për besnikëri ndaj komuniteteve vendore, në praktikë ata janë besnikë vetëm ndaj partisë që përfaqësojnë, e cila është përgjegjëse për rizgjedhjen e tyre, dhe siç ka treguar historia disa herë, kjo besnikëri bie në kurriz të shqetësimeve të komuniteteve vendore.¹³ Sistemi zgjedhor në fuqi ngre kështu në skenë vetëm partitë politike dhe askënd tjetër, sidomos në bashkitë e mëdha. Ky sistem e bën shumë të vështirë zgjedhjen e kandidatëve të pavarur. Në fakt, edhe sondazhi ynë tregon se vetëm 1% e këshilltarëve të intervistuar e quajnë veten të pavarur, por edhe në këtë rast nuk dihet nëse këta kandidatë konkurren në mënyrë të pavarur apo me mbështetjen e një partie politike, të cilën ata vendosën të mos e përfaqësonin më në këshill. Sidoqoftë, partia politike është e domosdoshme për t'u zgjedhur në këshillin bashkiak.

Gjithashtu, si pasojë e sistemit elektoral, këshilli bashkiak, pavarësisht nga rëndësia e madhe që ka në ligj, praktikisht shpesh përfundon në një zgjatim të kryetarit të bashkisë. Ky i fundit, për vetë faktin që zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët, ka më shumë pushtet përballë një trupe kolegjiale deri diku anonime. Ky raport përkeqësohet edhe më tej për faktin që shumica e këshilltarëve shpesh janë të emëruar të partisë politike nga ku ka dalë edhe kryetari i bashkisë. Dhe për sa kohë kryetari i bashkisë ka mbështetjen e partisë politike në fjalë, ai nuk mund të monitorohet apo kontenstohet nga trupa e këshilltarëve bashkiakë. Kjo do të thotë që në praktikë këshilli bashkiak shpesh thjesht shërben si një organizëm formal, që vulos vendimet e kryebashkiakut.

Për pasojë, sistemi zgjedhor në fuqi ka kontribuar drejt rritjes së mëtejshme të shkëputjes mes këshilltarëve dhe qytetarëve. Kjo dëmton përgjegjshmërinë dhe përfaqësimin. Është e pamundur të flitet për përgjegjshmëri në mungesë të njohjes së këshilltarëve nga qytetarët. Këshilltarët janë përgjegjës ndaj qytetarëve tërthorazi nëpërmjet partisë së tyre politike, që në rrethana kolegjiale do të thotë aspak përgjegjës ndaj tyre. Nga ana tjetër, përse kohë që sistemi mbështet anonimitetin e këshilltarëve, ata nuk mund t'i përfaqësojnë qytetarët, sepse nuk njihen prej tyre. Duke qenë të zgjedhur krejtësisht me anë të mbështetjes partiake, këshilltari është i prirur që së pari dhe më së shumti të përmbushë detyrimet partiake dhe më pas ato që i përkasin komuniteteve vendore. Megjithëse këto nuk janë gjithmonë të ndara, ato nuk përputhen gjithnjë. Kurdoherë që interesat dhe nevojat partiake nuk përputhen me interesat e qytetarëve, të parat kanë përparësi. Siç tregon edhe sondazhi ynë me këshilltarët, ata i dedikojnë më shumë kohë angazhimeve të tyre politike sesa atyre që lidhen me punën nëpër komisionet e këshillit apo punën e këshillit bashkiak në përgjithësi.

¹³ Ky është betimi i këshilltarëve kur marrin detyrën: Unë betohem në emër të zgjedhësve që më votuan, të mbroj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe gjithë ligjet e saj. Unë betohem që gjatë gjithë aktivitetit tim do të udhëhiqem nga interesat e qytetarëve [emri i komunës ose bashkisë] dhe do të punoj ndershëmrisht dhe devotshmërisht për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies. Shih Nenin 28 të Ligjit Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore.

Përparësitë e sistemit proporcional në qeverisjen lokale në Shqipëri

Mangësitë e mësipërme nuk janë thjesht problematike për një periudhë afatshkurtër. Akoma më shqetësues është fakti se ato kërcënojnë demokratizimin e qeverisë vendore në të ardhmen. Megjithatë, sistemi zgjedhor në fuqi ka disa përparësi të rëndësishme, të cilat shpjegojnë edhe qenien e tij ende në fuqi. Së pari, sistemi proporcional prodhon këshilltarë të shkolluar. Sipas statistikave zyrtare në Shqipëri, shumica e këshilltarëve në pjesën më të madhe të bashkive të mëdha kanë arsim të lartë. Megjithëse të dhënat nuk janë të plota, në bashkitë e Durrësit, Vlorës dhe Elbasanit më shumë se 90% e këshilltarëve kanë arsim të lartë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për bashkitë e tjera të mëdha.¹⁴ Krahasuar me mesataren shqiptare, këta këshilltarë janë shumë më të arsimuar. Cilësia e këshilltarëve është një çështje thelbësore, sepse një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet qeveria vendore është cilësia e ulët e këshilltarëve në përgjithësi. Në shumicën e rasteve këshilltarëve u mungon koha e nevojshme, energjia dhe njohuria që të merren më çështjet e qeverisë vendore. Ata nuk mund të përballen apo të analizojnë propozimet e administratës vendore. Nga kjo pikëpamje, këshilltarët e arsimuar janë një pasuri e rëndësishme.

Sidoqoftë, ne po punojmë këtu nën hamendjen sipas së cilës qytetarë më të arsimuar janë këshilltarë më të mirë. Kjo hamendje nuk është domosdoshmërisht e vërtetë, megjithëse shumë joshëse. Niveli më i lartë arsimor nuk sjell patjetër këshilltarë më cilësorë, veçanërisht në mungesë të një lidhjeje të qartë mes tyre dhe qytetarëve. Kjo është edhe më e vërtetë duke ditur se sistemi proporcional në fuqi i detyron këshilltarët t'i jenë besnikë partisë politike dhe i detyron ata t'u binden vendimeve të saj edhe atëherë kur ata nuk janë në një mendje. Me cilësi ne nuk kuptojmë thjesht nivel arsimor, por edhe shkallën e njohjes nga këshilltari dhe shkallën e përfaqësimit nga ai të shqetësimeve të komunitetit. Në fakt, megjithë nivelin shumë të lartë arsimor, këshillat bashkiakë nuk e kanë përmbushur misionin e tyre përse i përket përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Një përparësi tjetër e rëndësishme e sistemit proporcional, duke pasur parasysh eksperiencën e hidhur zgjedhore në Shqipëri, është se ky sistem çon në zgjedhje të lira dhe të ndershme. Shqipëria mbizotërohet nga një klimë politike shumë e polarizuar, sidomos gjatë zgjedhjeve. Në fakt, siç tregon eksperiencia e zgjedhjeve parlamentare, elementi mazhoritar ka qenë një nga burimet kryesore të konfliktit. Në një sistem mazhoritar kandidatët e njohin njëri-tjetrin dhe luftojnë për një zonë të caktuar zgjedhore. Konkurrimi është i prirur të jetë në plan më personal dhe shumë i ashpër. Në shumë raste një gjë e tillë ka sjellë përplasje të forta mes kandidatëve, edhe kur direktivat e partisë kanë qenë të kundërta. Një sistem zgjedhor proporcional e eviton diçka të tillë, sepse e bën konkurrimin më pak personal dhe më të lehtë për t'u administruar. Në këtë mënyrë ka më pak vend për ndërhyrje dhe abuzim.

Një sistem proporcional është më i lehtë për t'u administruar dhe më pak vend për abuzim edhe sepse është më pak i kushtueshëm. Kjo në fakt është një nga arsyet kryesore pse ky sistem është ende i prirur të jetë në fuqi. Një sistem mazhoritar me shumë zona zgjedhore dhe kandidatë do të ishte shumë më i kushtueshëm nga pikëpamja financiare dhe shumë më i vështirë për t'u administruar nga pikëpamja e numërimit të votave. Të dyja këto mangësi janë shumë të rëndësishme, duke ditur se Shqipëria ka kaluar përmes një sërë zgjedhjesh me probleme në këto vite. Sidoqoftë, këto mangësi u përkasin më shumë kushteve të tanishme dhe jo përpjekjeve për demokratizim në të ardhmen, kur këto të fundit duhet të peshojnë më tepër në zgjedhjen mes dy sistemeve.

¹⁴ Republika e Shqipërisë. Ministria e Decentralizimit dhe Pushtetit Lokal: Të dhëna mbi popullsinë dhe burimet njerëzore

Një sistem mazhoritar

Deri tani jemi marrë me disa nga pasojat negative që sjell sistemi elektoral aktual i proporcionalit të pastër në pushtetin vendor. Gjithashtu jemi përqendruar edhe tek disa nga avantazhet e këtij sistemi, pasi ato përbëjnë disavantazhet e një sistemi elektoral alternativ, atij mazhoritar. Në të njëjtën mënyrë do të përqendrohemi tek përparësitë dhe të metat e një sistemi elektoral mazhoritar, ndonëse në këtë rast argumenti ynë themelor është se ky sistem ofron më shumë mundësi për konsolidimin e demokracisë në nivelin lokal.

Në përkufizimin tonë sistemi elektoral mazhoritar do të thotë një sistem në të cilin bashkia është e ndarë në zona elektorale sipas lagjeve apo ndarjeve ekzistuese administrative. Secila prej tyre zgjedh përfaqësuesin (ose përfaqësuesit në varësi të popullatës) e saj në këshillin bashkiak. Natyrisht që këta përfaqësues duhet të jenë anëtarë të përhershëm të komunitetit që përfaqësojnë në këshillin bashkiak. Në këtë sistem qytetarët votojnë për emra të veçantë, qofshin këta kandidatë të pavarur apo të mbështetur nga subjekte politike, dhe jo vetëm për një subjekt të caktuar politik.

Përparësitë e një sistemi mazhoritar

Përparësi kryesore e një sistemi të tillë elektoral është fakti se ai e institucionalizon marrëdhënien këshilltar–qytetar, duke e ngushtuar ndjeshëm hendekun ekzistues midis autoriteteve vendore dhe komuniteteve lokale. Këshilltarët përfaqësojnë një elektorat të caktuar, të cilit jo vetëm i përkasin, por edhe i raportojnë. Një përfaqësim i tillë është i domosdoshëm për të mbrojtur dhe avancuar interesat e komuniteteve të ndryshme brenda bashkisë. Për momentin përfaqësimi gjeografik, aty ku ekziston, është tërësisht i rastësishëm. Kjo pasqyrohet edhe në pabarazinë në rritje, si përsa i përket infrastrukturës, ashtu edhe të ardhurave për kokë, midis zonave të ndryshme të bashkisë. Komunitetet periferike pothuajse nuk e ndikojnë aspak procesin e vendimmarrjes dhe investimet janë të përqendruara kryesisht në qendrat e bashkive, duke i kushtuar kështu gjithnjë e më pak vëmendje periferive. Kjo ndodh jo vetëm si pasojë e mungesës së përfaqësimit gjeografik, por edhe për shkak të mungesës së fondeve si dhe të gjendjes së mjerueshme të shumë qendrave nëpër bashkitë e Shqipërisë. Megjithatë, një sistem mazhoritar do të impononte më shumë vëmendje ndaj të gjitha zonave të qytetit, duke përfshirë edhe zonat më periferike.

Qytetarët janë më të përfaqësuar dhe mund të ndikojnë më lehtë në procesin e vendimmarrjes në një sistem ku çdo zonë elektorale brenda qytetit zgjedh përfaqësuesin e vet në këshill. Gjithashtu edhe vetë këshilltarët do të kenë një shtysë më të madhe për të tejçuar shqetësimet e komunitetit që ata përfaqësojnë tek organet e pushtetit vendor, jo vetëm sepse i përkasin këtij komuniteti, por edhe pasi janë të interesuar të rizgjidhen. Shtysa për të ndërvepruar më shumë me qytetarët në këtë rast nuk është artificiale, por pjesë e sistemit, çka nënkupton më shumë njohuri mbi këshilltarët dhe këshillin nga ana e qytetarëve. Një njohuri e tillë është e domosdoshme, ndonëse jo e mjaftueshme, që qytetarët t'i kërkojnë llogari pushtetarëve vendorë.

Në këtë mënyrë mund të ngushtohet hendeku midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Kjo do të thotë më shumë llogaridhënie nga ana e autoriteteve vendore, pasi qytetarët do të dinë kujt t'i drejtohen për të kërkuar shpjegime apo llogari për problemet e tyre apo të komunitetit. Ky proces përbën edukimin politik të qytetarit, pasi tashmë nuk është e nevojshme që qytetarit t'i mësohen të drejtat apo emrat e këshilltarëve, sepse kjo ndodh natyrshëm nga vetë dinamika e sistemit. Edukimi politik shtrihet edhe më tej. Ai vjen edhe si rrjedhojë e faktit se në një sistem mazhoritar zgjedhjet bëhen më kuptimplota. Elektoratit i jepet mundësia të penalizojë ata këshilltarë që nuk kënaqin pritshmërinë e elektoratit. Qytetari voton dhe mund të zgjedhë midis emrave konkretë dhe jo thjesht midis partive politike që mund të prodhojnë kandidatë që

nuk gëzojnë simpatinë e elektoratit. Rrjedhimisht elektorati do të maturohet jo vetëm përse i përket funksioneve dhe detyrave të këshilltarit, por edhe në përzgjedhjen e atyre këshilltarëve që mund t'i përmbushin më mirë nevojat e tyre. Kjo metodë, ndonëse më afatgjatë, është shumë më efikase sesa fushatat e ndërgjegjësimit apo trajnimet me qytetarët.

Një tjetër përparësi e mazhoritarit është se ai mund të krijojë kushtet e nevojshme për zgjedhjen e këshilltarëve të pavarur në këshillin bashkiak. Natyrisht që kjo do të varet nga madhësia e zonave elektorale. Në çdo rast në zgjedhjet lokale zona elektorale do të jetë më e vogël se ajo e zgjedhjeve parlamentare, gjë që rrit mundësinë për zgjedhjen e kandidatëve të pavarur, nëse publiku është i pakënaqur nga kandidatët e propozuar prej subjekteve politike. Ky është një zhvillim pozitiv, po të kihet parasysh se dimensionin themelor i pushtetit vendor duhet të jetë trajtimi i çështjeve teknike që kanë të bëjnë me përditshmërinë e qytetarit.¹⁵ Është e vështirë të parashikohet se sa hapësirë do të krijojë një sistem elektorale mazhoritar për kandidatët e pavarur në Shqipëri. Diçka e tillë varet jo vetëm nga përmasa e zonës elektorale, por edhe nga mentaliteti elektorale i votuesit, pra në ç' masë ai/ajo voton për individin dhe në ç' masë vota është për partinë politike. Nëse kjo e fundit është faktori përcaktues për votuesin, atëherë ndryshimi i sistemit elektorale nuk do të sjellë ndonjë ndryshim thelbësor në konfigurimin politik të këshillave bashkiak.

Sipas testimeve të kryera nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN), në kontekstin shqiptar, ndonëse partia politike është një faktor themelor, qytetarët i kushtojnë një rëndësi mjaft të madhe edhe cilësive të kandidatit. Logjikisht kjo duhet të jetë edhe më e theksuar në zgjedhjet lokale. Kjo do të thotë se partia politike nuk është faktor tërësisht përcaktues. Sipas anketës së kryer me qytetarët, përqindja e të intervistuarve që deklaruan se do të votonin për kandidatin e një partie politike për të cilën nuk kanë simpati, nëse mendojnë se ai është kandidati më i mirë, ishte më e madhe se përqindja e atyre që deklaruan të kundërtën. Për më tepër partia politike vinte e katërta për nga rëndësia në zgjedhjen e votuesve, pas aftësive të individit, figurës morale të kandidatit dhe transparencës me qytetarët. Ndonëse rezultatet e vrojtimit me qytetarët nuk mund të na ofrojnë përgjigje përfundimtare, ato tregojnë qartë se partia politike nuk është i vetmi faktor që përcakton zgjedhjen e votuesit, sidomos po të kihet parasysh se një e treta e të intervistuarve nuk simpatizonin asnjë parti politike. Rrjedhimisht është më se e arsyeshme të presupozohet se kalimi nga një sistem elektorale proporcional në një sistem elektorale mazhoritar do ta rrisë edhe më tej rëndësinë e individit.¹⁶

Rritja e rëndësisë së individit mund të sjellë edhe rritjen e cilësisë së kandidatëve që zgjidhen në këshillin bashkiak. Në një sistem mazhoritar partitë politike do të synojnë përzgjedhjen e kandidatëve që gëzojnë popullaritet brenda komunitetit të tyre. Në këtë mënyrë ata do të kenë edhe një profil më publik dhe si rrjedhojë do të jenë edhe më të hapur ndaj qytetarëve, duke përfaqësuar kështu më mirë interesat e komunitetit të tyre. Kjo do t'i bëjë ata më cilësorë dhe jo thjesht përse i përket nivelit të edukimit. Në fakt, një dinamikë e tillë ka ndodhur tashmë me kryetarët e bashkive. Në shumicën dërrmuese të rasteve partitë zgjedhin kandidatë që janë popullorë dhe gëzojnë respektin e qytetarëve.

Gjithashtu në një sistem mazhoritar është më se e mundshme që një këshilltar i caktuar të gëzojë më shumë se një mandat nga zgjedhësit. Në të kundërt, nga vetë dinamika e tij, sistemi proporcional shoqërohet me një nivel të lartë qarkullimi të këshilltarëve. Sipas anketës së kryer

¹⁵ Shiko IDEA manual on electoral systems (manual mbi Sistemet Elektorale). http://www.idea.int/publications/esd/english/esd_english.pdf

¹⁶ Në sistemin e tanishëm elektorale, sipas Kodit Elektorale, "numri i votave të vlefshme të fituara nga një kandidat i pavarur ndahet me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme dhe shumëzohet me numrin e vendeve në këshill. Nëse rezultati është i barabartë ose më i madh se 1, atëherë kandidati i pavarur fiton një vend në këshillin bashkiak." Sa më e vogël të jetë bashkia aq më pak vota i duhen një kandidatit të pavarur për të fituar një vend në këshill. Megjithatë, në këtë sistem është më e vështirë për kandidatët e pavarur të fitojnë, pasi ata duhet të konkurrojnë në të gjithë qytetin dhe jo në një zonë të caktuar elektorale.

me këshilltarët, 77% e tyre ishin në këshillin bashkiak për herë të parë. Kjo ndodh pasi në sistemin proporcional lidhja midis këshilltarit dhe një elektorati të caktuar është inekzistente. Në sistemin mazhoritar kjo lidhje jo vetëm ekziston, por është edhe e fuqishme, gjë që e bën të natyrshme rikandidimin e individit për postin e këshilltarit bashkiak dhe krijon vazhdimësi në këshill. Kjo përbën një përparësi të rëndësishme të mazhoritarit.

Për të gjitha arsytet e mësipërme, një sistem mazhoritar në parim përmbush dy objektiva të ndërlydhura që përmirësojnë funksionimin e këshillit bashkiak. Nga njëra anë, ai lidh më mirë këshillin bashkiak me qytetarët. Nga ana tjetër, dhe si pasojë, rritet edhe profili dhe rëndësia e këshillit bashkiak si institucion. Nga një institucion realitivist anonim për momentin, ai kthehet në një institucion që gëzon legjitimitet përfaqësues, për faktin sepse zgjidhet direkt nga qytetarët. Në këtë mënyrë ai mund të shërbejë shumë më mirë si një institucion legjislativ dhe kontrolli në raport me ekzekutivin në pushtetin vendor. Duke përmbushur kështu edhe misionin që i është caktuar me ligj.

Mangësitë e një sistemi mazhoritar dhe disa zgjidhje të mundshme

Një nga mangësitë kryesore të një sistemi mazhoritar, si dhe përparësia themelore e proporcionalit, është fakti se ai prodhon shumica të mëdha në këshill. Në varësi edhe të shpërndarjes demografike të votuesve, ekziston mundësia që një parti politike të fitojë të gjitha vendet në këshillin bashkiak. Rrjedhimisht mund të krijohen bashki tërësisht “të kuqe” apo “blu”. Kjo do ta cenonte ndjeshëm funksionimin e këshillit bashkiak, pasi opozita është e domosdoshme për një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme. Megjithatë, në një sistem mazhoritar ekzistojnë dy faktorë që mund ta eliminojnë mundësinë e një zhvillimi të tillë ose që zbusin pasojat e tij, nëse ai ndodh.

Së pari, duhet theksuar se në një sistem mazhoritar ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis këshilltarëve dhe elektoratit të tyre. Edhe në mungesë të opozitës diçka e tillë mund të ulë ndjeshëm pasojat e një këshilli të dominuar nga një parti e vetme politike. Ndonëse këshilltarët mund t'i përkasin të njëjtës parti, ata së pari do të përgjigjen përpara elektoratit të tyre, gjithmonë nëse janë të interesuar për rikandidim. Kjo do të thotë që vetë komuniteti mund të luajë një rol më aktiv, duke ndikuar në mënyrë më direkte, nëpërmjet këshilltarëve, në procesin e vendimmarrjes. Së dyti, sistemi mazhoritar në nivel lokal mundëson futjen e kandidatëve të pavarur në këshillin bashkiak. Kuptohet që edhe në këtë rast mungesa e opozitës politike përbën një problem në vetvete.

Megjithatë, duhet theksuar se fitimi i të gjitha vendeve në këshill nga një forcë e vetme politike varet shumë nga shpërndarja demografike e votuesve si dhe nga madhësia e zonave elektorale. Nëse mbështetësit e një subjekti politik janë të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë territorin dhe nëse zonat elektorale janë të mëdha, atëherë është më se e mundur që në bashki të caktuara një subjekt politik mund të fitojë të gjitha vendet në këshillin bashkiak. Por sikurse është argumentuar edhe më sipër, zonat elektorale në një sistem elektorale mazhoritar në zgjedhjet lokale nuk mund të jenë shumë të mëdha (ndonëse Tirana mund të përbëjë një përjashtim në këtë drejtim). Gjithashtu është e vështirë që simpatizantët e një force politike të jenë të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë qytetin. Sa më të vogla zonat elektorale, aq më e mundur është që kandidatët e pavarur apo partitë e vogla politike të mund të përfaqësohen në këshillin bashkiak. Pra, gjithçka varet nga mënyra se si përcaktohen kufijtë e zonave elektorale, gjë që është shqetësuese, pasi përbën një shtysë reale për *gerrymandering* (deformimin e zonave elektorale).

Ky është një tjetër disavantazh i sistemit mazhoritar, jo vetëm deformimi i zonave elektorale, por edhe ecuria e procesit zgjedhor në përgjithësi. Mazhoritari krijon më shumë hapësira për parregullsi apo edhe manipulime në procesin zgjedhor si dhe krijon një klimë më të tensionuar politike në përgjithësi. Ky është një tjetër argument i fuqishëm kundër mazhoritarit. Sipas këtij argumenti, fakti që kandidatët konkurrojnë personalisht dhe e njohin njëri-tjetrin krijon më shumë mundësi për përplasje dhe parregullsi, pavarësisht nga vullneti i subjekteve politike. Individët kanë më shumë pavarësi dhe duke kërkuar të fitojnë garën elektorale e personalizojnë atë dhe mund të ndërmarrin edhe veprime që e cenojnë procesin elektorale.

Ndonëse ky argument qëndron dhe duhet marrë seriozisht, duhet theksuar se mundësia e konfliktit në nivelin lokal nuk është aq e lartë sa ç'mund të duket në pamje të parë. Fakti që kandidatët e njohin njëri-tjetrin, mund të jetë si faktor nxitës ashtu edhe frenues në garën elektorale. Fakti që kandidatët i përkasin të njëjtin komunitet, mund të jetë një arsye më shumë për uljen e tensioneve lokale. Për më tepër rëndësia më e pakët e zgjedhjeve lokale në krahasim me ato parlamentare e ul mundësinë e deformimit të procesit elektorale.

Megjithatë, edhe në mungesë të tensioneve lokale, sistemi mazhoritar mund të prodhojë këshilla bashkiakë që janë tejet të fragmentizuar për të qenë efikasë. Të paktën ky është një nga argumentet e ngritura nga kundërshtarët e sistemit mazhoritar. Sipas këtij argumenti, në momentin që çdo këshilltar do të përfaqësojë zonën e tij/saj elektorale, do të humbasë shqetësimi dhe vizioni për të mirën e përgjithshme të qytetit. Këshilltari mund të anashkalojë mangësitë apo abuzimet në administratën lokale për sa kohë tërheq investime në zonën e tij elektorale. Kjo do ta vështirësonte dhe komplikonte vendimmarrjen, sidomos pasi këshilltarët do të jenë më të pavarur nga subjektet politike. Në një periudhë afatgjatë kjo mund të dobësonte edhe vetë partitë politike, gjë që rrezikon vetë procesin e demokratizimit. Në sistemin e tanishëm elektorale këshilltarët përfaqësojnë të gjithë qytetin dhe jo zona të caktuara elektorale.

Ndonëse rreziku i fragmentarizimit mbetet, ai nuk është aq kërcënues sa parashtrohet nga kundërshtarët e sistemit mazhoritar. Kjo, për arsyen e thjeshtë se një fragmentarizim i tillë ekziston edhe në këshillat aktualë, sipas subjekteve politike, dhe është mjaft i thellë. Për më tepër ky fragmentarizim është i vështirë të imagjinohet, pasi lagjet apo njësitë e ndryshme administrative nuk kanë interesa të kundërta. Zonat elektorale janë pranë njëra-tjetrës dhe jo të izoluara, kështu që tubacionet, kanalizimet apo rrugët që ndërtohen në një zonë të caktuar përmirësojnë edhe infrastrukturën e zonave përreth. Ndonëse zona të ndryshme do të konkurrojnë për më shumë investime, debati do të jetë i përqendruar tek problemet e përditshmërisë dhe jo thjesht tek debatet politike të ditës, ndaj të cilave qytetarët mund të jenë tërësisht indiferentë. Qeverisja lokale, përtej debateve politike, duhet të fokusohet gjithnjë edhe më shumë në çështjet teknike, që përbëjnë shqetësim primar për komunitetet lokale. Kjo mund ta komplikojë vendimmarrjen, por edhe do të përmirësojë përcaktimin e prioritetëve nga organet vendore, pasi ato do të pasqyrojnë më mirë nevojat e qytetarëve, të paktën përsa kohë këshilltarët mbeten të dedikuar ndaj nevojave të komunitetit të tyre.

Duhet theksuar se në sistemin aktual dedikimi i këshilltarëve vjen si pasojë e përkatësisë partiake. Ai është i nevojshëm në mënyrë që t'i krijojë mundësi individit për të pasur një karrierë politike brenda partisë. Sikurse e tregon edhe anketimi ynë, shumica dërrmuese e këshilltarëve janë në këshillin bashkiak prej partisë politike që ata përfaqësojnë. Qenia në këshill do të thotë të përmbushësh një detyrim politik. Në momentin që lidhja midis këshilltarit bashkiak dhe partisë politike dobësohet ose edhe eliminohet, atëherë mund të krijohen një sërë komplikimesh. Më shqetësues nga këta është niveli i përkushtimit të këshilltarëve. A do të mbeten këshilltarët të përkushtuar jashtë mbikëqyrjes së partisë politike? Kjo është një pyetje mjaft e vështirë. Sidomos në bashkitë e mëdha puna që pritet nga këshilltarët është mjaft e madhe, ndërkohë që shpërblimi financiar mjaft i vogël. Rrjedhimisht këshilltarët e pavarur, në mungesë të disiplinës partiake, mund të mos e ruajnë nivelin e përkushtimit, veçanërisht nëse ata nuk janë të interesuar për t'u zgjedhur për një mandat të ri. Në sistemin aktual partia politike luan rolin e një mekanizmi korrektues, duke i disiplinuar këshilltarët, duke bërë ndarjen e detyrave dhe

organizimin e punës. Në mungesë të një prezence të fortë nga partitë politike në kushtet aktuale, këshilltarët mund të bëjnë një punë më të dobët.

Në mënyrë që të eliminohet ky problem, është e rëndësishme që ndryshimi i sistemit elektoral të shoqërohet edhe me një sërë masash të tjera. Së pari, është e rëndësishme që këshilltarët të kenë një dimension më publik si dhe të rritet rëndësia e postit të këshilltarit bashkiak. Kjo nuk do të thotë dhënia e më shumë kompetencave, por krijimi i nxitjeve financiare dhe lehtësirave të tjera që mund të përmirësojnë punën e këshilltarëve. Megjithatë, këto masa nuk do ta eliminojnë tërësisht problemin në fjalë. Ky problem është tepër i vështirë për t'u evituar në një periudhë afatshkurtër. Përparësia e sistemit mazhoritar qëndron në faktin që ai i jep mundësinë popullatës lokale për ta korriguar këtë problem. Elektoratit i jepet mundësia të penalizojë ata këshilltarë, performanca e të cilëve lë për të dëshiruar. Kuptohet, kjo do të ndodhë pas një periudhe të caktuar kohore me maturimin e elektoratit. Ky është procesi i edukimit politik në demokraci dhe nuk ka mënyrë më të mirë për të mësuar demokracinë sesa duke e ushtruar atë.

Zvogëlimi i numrit të këshilltarëve do ta rriste rëndësinë e postit të këshilltarit bashkiak si dhe nivelin e përgjegjshmërisë së tyre. Rëndësia e çdo këshilltari është në disproporcion me numrin e përgjithshëm të këshilltarëve, d.m.th. sa më i madh numri i këshilltarëve aq më pak i rëndësishëm është një këshilltar në veçanti. Për momentin në bashkitë e kategorisë së parë, me përjashtim të Tiranës, një këshilltar përfaqëson rreth 2500 banorë. Ky është një numër relativisht i vogël, po të kihet parasysh se një deputet përfaqëson pothuajse dhjetë herë më shumë qytetarë. Nëse një zonë e caktuar elektorale do të kishte 5000 banorë, atëherë numri i këshilltarëve do të përgjysmohej. Në të njëjtën kohë një zonë e tillë elektorale është mjaftueshmërisht e vogël për ta ruajtur marrëdhënien këshilltar–qytetar, sidomos në bashkitë me popullatë më të vogël, p.sh. nën 50 000 banorë, ku raporti i përfaqësimit është mesatarisht një këshilltar për 1200 banorë. Në të gjitha këto raste numri i këshilltarëve mund të zvogëlohet duke ruajtur lidhjen e tyre me qytetarët. Këto zona të vogla elektorale rrisin edhe mundësinë e përfaqësimit të grupeve në minoritet, si ato politike ashtu edhe të tjerat, gjë që normalisht nuk është pasojë e sistemit mazhoritar, por përkundrazi konsiderohet si një nga mangësitë e këtij sistemi.

Akoma më problematike është shkalla në të cilën qeverisja vendore bie pre e interesave mafioze apo klanore, veçanërisht nëse sistemi mazhoritar shoqërohet me një zvogëlim të numrit të këshilltarëve, gjë që e bën më të lehtë kapjen e këshillit nga këto interesa. Ndonëse edhe për momentin këto interesa e ndikojnë vendimmarrjen e qeverisë lokale, ato kanalizohen kryesisht nëpërmjet degëve lokale të partive politike. Si rrjedhojë, ndikimi i tyre është më i kufizuar, pasi partitë politike kanë një shkallë relativisht të lartë centralizimi, që shpesh mund ta ndalojë penetrimin e këtyre interesave në vendimmarrjen lokale. Në sistemin mazhoritar ka më shumë decentralizim përse i përket përzgjedhjes së kandidatëve lokalë. Interesat klanore apo mafioze mund të konsolidohen rreth këtyre kandidatëve dhe të kontrollojnë procesin e vendimmarrjes.

Në rastin e Shqipërisë, ky është një shqetësim tepër konkret, pasi kapja e shtetit është një fenomen në rritje dhe është i pranishëm edhe në nivelin parlamentar. Ndonëse ky problem nuk mund të eliminohet lehtë, sistemi mazhoritar ofron disa mekanizma për ta luftuar atë. Nëse realizohet një proces elektoral i rregullt, votuesit i jepet mundësia për të zgjedhur midis kandidatëve të ndryshëm. Është vendimi i votuesit ai që përcakton nëse një kandidat i korruptuar ose që përfaqëson interesa klanore apo mafioze do të zgjidhet ose jo, veçanërisht nëse sistemi mazhoritar i krijon mundësinë edhe kandidatëve të pavarur për t'u zgjedhur.

Së fundi, një nga argumentet bazë që përdoret kundër një sistemi mazhoritar është fakti që ky sistem është shumë më i kushtueshëm sesa sistemi proporcional. Kjo në fakt duket se është një nga arsyet themelore përse një sistem i tillë preferohet në vende si Shqipëria. Më shumë kërkime duhen bërë për të përcaktuar me saktësi koston reale të një sistemi mazhoritar për zgjedhjet vendore në Shqipëri dhe nëse ai është i përballueshëm në të ardhmen e afërt. Megjithatë, duhet pasur parasysh se sado i kushtueshëm të jetë një sistem mazhoritar, kostoja në vetvete përbën një konsideratë momentale, e cila nuk duhet t'u mbivendoset vizioneve afatgjata

për konsolidim demokratik. Kështu, në një periudhë afatgjatë mund të jetë sistemi proporcional ai që i kushton më shumë vendit. Pra, kostoja e një sistemi elektoral mazhoritar në rastin me keq mund ta vonojë, por jo evitojë vendosjen e një sistemi të tillë.

Konkluzion: Përse një sistem elektoral mazhoritar?

Logjika e decentralizimit dhe e fuqizimit të qeverisjes lokale nuk nënkupton thjesht më shumë efikasitet, por mbi të gjitha më shumë demokraci. Në fakt, argumenti se decentralizimi e rrit efikasitetin bazohet në presupozimin se qeverisja vendore ka më shumë përgjegjshmëri ndaj qytetarëve se ajo qendrore.¹⁷ Qeverisja lokale është pikënisja më e mirë për ngushtimin e hendekut midis atyre që qeverisin dhe atyre që qeverisen. Sa më shumë të thellohet ky hendek aq më shumë rrezikohet demokratizimi. Kjo përbën në vetvete sfidën më të madhe me të cilën përballet demokracia shqiptare në të tashmen dhe me sa duket edhe në të ardhmen. Në kuadrin e qeverisë lokale këshilli është ai institucion që duhet të shërbejë si urë lidhëse midis komunitetit dhe pushtetit vendor. Për më tepër kur decentralizimi nënkupton fuqizimin e mëtejshëm të këtij institucioni. Një proces që duhet të shoqërohet me më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri për ta sjellë qeverisjen më pranë nevojave të qytetarit. Në të kundërt, inefikasiteti, praktikat korruptive dhe jodemokratike thjesht do të transferoheshin nga niveli qendror në atë lokal, çka e bën vet decentralizimin të padëshirueshëm.

Pikërisht në këtë aspekt qëndron përparësia themelore e një sistemi mazhoritar. Në këtë sistem pjesëmarrja qytetare është një produkt i natyrshëm i dinamikës politike që prodhon vetë sistemi. Në këtë mënyrë përpjekjet për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje nuk mbeten artificiale apo sporadike, por vijjnë si pasojë e nismave të ndërmarra nga vetë këshilltarët, gjë që garanton vazhdimësinë e pjesëmarrjes qytetare.

Për sa kohë përfaqësuesit vendorë janë të interesuar të dinë opinionin e publikut, pjesëmarrja qytetare është e garantuar. Si pasojë e sistemit elektoral aktual iniciativat qytetare nuk përbëjnë çështje të ndonjë interesi të veçantë për sa kohë këshilltarët përgjigjen para së gjithash para partive politike dhe jo komunitetit lokal. Kjo është arsyeja përse iniciativa të tilla mbeten artificiale apo bazohen thjesht tek fushata ndërgjegjësimi.

Është e vështirë të ndërtohet një traditë demokratike duke mbështetur vetëm tek ndërgjegjësimi qytetar. Ndonëse ndërgjegjësimi është i rëndësishëm, gjetjet tona tregojnë se interesi është faktori primar.

Në këtë aspekt sistemi mazhoritar ka dy avantazhe themelore. Së pari, ai mundëson lidhjen midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve. Së dyti, si pasojë e kësaj marrëdhënieje rritet edhe profili i këshillit bashkiak. Në këtë mënyrë këshilli bashkiak nuk është më një organ relativisht anonim tërësisht në funksion të kryetarit të bashkisë, por edhe një instrument që shërben për përcaktimin prioriteteve apo për shpërndarjen dhe kontrollimin e investimeve sa më në harmoni me nevojat e qytetarëve. Ky është edhe misioni i këshillit bashkiak sipas ligjit për pushtetin vendor, mision që pjesërisht për pasojë të sistemit elektoral mbetet ende në letër.

Fatkeqësisht kjo nuk ka ndodhur veçanërisht si pasojë e sistemit ekzistues elektoral. Këshilltarët zgjidhen nëpërmjet një sistemi të pastër proporcional nga listat e partive politike. Qytetarët votojnë për partinë politike dhe më pas çdo parti fut në këshill një numër këshilltarësh në proporcion me përqindjen e votave që ka fituar. Kjo do të thotë që këshilltarët kanë më shumë përgjegjësi ndaj partisë politike që i ka kandiduar sesa ndaj komunitetit që përfaqësojnë teorikisht në këshill. Për më tepër ata nuk përfaqësojnë ndonjë zonë të caktuar elektorale, por të gjithë qytetin. Meqenëse numri i këshilltarëve në bashkitë e mëdha është mjaft i madh, ata

¹⁷ *Decentralization in the Transition Economies: Challenges and the Road Ahead*. Poverty Reduction and Economic Management Unit for Europe and Central Asia. The World Bank. June 14, 2001 Page 7.

njihen shumë pak nga qytetarët, gjë që u pasqyrua edhe në rezultatet e anketës tonë me qytetarët. Vetë sistemi elektoral nuk e nxit ndërveprimin midis qytetarëve dhe këshilltarëve. Jo vetëm që këshilltarët nuk njihen nga qytetarët, por ata as nuk kanë ndonjë nxitje për t'u bërë të njohur, pasi zgjidhen nëpërmjet listave partiake. Natyrisht që mosnjohja është një shkas më shumë për të nxitur perceptimet ekzistuese mbi nivelin e lartë të korrupsionit.

Në këto kushte bëhet e domosdoshme gjetja e mekanizmave nëpërmjet të cilave qytetarët mund të lidhen me këshilltarët. Sistemi elektoral më i përshtatshëm për këtë qëllim është mazhoritari. Në një sistem të tillë bashkia është e ndarë në njësi administrative apo në lagjet ekzistuese, të cilat përbëjnë zona elektorale dhe zgjedhin përfaqësuesin (ose përfaqësuesit, në varësi të popullatës) e tyre në këshillin bashkiak. Një sistem i tillë, së pari, i bën më të njohur këshilltarët, pasi tashmë qytetarët votojnë për një emër konkret dhe jo për një parti politike. Kjo mund të sjellë edhe më shumë përgjegjshmëri në qeverisje, pasi qytetarët do të dinë kujt t'i drejtohen për të kërkuar llogari. Në të njëjtën kohë edhe vetë këshilltarët janë të interesuar të ndërveprojnë më shumë me elektoratin e tyre, nëse duan të rizgjidhen. Pra, motivimi për më shumë ndërveprim dhe informacion ekziston në të dyja palët, qytetarë dhe këshilltarë, pasi ai tashmë imponohet nga vetë sistemi elektoral.

Natyrisht nuk është e lehtë të ndryshosh sistemin elektoral, sidomos po të kihet parasysh se edhe sistemi mazhoritar ka mangësitë e veta. Megjithatë, një analizë krahasuese midis këtyre sistemeve tregon se mazhoritari ka një përparësi të dukshme përse i përket krijimit të kushteve të nevojshme për më shumë demokratizim. Sistemi elektoral ekzistues është një nga faktorët pengues përse i përket zhvillimit të demokracisë lokale. Ai i ka kthyer gjithnjë e më tepër këshillat bashkiakë në instrumente partiake dhe jo në forume të demokracisë lokale. Me decentralizimin e mëtejshëm të pushtetit dhe teksa këshillat marrin më shumë kompetenca, partitë politike do të synojnë gjithnjë e më tepër t'i kenë ato nën kontroll, gjë që mund të krijojë probleme për demokratizimin e pushtetit vendor në të ardhmen.

NË KËRKIM TË KIMERËS: NË KUFINJTË E TEORIVE TË PËRFAQËSIMIT

DR. ERMAL HASIMJA*

Abstrakt. Shumica e konceptimeve të përfaqësimit synojnë të ngurtësojnë shpjegimin e legjitimitetit të tij duke u nisur nga objekte esencialiste (identitete, interesa, opinione, etj). Në pamundësi për të arritur në një përkufizim unik të përfaqësimit, këto modele nuk bëjnë gjë tjetër veçse privilegjojnë njërin aspekt në raport me të tjerët. Ndryshe nga këto prirje, në këtë shkrim paraqes një konceptim alternativ të përfaqësimit që mbështetet në pranimin e polisemisë (shumëkuptimisë) së marrëdhënieve mes të përfaqësuarve dhe përfaqësuesve. Një konceptim i tillë mbështetet edhe në kritikën që u bëhet modeleve klasike identitare nga filozofia e gjuhës, psikanaliza apo dekonstruktivizmi. Njëkohësisht e shikoj si të rëndësishme prirjen për të shpjeguar kuptimin e përfaqësimit nisur nga kuptimi që i japin atij vetë të përfaqësuarit. Si i tillë, përfaqësimi lidhet me vendimin e votuesve për të mbështetur një projekt të caktuar politik, cilido qoftë perceptimi i tyre për projektin dhe për raportin që kanë me të.

Hyrje

Analiza e përfaqësimit në ditët e sotme është shumëpërmasore. Nga pikëpamja teorike kemi problemin e përshtatjes së përfaqësimit me demokracinë në sfondin e një debati të nisur që nga koha e Rousseau-it. Nga pikëpamja institucionale, është e nevojshme që kjo përshtatje të bëhet operationale dhe të mundësojë jo vetëm përfshirjen, por edhe balancimin e përfaqësimit në nivel shoqëror. Jo më pak i rëndësishëm është problemi i grupeve të skajuarra si dhe të diskriminuara; një problem që del në dritë pikërisht kur përfaqësimi bëhet i përgjithshëm dhe kur bëhet e qartë se disa individë apo grupe mund të përfaqësohen më mirë se disa të tjerët. Në tryezën e punës imponohen pyetjet e mëdha që janë çelësi i zgjidhjes së problemeve të mëparshme: çfarë përfaqësohet dhe si?

Shumica e analizave mbi përfaqësimin politik në ditët e sotme përqendrohen te “kriza e përfaqësimit”. Ky tekst, përkundrazi do të trajtojë një tjetër “krizë”, atë të konceptimeve teorike të përfaqësimit. Një nga arsyet përse e shoh këtë si të rëndësishme, është sepse “kriza e përfaqësimit” mund të vijë në jetë pikërisht dhe kryesisht për shkak të vështirësisë për të identifikuar një model të vetëm përfundimtar të përfaqësimit. Rrjedhimisht, analizat mbi “krizën e përfaqësimit” ose bien në kurthin e lehtësisë publicistike për të gjetur *Burimin* unik të problemit, ose prirjen të ndërtohen mbi konceptime të tejkaluara, simpliste dhe ideal-tipike të

* Dr. Ermal Hasimja është politolog dhe lektor në Universitetin Europian të Tiranës. Fushat e tij të studimit janë kryesisht teorinë e përfaqësimit, teorinë e demokracisë, sjelljet politike dhe komunikimi politik. Për më tepër informacion: www.hasimja.com.

përfaqësimit. Në këtë tekst fillimisht do të parashtrij disa nga konceptimet kryesore, jo për të dhënë informacion, por për të argumentuar vështirësinë e gjetjes së një modeli unik dhe arsytet e saj. Më pas do të trajtoj shkurtimisht sfidat që paraqesin për teorinë e përfaqësimit pozicione bashkëkohore të ndërtuara mbi filozofinë e gjuhës, psikanalizën apo filozofinë e sotme politike. Këtu do të jetë i pashmangshëm trajtimi i identitetit. Në përfundim do të përpiqem të ofroj një konceptim alternativ personal të përfaqësimit, përtej përpjekjeve me prirje esencialiste, agregative dhe unifikuese.

Konceptimet bashkëkohore të përfaqësimit

Fillimisht duhet thënë se bollëku i konceptimeve të përfaqësimit, po aq sa dhe paqëndrueshmëria e tyre, varet drejtpërdrejt nga proliferimi i teorive të demokracisë. Zakonisht, përcaktimi i një qëndrimi ose modeli të demokracisë, përkufizon edhe modelin e përfaqësimit. Mund të konstatojmë shkurtimisht se qoftë demokracia, qoftë përfaqësimi, hapen ndaj pluralitetit të konceptimeve vetëm atëherë kur nuk ballafaqohen më me sisteme aristokratike ose autoritare, por me opsionet e shumta të sistemeve moderne perëndimore.

Përkufizimet e para tashmë klasike të përfaqësimit ofrohen nga Hanna Pitkin-i (Pitkin, 1971). Më tepër sesa ofrimin e ndonjë modeli, tundim i përhershëm mes teoricienëve të fushës, ajo kontribuon me përkufizimin e dilemave. Përfaqësuesin mund ta konsiderojmë si të deleguar (*delegate*), ose si të besuar (*trustee*). Një i deleguar në kuvend do të përcillte drejtpërdrejt dhe rreptësisht qëndrimin e të përfaqësuarve, ndërsa një i besuar do të mund të përfitonte prej njëfarë pavarësie dhe besimit të votuesve tek aftësia e tij për t'i përfaqësuar. Pitkin-i e dyfishon dallimin duke shtuar dikotominë mes përfaqësimit si "*standing for*" (*delegate*) dhe "*acting for*" (*trustee*). Duke qenë e ndërgjegjshme për problemet dhe madje edhe pamjaftueshmërinë e këtyre dikotomive, Pitkin-i shton se përfaqësimi duhet parë metaforikisht si një objekt të cilin studiues të ndryshëm e shohin përmes "flash-it" të vet në një dhomë të errët. Secili sheh vetëm njërin aspekt, por jo të gjithin. Elementi i llogaridhënies është i rëndësishëm natyrisht, po aq sa ai i autorizimit që e paraprin.

Një nga përkufizimet më të hollësishme bashkëkohore mbetet ai i Jane Mansbridge-it (Mansbridge 1998, 2003, 2004). Në fakt, e ndeshur me të njëjtën vështirësi përkufizuese Mansbridge-i ndërton katër modele që nuk përjashtojnë plotësisht dhe në çdo rast njëri-tjetrin, madje mund të ndërthuren. Përfaqësimi premtues përshkruan një marrëdhënie në të cilën votuesi V ushtron pushtet mbi përfaqësuesin P në momentin T duke e shtyrë të realizojë një premtim të bërë pasi të marrë votën në çastin $T1$,

$$VT1 \rightarrow PT2.$$

Përfaqësimi parashikues funksionon mbi bazën e përllogaritjes që përfaqësuesi bën për preferencat e votuesit në të ardhmen dhe jo në çastin aktual,

$$PT2 \leftarrow VT3.$$

Në këtë rast marrëdhënia e pushtetit, përsëri është konceptuar në formën klasike veberiane, por e kthyer mbrapsht. Ky lloj përfaqësimi kërkon shpalosjen e të gjithë arsenalit të komunikimit mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, qoftë për informimin mbi preferencat në kohën $T3$, qoftë për mundësinë e ndikimit të këtyre preferencave. Dallimi kryesor mes këtyre dy modeleve të para është se vetëm ai premtues përfshin mundësinë e plotë të llogaridhënies, ndërsa i dyti fokusohet më tepër te autorizimi. Gjithashtu tek modeli parashikues, Mansbridge-i bën një paralelizëm interesant me mekanizmin e tregut. Votuesit dhe përfaqësuesit shikohen të përfshirë në një marrëdhënie të ndërsjellë ndikimi. Përfaqësuesit ndikohen nga preferencat e votuesve, po aq

dhe përpiqen t'i orientojnë ato. Një pikëpamje që në fakt mbështesin autorët e teorive të sjelljes racionale si Downs (1997), Przeworski (1999), Hardin (1980, 2004), apo më vonë edhe autorë të sotëm të psikologjisë politike si Lupia & Popkin (2000).

Përfaqësimi xhroskopik e shikon përfaqësuesin si të orientuar nga idetë dhe qëndrimet e tij. Ky model i afrohet më tepër konceptimit të përfaqësuesit si “*trustee*” në një *modus operandi* të tipit “*acting for*”. Modeli i katërt i Mansbridge-it, përfaqësimi surrogat, e shkëput përfaqësuesin prej kufizimit gjeografik dhe vendos një lidhje të drejtpërdrejtë mes tij dhe një grupi të caktuar, pa çuar detyrimisht dhe ekskluzivisht të përfaqësimi i plotë përshkrues. Kështu një përfaqësues surrogat nuk përfaqëson votuesit e zonës së tij, por grupe të caktuara shoqërore, të cilave zakonisht u bëhet zëdhënës apo mbrojtës. Grupe të tilla mund të mos jenë fare pjesë e zonës së tij zgjedhore (p.sh. një senator amerikan që përfaqëson të gjithë homoseksualët, zezakët, portorikanët, veteranët e Vietnamit, etj). Siç shihet, Mansbridge-i nuk mëton t'i përgjigjet përfundimisht pyetjes se çfarë përfaqësohet, ose të paktën jo përmes një modeli unik. Në fakt, modelet e saj më tepër i përgjigjen pyetjes si realizohet marrëdhënia e përfaqësimit sesa asaj se çfarë përfaqësohet.

Nadia Urbinati (1998) ofron një konceptim origjinal të orientuar më tepër drejt përfaqësimit si “*acting for*”. Ajo e konsideron përfaqësimin si avokatësi (*advocacy*). Një përfaqësues i tillë ka dy veçori: “një lidhje të pasionuar të përfaqësuesit me çështjet e zgjedhësve” dhe “një shkallë të caktuar autonomie të përfaqësuesit në gjykimin e tij”. Një aspekt i rëndësishëm i këtij konceptimi sipas Urbinati-t është hapja e shtegut të lirë për njëfarë agonizmi në skenën parlamentare. Konceptimi origjinal i Urbinati-t hedh dritë mbi trysninë teorike të orientuar drejt përshtatjes së modeleve ideal-tipike të demokracisë me realitetin e përfaqësimit. Vetë Urbinati mendon se nuk ka asnjë mënyrë për ta bërë përfaqësimin të jetë çfarë s'mund të jetë, domethënë një zëvendësues i vlefshëm për demokracinë e drejtpërdrejtë¹. Autorë të tjerë si Iris Marion Young (Young 2000) mendojnë se e kundërta e përfaqësimit nuk është domosdoshmërisht pjesëmarrja e drejtpërdrejtë, por përjashtimi (*exclusion*). Jo vetëm kaq, por përfaqësimi shihet natyrisht si një formë e zhvendosur, por sidoqoftë më e lartë e pjesëmarrjes. Duhet theksuar se pikëpamjet e autorëve të tillë mbështeten fuqimisht në mbrojtjen e kuvendimit (*deliberation*) publik, përfshirë edhe versionin agonist të tij.

Çështja e përfaqësimit të grupeve të skajuar dhe atyre të diskriminuara është qendrore dhe e pashmangshme praktikisht për të gjithë autorët. Suzane Dovi (2002), mbrojtëse e flaktë e përfaqësimit përshkrues (*descriptive*) mendon se përkatësia objektive në një grup (etnik, kulturore, social, etj) nuk mjafton për të qenë një përfaqësues i mirë i grupit. Përfaqësuesi duhet të jetë “një prej nesh” (*one of us*), pra duhet të jetë shpirtërisht i lidhur me kauzën e grupit që përfaqëson. Prandaj jo çdo femër apo çdo zezak mund të përfaqësojnë denjësisht femrat apo zezakët në parlament. Natyrisht Dovi e ka të vështirë të na ofrojë ndonjë kriter të matshëm për të identifikuar në praktikë përfaqësues të tillë, e aq më pak kritere normativë të shndërrimit të tyre në faktorë institucionalë.

Melissa Williams (1998) i kundërvihet modelit rollsian të perdes së mosnjohjes duke vënë në dukje se një mekanizëm i tillë i trajton individët në mënyrë të paanshme vetëm teorikisht, por nga ana tjetër riprodhon pabarazitë shoqërore duke mos garantuar një përfaqësim të drejtë. Për të pajtuar liberalizmin e majtë amerikan me nevojën për një përfaqësim më të plotë të grupeve të skajuar ajo ri-interpreton parimin e dytë të teorisë së drejtësisë së Rawls-it, sipas

¹ Në thelb qëndron vështirësia klasike: nëse demokracia është sundim i popullit, atëherë si ta bëjmë konceptualisht të pranueshëm faktin që vendimet i marrin përfaqësuesit e tij dhe jo popullit vetë? R.Dahl-i (Dahl 1989) tenton ta zgjidhë këtë problem duke argumentuar se demokracia athinase dhe ajo përfaqësuese e ditëve të sotme nuk kanë ndonjë ndryshim në thelb, meqenëse edhe në Athinë vetëm pak njerëz flisnin, ndërsa shumica vetëm dëgjonte dhe votonte e ndikuar prej tyre. Në fakt, më duket se Dahl-i këtu, në vend që të zgjidhë problemin, thjesht shkatërron dikotominë mes dy modeleve, duke na treguar se në thelb asnjëri nuk është ajo që ne quajmë demokraci në një kuptim të pastër etimologjik.

të cilit të gjithë vlerat shoqërore duhet të ndahen në mënyrë të barabartë, përveçse në rastin kur ndarja e pabarabartë e tyre është në dobi të të gjithëve. Sipas Williams-it, trajtimi i barabartë i të gjithëve do të mbante gjallë sistemin e pabarazive socio-ekonomike, prandaj grupet e skajuara duhet të trajtohen ndryshe politikisht nga pjesa tjetër e shoqërisë. Një konceptim i tillë i hap rrugën diskriminimit pozitiv ose praktikave të riformulimit të zonave në dobi të përfaqësimit të pakicave. Ai synon një formë të fortë të përfaqësimit përshkrues të shtruar prej Williams-it në trinomin “zë, besim dhe kujtesë” (*voice, trust and memory*). Grupet e skajuara kanë nevojë për përfaqësues që të çojnë në parlament zërin dhe pikëpamjet e tyre, kanë nevojë për përfaqësues që të kenë besimin e tyre si dhe të ndajnë me ta kujtesën e përbashkët grupore.

Sfidat e praktikës ndaj modeleve teorike

Përgjithësisht duket se në politikën e përditshme modelet teorike të përfaqësimit janë të pamjaftueshme për të kapur gjithë poliseminë e termit “përfaqësim”. Për këtë arsye, politologët priren aktualisht të hapin vështrimin në të gjithë format e mundshme, përfshirë edhe ato që dalin përtej vizionit klasik të demokracisë përfaqësuese. I tillë është rasti i klientelizmit që përgjithësisht konsiderohet si një formë patologjike dhe politikisht jokorrekte e përfaqësimit. Si i tillë klientelizmi është një sfidë e fortë ndaj demokracisë përfaqësuese, sikurse e konstaton edhe Piattoni (2001), por megjithatë kuptimi i tij duhet parë me më tepër kujdes. Në të vërtetë, nga një pikëpamje teorike, klientelizmi, si dhënie e votës në këmbim të një përfitimi të matshëm me natyrë jopublike, është ndoshta një formë mjaft efikase e përfaqësimit të interesave. Por ama, vetëm e interesave *hic et nunc*, sepse një përfaqësues që fiton postin e tij përmes klientelizmit, nuk përfaqëson më askënd pas çastit të dhënies së shërbimit të kërkuar në këmbim të votës. Një sfidë interesante politike është përkufizimi i matshëm i klientelizmit. Nëse një fshatar voton për një kandidat në këmbim të premtimit për një vend pune në “shtet”, jemi pak a shumë të një mendjeje se bëhet fjalë për klientelizëm. Po kur 500 fshatarë votojnë për një kandidat në këmbim të premtimit të një rruge apo shkolle? Qoftë edhe në kurriz të fshatrave të tjerë që ndoshta nuk do të përfitojnë drejtpërdrejt nga vota e tyre, qoftë edhe për nevoja më jetike? Në skajin e tij të largët, klientelizmi përplaslet me dështimin e përpjekjeve të vjetra për përkufizimin e koncepteve të “së mirës së përbashkët”, “interesit të përgjithshëm”, etj. Sido që të përkufizohet, duket se klientelizmi i afrohet më tepër njëfarë përfaqësimi që e vë theksin tek maksimizimi i efekteve të llogaridhënies, por me saktësimin që ajo vlen vetëm në çastin e parë. Pas kthimit të “favorit”, përfaqësuesi merr plotësisht në dorë interpretimin e ekzistencës së tij në parlament. Përtej klientelizmit dhe në një kuadër më të përgjithshëm, autorë si Przeworski, Stokes-i e Manin-i (2000) përpiqen ta thjeshtëzojnë përkufizimin e përfaqësimit siç e shohim në praktikë brenda kritereve të përgjigjshmërisë dhe llogaridhënies. Edhe këtu ndeshemi përsëri me një model të ngjashëm me atë të tregut. Përfaqësuesi dhe të përfaqësuarit duket se veprojnë sipas parimeve të shkëmbimit të arsyeshëm me synimin e maksimizimit të përfitimit. Premtimet kanë rëndësi po aq sa dhe parashikimet e arsyeshme për perceptimin e palës tjetër mbi marrëdhënien e dyanshme².

Në fakt problemi i pritshmërisë nga përfaqësimi është shumë më i gjerë se kaq dhe nuk është i shkëputur nga problemi i një pritshmërie të përgjithshme nga politika. Bobbio (1984) shikon me shumë dyshim prirjen për të kërkuar angazhim të plotë nga qytetari dhe për ta kthyer atë në një “*cittadino totale*”. A nuk është pikërisht ky shtegu nga të çojnë shumë prej kritereve demokratike të hartuara sot nga teoricienë të shumtë të demokracisë pjesëmarrëse dhe

² Akoma më thjeshtë se kaq dhe në sfondin e pozicionimit në raport me teoritë e demokracisë gjenden modele si ai i Shapiro-s (2003). Ndikimi i Shumpeter-it është këtu i dukshëm, sepse analiza fokusohet tek konkurrenca mes përfaqësuesve, pa ndonjë vëmendje të veçantë për legjitimimin e përfaqësimit.

kuvenduese? Në një formë më të sofistikuar, në një nga tekstet e tij të rralla politike, Heidegger-i (1958) parashtron rrezikun e një politike totalitare që në analogji të plotë me nënshtrimin e shkencës nga teknika, synon të realizojë “*sigurimin total të qenies*” ndaj pasigurisë duke ia nënshtruar atë, ndoshta jo më një Fyhreri, por tërësisë së qytetarëve. Një rrezik i përsëritur fuqishëm nga e gjithë tradita liberale. Dizajni i institucioneve bashkëkohore përfaqësuese të bën të mendosh se ky rrezik është marrë parasys, përtej njëfarë hipokrizie teorike normative. Nëse duam vërtet përfaqësim sa më të saktë të qytetarëve, përse nuk përdorim mandatet detyruese si në Komunën e Parisit, frymëzuar nga Rousseau-i? Ose përse nuk i zhvillojmë zgjedhjet çdo vit apo çdo muaj? Përse nuk i zgjedhim përfaqësuesit me hedhje në short, procedura më demokratike e mundshme që njohim që nga Athina e Perikliut? Përse vendosim kritere përzgjedhëse për përfaqësuesit (mosha, shkollimi, etj)? Përse nuk i miratojmë të gjithë ligjet me referendum?

Sfidat me të cilat praktika politike përplas modelet teorike janë të shumta dhe shpesh bëhen të dukshme pikërisht nga sofistikimi i strategjive konkurruese të partive politike. Dukuria e Dushkut në Shqipëri në vitin 2001 është një shembull tipik. Edhe pa qenë një rast shkeljeje ligjore, ajo përbën një deformim të përfaqësimit, për aq sa përdoret vetëm nga njëra palë. Në zgjedhjet e vitit 2005, përkundrazi Dushku mund të konsiderohet si e legjitimuar nga zbatimi masiv prej dy partive kryesore. Një tjetër deformim praktik është rasti i përçarjes së elektoratit të majtë, i cili megjithëse mazhoritar, në disa zona mundësoi fitoren e të djathtës edhe pse pakicë.

Mund të shtonim këtu edhe debatet mbi format e përfaqësimit përmes kuotave që prekin jo vetëm barazinë e antarëve të partive, apo meritokracinë, por edhe vendosin hierarki të dyshimta në nevojat për përfaqësim të disa grupeve në raport me të tjerë po aq ose më shumë të diskriminuar. Praktikrat e krijimit të zonave me shumicë të përbërë nga pakicat me qëllim zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, dëshmojnë të paktën në SHBA (shih p.sh. Lublin 1997) se rezultatet mund të jenë të kundërta. Në vend që të nxisin përfaqësimin, ato mund ta përkeqësojnë, meqenëse përfaqësuesit e dalë nga vetë pakicat në zona të tilla “të sigurta” kanë prirjen të punojnë më pak dhe të jenë më pak efikasë në mbrojtjen e interesave të grupeve nga kanë dalë. Përkundrazi, duket se rezultatet maksimale arrihen në zona të banuara nga shumica dhe me përfaqësues prej saj, por ku ky i fundit është më i ndjeshëm ndaj interesave të pakicës, qoftë edhe vetëm për shkak të nevojave zgjedhore në një atmosferë konkurrence të fortë me aftësitë joshëse të kundërshtarit.

Në fakt sfidat që praktika i bën modeleve teorike janë në zanafillën e një prirjeje origjinale aktuale. Autorë si Hardin (2004) apo Sabl (2002) propozojnë që në vend që të mbyllim kuptimin e përfaqësimit brenda kornizave të modeleve teorike, duhet të bëjmë të kundërtën, pra ta konceptojmë përfaqësimin ashtu si ai prodhohet në realitetin politik. E thënë ndryshe të nxjerrim parimet normative nisur nga sjellja në praktikë³.

Identitetet dhe përfaqësimi

Kërkesat identitare grupore marrin forcën e tyre të plotë me daljen në skenë të teorive të drejtësisë si ajo e Rawls-it dhe pasuesve të tij, qoftë të mbrojtura prej tyre, qoftë si reagim kritik ndaj perceptimit të pamundësisë së tyre për t’i garantuar. Analiza e Williams-it e trajtuar më lart ilustron mundësinë e interpretimit kontradiktor të Rawls-it. Nga njëra anë perdja e mosnjohjes ofron realisht një situatë kontraktualiste të paanshme (pozicioni origjinal), por nga ana tjetër, parimi i dytë i teorisë së tij lë hapësirë për përligjien e kërkesave specifike të grupeve të caktuara. Pakicat etnike e kulturore apo femrat janë disa nga kategoritë më të përmendura. Në

³ Sabl-i sjell e ilustron këtë nevojë me dallimin që ekziston mes mënyrave të ndryshme të përfaqësimit dhe posteve përkatëse (vendore, parlamentare, etj).

këtë sfond shkruajnë Kymlicka (1996, 2002), Philips (1999) apo Williams (1998).

Shumica e modeleve teorike të përfaqësimit deri në vitet '80-të mbështeteshin mbi supozime të vagullta se në politikë përfaqësohen interesa, opinione, apo thjesht identitete grupore. Në gjuhën e përditshme, përfaqësimi nënkupton përfaqësimin e votuesve, megjithë mjegullën konceptuale që e shoqëron. Kështu themi se një deputet përfaqëson zonën e tij. Por sa e saktë është kjo? Nga rreth 40.000 banorë të një zone mesatare në Shqipëri, deputeti përfaqëson mesatarisht rreth 5.000-7.000 votues që i japin votën drejtpërdrejt. Të tjerët ose abstenojnë, ose votojnë kundër, ose thjesht nuk kanë të drejtën e votës (fëmijët, të sëmurët mendorë, etj). Edhe ata që e votojnë në fakt e bëjnë këtë për arsye të ndryshme. Vështirë të themi se këta votues kanë interesa apo opinione të njëjta. Për më tepër ato ndryshojnë vazhdimisht gjatë mandatit të përfaqësuesit.

Në fakt një nga vështirësitë kryesore të konceptimit të përfaqësimit duket se është pikërisht ajo e përkufizimit të asaj çfarë përfaqësohet. Për ta tejkalluar këtë autorë të shumtë preferonin të përkufizonin përfaqësimin nisur nga përkufizimi i interesave, opinioneve apo identiteteve të votuesve. Sfidat dhe njëkohësisht ndihmesa më e madhe për tejkallimin e këtij problemi vjen në fakt nga disiplina të tjera shkencore. Së pari nga filozofia e gjuhës, sidomos ajo pjesë e saj e frymëzuar nga Wittgenstein-i (2003). Ky i fundit kishte konstatuar se fjalët e marrin kuptimin nga konteksti. Kështu komunikimi është i mundur vetëm kur palët ndajnë të njëjtin kontekst. Por jo vetëm kaq. Imponimi i kontekstit sjell edhe imponimin e kuptimit të fjalëve. Në dritën e pohimeve të Wittgenstein-it, politika mund të interpretohet si një "lojë gjuhe", ose si një betejë për përkufizimin e kontekstit. Kjo është goditja e parë e madhe që u jepet pikëpamjeve esencialiste mbi identitetet dhe komunikimin. Habermas-i (1987, 1992) është i vetëdijshëm për një sfidë të tillë, teksa ndërton modelin e tij të pushtetit komunikativ mbështetur në një konceptim gjithashtu komunikativ të racionalitetit. Megjithatë i shpëton tundimit universalist të identifikimit të arsyeshmërisë tek subjekti, Habermas-i mbetet i prekshëm nga kritikët që i vijnë kryesisht nga e majta⁴: pikërisht sepse e vërteta është lokale dhe racionaliteti komunikativ, konsensusi nuk mund të jetë gjë tjetër veçse fitore e një konteksti mbi një tjetër, ose e thënë me gjuhë gramshiane në një kontekst shoqëror: nuk mund të jetë veçse fitore hegjemonike.

Por natyrisht mund ta shfrytëzojmë teorinë e Wittgenstein-it akoma më mirë në rastin e përfaqësimit. Nëse e shohim politikën si lojë gjuhe e kemi më të lehtë të kuptojmë paqëndrueshmërinë e përkufizimit të thelbit të opinioneve, interesave apo identiteteve. Këtë problem nxjerr në pah edhe Young-u (2000) teksa konstaton pikërisht ngurtësinë thjeshtëzuese të konceptimeve esencialiste të përfaqësimit grupor. Një individ mund të bëjë pjesë në dhjetëra grupe të ndryshme, të pajisur secili me identitetin e tij përkatës. Nga ana tjetër, këto identitete ndryshojnë vazhdimisht dhe askush nuk ruan të njëjtin koleksion identitetesh gjithë jetën. Njerëzit rriten, plaken, ndryshojnë profesion, status social, vetëdijen sociale e politike, nivelin e jetesës, etj. Huddy (2001, 2003) konstaton qartë mekanizmat e funksionimit konjitiv dhe kategorizues të identiteteve shoqërore e politike. Artificialiteti i ndërtuar prej ligjërimit duket i pasulmueshëm.

Prirjet esencialiste të konceptimit të identiteteve mund të sulmohen edhe nga pozicione më të qarta dekonstruktiviste, përmes kritikës së njëfarë metafizike të pranisë, shprehur në kërkimin sa të pandalshëm aq dhe të kotë të identiteteve përmes metaforave dhe metonimive teorike e institucionale. Natyrisht, Derrida-ja është i një rëndësie themelore këtu, pavarësisht se përpjekjet dekonstruktive e gjejnë zanafillën që tek Nietzsche-ja⁵ (1988), ndërkohë që roli i ligjërimit në ngjizjen e identiteteve dhe konceptimin e hartës sociale përmes konstruksioneve morale shfaqet fuqishëm te Foucault-ja (1993, 1994).

⁴ P.sh. Jean-Marie Vincent (1993) kritikon Habermasin për miopininë e tij ndaj pasqyrimit të pushtetit social në hapësirën publike.

⁵ P.sh. dekonstruktimi i së mirës dhe i së keqes si në rastin e feve moniste. Megjithatë Nietzsche-ja mund të kritikohet paradoksalisht për ndërtimin e një esence të re morale mbi rrënojat e një të vjetre.

Një sfidë tjetër u vjen modeleve të mëparshme nga psikanaliza. Në psikologji mund të dallojmë qartas dy modele shpjeguese të formimit të identiteteve: teorinë e identitetit social (fortësisht simbolike) dhe teorinë e interesit racional (shumë pranë teorive të sjelljes racionale). Psikanaliza bashkëkohore, përmes Lacan-it (1999) e vë theksin te roli i tjetrit në krijimin dhe zhvillimin e identitetit të njeriut. Stadi i pasqyrës i propozuar teorikisht nga Lacan-i dallon në thelb prej teorisë së Freud-it. Ky i fundit e shihnte identitetin njerëzor në mënyrë pak a shumë të dhënë njëherë e përgjithmonë, pikërisht për shkak të forcës së veprimit të impulseve themelore. Pommier-i (1993), nënvizon karakterin thellësisht politik dhe esencialist të teorisë së Freud-it, duke u fokusuar tek marrëdhëniet komplekse grup-udhëheqës, të ngritura mbi kompleksin e Edipit. Thyerja vendimtare e Lacan-it qëndron në futjen e rolit të tjetrit dhe rrjedhimisht relativizimin e prirjes esencialiste frojdiste. Në stadin e pasqyrës, fëmija shikon veten në pasqyrë, teksa e ëma i tregon me gisht shembëlltyrën virtuale shoqëruar me fjalët që bëjnë lidhjen mes origjinalit dhe imazhit të pasqyruar. Fëmija identifikon imazhin si të njëjtë me veten, por në fakt për të imazhi nuk është një virtualitet, por një “tjetër” si ai. Ky proces ratifikohet nga prindi, që në fakt nënkupton diçka tjetër, jo ngjashmërinë me tjetrin, por idenë e përkatësisë së imazhit me origjinalin. Në formë simbolike, sipas Lacan-it stadi i pasqyrës e shoqëron individin gjithë jetën si një proces i natyrshëm identifikimi ose krahasimi me tjetrin. Për këtë arsye, mund të thuhet se ndryshe nga konceptimi frojdian, identiteti individual nuk është diçka e ngurtë, por përkundrazi një entitet fluid i modelueshëm në varësi të imazhit të tjetrit që njeriu shikon në pasqyrë-shoqëri. Rrjedhimisht nuk ka ndonjë kuptim të madh të flasësh për identitete duke nënkuptuar attribute të ngurta të lidhura fatalisht me bartësin e tyre.

Kjo ndryshon shumëçka për përfaqësimin, sepse shkatërron që në pikënisje përpjekjet për argumentimin e përfaqësimit grupor duke relativizuar identitetet dhe duke treguar se sa i prekshëm (disa do të thonin i manipulueshëm), madje i krijueshëm është identiteti nga ligjërimi politik. Këtë e nënvizon edhe Bourdieu-ja (1987) kur analizon rolin e zëdhënësit politik të një grupi. Pikërisht sepse përfaqësuesi ekziston, pikërisht sepse ai përfaqëson, grupi i supozuar si i përfaqësuar dhe i simbolizuar nis të ekzistojë duke i dhënë legjitimitet edhe vetë përfaqësuesit si zëdhënësi i atij grupi.

Modelet e vjetra të përfaqësimit e shohin shoqërinë njësoj si një vrojtues i lashtë që sheh qiellin natën. Me qëllim që t’i japë kuptim qiellit, ai tundohet nga një përpjekje mitologjike për gjetjen e lidhjeve gjeometrike apo biomorfe mes yjeve. Kjo është arsyeja përse sot njohim më shumë emërtimet e zodiakut sesa sistemet yjore. Por ky është një konstruksion artificial i mendjes sonë. Vrojtuesi ynë i lashtë përgjithësisht nuk është në gjendje të dallojë lidhjet gravitacionale mes yjeve. I njëjti problem qëndron edhe me përkufizimet e opinioneve, interesave apo identiteteve që duhen përfaqësuar. Përveç kësaj duhet shtuar fakti që ndryshe nga yjet, opinionet, interesat dhe identitetet ndryshojnë vazhdimisht pa ndonjë rregull të caktuar.

Vështirësia e përdorimit të një skeme të ngurtë identitare konstatohet edhe nga post-marksistët (demokratët radikalë). Pasoja e parë e këtij konstatimi është braktisja e disa prej shtyllave të doktrinës marksiste dhe në rradhë të parë e besimit te një arsye universale. Mouffe dhe Laclau (2000, 2001) kritikojnë dogmën marksiste duke këmbëngulur se e vetmja mënyrë e rigjallërimit të së majtës është krijimi i zinxhirëve të njëvlefshëm (chains of equivalence) që bashkojnë kërkesat e grupeve të ndryshme në një betejë të vetme. Para se të arrijnë deri këtu, ata kalojnë në një dekonstruktiv të rivendikimeve identitare frymëzuar nga teoria e Wittgenstein-it dhe Derrida-ës. Nga ana tjetër, kritikojnë Rawls-in dhe Habermas-in, të cilët, sipas tyre, e shohin demokracinë si rezultat të një konsensusi racional mes njerëzve të aftë për t’u ngritur mbi barrierat klasike egocentrike njerëzore. Mouffe dhe Laclau mendojnë se hapësira publike nuk mund të ndërtohet mbi konsensusin (që shfaqet si i pamundur), por mbi ndeshjen e rivendikimeve të ndryshme. Detyra e së majtës është të përfshijë në ofertën e vet përfaqësuese kërkesa ose kauza të njëvlefshme të cilat dogma marksiste i kishte përjashtuar apo thjeshtëzuar (lufta kundër seksizmit, racizmit, mbrojtja e mjedisit, lufta kombëtare, etj). Hegjemonia kapitaliste, e kuptuar sipas konceptit gramshian, mund të hidhet poshtë vetëm

përmes një hegjemonie kulturore socialiste, edhe pa ngulmuar në pretendimin e universalizmit të vlerave të saj. Konstruksioni iluziv identitar dhe ai i arsyes nuk mund të zëvendësohet me ndonjë konstruksion tjetër, prandaj e vetmja mënyrë është mbrojtja e vlerave të së majtës në një hapësirë publike që duhet konceptuar si agoniste⁶. Aktualisht, autorë të tillë, konstatojnë vështirësitë e së majtës për t'u ndeshur me vlerat hegjemonike neoliberalë të rrënjësura suksesshëm në shoqëritë perëndimore. Prej nga vijnë dhe problemet përfaqësuese të së majtës në ditët e sotme, ilustruar me mosgjetjen e një alternative ndaj neoliberalizimit apo me degjenerimin e “Rrugës së tretë” në një kopje të zbukuruar të theçerizmit.

Një konceptim alternativ i përfaqësimit

Deri këtu pamë disa nga sfidat kryesore të përfaqësimit kryesisht në nivelin teorik: problemi i përputhjes me teoritë klasike të demokracisë, pamundësia e përcaktimit të asaj çka përfaqësohet, pamundësia e përkufizimit të natyrës së veprimit të përfaqësuesit, problemi i përfaqësimit të grupeve të skajuara, etj. E megjithatë elitat politike i referohen përfaqësimit dhe votuesit ndihen të përfaqësuar, të përfaqësuar pak ose aspak, por sidoqoftë nisen nga ideja se përfaqësimi është norma dhe mospërfaqësimi ose përfaqësimi i keq janë shmangia prej saj. Më lart kemi trajtuar kryesisht artificialitetin e konceptimit të identiteteve të para nga një pikëpamje esencialiste. Por e njëjta analizë është lehtësisht e transferueshme për përfaqësimin e ideve, opinioneve apo interesave. Të gjithë këto kategori janë të ndërtuara përmes ligjërimit politik dhe nuk ekzistojnë përtej tij. E megjithatë tundimi për t'i ricikluar në teoritë e përfaqësimit është mjaft i madh. Young-u i dorëzohet këtij tundimi pasi ka hedhur poshtë pretendimin esencialist të përfaqësimit radikal përshkrues, duke vënë në thelb të teorisë së saj idenë se megjithatë perspektivat sociale të para si një përvojë jetësore e përbashkët për një grup janë një pikënisje legjitime për përligjen e një “përfaqësimi special”.

Problemi vjen nga fakti se autorët e ndryshëm përpiqen të ngurtësojnë një element të caktuar mbi bazën e të cilit të ndërtojnë përfaqësimin. Por ndoshta ne mund ta mendojmë përfaqësimin të hapur ndaj polisemisë së dukshme të tij. Në këtë rast do të duhet të pranohet, siç na e sugjeron edhe analiza e sjelljeve zgjedhore, se qytetarët që votojnë për një kandidat apo një parti e bëjnë këtë mbështetur në pikënisje të ndryshme, madje pse jo edhe kundërshtuese me njëra-tjetrën. Nuk kemi pse të presin që ata të jenë të gjithë të një mendjeje përsa i përket pyetjes se si i përfaqëson deputeti, apo se cilin element të tyre përfaqëson ai. Nëqoftëse pranojnë poliseminë e ligjërimit politik si ngjizës i identiteteve (rrjedhimisht edhe i interesave, historive apo opinioneve grupe), duhet të pranojmë edhe poliseminë e kuptimeve që çdo individ i jep marrëdhënieve të përfaqësimit në të cilat angazhohet përmes votës. Kjo vlen jo vetëm për grupet e ndryshme, por edhe brenda një grupi.

Kështu na shpaloset një marrëdhënie përfaqësimi që sendërtohet në vendimin e votuesit apo votuesve për të mbështetur një projekt të caktuar politik, pavarësisht kuptimit ai i jep kësaj marrëdhënieje. Projekti politik përfshin jo vetëm strategjitë e ofruara qeverisëse (program elektoral, program qeverisës, përmbledhje idesh, elementë ideologjikë), por edhe burimet njerëzore (parti, lider, kandidat). Ky konceptim e tejkalon minimalizmin shumpetarian që kufizohet në përzgjedhjen e një elite, pavarësisht se e përmban atë. Nga ana tjetër, pranimi i polisemisë së përfaqësimit na mundëson të pranojmë si legjitim fokusimin tek njëri element i projektit politik (p.sh. te lideri, përmes personalizimit të politikës) duke njohur kufizimet

⁶ Agonizmi (si kundërshtim) këtu i kundërvihet antagonizmit (si armiqësi). Në fakt, demokratët radikalë mbrojnë një minimum esencializmi kur shprehen se sidoqoftë njerëzit ndajnë disa vlera minimale të përbashkëta që mundësojnë një pranim të proceduralizmit demokratik. Një qëndrim i tillë, tingëllon paksa në kundërshtim me dekonstruktimin që ata i bëjnë vlerave në përgjithësi, por është e qartë se nëse edhe ky minimum hidhet poshtë, politikës në tërësi i rrënohen themelet mbi të cilat qëndron.

e qytetarit, por pa dalë jashtë kriterëve demokratike bazike. Në një formë pak më të lirshme mund të shpreheshim se përfaqësuesi përfaqëson vendimin e qytetarëve për të mbështetur projektin e tij politik, pavarësisht kuptimit që ai i jep këtij projekti. Është e qartë se sipas këtij pikëvështrimi, në sfondin e prirjeve për konvergjencë ideologjike, politika si ndeshje idesh e humb paksa “magjinë” e saj. Prandaj një formulim më koherent, i qartë dhe i profilizuar i ligjërimit politik mund të shihet si një kriter i rëndësishëm, ndonëse jo i domosdoshëm, për një përfaqësim përfshirës.

Në mbyllje, mund të kthehemi te pyetjet kryesore të shtruara në fillim. Së pari, sipas këtij konceptimi alternativ, nga pikëpamja filozofike, demokracia dhe përfaqësimi nuk na shfaqen si kundërshtuese e as përjashtuese. Në rastin më të keq mund ta gzykojmë termin demokraci si të papërshtatshëm etimologjikisht, por kjo nuk na ndryshon asgjë: ajo që ne quajmë sot demokraci përfaqësuese, edhe po të quhej ndryshe, duket si forma më e përshtatshme e shprehjes së vullnetit lirë e të barabartë të qytetarëve përmes përfaqësimit. Nga pikëpamja institucionale, pranimi i një polisemie të përfaqësimit e bën të pakuptimtë tundimin e “përfaqësimit special” apo të çfarëdo forme të përfaqësimit përshkrues që priret të ngurtësojë një hartë të caktuar shoqërore. Kështu e rikthejmë problemin e grupeve të skajuar tek origjina e tij e vërtetë sociale dhe rrënjët e tij, larg zgjidhjeve artificiale e afatshkurtra, pa mohuar sidoqoftë rolin që politika mund të luajë në gjetjen e rrugëve të reja për promovimin e pikëpamjeve të grupeve identitare që e shohin veten si të rrezikuar.

Së fundmi, në kontekstin e asaj që u tha më lart, mund të na rezultojë e pabazuar të flitet për “krizë” përfaqësimi. Konstatimi i “krizës”, si konstatimi i çdo statusi, mund të bëhet vetëm nëse zotërojmë mjetet e nevojshme për të matur përfaqësimin, gjë që nga ana e vet nuk mund të bëhet pa përcaktuar përfundimisht dhe ngurtësisht pikërisht të gjithë ato elementë që polisemia e përfaqësimit na i bën të pakapshëm.

Një metaforë nga fizika kuantike ndoshta mund të na vijë në ndihmë këtu. E kam fjalën për “macen e Schrodinger-it” që ilustron parimin e papërcaktueshmërisë. Një mace mbyllet në një kuti metalike në të cilën një thërmijë sub-atomike me natyrë duale (thërmijë dhe/ose valë) mund të marrë njërin status apo tjetrin dhe të shkaktojë nisjen e një mekanizmi që mund të vrasë macen. Ndërhyrja e vëzhguesit në konstatimin e gjendjeve të mbivendosura shkakton kolapsin e situatës në njërin apo tjetrin status. Nëse hapim kutinë ne konstatojmë njërin status, por kurrë të dy njëkohësisht. Pa ndërhyrjen e faktorit antropik, ne nuk mund të themi kurrë me siguri nëse macja është gjallë apo e ngordhur. E njëjta gjë do të vlente edhe për analizën e marrëdhënieve të përfaqësimit. “Matja” e tij përmes sondazheve apo analizës spekulative rrezikon të kapë njërin element duke eklipsuar të tjerët. A nuk e vërteton këtë edhe ekzistenca e konceptimeve të shumta e nganjëherë edhe kundërshtuese të përfaqësimit? Përpjekja për të studiuar përfaqësimin nuk mund të na detyrojë ta konsiderojmë rrethin si katror “për lehtësi studimi”. Konceptimi i përfaqësimit që ofrova më lart merr parasysh dhe pranon pamundësinë e identifikimit të një kuptimi përfundimtar të përfaqësimit nga pikëpamja e studiuesit, duke bërë të përputhshëm gjithsesi përfaqësimin me kriteret e demokracive të sotme. Natyrisht, një konceptim i tillë nxjerr në sipërfaqe shumë pyetje të reja, të cilat tejkalojnë qëllimin e këtij teksti.

Bibliografia

- Bourdieu, Pierre (2001), *Langage et pouvoir symbolique*, Editions du Seuil, Paris.
- Dahl, Robert A. (1989) *Democracy and Its Critics*. Yale University Press. New Haven.
- Derrida, Jacques (1967), *Ecriture et difference*, Editions du Seuil, Paris.
- Dovi, Suzanne (2002). *Preferable Descriptive Representatives: Will Just Any Woman, Black, or Latino Do?* Në *The American Political Science Review*. Vol. 96, Nr. 4.
- Elster, John (1998). *Deliberative Democracy*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Foucault, Michel (1976), *Histoire de la sexualité 1. La volonté de savoir*, Gallimard, Paris.
- Habermas, Jurgen (1987), *Theorie de l'agir communicationnel*, Fayard, Paris.
- Habermas, Jurgen (1997). *Droit et démocratie. Entre normes et faits*. Editions Gallimard, Paris.
- Hardin, Russell. (2004). *Representing Ignorance*. Në *Social Philosophy and Policy*, 21(1).
- Hardin, Russell. (1995). "Self-interest, group identity," in *Nationalism and Rationality*, eds, Alber Breton, Gianluigi Galeotti, Pierre Salmon, and Ronald Wintrop. Cambridge: Cambridge University Press.
- Heidegger, Martin (1958). *Essais et conférences*. Editions Gallimard, Paris.
- Huddy, Leonie (2001). *From Social to Political Identity: A Critical Examination of Social Identity Theory*. Dans *Political Psychology*, Vol. 22, No. 1.
- Huddy, Leonie (2003). *Group Identity and Political Cohesion*. Në *Oxford Handbook of Political Psychology*. Oxford University Press. New York.
- Kymlicka, Will (2002) *Multiculturalism and Minority Rights: West and East*. Dans *Journal of Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*. Nr. 4/2002.
- Kymlicka, Will (1996), *Multicultural Citizenship: A Liberal Theory of Minority Rights*, Clarendon Press.
- Lacan, Jacques, (1999), *Ecrits 1*, Editions du Seuil, Paris.
- Laclau, Ernesto, Mouffe, Chantal (2001) *Hegemony and Socialist Strategy*, Verso Books, London.
- Lublin, David (1997), *The paradox of representation. Racial Gerrymandering and Minority Interests in Congress*. Princeton University Press, Princeton, New Jersey.
- Lupia, Arthur & McCubbins, Mathew D. & Popkin, Samuel L. (2000). *Elements of Reason. Cognition, Choice, and the Bounds of Rationality*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Manin, Bernard (1995). *Principes du gouvernement représentatif*. Calmann-Levy, Paris.
- Mansbridge, Jane. (2004) *Representation Revisited: Introduction to the Case Against Electoral Accountability*. Në *Democracy and Society*. Vol. 2. Nr.1.
- Mansbridge, Jane. (2003). *Rethinking Representation*. Në *American Political Science Review*. Vol. 97, Nr.4.
- Mansbridge, Jane. (1998). *The Many Faces of Representation*. Working Paper, John F. Kennedy School of Government, Harvard University.
- Nietzsche, Friedrich, (1977), *Genealogia della morale*, Newton, Roma.
- Phillips, Anne (1999). *Stratégies de la différence : politique des idées ou politique de la présence ?* Në *Mouvements*, Nr 3.
- Piattoni, Simona (2001) *Clientelism, Interests and Democratic Representation. The European Experience in Historical and Comparative Perspective*. Cambridge University Press, New York.
- Pitkin, Hanna (1971). *The Concept of Representation*. University of California Press, Berkeley.
- Przeworski, Adam & Stokes, Susan C. & Manin, Bernard (edited By) (1999). *Democracy, Accountability and Representation*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Rawls, John (1999). *A Theory of Justice. Revised Edition*. Oxford University Press. Oxford.
- Schumpeter, Joseph (1962). *Capitalism, Socialism and Democracy*. Harper Perennial, London.
- Shapiro, Ian (2003). *The State of Democratic Theory*. Princeton University Press. Princeton.
- Urbinati, Nadia (1998). *Rhetoric and Representation: The Politics of Advocacy*. Në *Annual Meeting of the American Political Science Association*. Boston.
- Vincent, Jean Marie (1995). *Les méandres du pouvoir. De la domination à la liberté*. Në *Futur Antérieur* 25-26 : 1995/6.
- Williams, Melissa (1998). *Voice, trust and memory. Marginalized Groups and the Failings of Liberal Representation*. Princeton University Press. Princeton.
- Wittgenstein, Ludwig (2003), *Philosophical Investigations*, Blackwell Publishing.
- Young, Iris Marion (2000), *Inclusion and Democracy*. Oxford University Press. New York.

DIKTATURA PA HUMOR – OSE MUNGESA E BARSOLETAVE SHQIPTARE MBI SOCIALIZMIN

SHANNON WOODCOCK*

Abstrakt. Në këtë artikull shqyrtohet mungesa e barsoletave në Shqipërinë post-socialiste në lidhje me regjimin socialist dhe liderët e tij. Ndryshe nga vende të tjera post-komuniste, si Rumania, ku barsoleta të tilla janë të shumta dhe tregohen shpesh, në Shqipëri ka një mungesë të theksuar të barsoletave mbi periudhën e socializmit. Edhe ato barsoleta të pakta që ekzistojnë, më shumë sesa socializmin dhe liderët e tij, vënë në lojë vetë qytetarët dhe popullin si viktima të regjimit. Në këtë artikull eksplorohen disa nga arsyet se përse barsoleta mbi regjimin munguan në Shqipërinë socialiste. Disa nga këto arsye kanë të bëjnë me ashpërsinë e diktaturës komuniste në Shqipëri, të tjera me specifikat e shoqërisë së mbyllur dhe pak të urbanizuar shqiptare gjatë socializmit. Por një nga arsyet themelore që theksohet në këtë artikull është fakti se shumë më tepër sesa në vende si Rumania, në Shqipëri regjimi komunist dhe diktatori Enver Hoxha ishin pjesë e projektit kombformues. Komunizmi dhe kombformimi shqiptar ishin pjesë e të njëjtit projekt, çka shpjegon edhe identifikimin intensiv të popullatës me regjimin dhe mungesën relative të barsoletave mbi regjimin dhe liderët e tij gjatë apo pas periudhës socialiste.

Hyrje

Shqiptarët më njohën me vendin e tyre nëpërmjet barsoletave. Gjatë dy viteve që jetova dhe punova në Shqipëri, në vitet 2003 – 2005, më tregonin barsoleta për të portretizuar stereotipat rajonalë, bënë shaka me ndryshimet mes fshatit dhe qytetit dhe ironizonin mënyrat se si besimtarët myslimanë, katolikë dhe ortodoksë kishin jetuar në paqe së bashku. Ajo që nuk dëgjova në Shqipëri ishin barsoletat për periudhën socialiste ose për socializmin në përgjithësi. Kishte barsoleta për politikanët bashkëkohorë, por në asnjërën prej tyre nuk përmendej Enver Hoxha, diktatori që u shfaq në mënyrë të frikshme për 40 vjet me radhë me anë të regjimit të tij të izolimit, mungesave të herëpashershme në ushqime dhe punës së rëndë. Mungesa absolute e barsoletave politike për socializmin shqiptar në bisedat, kujtimet dhe shkrimet akademike postsocialiste është një fakt shumë befasues në krahasim me vende të

* Shannon Woodcock është pedagoge në Universitetin La Trobe në Melbourne të Australisë. Në vitin 2006 ajo ka marrë titullin Doktore e Shkencave nga Universiteti i Sidneit. Ajo ka punuar si kërkuese shkencore në Holocaust Memorial Institute në Washington. Ajo gjithashtu ka botuar një sërë artikujsh në disa nga revistat shkencore botërore mbi holokaustin dhe studimet e genocidit. Woodcock gjithashtu ka dhënë mësim si *visiting fellow* në Universitetin e Tiranës dhe të Elbasanit gjatë periudhës 2003-5. Ju lutemi dërgoni komentet tuaja në lidhje me artikullin në adresën s.woodcock@latrobe.edu.au

tjera postsocialiste evropiane, të tilla si Rumania, ku barsoletat nga periudha socialiste ishin të shpeshta dhe tregoheshin që kur Çausheku ishte gjallë dhe vazhdojnë të qarkullojnë akoma sot në rrethe të ndryshme formale dhe informale.

Si është e mundur që Rumania dhe Shqipëria, dy vende që shpesh identifikohen së bashku si diktaturat komuniste më të ashpra, kanë kultura postsocialiste kaq të ndryshme në tregimin e barsoletave? Ashtu siç shkruan Donna Goldstein, humori ka një ndikim të rëndësishëm në analizën sociale, “sepse ai tregon ambiguitetin, kontradiktën, paradoksin dhe paqëndrueshmërinë, ndërkohë që nxit interpretime të shumta për botën”.¹ Në Rumani barsoletat në lidhje me periudhën socialiste tregojnë se si e kaluara e afërt funksionon në të tashmen postsocialiste dhe evropiane, ndërsa për Shqipërinë është e qartë mungesa e barsoletave për socializmin, çka më nxit që të zbuloj se si kuptohej dhe kujtohej e kaluara diktatoriale aty.

Në këtë studim do përqipem të gjej sasinë, përmbajtjen dhe hapësirat e barsoletave të treguara për socializmin shqiptar që ekzistoi përpara vitit 1992 dhe rrugëve me anë të të cilave socializmi është i përjashtuar nga diskutimi publik edhe tani pas (afërsisht) 15 vjetësh nga hapja e kufijve.² Gjatë bërjes së këtij kërkimi, kam gjurmuar trajtat e humorit politik në forumet në internet të tilla si listimet shqiptare dhe faqet e *chat-it*, si dhe e kam plotësuar këtë me intervista formale dhe informale me kolegë dhe miq shqiptarë në Shqipëri dhe me një sondazh me diasporën shqiptare.³ Shakatë për politikën në formën e një strukture anekdote janë një formë e veçantë e humorit, që mbledhet dhe studiohet në mënyrë relativisht të lehtë, megjithëse kjo gjë nuk është bërë aspak në studimet akademike për Shqipërinë. Gjithsesi, barsoletat janë thjesht një përfaqësim i kufizuar i humorit të një periudhe të dhënë. Ndërsa ky studim analizon barsoletat politike të stilizuara për diktatorët dhe socializmin, ai nuk merret me natyrën e humorit në programet televizive dhe gazetat e sanksionuara nga shteti, të cilat në kontekstin shqiptar ndiqnin linjën shtetërore.⁴ Barsoletat politike në Evropën socialiste kalonin kufijtë, përktheheshin, përmirësoheshin, botoheshin në libra dhe në internet pas vitit 1989, dhe madje edhe përshtateshin përsëri për personazhet e rinj në pushtet. Në Rumani barsoletat kundër regjimit socialist kishin të bënin kryesisht me radhët e gjata të ushqimeve dhe me transportin publik dhe akoma tregohen me kënaqësi për të gjithë shtresat e shoqërisë.⁵ Në kundërshtim me këtë, kam gjetur shumë pak barsoleta politike për periudhën e Enver Hoxhës dhe me origjinë nga kjo periudhë, ndonëse ka barsoleta pafund për politikën e pas vitit 1992.⁶

Në kundërshtim me Rumaninë, në Shqipëri ka shumë pak gjëra të shkruara për historinë, e tanishme ose më të hershme, të tregimit të barsoletave.⁷ Megjithatë, tradita e tregimit të barsoletave në ritualet formale të komunitetit si dasmat apo kafenetë është mjaft e përhapur, dhe tani kanë filluar të qarkullojnë barsoleta që datojnë që nga Lufta e Dytë Botërore, pra tregimi i barsoletave është një ngjarje sociale popullore. Për shembull ndarjet më të mëdha të identiteteve rajonale shqiptare janë artikuluar dhe janë bërë subjekt i shumë barsoletave, të tilla si më poshtë:

Tre gra janë duke pritur në maternitet për të lindur. Doktorin shkon te gruaja nga Korça dhe i kërkon që të këndojë një këngë të bukur. Ajo këndon dhe menjëherë del fëmija. Më pas ai shkon tek gruaja nga Shkodra dhe i kërkon asaj që të tregojë një barsoletë. Ajo tregon barsoletën dhe menjëherë del fëmija. Ai shkon dhe tek gruaja e tretë që është nga Vlora dhe ajo këndon, pastaj tregon një barsoletë, por fëmija nuk lëviz. I nervozuar doktorin bërret: “Mallkuar qofsh ti dhe nëna që të ka bërë” dhe pikërisht në këtë moment del fëmija.⁸

Sipas stereotipave rajonalë, jugorët këndojnë, vlonjatët (labët) zihen, ndërsa tregimi i barsoletave është një stereotip më vete për kryeqytetin e veriut, Shkodrën. Këto ishin stereotipat shqiptarë përpara periudhës socialiste, të cilat u konsoliduan nëpërmjet tregimit të barsoletave në periudhën socialiste, dhe sot mbeten një nga rrugët kryesore të organizimit të identitetit shqiptar.

“Tregojmë barsoleta që bëjnë për të qeshur, jo barsoleta me Enver Hoxhën”

Meqenëse Shqipëria shpesh konsiderohet si një rast i veçantë, nuk është për t'u habitur që një nga diktaturat më të izoluara dhe më të ashpra siç ishte ajo e Enver Hoxhës është e papajtueshme me humorin, por nga ana tjetër, Shqipëria është i vetmi vend ndër ish- shoqëritë socialiste evropiane që i mungonin rrethet e barsoletave politike, të cilat talleshin me udhëheqësin dhe “shoqërinë e re” që ai kërkonte të krijonte.⁹ Enver Hoxha e sundoi Shqipërinë nga viti 1946 deri me vdekjen e tij në 1985. Sipas historianit Isa Blumi, Hoxha zhvilloi një shtet socialist, i cili u bazua në strukturat sociale familjare dhe rajonale ekzistuese, një diktaturë e klaneve toskë të jugut kundër klaneve gegë të veriut.¹⁰

Kanalet tradicionale të organizimit social u shndërruan në kanale të kontrollit shtetëror, duke përdorur mekanizma të kontrollit shoqëror, si rëndësia e familjes mbi atë të individit apo vlera si besa, nderi dhe farefisi. Në shoqërinë tradicionale shqiptare turpërimi i vetvetes sjell turpërimin e gjithë familjes dhe kështu nën juridiksionin socialist, shkeljet e presupozuara të një individit sollën persekutimin e zgjeruar të familjes së tij/saj, që shpesh shoqërohej me shpërnguljen në një vend tjetër ose me burgosjen e tyre.¹¹ Shqipëria është një vend malor dhe me një popullsi të vogël, e cila numëronte vetëm 1.13 milionë banorë në vitin 1946 dhe 3.11 milionë banorë në vitin 1992.¹² Individët ishin të kufizuar si nga lidhjet familjare ashtu edhe nga lëvizshmëria e ulët sociale dhe fizike, e cila ishte e mundur vetëm brenda një shteti të mbyllur dhe të vogël nën socializëm. Industrializimi dhe urbanizimi i pakët nuk siguruan as anonimitetin dhe as mundësinë për mobilitet social, aq sa ishte e mundur në rastin e Rumanisë. Hoxha i ndërpreu lidhjet me Jugosllavinë, Rusinë dhe në vazhdim edhe me Kinën, vazhdoi të mbante gjendjen e luftës me Greqinë dhe militarizoi rëndë vendin, duke krijuar një gjendje të vazhdueshme frike, sipas së cilës Shqipëria si komb ishte gjithmonë në rrezik. Ashtu siç deklaronte dhe pasuesi i Hoxhës, Ramiz Alia, Hoxha u bë udhëheqës “atëherë kur Shqipëria ishte në udhëkryq të historisë, kur vetë ekzistenca e popullit dhe kombit shqiptar ishte vënë në dyshim... ai shihte si një nevojë të madhe krijimin e një partie komuniste, si një pikë kyçe për të shpëtuar atdheun dhe për të ndriçuar popullin”.¹³

Në nenin 55 të Kodit Penal, të titulluar “Propaganda dhe Agjitacioni me karakter Fashist, Antidemokratik, Fetar, Luftë-nxitës dhe Antisocialist”, një individ mund të dënohej minimumi me tetë vjet burg, ose maksimumi, në kohë lufte, me 25 vjet burg ose me vdekje, në qoftë se bënte një koment ose tregonte një anekdotë, e cila interpretohej si kundër socializmit. Sipas një kërkimi të Agim Mustës, aktivisti më prolific për njohjen e krimeve të kryera në Shqipërinë socialiste ndërmjet viteve 1945 dhe 1992, ka pasur 5487 ekzekutime politike, 19 250 njerëz të internuar ose të shpërngulur brenda vendit dhe 11 536 familje të përjashtuara jashtë kufijve.¹⁴ Duke pasur parasysh që popullsia shqiptare ishte më pak se tre milionë banorë, këto shifra tregojnë dimensionin e lartë të persekutimit politik. Një nga filmat e paktë që përshkruan brutalitetin e regjimit socialist është *Vdekja e Kalit*, realizuar në vitin 1995.¹⁵ Në këtë film, protagonistin burgoset vetëm sepse në kundërshtim me dëshirën e shefit, nuk vrau një kalë, çka çoi drejt vdekjes gruan e tij pas një aborti të paligjshëm dhe familja u internua në një kamp pune të detyruar.¹⁶ Ndërsa familja e tij po internohej natën, fqinjët që shikojnë nga dritaret spekulojnë arsytet pse familja e të dënuarit po pëson këtë fat dhe dikush pëshpërit se ndoshta ai ka treguar ndonjë barsoletë në punë. Në fakt, njerëzit besonin se në Shqipëri mund të arrestohesh jo vetëm po të ankohesh apo talleshe me realitetin e ashpër të mungesës së ushqime dhe lirisë (si agjitacion dhe propagandë kundër socializmit). Besohej gjerësisht se edhe tregimi i barsoletave ishte një pretekst i mirë për persekutim politik.

Gegët e veriut persekutoheshin në mënyrë të vazhdueshme nga regjimi socialist që kontrollohej kryesisht nga toskët, që i konsideronin gegët si më pak të zhvilluar, të zhytur në kulturën tradicionale dhe ligjet kanunore dhe më besimtarë (si katolikë) sesa jugorët myslimanë.¹⁷ Stereotipi që ishte krijuar për shkodranët si tregues barsoletash u gërshetua me stereotipin e gegëve si armiq të më të mundshëm të regjimit. Dhe është interesante për t'u përmendur që

megjithëse shumë nga ata që më treguan barsoleta politike, ndonëse në moshë të mesme dhe të rritur në Tiranë, shpesh theksonin se origjina e këtyre barsoletave ishte nga Shkodra, duke zhvendosur në këtë qytet jo vetëm skenarët e barsoletave, por edhe aktin anti-komunist të tregimit të barsoletave. Një mikeshë nga Tirana, duke iu përgjigjur kërkesës time për barsoleta, më dërgoi me postë elektronike një anekdotë politike që zhvillohej në Shkodër dhe më tha që nuk e kuptonte se pse miqtë e saj shkodranë nuk ia kishin treguar akoma këtë anekdotën.¹⁸ Kur unë i bëra këtë pyetje miqve të saj shkodranë, njëri nga ata m'u përgjigj se “ne tregojmë barsoleta që bëjnë për të qeshur, jo barsoleta me Enver Hoxhën”.¹⁹

Për t'u mbrojtur nga një pushtim i mundshëm nga trupat ushtarake amerikane dhe ruse, fabrikat shqiptare prodhuan 180 000 bunkerë çimentoje deri në vitin 1985, pa përmendur miliona shtylla betoni dymetroshe me majë hekuri kundër parashutistëve që mund të hidheshin nga qielli.²⁰ Fabrikat e nëndheshme prodhonin armë. Fatos Lubonja, filozofi që u burgos për “propagandë dhe agjitacion” ndërmjet viteve 1974 dhe 1991, tregon se “në regjimin totalitar të izoluar të Hoxhës, shqiptarët u mëkuan të besojnë që ata ishin “kërthiza e botës”, një paradisi në mes fuqive të tjera “djallëzore”.²¹ Për shembull, Lubonja kujton që kur ai ishte një i burgosur politik dhe lajmet e filtruara nga regjimi flisnin për takimin e parë midis presidentit Bush dhe Gorbaçovit, qytetarët besonin që dy udhëheqësit botërorë ishin takuar vetëm e vetëm që të vendosnin se çfarë të bënin me Shqipërinë. “Që të dyja, si tërheqja e vëmendjes botërore ashtu dhe shfaqja e paranojës për ambiciet e botës së jashtme, ishin tiparet thelbësore të socializmit ideologjik”.²² Kjo paranojë e vazhdueshme ndaj pushtimit ndërkombëtar u përdor për të justifikuar kontrollin e “disidencës” së brendshme për të mirën e “kombit”. Vizioni i një kombi shqiptar të pavarur ishte një qëllim që e kishte për zemër vetë “populli shqiptar”, duke përfshirë dhe ata që ishin në burg, dhe Hoxha perceptohej kështu si një udhëheqës që kishte për zemër vetëm interesat e “kombit”, megjithëse kërcënimi ndaj këtij vizioni të përbashkët ishte një terror i sajuar.

Në Rumani, anonimiteti i popullatave dhe qyteteve të mëdha siguroi njëfarë lirie për tregimin e barsoletave, u krijua një grup alternativ dhe paralel identiteti kundër regjimit, gjë që natyra shumë e strukturuar dhe e vogël e shoqërisë shqiptare nuk e lejoi. Shpërngulja e vazhdueshme e familjeve shqiptare brenda Shqipërisë konsolidoi akoma më shumë mosbesimin ndaj të panjohurve, aq sa vetë njerëzit u mbyllën përballë atyre që shteti i quante “armiqtë e popullit”. Radhët e gjata të ushqimeve dhe transporti publik i mbipopulluar nuk ishin vende të përshtatshme për barsoleta kundër partisë në Shqipëri sikurse në Rumani. Në Rumani nuk kishte shumë gjasa që agjentët sekretë (*securitate*) të qëndronin gjithë natën në radhë dhe tregimi i një anekdote për të matur të qeshurën e tjetrit ishte edhe një provë se kujt mund t'i besojë.²³ Ndërsa në Shqipëri, përveç atyre që banonin te “blloku”, të gjithë të tjerët duhej të qëndronin në radhë të gjata, duke përfshirë dhe sigurimsat. Një i intervistuar, kur po e pyesja se në cilin vend mund të tregoheshin barsoleta, u përgjigj se “mund të tregoheshin barsoleta gjatë ndeshjeve të sportit, por duke pasur shumë frikë, mund të thuheshin vetëm gjëra të tilla si: “jam duke ngrënë bukë me gjalpë”, ose “nuk kam bukë” dhe mënyra se si thuheshin këto mund të nxiste ose jo dyshime për propagandë”.²⁴

Diktatori si mbrojtës dhe “njeriu i ri” i uritur

Në sytë e njerëzve Enver Hoxha nuk ishte thjesht një diktator, por gjithashtu një udhëheqës që punoi për të realizuar qëllimin e përbashkët, mbijetesën e kombit shqiptar. Një nga tabutë e literaturës postsocialiste janë ndjenjat e dyfishta që të shtypurit kanë për diktatorët/mbrojtësit e kombit të tyre. Si historiane, më intereson heshtja dhe qetësia e shqiptarëve për të kaluarën socialiste, veçanërisht kur e krahasoj me Rumaninë. Ndërsa rumunët luftuan nëpër rrugë dhe filmuan ekzekutimin e Çausheskut që e ritransmetuan gjatë gjithë vitit 1989 (dhe në çdo Krishtlindje këtej e tutje), shqiptarët mbajtën zi për vdekjen e Enver Hoxhës në vitin 1985 dhe

toleruan vazhdimin e qeverisjes së hekurt të Ramiz Alisë deri në vitin 1992. Ajo që më habiti ishte mënyra se si në vitin 2003 Ramiz Alia akoma shfaqej nëpër kafenetë publike dhe familja e Hoxhës ishte subjekt interesi nëpër gazeta. Në Rumani, gazetatat intelektuale të tilla si *Dilema* kanë prodhuar së fundi botime, të cilat i përkasin temës së barsoletave të periudhës socialiste dhe *blog-et* nostalgjike për periudhën socialiste prodhohen me shumicë nga individë që kanë qenë fëmijë në vitin 1989, si dhe nga nacionalistët rumunë.²⁵ Ndërsa në Shqipëri nostalgjia për të kaluarën socialiste është e kufizuar tek një grup të moshuarish ose tek një fraksion i vogël i Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilët janë të pranishëm në një faqe në internet që administrohet nga Italia.²⁶ Kur dikush në një *chat list* shqiptare tregon një anekdotë me temë nga e kaluara, ajo ose injorohet ose prodhon reagimin e një përdoruesi tjetër të forumit, i cili menjëherë deklaron që komentet mbi komunizmin/ burgun/ persekutimin nga shteti nuk janë për të qeshur. Pra, duket se faktet nga e kaluara socialiste nuk konsiderohen një çështje me të cilën mund të bëhet humor dhe madje ndonjëherë trajtohen me mjaft trishtim.

Barsoletat e pakta politike që munda të gjej duke iu lutur të intervistuarve gjatë intervistave kanë një tipar të përbashkët në atë që përbën humorin brenda tyre; dhe kjo nuk është sjellja qesharake e diktatorit, por varfërimi i vazhdueshëm i shqiptarëve nën sundimin e Hoxhës. Në studimin e tij për humorin, Bergson-i thekson që kontrasti midis njeriut dhe makinës shpesh është komik, dhe në këto barsoleta shqiptare trupi njerëzor tradhton “njeriun e ri” ideologjik të socializmit me anë të urisë që ai shfaq.²⁷ Një anekdotë e vërtetë që shfaqet në një faqe të njohur në internet vë në lojë një parullë të partisë “edhe bar do të hamë dhe armiqve nuk do t’i shtrimë dorën”.

Një fshatare e varfër i thotë të shoqit: “Familja jote po vdes nga uria, shko në Tiranë dhe kërkoj udhëheqësve tanë të na ndihmojnë. Kështu, fshatari zbret në Tiranë, troket në derën e parë që ia hap Mehmet Shehu, krahu i djathtë i Hoxhës. “Shoku Shehu”, thotë fshatari, “familja ime po vdes urie dhe unë më mirë do të haja bar sesa t’i shtrija dorën armikut...” Shehu i thotë: “Ke bërë gjënë e duhur”. I jep 100 lekë dhe mbyll derën. Duke kujtuar porosinë e gruas së tij, fshatari shkon në shtëpinë e Enver Hoxhës dhe troket. Kur Enveri përgjigjet, fshatari i thotë: “Xhaxhi Enver, familja ime po vdes nga uria dhe më mirë do haja bar sesa t’i shtrija dorën armikut për ndihmë”. Enveri i përgjigjet “Shok, ti ke bërë gjënë më të duhur. Fillo të hash në këtë anë të oborrit dhe në qoftë se je akoma i uritur mund të vazhdosh edhe mbrapa tij”.²⁸

Një anekdotë e ngjashme me këtë të fundit m’u tregua nga një mik në Tiranë, i cili më këshilloi që barsoletat t’ua kërkoja shkodranëve:

Një ditë Z. Xhemal Dymylja, kryetari i Bashkisë së Shkodrës, pa një tufë me njerëz që po hanin bar përreth statujës së Tre Heronjve në sheshin qendror të qytetit. Në atë moment ai filloi t’i bërtiste atyre “Çfarë po bëni?! Shoku Mehmet do vijë të na vizitojë javën tjetër dhe ju po hani barin! Tani ejani merrni 100 lekë dhe ikni tutje!” Një javë më vonë vjen Shehu dhe sheh njerëz që ishin ulur me duar dhe me gjunjë duke ngrënë bar në fund të statujës dhe edhe iu tha: “Shokë! Javën tjetër këtu vjen Enver Hoxha! Ejani merrni 500 lekë dhe ikni tutje!” Një javë më vonë një makinë e zezë ndalon në shesh dhe prej andej zbret Enver Hoxha. Ai sheh që ka disa njerëz që po hajné bar në bazën e statujës, ecën drejt tyre dhe u thotë: “Mos e hani tani të gjithë, kemi një dimër të gjatë përpara!”²⁹

Në të gjitha barsoletat, protagonistin njerëzor shqiptar mbetet një socialist i mirë, që ndjek fjalë për fjalë udhëzimet socialiste, duke parapëlqyer më mirë të hajë bar sesa t’i shtrijë dorën armikut për ndihmë, ndërsa nga ana tjetër, është përkushtimi i Enver Hoxhës për të njëjtën doktrinë për të cilën ai është gati të sakrifikojë qytetarin socialist shqiptar më shumë sesa ta mbështesë atë. Populli shqiptar do të parapëlqente më shumë të hante bar sesa t’i kërkonte ndihmë ndokujt

(d.m.th. armikut). Aspekti humoristik i anekdotës është supozimi i Hoxhës që trupi mund të ndryshojë në mënyrë që t'i përshtatet ideologjisë, në vend që të jetë sistemi ideologjik i aftë për të lehtësuar nevojat themelore njerëzore për ushqim; papërputhshmëria e utopisë ideologjike me realitetin fizik.

Këtë anekdotë ia tregova një grupi shkodranësh në një takim social në Sidnej, të cilët reagueshan me një të qeshur të mbytur – ata nuk e kishin dëgjuar anekdotën më parë – dhe më pas një burrë bëri një koment: “Po, ata me të vërtetë donin të na vrisnin”³⁰ Është interesante për t'u theksuar që barsoletat ishin të njohura dhe në bastionet e partisë, ku veprimi i tyre zhvendoset gjithmonë në Shkodër, e cila shërben si Tjetri politik dhe kulturor, me një reputacion të stereotipizuar si vendi i barsoletave dhe i rezistencës ndaj shtetit. Nuk mendoj që këtu kemi të bëjmë me ndonjë konspiracion politik, por thjesht me mënyrën se si Shkodrani shërben si Tjetri (barsoletaxhiu), ku projektohet dhe zhvendoset ndjenja anti-sistem e atij/asaj që tregon barsoletën.

Ndryshe nga Rumania, ku barsoletat në lidhje me socializmin ishin kanali i parë i informacionit për regjimin e kaluar, shpesh në Shqipëri m'u desh të pyesja direkt se si jetohej në vitet 1980. Në kontekstin e një bisede që pata me nënën e një kolegu për radhët e qumështit që fillonin në orën tre të mëngjesit, tregova shakanë e mëposhtme, që është mjaft e njohur në Rumani:

Një burrë kishte qëndruar në radhë për tre orë rresht pa lëvizur dhe ai papritur thotë: “Më ka ardhur në majë të hundës! Do shkoj të vras Çausheskun!” Lë një shishe në vendin e tij dhe largohet. Kur kthehet gjashtë orë më vonë, të gjithë e pyesin “Hë?! E vrave?”. Ai thotë: “Jo, radha ishte shumë e gjatë, por lashë një shishe për të ruajtur radhën dhe atje!”

Askush nuk qeshi dhe gruaja shqiptare që kishte qenë nëpër radha më tha që nuk ishte për të qeshur, sepse askush nuk kishte ëndërruar të vriste Hoxhën. Në të vërtetë, kur interviston shqiptarë që kanë qenë fëmijë në kohën e vdekjes së Hoxhës, ata përpiqen të më bëjnë përshtypje duke kujtuar varrimin, një atmosferë trishtimi dhe frike. Kjo ishte ndryshe nga eksperiencia me rumunët, që pavarësisht se ishin shumë të rinj për të kuptuar qartësisht se çfarë kishte ndodhur, u ish thënë se ky ishte një ndryshim për mirë ose ndienin lehtësim dhe inat përreth tyre. Fatos Lubonja shkruan që njerëzit u gjallëruan pas vdekjes së Hoxhës, por në mënyrë të heshtur, madje dhe në shtëpinë e tyre, pas kaq shumë kohe në heshtje.³¹

Pal Vata - një rast i studimor i mobilizimit të përkohshëm të humorit

Në vazhdim të këtij studimi, pyeta më shumë se njëqind miq dhe kolegë në qoftë se ata kujtonin ndonjë anekdotë politike në Shqipëri dhe një seri me pyetje të tjera për mënyrën se si tregoheshin barsoletat, ose nëse kishin pasur frikë t'i tregonin ato. Një mik më dërgoi me postë elektronike një indikacion të paqartë nga babai i tij, që i kish thënë: “Të gjeja Pal Vatën”. Kur i pyesja shqiptarët mbi 45 vjeç se kush ishte Pal Vata, përgjigja ishte një pauzë, pastaj një e qeshur dhe pastaj disa barsoleta. Megjithëse tregoheshin vazhdimisht vetëm katër barsoleta, ishte e qartë që në një periudhë të caktuar, barsoletat e Pal Vatës ishin të përhapura në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Në të vërtetë kishte nuanca humorit që në përmbajtje ishin politike, por ato nuk ishin grimca humoristike në stilin e barsoletave politike të llojit të vendeve të tjera socialiste evropiane, ato në fakt ishin cikle barsoletash spontane dhe autoktone.

Në këto grimca humoristike, Pali ishte një anëtar partie. Atij i pëlqente të mburrej duke i dhënë biçikletës për të shkuar në takimet e partisë, kishte një bark të madh ndërkohë që të tjerët ishin të uritur dhe nuk dinte asgjë për seksin apo për gratë. Një seri barsoletash për Pal Vatën e shfaq atë duke kontrolluar një projekt ndërtimi dhe megjithëse nuk di se si do të jetë produkti, në fund ai jep urdhra. Në këtë mënyrë Pali është protagonist i tipik budalla, i cili përfaqëson

plasaritjet më të mëdha të sistemit socialist me trajta të dukshme.

Prejardhja e këtyre grimcave humoristike, çuditërisht kujtohet nga të gjithë dhe nuk konsiderohet një histori për të qeshur. Kur një shqiptar 20-vjeçar që jeton në Australi pyeti të ëmën nëse Pal Vata ekzistonte me të vërtetë, ajo u bë serioze në fytyrë dhe i shpjegoi që Pal Vata ishte një “njeri i shkretë”, vajza e të cilit ishte “vrrarë nga partia” (në një aksident në hekurudhë) dhe ata e bënë Palin hero të popullit për “sakrificën” e tij.³² Pal Vata i vërtetë ishte bërë shumë i kërkuar dhe mendimi i tij kërkohej nëpër gazeta dhe ftohej nëpër kongrese dhe takime dhe nga të tjerët konsiderohej si një i metë që impresonohej nga i njëjti shtet që i kishte shkatërruar familjen dhe sipas kësaj logjike dhe nderin e tij. Sigurisht, ajo që i bën këto grimca humoristike për të qeshur është se ato shfaqin kotësinë dhe budallallëkun e procedurave dhe anëtarëve të partisë. Megjithatë dhe përdorimi specifik i Pal Vatës prodhon një kontekst unik në të cilin anëtari i partisë, ndonëse ironizohet, nuk është i keq në mënyrë të vullnetshme, përkundrazi ai të shkakton keqardhje si një administrator i pandërgjegjshëm i së keqes, pasi familja dhe nderi i tij janë shkatërruar nga një sistem çnjerëzor. Duke biseduar me diasporën shqiptare postsocialiste në Sidnej për Pal Vatën, arritëm të zëvendësojmë të qeshurën në barsoleta me shpjegime serioze për “turpin” e historisë së vërtetë, gjë e cila tregon që e qeshura mbi socializmin është e kufizuar dhe e mobilizuar nga konjunktura shumë të veçanta në kohë dhe në hapësirë.³³

Teorizimi i hapësirës familjare në socializëm

Zbatimi i parullës së famshme të Hoxhës që “nuk mund të lejojmë barërat e këqija të rriten, por duhen shkukur nga rrënjët”, nënkuptonte që në qoftë se një individ hetohej, burgosej ose madje vetëm dyshohej nga strukturat shtetërore, e tërë familja e tij gjithashtu duhej t’i nënshtrohej të sipërshënuarave ose të persekutohej.³⁴ Shumë familje u përpoqën që të siguronin shpëtimin e tyre duke pasur të paktën një anëtar të familjes në parti, të cilëve shpesh iu kërkohej të mbikëqyrnin anëtarët e tjerë. Mbi të gjitha, ishte jetësore të garantohej familja dhe të shprehej mbështetja ndaj regjimit për të evituar persekutimin apo nevojën për të persekutuar të tjerët. Strukturat sociale mbi të cilat Hoxha ndërtoi regjimin e tij u zhvilluan dhe u konsoliduan për gjysmë shekulli gjatë socializmit dhe mbetën në vend me rënie e tij, edhe sepse udhëheqësit shqiptarë mundësuan një tranzicion paqësor drejt një hapje demokratike. Anëtarët e një familje apo komuniteti që ishin në Partinë Socialiste mbetën të afërm dhe miq, duke i ruajtur marrëdhëniet midis tyre edhe pas vitit 1992. Anëtarët e aparatit të dikurshëm të partisë u bënë aktorë prominent në strukturat e shoqërisë civile dhe të qeverisë, ashtu siç ndodhi dhe në vendet e tjera ish-socialiste. Megjithëse pas vitit 1992 në Shqipëri ka pasur disa raste kompensimi për krimet e së kaluarës, shumë pak nga ish-të persekutuarit kanë marrë shpërblimin e burgut dhe nuk ka një rrugë institucionale nëpërmjet së cilës mund të vendoset drejtësia ose dëmshpërblimi.

Ajo që të befason në rastin e Shqipërisë është se mungojnë diskure që pretendojnë se “populli” është një viktimë e pafajshme, që u mashtrua nga forca të huaja (të jashtme) apo ligjërime të vetëfajësimit për faktin që nuk u denoncua ajo që “po ndodhte nën socializëm”, siç ndodh rëndom në Rumanë. Kur pyeta një grua, e cila kishte qenë mësuese shkolle, se si ndihej për të kaluarën, ajo më tha që “ndiheshim të frikësuar se të huajt me të vërtetë mund të vinin këtu, nuk dinim asgjë për botën e jashtme, nuk mund të bënim asgjë tjetër”.³⁵ Në qoftë se e krahasojmë me Rumaninë, ku mbizotërojnë diskurset e viktimizimit dhe ankesave, ajo që është e habitshme për diskursin shqiptar që merret si shembull këtu, është se nuk ka ndonjë reagim ose turp të vokalizuar të individëve të veçantë, por ekziston vetëm një shpjegim i përbashkët që gjërat në atë kohë ishin ashtu siç ishin, dhe që ajo ishte një kohë e keqe. Kjo nuk do të thotë që njerëzit kanë harruar përgjegjësitë për krime të caktuara, por që ata janë të ndërgjegjshëm se të njëjtët individë dhe të njëjtat familje përbëjnë dhe sot matricën sociale.³⁶ Përveç kësaj, ekziston një rezistencë popullore për mosheqjen e bunkerëve ushtarakë, të shëmtuar dhe të kudondodhur në zona publike, si dhe një tendencë unike për të ruajtur vëllimet e librave të Enver Hoxhës,

sepse këto janë kujtimet fizike të asaj që shqiptarët kanë vuajtur, në mënyrë që të dilnin si një komb-shtet i pavarur. Nuk mendoj që këto mënyra të lidhjes me shenjat [dalluese] të së kaluarës shërbejnë në të tashmen për justifikuar krimet e së kaluarës, por ndoshta përbëjnë një diskurs që është unik në Evropë dhe pranon se ekzistenca kombëtare shqiptare dhe Enver Hoxha ishin dy çështje të lidhura ngushtë në këndvështrimin e përditshëm të njerëzve të asaj kohe. Po si mund t'i kuptojmë këto dy identitete e ndryshme, ku kemi nga njëra anë rumunët, të cilët vazhdojnë të tregojnë të njëjtat barsoleta që tregonin edhe nën socializëm, dhe nga ana tjetër shqiptarët, që edhe në postsocializëm rrallë e përmendin dhe e përqeshin Hoxhën?

Renata Saleci ka teorizuar mbi mënyrën se si shteti socialist bazohej në qytetarin socialist, i cili publikisht bindej ndërsa në mënyrë private kritikonte regjimin, dhe sipas vetë asaj, kjo dyanshmëri donte të thoshte që qytetarët ishin të ndërgjegjshëm që kishin dështuar për t'u bërë si socialistë “të mirë” ashtu edhe disidentë “të mirë”.³⁷ Duke lëvizur midis këtyre dy fushave që ecnin paralelisht, nga njëra anë ajo e parullave të fushës publike dhe e autokritikës, nga ana tjetër fusha alternative e barsoletave, që ishte edhe arena e sharjeve dhe shakave kundër regjimit, qytetari shqiptar zgjodhi heshtjen, i ndërgjegjshëm se vetë ajo/ai mund të ishte i denoncuari i radhës. Përveç kësaj, kënaqësia në tregimin e barsoletave anti-regjim qëndron në ndjenjën e komunitetit që krijohet në raport me thundrën shtypëse të shtetit, që monitoronte sjelljen e qytetarit në emër të idealit të utopisë socialiste. Në Rumaninë postsocialiste tregimi i barsoletave është kënaqësi, sepse kujton një identitet të fortë të përbashkët, i cili u ndërtua si një opozitë kundër dhe brenda survejimit të shtetit të mëparshëm socialist.

Në Shqipëri, një arenë e tillë alternative identiteti të përbashkët deri në vitin 1990 nuk mundi të ekzistonte. Udhëheqësit dhe burokratët socialistë i bënë më të dukshme ndarjet tradicionale familjare dhe rajonale nëpërmjet institucioneve të shtetit dhe lëvizjes së kontrolluar të njerëzve. Popullsia e vogël bëri që anonimiteti dhe ndarja klasore të ishte e pamundur, dhe koncepti i shtetit etnokombëtar, i cili hyri formalisht vetëm në vitin 1912, u ndërtua më gjerësisht vetëm gjatë regjimit socialist; nuk kishte një diskurs të fuqishëm ose një histori moderne të institucionalizuar të “popullit shqiptar”, që ekzistonte para krijimit të shtetit të Hoxhës ose jashtë kufijve të shtetit të tij.³⁸ Në këtë mënyrë, çdo ditë e më shumë populli shqiptar u mbyll brenda kufijve të shtetit, për të treguar një identitet etnokombëtar shqiptar të pavarur.

Fatos Lubonja, në një shkrim të vitit 1994 të titulluar “Privatësia (Privacy) në regjimin totalitar”, argumenton që shqiptarëve nën regjimin e Hoxhës, jo vetëm që i mungonte hapësira individuale për analizimin e vetvetes, për besimin dhe kulturën individuale, për mendimin kritik dhe për një kulturë komuniteti, por gjithashtu kishte mungesë të imponuar të afërsisë me identitetin e komunitetit.³⁹ Kjo mungesë afërsie me idealin e identitetit të komunitetit të utopisë socialiste u përkeqësua nga qëllimi kryesor për të mbajtur një komb të pavarur shqiptar, një qëllim që qytetarët besonin se e kishin të përbashkët me Enver Hoxhën. Ndërgjegjësimi i popullit që ata nuk po e përmbushnin identitetin ideal të shoqërisë socialiste, megjithëse ata duronin vuajtje të mëdha fizike në përpjekje për të përmbushur këtë identitet, përjetësonte frikën që ndoshta populli shqiptar nuk mund të shpëtonte si një komb-shtet i pavarur. Mungesa e barsoletave për Enver Hoxhën gjatë qeverisjes së tij mund të përketet si një mungesë hapësire për një arenë alternative të një identiteti të përbashkët që mund të ngjizej rreth vuajtjes nën qeverisjen e Enverit. Kjo, sepse qëllimi kryesor i qytetarëve ishte që të përmbushnin idealin e identitetit social të shpallur nga Hoxha, të siguronin mbijetesën e kombit të tyre. Në ato pak barsoleta që ekzistojnë, protagonistit shqiptar është në gjunjë duke ngrënë bar, duke u përpjekur që të përmbushte idealin kombëtar dhe jo duke mbajtur radhën për të vlarë Hoxhën, udhëheqësin dhe mbrojtësin kombëtar. Hoxha nuk u bë një figurë qesharake pas vitit 1992, sepse njerëzit sinqerisht e kishin identifikuar atë me përpjekjen për mbijetesën e kombit, një identifikim i inkurajuar nga vetë Enver Hoxha.

Vlera e këtij mësimi mund të zbulohet nëpërmjet shkrimeve dhe përvojave të të persekutuarve politikë nën sundimin e Hoxhës. Njëra nga vetëm dy barsoleta për periudhën socialiste që m'u tregua pa asnjë lutje nga ana ime, ishte ajo që më tregoi një burrë që kishte kryer

23 vjet burg nën akuzën e propagandës kundër socializmit (sepse kishte treguar një barsoletë). Ai kishte kërkuar një biftek në një pijetore, duke kërkuar që t'i sillnin “Surratin e Maos”.⁴⁰ Duke qenë pjesëmarrëse në një projekt gojor historie, udhëtova më këtë njeri në burgun e Spaçit, ku kishte kaluar moshën e tij të rinisë. Ai kishte kaluar një kohë të gjatë duke u menduar se si ndaj tij u ngrit akuza e të qenit “armik i popullit”, dhe ai e shihte veten e tij në radhë të parë si një individ, më pas si një mbështetës i vendosur i një shteti shqiptar të pavarur, dhe në fund si një viktimë e regjimit socialist. Kujtimet e të burgosurve na ndihmojnë të kuptojmë se hapësira e burgut ishte ndryshe nga ideja që kish krijuar regjimi komunist se të burgosurit politikë ishin një komunitet i veçuar nga ideja e “popullit shqiptar”. Sipas këndvështrimit tim, të burgosurit ishin krenarë për punën që kishin bërë, sepse kjo ishte dëshmi e dedikimit të tyre për mbijetesën e kombit shqiptar, çka provonte që ata nuk ishin “armiqtë e popullit”, siç kërkonte t'i damkoste shteti.

Gjithashtu, ish-të burgosur politikë të tillë si Uran Kalakulla dhe Agim Musta kanë shkruar gjatë për përvojat dhe miqtë e tyre në burgje dhe për rolin kryesor që luante humori “për të mbajtur shpirtrat e tyre të shëndetshëm”.⁴¹ Të burgosurit e përdornin humorin për të qeshur me personazhet politike të regjimit, të cilët konsideroheshin të ndryshëm nga ata që bënin punën e detyruar për hir të dashurisë që kishin ndaj kombit shqiptar, duke përjashtuar në mënyrë diskursive Enver Hoxhën dhe rojet e burgut nga “populli shqiptar”. Edhe nëpër burgje, barsoletat tregoheshin vetëm nëpër grupe të ngushtë miqsh, sepse përdorimi i torturës si dënim ishte shumë i përhapur dhe mizor.⁴²

Përfundimi

Në vitin 2006 dhe veçanërisht nëse jeton në një demokraci kapitaliste në Australi apo Shqipëri, është e vështirë të kritikosh besimin e dikujt në një çështje kaq të nderuar (siç është mbijetesa kombëtare nga pushtimi ndërkombëtar) dhe që një ditë me diell del se ishte një mashtrim absurd dhe tragjik. Besimi i përbashkët kombëtar në qëllimet e regjimit të Hoxhës dhe marrëdhënia rezultuese ambivalente me diktatorin ishte tabu përpara vitit 1992, për shkak se mungonte hapësira - fizike dhe psikologjike - për njerëzit që të shprehnin ndjenjat negative që ata mund të kishin për Hoxhën dhe ishte një tabu pas vitit 1992, për shkak të identifikimeve të mëparshme pozitive me të, duke ndarë një dedikim popullor të përbashkët për shpëtimin kombëtar. Ishte qëllimi i përbashkët për një Shqipëri të pavarur, megjithëse në një mjedis të mykur nga iluzionet dhe terrori paranojak, që bënë që barsoletat politike për diktatorin, në atë kohë apo edhe tani, thjesht nuk bënin për të qeshur. Mungesën e barsoletave post-socialiste për Shqipërinë socialiste, unë e përktej si një refuzim kolektiv për të thjeshtëzuar apo kundërshtuar identifikimin popullor dhe intensiv me Enver Hoxhën, si një udhëheqës kombëtar dhe diktator i egër. Sinqeriteti me të cilin shfaqet ky refuzim është unik në Evropën postsocialiste.

Puna kërkimore e këtij studimi u bë e mundur me ndihmën e shumë miqve të mi të durueshëm shqiptarë në Shqipëri, Australi dhe në Shtetet e Bashkuara. Falënderime të veçanta për Xhuljeta Harasanin, Luljeta Ikonomin, Ariel Ben-Amos, Donika Xhixhën, Nevila Gremin, Ilir Kalemajn, Muratin, Valentinën dhe çdokujt në Rozafën e Sidnejt i premtoj nga tani dhe në të ardhmen vetëm barsoleta për të qeshur.

Shënime

¹ Donna M. Goldstein, *Laughter Out of Place: Race, Class, Violence, and Sexuality in a Rio Shantytown* (Berkeley: University of California Press, 2003), 6.

² Një kontribues shqiptar në një forum po ashtu shqiptar e kishte titulluar kontributin e tij romii tironc kapil [emri i autorit], ‘barsoleta mas vdekjes Enverit, se para nuk kishte :))’ [titulli i mesazhit], Forumi Shqiptar > Argëtim & zbavitje > Humor shqiptar > Humori i mençur i Tef Palushit!, <http://forumihorizont.com/shortthread.php3>. Thread id 3207. Postuar më 4 Dhjetor 2003, parë së fundi më 30 korrik 2006.

³ Për më shumë faqe në internet shqiptare që kanë tema humoristike dhe barsoletash dhe gjithashtu blog-e në lidhje me historinë shqiptare shikoni : <http://shqiperia.com/humouri/index.php>, <http://www.kokoshka.com>, <http://www.dallavere.com/dallavere/index.php>, www.albforumi.com, www.veriu.org, www.durresi.it, www.korcavizion.com, dhe www.shkoder.net. ‘Shqiptar’ në këtë studim i referohet shqiptarëve etnikë nga shteti shqiptar. Shqiptarët nga Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi nuk mund të referohen në këtë studim si të tillë. Në asnjë mënyrë ky nuk është një vendim politik, por bëhet për shkak të përvojave të ndryshme historike midis shqiptarëve në ish – Jugosllavi dhe atyre të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

⁴ Në shoqëritë e tjera socialiste evropiane, çështja sesa disidencë mund të lexojmë brenda rreshtave të humorit zyrtarisht të sanksionuar televiziv apo të shkruar po shfaq debate të mëdha, ndërsa në Shqipëri komedia që zhvillohej çdo vit për “Programin e Vitit të Ri” shihej nga të gjithë dhe konsiderohej si shkalla matëse e asaj që regjimi lejonte në subjektin e humorit. Gjithashtu media e shkruar i përdorte barsoletat dhe karikaturat, por në linjë me politikën e ditës së regjimit. Për shembull shih Alfred L. Lorenz, *Albanische Karikaturen: Katalog zur ersten albanischen Karikaturenausstellung in der Bundesrepublik Deutschland und West-Berlin* (Munich: Deutsch-Albanische Freundschaftsgesellschaft, 1987) dhe Bardhyl Fico, *Përralla për gogot dhe me gogot treguar nga gaztorët eurokomunistë dhe dy të vërteta që nuk i thonë* (Tirana: 8 Nëntori, 1983).

⁵ E bazoj këtë deklaratë në eksperiencën time personale mes viteve 1997 dhe 2006 në sesionet e tregimit të barsoletave të panxitura nga dikush ndaj Causheskut në të gjitha klasat e rumunëve mbi 25 vjec.

⁶ Duke e krahasuar me 15 libra rumunë me barsoleta të botuar pas 1990 dhe të mbajtura nga Libraria e Kongresit, ka ndoshta afërsisht vetëm shtatë përmbledhje botimesh me barsoleta për Shqipërinë në të njëjtën periudhë, gjysma e të cilëve janë shkruar nga komedianë të cilët kanë punuar gjithashtu gjatë regjimit socialist, dhe pak prej tyre përmbajnë një ose dy barsoleta për socializmin. Shih për shembull Ahmet Banushi, *Gomari me pasaportë: fabula, mikrofabula, epigrame, epitafe* (Tirana: Glob, 1994), Ahmet Banushi, *Kali në asistencë: fabula-epigrame* (Tirana: Omsca, 1998), Filip Çakuli, *Kur qeshim me politikanët* (Tirana, Hosteni, 2000), dhe Ferdinand Radi, *11 raunde humor* (Tirana, Iliria, 2003). Zef Gjeta, *Barsoleta pa fund* (Tirana: Hoktari, 2005), ka një kapitull të vogël (fq.295-316) të titulluar “Fjalë të urta nga kohët e kaluara”, por që nuk janë barsoleta nga Shqipëria socialiste. Jua tregova shqiptarëve këto barsoleta për të treguar rëndësinë e detajeve të vogla të importuara nga jashtë, si për shembull në njërin nga këto barsoleta presupozohet sikur të gjithë shqiptarët kanë një makinë, kur në fakt shumë pak kishin makinë para vitit 1992..

⁷ Për studimet shqiptare për humorin shih Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe të humorit* (Tirana: Toena, 2000) dhe Naum Prifti, *Dasmë pa nuse : komedi* (Tirana: Naim Frashëri, 1969).

⁸ CS I intervistuar nga Ariel Ben-Amos në Vlorë 23 Mars 2006. Intervistat e zhvilluara nga unë ose nga Z. Ben-Amos për tregimin e barsoletave janë koduar dhe shënuar në mënyrë që të mbrojnë identitetin e të pyeturve. Transkriptet origjinale të intervistave të koduara zotërohen nga autori.

⁹ Shumë studime për humorin në vendet socialiste fillojnë me shprehjen e Orwell-it që barsoletat janë “revolucione të vogla”, e cila pa dyshim sjell konkluzionin e diskutueshëm, sipas të cilit në qoftë se barsoletat janë revolucione ato atëherë janë impotente. Shih Robert Cochran, ‘“What Courage!”: Romanian “Our Leader” Jokes,’ *Journal of American Folklore* 102.405 (July-Sept. 1989), 259-274. Kjo përpjekje për të studiuar humorin në marrëdhënie me strukturat e pushtetit në shoqërinë socialiste mund të rritet më shumë, në qoftë se marrim në konsideratë studimet se si shteti perceptohej dhe ndërtohej nga qytetarët socialistë, të tilla si Sheila Fitzpatrick, *Ordinary Life in Extraordinary Times: Soviet Russia in the 1930s* (New York: Oxford University Press, 1999); Renata Salecl, *The Spoils of Freedom: Psychoanalysis and Feminism after the Fall of Socialism* (London; New York: Routledge, 1994).

¹⁰ Isa Blumi, ‘The Politics of Culture and Power: The Roots of Hoxha’s Postwar State,’ *East European Quarterly* 31.1 (Sept. 1997), 379-99.

¹¹ Për studimet mbi burgjet në Shqipëri shih Agim Fusta, *Burgjet e Shtëtit burg* (Tirana: Tona, 2000), *Gjëmat e komunizmit në Shqipëri* (Tirana: Geer Publishing House, 2001) and *Burgjet e Diktatures Komuniste në Republike e Shqipërisë 1944-1991* (Tirana: Mirgeeralb, 2005); Susan Greeley Murati, *A cultural psychological study of the narratives of the ex-politically persecuted people of Albania: Toward a national narrative* (Unpublished Thesis, Alliant International University, California School of Professional Psychology, San Diego 2003 UMI database number AAT 3082503). Shih gjithashtu botimet e Qendrës së Rehabilitimit Shqiptar për Viktimat e Traumës dhe Torturës në www.arct.org, dhe dokumetarin për të zhdukurit në burgje të drejtuar Roland Gjoza, *Të Zhdukurit* (Tirana: Studio

Albafilm dhe Departamenti i filmit artistik i ATSH, 2002).

¹² Institutit i Statistikave të Republikës së Shqipërisë mbi historinë e popullsisë <http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Sociale/Popullsia/POP%202004/pop1.xls>, parë për herë të fundit më 4 Nëntor 2006

¹³ Ramiz Alia, 'Enver Hoxha: Lufta e flamurit për liri dhe socializëm', Konferenca Kombëtare dedikuar punës së pavdekshme të shokut Enver Hoxha, 15-16 tetor 1985 (Tiranë; 8 Nëntor 1985), 6-7. Për të krahasuar sesi të njëjtët njerëz e përshkruanin Enver Hoxhën 10 vjet më vonë, shih Agim Musta dhe Mexhit Kokalari, Kush ishte Enver Hoxha (Tiranë, Apollonia 1996).

¹⁴ Musta, Burgjet e Diktatures Komuniste në Republike e Shqipërisë 1944-1991, 4.

¹⁵ Filma shqiptarë të tjerë dramatikë prodhuar në periudhën e postsocializmit për socializmin janë: Parullat Gjergj Xhuvani (Francë/Shqipëri:2001 dhe I dashur armik (Shqipëri/Francë/Gjermani:2004) Sidoqoftë programimi televiziv është i prirur kryesisht ndaj filmave të realizimit socialist të prodhuar para vitit 1992 sesa ndaj filmave shqiptarë postsocialistë.

¹⁶ Në fakt, ky film është i mirënjohur në komunitetin rom shqiptar si një përfaqësim pozitiv i këtij grupi etnik; protagonistit i filmit fsheh kalin e shpëtuar në një komunitet rom, i cili interpretohet si një reflektim i kujdesshëm i kurajës së komuniteteve rome për të vepruar jashtë ligjeve të diktaturës. Vetë identifikimi i minoriteteve rome në Shqipëri në marrëdhënie me shtetin socialist do të ishte një kontribut i çmuar për të kuptuar heterogjenitetin e identiteteve të përbashkëta të artikuluara brenda një diktature etnokombëtare si ajo e Hoxhës.

¹⁷ Shqipëria ishte i vetmi vend që shpalli ateizmin dhe i ktheu në shtëpi kulture vendet fetare.

¹⁸ XH bisedë personale 31 Mars 2006.

¹⁹ MR Shënime 13 Shkurt 2006.

²⁰ Shih Michael Kaser 'Vazhdimësia ekonomike në historinë e trazuar të Shqipërisë', Studimet europiane - Aziatike 53:4 (2001) 627 - 637, 629.

²¹ Fatos Lubonja, në një intervistë me Pawel Smolenski 'O czym marza Albanczyzy,' në Wyborcza (27 June 2002), 15.

²² Lubonja, Wyborcza 15.

²³ Mundësia që mund të arrestonin në qoftë se tregojë një anekdotë politike në Evropën socialiste gjithashtu shërbeu si një subjekt popullor për të treguar barsoleta. Shih Bruce Adams, Revolucione të vegjël në rusi: Historia ruse dhe sovjetike e shekullit të 20 sipas barsoletave (New York: Routledge Curzon, 2004), 48.

²⁴ FCV intervistuar nga Ariel Ben - Amos në Vlorë më 23 Mars 2006

²⁵ Për faqet në internet për historinë rumune shih <http://www.fanclub.ro/showthread.php?t=17521> and <http://cyberculture.ro/blog/?p=131>.

²⁶ Dhe akoma sot, njëra nga dy partitë politike mbizotëruese në Shqipëri mbetet, të paktën si emër, Partia Socialiste.

²⁷ Henri Bergson, Laughter : an Essay on the Meaning of the Comic in Comedy (New York: Doubleday, 1956), 64.

²⁸ Mendova që ishte origjinale, sepse nuk e kam dëgjuar këtë anekdotë me emrin e ndonjë diktatori tjetër dhe sepse pasi e lexova pyeta njerëzit në mënyrë të drejtpërdrejt në qoftë se ata dinin ndonjë anekdotë me këtë parullë dhe kishte përgjigjet e shumta për të njëjtin vend dhe të njëjtën kohë. E postuar nga romii tironc kapil 'Enveri dhe populli' [titulli i mesazhit] [http://forumihorizont.com/shortthread.php3? Thread id 3207](http://forumihorizont.com/shortthread.php3?Thread%20id%203207), postuar më 4 Dhjetor 2003, parë për herë të fundit 30 Korrik 2006.

²⁹ XH bisedë personale 31 Mars 2006.

³⁰ Shënime personale 3 Mars 2006.

³¹ Fatos Lubonja 'Privatësia në Regjimin Totalitar,' Përpjekja 20 (2005), 102-12, 112.

³² VR i intervistuar më 12 Maj 2006.

³³ Grimcat humoristike me Pal Vatën nuk tregohen nga shqiptarët në postsocializëm si një mënyrë për të kujtuar socializmin; fakti që unë ua kujtova njerëzve ato nuk do të thotë ripërfshirjen e tyre në jetën e përditshme. Barsoletat funksionojnë në mënyrë të veçantë në vendin e zanafillës së tyre, që nuk është me vend për Australinë, dhe tregimi i anekdotave është një veprim social i mbyllur, ku çdokush duhet të jetë në gjendje të kontribuojë me një anekdotë dhe të ndajë sëbashku me të njëjtën qeshur. Kur ndalon dhe fillon shpjegosh brezave më të rinj pse diçka është për të qeshur ose cilët janë pjesët joshqiptare që janë shartuar me barsoletat shqiptare, evoluimin dhe vetë praktikën e tyre, e bën këtë një bisedë edukative sesa një rreth për tregimin e barsoletave.

³⁴ Si shembull të kësaj deklarate, shih fjalimin e Enver Hoxhës '25 vjet beteja dhe fitore në rrugën e socializmit' botuar në 28 Nëntor 1969, në librin e Enver Hoxhës, Fjalime: Revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë partisë dhe i gjithë jetës në vendin tonë" (Tirana: Naim Frashëri, 1974) 57 - 140, 58). Për një përmbledhje të pabotuar të 300 dëshmimeve të refugjatëve shqiptarë nga persekutimi politik në Shqipëri shih Komiteti Kombëtar për një Shqipëri të Lirë, Dëshmi të Kushteve Skllavëruese të Punës brenda Shqipërisë, të prezantuar në Kombet e Bashkuara në vitin 1952, mbajtur në Librarinë e Kongresit të Shteteve të Bashkuara, Washington DC. Për t'u shënuar dëshmia e Z. Zil Sulejmani, i cili tregon për burgosjen e grave dhe të bijave të njerëzve që ishin detyruar të linin vendin, në burgun e Gjirokastrës, 23.

³⁵ Biseda me M.K., 31 dhjetor 2005

³⁶ Marrëdhënia e shqiptarëve dhe rumunëve me të kaluarën e tyre duhet lexuar gjithashtu në mënyrat shumë të

ndryshme të kërkimit falje publike për të kaluarën komuniste në të dy vendet. Kjo do të mund të shfaqte një parashtrim të ndryshëm të marrëdhënies me shtetin, i cili përfaqëson qytetarin të angazhuar në strukturat politike si në atë kohë edhe tani në të tashmen.

³⁷ Salecl, *The Spoils of Freedom*, 47-49.

³⁸ Sigurisht që kishte ndryshime klasore të dukshme; midis atyre që jetonin në “bllok” dhe atyre që nuk jetonin aty, midis jugorëve dhe veriorëve, midis njerëzve që jetonin në Tiranë dhe atyre që jetonin nëpër fshatra, midis familjeve që kishin pozicione pushteti para komunizmit dhe atyre që erdhën në pushtet me anë të Partisë Komuniste. Por ishte një skandal që zj. Hoxha kishte 24 palë këpucë dhe që edhe një diplomat që ishte dërguar në Angli duhet të qëndronte dhe ai në radhë.

³⁹ Lubonja, ‘Privatësia ne Regjimin Totalitar,’ 2005.

⁴⁰ Kjo ishte një anekdotë politike meqë Kina e Mao-s ishte në atë kohë i vetmi aleat ndërkombëtar i Shqipërisë. Një gërshetim i kushteve të vështira të jetesës (mungesa e biftëkëve nëpër pijetore), një dyndje të programeve kulturore kineze në radio dhe në televizion, dhe një ndjenjë raciste e përgjithësuar si një vend evropian që kishte aleatë në Azi, coi në rritjen e numrit të ‘barsoletave’ raciste kundër Kinës. Një anekdotë tjetër e papranueshme për periudhën e socializmit ishin gjithashtu të referuara me etnicitetin dhe mu rrëfye kjo gjë për të më treguar që në socializëm ishte një fyerje e dënueshme nga ligji në qoftë se për shembull dikush theksonte që romët shqiptarë ishin një grup etnik më vete.

⁴¹ Ky citim e ka burimin nga Uran Kalakulla, *21 Vjet Burg Komunist (1961-1982: Kultime, Mbresa, Portrete dhe Refleksione)* (Tirana: self-published, 2001), 358. Shih gjithashtu Agim Musta, *Mjerim pa fund: shkrime publicistike* (Tirana: Toena, 1998), 99. Është gjithashtu interesante për të theksuar që shumë shqiptarë që intervistova me rekomanduan që të takoja ish të burgosur politikë në mënyrë që t’u kërkoja atyre barsoleta, duke u bazuar në faktin që ata që kishin qenë në burg kishin arsye për të urreyer Hoxhën saqë mund edhe ta tallnin atë. Kjo mënyrë kuptimi i barsoletave që lindin nga urrejtja, sesa nga ambivalenca e identifikimeve, shfaq nevojën për të konsideruar gjithashtu besimin kulturor të shqiptarëve në pushtetin e syrit të keq, që do të thotë që në qoftë se thua diçka të palejuar, të tillë si një anekdotë për të vranë Enver Hoxhën, ekziston mundësia që me [anë të syrit të keq] të invokohet një veprim i tillë.

⁴² Për detaje mbi torturat e përdorura në Shqipëri shih Agim Musta, *Gjëmat e Komunizmit në Shqipëri* (Tirana: Geer, 2001) 264-267. Është interesante për t’u theksuar që shqiptarë që nuk janë persekutuar politikisht nga regjimi më kërkojnë që të intervistoj ato që janë persekutuar nga regjimi në mënyrë që të gjej barsoleta, sepse ata bazohen në tezën që tregimi barsoletave për Hoxhën duhet të bazohet patjetër tek urrejtja. Nuk ka vetëm një mungesë kërkimi akademik mbi faktet historike të persekutimit politik nën Hoxhën dhe se si të burgosurit u përballën me përvojat e tyre, por gjithashtu kërkimet akademike mungojnë edhe për komunitetet e papersekuara se si i perceptuan të persekutarit.

NGA "REVOLUCIONI I KADIFENJTË" TEK "RESTAURIMI I KADIFENJTË": TRASHËGIMIA KOMUNISTE NË POLONI DHE SHQIPËRI*

GËZIM KRASNIQI**

Abstrakt. Ky shkrim analizon trashëgiminë komuniste të vendeve në tranzicion duke krahasuar dy raste studimore nga Europa Lindore, Poloninë dhe Shqipërinë, nga viti 1989 deri në vitin 1997. Theksi vihet në analizimin e faktorëve që sollën rikthimin e partive ish-komuniste në pushtet – ose siç u quajt nga Adam Michnik-u “restaurimi i kadifenjtë” - në një kohë të shkurtër pas rënies së komunizmit në këto dy vende, pastaj kulturën e tyre politike, profilin e partive politike, prirjet për absolutizëm politik dhe mosbesimin në institucionet politike. Ky shkrim argumenton që pavarësisht traditave të ndryshme, elitave politike apo kulturave të ndryshme, shumica e vendeve të Europës Lindore (përfshi këtu edhe Poloninë dhe Shqipërinë) kanë përjetuar rikthimin e partive ish-komuniste (kryesisht të rimodeluara si parti Socialiste ose Socialdemokratike) në pushtet shumë pak kohë pas rënies së regjimit komunist si një shenjë të mbizotërimit të trashëgimisë komuniste dhe si një ndryshim në kursin e reformave që u diktua nga nevoja e njerëzve për më shumë mirëqenie sociale dhe siguri në jetë. Kështu, edhe Polonia edhe Shqipëria u ndeshën me të njëjtat probleme të trashëgimisë komuniste, si prirjet autoritare të kryetarëve të shteteve, Walesa dhe Berisha, si dhe me “restaurimin e kadifenjtë”. Gjithsesi, siç argumentohet në këtë shkrim, ajo çka i dallon këto vende është konsolidimi demokratik, zhvillimi ekonomik dhe integrimi europian. Polonia i ka arritur të gjitha këto, Shqipëria është ende rrugës drejt arritjes së tyre.

Hyrje

Ngjarjet e pashembullta të rënies së komunizmit në Europën Lindore në 1989-ën shënuan jo vetëm fundin e një periudhe pesëdhjetë vjeçare ndarjeje të Europës përmes së ashtuquajturës *Perde të Hekurt*, por shënuan gjithashtu edhe fillimin e një ere të re për vendet ish – komuniste: rruga e gjatë dhe e lodhshme drejt demokracisë. Kjo e fundit do të konsiderohet si *proseci i tranzicionit drejt demokracisë* dhe vendet që kalojnë përmes këtij procesi do të njihen si *vende në tranzicion*. Rënia e komunizmit në 1989-n do të njihet si “revolucioni i kadifenjtë” për shkak të një karakteri paqësor që patën ngjarjet e atij viti në përgjithësi në Europën Lindore.¹ Vendeve të Europës Lindore iu desh që brenda një kohe të

* Përktheu Blerjana Bino, Universiteti Europian i Tiranës.

** Gëzim Krasniqi përfundoi studimet universitare për shkencë politike në Universitetin e Prishtinës në vitin 2005, ndërsa në 2007-ën u diplomua në studimet master për demokraci dhe të drejtat të njeriut në Europën Juglindore në Universitetin e Sarajevës dhe Bolonjës.

¹ Vejevoda, Ivan. “Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore”. *Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe* Vol. 2. (1995): fq. 43.

shkurtër (nga 1989–a deri në 1991-shin) të zgjidhnin në mënyrë demokratike qeveritë e tyre duke larguar kështu regjimin komunist dhe duke hyrë në një sistem të ri demokratik. Në atë kohë mendohej se euforia e popullit dhe mbështetja e fuqishme që vinte nga vendet e Europës Perëndimore, kryesisht në formën e premtimeve për integrim, do të shërbenin si një garanci për zhdukjen e komunizmit dhe të trashëgimisë së tij. Përkundër një supozimi të tillë, "*annus mirabilis* [viti i mrekullisë] 1989-a, gjatë të cilit shumë shpresuan se do të shihnin demokracinë të shfaqet nën fasadën e shkërmoqur shpejt të komunizmit, tregoi të ishte një vit plot me eufori të shkurtër dhe dërrmuese."² Destabiliteti politik dhe problemet e shumta socio-ekonomike e politike të tranzicionit do të kulminonin me një fenomen të papritur – kthimin në fuqi të partive ish-komuniste në një periudhë kohe shumë të shkurtër. Fenomen të cilin Adam Michnik-u do ta quante "restaurimi i kadifenjtë".³

Për të kuptuar aspektet e ndryshme të proceseve të tranzicionit dhe karakteristikat e strukturave sociale dhe të kulturës politike të popujve në vendet ish-komuniste është e rëndësishme që të analizojmë fenomenin e "restaurimit të kadifenjtë" dhe faktorët që e kanë shkaktuar atë. Fenomeni i rishfaqjes së partive ish-komuniste të rimodeluara është karakteristikë thuajse për të gjitha vendet në tranzicion. Analizimi i tij shërben për të kuptuar më mirë trashëgiminë komuniste në vendet ish-komuniste. Për më tepër ky fenomen na tregon edhe për efektet që pati rënia e komunizmit dhe karakteristikat e periudhës së tranzicionit në vende të ndryshme.

Në këtë shkrim do të analizojmë trashëgiminë komuniste të vendeve në tranzicion duke krahasuar dy raste studimore nga Europa Lindore, Poloninë dhe Shqipërinë, nga 1989–a deri në 1997-n. Kryesisht do të përqëndrohemi në analizimin e faktorëve që sollën rikthimin e partive ish-komuniste në pushtet në një kohë të shkurtër në këto dy vende pas rënies së komunizmit. Më pas do të ndalemi edhe në kulturën e tyre politike dhe analizën e tipareve të partive politike. Krahas kësaj, në shqyrtim do të merret edhe trashëgimia komuniste në terma të prirjeve për absolutizëm politik dhe mosbesim në institucionet politike. Në këtë shkrim do të përpiqemi të tregojmë se pavarësisht traditave të ndryshme, elitave politike apo kulturave të ndryshme, shumica e vendeve të Europës Lindore (përfshi këtu edhe Poloninë dhe Shqipërinë) e kanë përjetuar rikthimin e partive ish-komuniste në pushtet shumë pak kohë pas rënies së regjimit komunist si një shenjë të mbizotërimit të trashëgimisë komuniste dhe si një ndryshim në kursin e reformave – nevoja e njerëzve për më shumë mirëqenie sociale dhe siguri në jetë.

Së pari, shkrimi bën një përmbledhje të proceseve të tranzicionit në vendet e Europës Lindore si në nivelin teorik edhe në atë praktik, për të vazhduar më pas me një analizë të trashëgimisë komuniste në këto vende. Pjesa e dytë dhe e tretë bëjnë një analizë mëvehte për rastet studimore, Poloninë dhe Shqipërinë, duke u ndalur në zhvillimet pas 1989-s, në rotacionin politik dhe në tiparet e partive politike në këto vende. Ngjashmëritë dhe ndryshimet në proceset e tranzicionit në këto dy raste të marra në studim do të krahasohen nga pikëpamja e zgjerimit të Bashkimit Europian.

Metodologjia e përdorur për këtë shkrim përfshin si qasjet analitike edhe ato krahasuese. Literatura e përdorur përmban data dhe të dhëna nga zhvillimet social-politike në Poloni dhe Shqipëri si dhe pikëpamje dhe interpretime të autorëve të tjerë lidhur me këtë fenomen si Vejvoda, Holmes, White, Caldor, Butt, Linz, Kostelëcy, Bugajski, etj.

² Ibid, fq. 37

³ E cituar në Vejvoda, Ivan. "Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore". Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe Vol. 2. (1995): 43

Sfondi teorik i proceseve të tranzicionit demokratik

Rënia e Murit të Berlinit në 1989-n dhe *efekti domino* që ai pati në të gjitha vendet e Europës Lindore shënoi fillimin e procesit të tranzicionit demokratik në këto vende. Edhe pse nuk ka një pikëpamje të njëjtë mes studiuesve për shkaqet që çuan në rënien e komunizmit, në përgjithësi pranohet së rënia e shpejtë e komunizmit në 1989-n pati dy shkaqe kryesorë. Së pari, komunizmi konsiderohej si një formë e dominimit të huaj dhe si shtypje e identitetit kombëtar, pasi ai u ndërtua menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore nën ndikimin e fuqishëm të Rusisë dhe Ushtrisë së Kuqe. Shkaku i dytë ishte dështimi i regjimit komunist për të mbajtur premtimet për progres ekonomik e social krahasuar me vendet perëndimore.⁴ Për këtë arsye revolucionet nga 1989-a deri në 1991-shin Leslie Holmes i quan "refuzim i dyfishtë"⁵, çka do të thotë se këto vende përmes revolucionit refuzuan dominimin e huaj të Bashkimit Sovjetik (ky në fakt nuk është rasti i Shqipërisë) dhe komunizmin si një sistem politik. Tranzicioni nga post-komunizmi në demokraci i vendeve të Europës Lindore përfshin veç të tjerash edhe aspektet ekonomike dhe transformimet institucionale nga 1989-a deri në 2004-rën, kur vendet e para ish-komuniste u anëtarësuan në Bashkimin Europian.⁶ Ky aspekt do të analizohet pasi të kemi shqyrtuar në përgjithësi tranzicionin dhe pasi të jemi ndalur në rastet konkrete të Polonisë dhe Shqipërisë.

Transformimi institucional i vendeve të Europës Lindore

Deri nga fundi i viteve '90-të të gjitha vendet e Europës Lindore aplikuan rregullat formale dhe procedurat e demokracisë duke bërë rotacion paqësor të pushteteve dhe duke u shkëputur kështu nga komunizmi.⁷ Të gjitha vendet e Europës Lindore tanimë kishin regjime të zgjedhur në mënyrë demokratike duke filluar me Poloninë, e cila organizoi zgjedhjet e para të lira e konkurruese dhe duke përfunduar me Shqipërinë, e fundit që u bë një vend pluralist dhe organizoi zgjedhje demokratike. Hapi i parë drejt këtij transformimi ishte hartimi dhe miratimi i kushtetutës dhe i rregullave demokratike të qeverisjes. Në lidhje me këtë Adam Przeworski argumentonte se "hapi i parë i rëndësishëm drejt demokracisë është kalimi i pushtetit nga një grup njerëzish në një grup rregullash".⁸ Tranzicioni drejt një sistemi shumë partiak u karakterizua nga një fazë ku partitë politike mbinin si "kërpudhat pas shiut"⁹, të cilat më pas konkurronin në zgjedhjet e lira. Zgjedhjet demokratike të mbajtura në vitet 1989 dhe 1991 sollën një rigjallërim të parlamentit si simbol i përfaqësimit dhe demokracisë. Megjithatë, në ndryshim nga parlamentet e vendeve perëndimore me demokraci të konsoliduar, parlamentet në vendet ish-komuniste patën një mandat shumë të shkurtër. Kjo shpjegohet me funksionin e tyre për të hartuar dhe miratuar kushtetutat e reja.¹⁰

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i transformimit institucional në vendet post-komuniste

⁴ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore* 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 17.

⁵ Holmes, Leslie. *Hyrje në pastkomunizëm*. Cambridge: Polity Press, 1997. fq. 14.

⁶ Privitera, Francesco. *Tranzicioni dhe demokracia në vendet post-komuniste*. Qendra për Studimet Pasuniversitare ndërdisiplinore. Sarajevë, Janar, 9-12. 2007.

⁷ Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" *International Affairs* 73.1 (1997): fq. 80.

⁸ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore* 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 125.

⁹ Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" *International Affairs* 73.1 (1997): fq. 69.

¹⁰ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore* 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 138.

ishte edhe reforma në administratë. Sfidat kryesore të tranzicionit ishin kontrolli demokratik mbi sferën publike dhe roli i shtetit.¹¹ Të gjitha këto procese ngjanin si një përpjekje e vendeve ish-komuniste për tu matur me institucionet demokratike të Europës Perëndimore. Ndërkohë që i gjithë procesi i rënies së komunizmit dhe periudha e tranzicionit konsiderohen si një orvatje e vendeve të Europës Lindore për "t'u kthyer Europës" pasi ekzistonte një perceptim popullor se demokracia ishte e barabartë me këtë kthim drejt Europës.¹²

Pra, brenda një kohe shumë të shkurtër të gjitha vendet e Europës Lindore krijuan kuadrin institucional dhe njohën të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve si një parakusht për funksionimin e demokracisë. Në fillim demokracia në vendet e Europës Lindore ishte formale ose procedurale,¹³ ose thënë ndryshe, ajo ishte një skelet që kishte nevojë të mbushej.¹⁴ Kështu që i mbetej spektrit politik dhe kulturës politike të vendeve përkatëse që "të mbushnin këtë skelet" të demokracisë. Në fakt, ashtu sikurse do të shohim edhe më poshtë, në vendet ish-komuniste mungoi një spektër dhe një kulturë e tillë politike për shkak të dominimit të gjatë komunist dhe trashëgimisë së tij.

Lufta ndaj trashëgimisë së të kaluarës : roli i kulturës politike

Ngjarjet e *annus mirabilis* (viti i mrekullisë, 1989) hapën rrugën për popujt e Europës Lindore drejt një sistemi politik pluralist, ekonomisë së tregut, heterogjenitetit të opinioneve dhe mbi të gjitha hapën rrugën drejt pasigurisë.¹⁵ Eksperienca negative, e përjetuar gjatë pesëdhjetë viteve të dominimit komunist, bëri që politika të konsiderohej si një aktivitet i neveritshëm dhe i turpshëm. Një perceptim i tillë natyrisht që do të çonte më pas në një refuzim të politikës dhe aktorëve të saj.¹⁶ Si rezultat i kësaj gjatë periudhës së tranzicionit njerëzit do të kishin një qëndrim mosbesues kundrejt institucioneve të reja dhe sistemit politik në përgjithësi. Një pasojë e drejtpërdrejtë e eksperiencës së gjatë komuniste ishte edhe shkatërrimi i shoqërisë civile dhe mungesa e një ndjenje qytetarie në shoqëritë e vendeve post-komuniste. Problemet me të cilat u përballën vendet e Europës Lindore ishin të shumta po të marrim parasysh faktin se demokracia nuk është thjesht një regjim politik, ajo është një sistem ndërveprues dhe nuk mund të funksionoj siç duhet nëse nuk ka një pjesëmarrje aktive të qytetarëve.¹⁷

Duke marrë në konsideratë faktin se "eksperienca historike e çdo kombi ndikon fuqishëm edhe politikën e tij"¹⁸, është mëse e qartë se një gjysëm shekulli nën sundimin komunist ka ndikuar dhe ka formësuar kulturën politike të shoqërive të vendeve të Europës Lindore. Kështu që kultura ekzistuese nuk ofronte një bazë të mirë për zhvillimin e institucioneve demokratike. Si rrjedhojë, kjo mungesë e shpirtit demokratik në shoqëritë ish-komuniste krijoi probleme për demokratizimin.¹⁹ Edhe pse në vendet në tranzicion kishte një përpjekje për të krijuar rregulla

¹¹ Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" *International Affairs* 73.1 (1997): 73.

¹² *Ibid*, fq. 60.

¹³ Për më tepër për demokracinë formale shih: Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore". *International Affairs* 73.1 (1997): 59-82

¹⁴ Vejvoda, Ivan. "Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore". *Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe* Vol. 2. (1995): 42.

¹⁵ Vejvoda, Ivan. "Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore". *Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe* Vol. 2. (1995): 41.

¹⁶ *Ibid*, fq. 40

¹⁷ Linz, Juan J. & Alfred Stephan. *Probleme të tranzicionit demokratik dhe konsolidimit: Europa Jugore, Amerika Jugore dhe Europa post – komuniste*. London: John Hopkins University Press, 1996. fq. 13.

¹⁸ Kostelecky, Tomáš. *Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore*. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq. 88.

¹⁹ Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" *International Affairs* 73.1 (1997): fq. 60.

dhe institucione sipas modelit perëndimor, mungesa e kulturës së duhur politike për zhvillimin e demokracisë bëri që të krijohej një lloj modeli politik *sui generis* (i veçantë në llojin e vet), i cili qëndronte mes modelit komunist dhe atij të demokracisë perëndimore. Një tendencë e tillë përshkruhet më së miri nga ajo që de Tocqueville e quante "*despotizmi demokratik*".²⁰ Lufta kundër trashëgimisë komuniste ishte e paefektshme si pasojë e kulturës politike të ndikuar nga era komuniste ose si e ka cilësuar Mikhail Gorbachev-i "kulturë politike ende e papërshtatshme".²¹

Prania e trashëgimisë komuniste në vendet në tranzicion çoi në kthimin në pushtet të partive ish-komuniste. Këtij fenomeni i shtohen edhe problemet socio-ekonomike që po përballonin këto shoqëri, zhdukja e shtetit të mirëqenies sociale, zhdukja e punësimit të plotë²², rritja e papunësisë dhe falimentimi i kompanive të mëdha si pasojë e paaftësisë së tyre për tu përballur me konkurrencën dhe tregun e lirë si dhe ulja e prodhimit të brendshëm²³.

Drejt "restaurimit të kadifenjtë"

Në zgjedhjet e para dhe të dyta demokratike e të lira që u mbajtën në vendet e Europës Lindore, partitë komuniste humbën shumë nga pushteti i tyre i mëparshëm. Megjithatë në proceset zgjedhore të mëvonshme gjatë tranzicionit të vendeve post-komuniste u vu re një rikthim i partive ish-komuniste. Disa studiues, si p.sh Adam Michnik-u, e quajnë këtë fenomen si "restaurimi i kadifenjtë", të tjerë e konsiderojnë si një shenjë që tregon se shumë votues janë bërë nostalgjik për disa aspekte të komunizmit siç ishin siguria më e madhe dhe stabiliteti social. Lituania ishte vendi i parë ku u rikthyen në pushtet ish-komunistët në zgjedhjet e tetorit 1992²⁴, precedent i ndjekur më pas edhe nga vendet e tjera të Europës Lindore. Krahas trashëgimisë sociale e politike të komunizmit, ka edhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në rikthimin në pushtet të ish-komunistëve.

Së pari, partitë komuniste pushuan së ekzistuari dhe shumica e tyre u shndërrua në parti socialdemokrate ose parti me orientim të majtë. Këto parti, tanimë të rimodeluara, trashëguan infrastrukturën e partive komuniste dhe mundën të ruanin lidhjet dhe rrjetin e tyre. Sipas Linz-it, partitë komuniste të rimodeluara mbështeteshin si në "vazhdimësinë organizative" – ekzistenca e një rrjeti të mirë organizaur të partisë në kohën e komunizmit – edhe në "vazhdimësinë kulturore", e cila i referohet traditës ideologjike të partive komuniste.²⁵ Është mëse e qartë që shumë prej anëtarëve dhe liderëve të rinj të partive komuniste të rimodeluara kishin qenë pjesë e aparatit të vjetër komunist, pra ata kishin një traditë të gjatë në aktivitetet politike dhe aftësitë organizuese. Po ashtu i rëndësishëm është edhe fakti se shumë zyrtarë ish-komunist përfituan nga reformat dhe sidomos nga procesi i privatizimit, të cilët u shndërruan në kapitalistë të rinj, duke krijuar një lloj 'borgjezie të kuqe'.²⁶ Kthimi i shpejtë në pushtet i partive ish-komuniste u ndihmua nga një kombinim i aspekteve të trashëguara nga e kaluara, si p.sh aftësitë organizuese,

²⁰ Ibid, fq. 61.

²¹ Cituar në Inglehard, Roland. Modernizimi dhe postmodernizimi: ndryshimet ekonomike, politike e kulturore në 43 shoqëri. Princeton: Princeton University Press, 1997. fq. 162.

²² Vejvoda, Ivan. "Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore". Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe Vol. 2. (1995): 41

²³ Kostecky, Tomáš. Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq. 33.

²⁴ Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" International Affairs 73.1 (1997): fq. 70.

²⁵ Cituar në: Kostecky, Tomáš. Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq. 5.

²⁶ Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komuniste. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002. xxxi.

rrjetet lokale dhe anëtarësia e madhe e partive komuniste si dhe nga një identifikim i fshehur që votuesit kishin me partitë komuniste dhe stabilitetin social që ato krijuan.²⁷

Për më tepër shumica e partive ish-komuniste, të shndërruara tanimë në parti socialiste ose socialdemokrate, patën mundësi që të promovonin atë që cilësohet si *imazh i dyfishtë*.²⁸ Kjo do të thotë se partitë ish-komuniste mund të shfaqeshin edhe si mbrojtëse të shtetit të mirëqenies sociale edhe si të angazhuara për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe ekonominë e tregut. Pra, ato kishin mundësi që përmes këtij imazhi të dyfishtë t'i drejtoheshin edhe votuesve nostalgjikë të komunizmit dhe të trembur nga reformat, por edhe votuesve që kërkonin një alternativë të re.

Së fundi, partitë ish-komuniste u kthyen në pushtet edhe falë faktit se konkuronin me koalicione të gjera, fronte anti-komuniste që nuk kishin një organizim të mirë, u mungonte eksperiencia politike, kohezioni i brendshëm dhe programet politike të qëndrueshme.²⁹ Në përgjithësi udhëheqësve të opozitës kundër komunizmit dhe ish-disidentëve u mungonte thuajse tërësisht eksperiencia politike, ata po hynin menjëherë në një fushë që nuk e njihnin, pra po bëheshin pjesë dhe aktorë të politikës dhe qeverisjes. Në këtë kuptim Janusz Bugajski me të drejtë ka thënë se "një klasë politikanësh efektive dhe profesionale do kohë që të krijohet, të zhvillohet dhe të maturohet."³⁰ Në përgjithësi në vendet post-komuniste partitë e reja që u krijuan u ndeshën me probleme të njëjta si mungesa e orientimit ideologjik, anëtarësia e ulët, udhëheqje e paqëndrueshme dhe struktura organizative të dobta. Në këtë mënyrë ato i hapën rrugën kthimit në pushtet të partive ish-komuniste.

Pra, i ashtuquajtur "restaurimi i kadifenjtë" ishte rezultat i një sërë faktorësh si p.sh ndikimi i trashëgimisë komuniste, problemet ekonomike e sociale, faktorë të brendshëm të partive politike etj. Ngjarjet e vitit 1989 bashkë me rënien e komunizmit sollën edhe shkatërrimin e shtetit të mirëqenies sociale si dhe "një katastrofë ekonomike dhe një vakum politik me përmasa të paimagjinueshme" në të gjitha vendet e Europës Lindore.³¹ Pavarësisht kësaj, në secilin prej këtyre vendeve u vunë re zhvillime të ndryshme në aspektin e transformimeve politike dhe institucionale për shkak të veçorive dhe traditës së çdo vendi. Në vijim do të analizojmë rastin e Polonisë dhe Shqipërisë.

Polonia: tranzicion përmes bisedimesh

Polonia ishte vendi i parë në Europën Lindore që zhvilloi zgjedhje demokratike (pjesërisht të kontestueshme) në qershor të vitit 1989 dhe solli në fuqi një kryeministër jo-komunist. Pas më shumë se një dekade përplasjesh dhe bisedimesh mes regjimit komunist dhe sindikatës opozitare, *Solidarnosc*, në prill të vitit 1989 u arrit një marrëveshje, e cila do të hapte rrugën drejt demokracisë liberale. Për këtë arsye tranzicioni në Poloni shpesh konsiderohet si "një tranzicion i arritur përmes bisedimesh".³² Curry argumenton se lidhja e re mes opozitës dhe qeverisë u krijua si rrjedhojë e gadishmërisë së vazhdueshme të punëtorëve polakë për të luftuar

²⁷ Urban, Joan Barth. "E majta post-komuniste: Trajektore të ndryshme, trashëgimi e përbashkët". E majta e transformuar në shoqëritë post-komuniste: rasti i Europës Lindore e Qëndrore, Rusisë dhe Ukrainës. Curry, Jane Leftwich & Joan Barth Urban (eds.). New York and Oxford: Rowman & Littlefield Publishers, Inc., 2003. fq. 259.

²⁸ Kosteletzky, Tomáš. Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq. 77

²⁹ Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komuniste. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002. xx.

³⁰ Ibid, fq. xxi.

³¹ Gasteyger, Curt. Europa: Nga ndarje tek bashkimi – Një përmbledhje e dokumentuar nga 1946 – 2006. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006. 213.

³² White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 24.

dhe e përgjegjshmërisë politike të udhëheqësve për të hyrë në bisedime me ta.³³ Si pasojë e këtij procesi bisedimesh institucionet e para ishin një kombinim i opozitës me komunistët që ishin në pushtet. Kështu, presidenti Jaruzelski ishte komunist dhe kryeministri vinte nga rradhët e *Solidarnosc-it*, Tadeusz Mazowiecki.

Megjithatë, si hyrje e vërtetë në tranzicion dhe si një hap i rëndësishëm drejt ndarjes përfundimtare me regjimin e vjetër komunist konsiderohet ndërmarrja e një programi reformash ekonomike të *terapisë së shokut (shock therapy)*, të drejtuar nga ministri i financave, Barcelowitsz-i. Në fakt, u deshën edhe dy vjet të tjerë që në Poloni të ndodhte procesi paqësor i tranzicionit politik dhe transformimi i pushtetit. Së pari, pas dorëheqjes së presidentit komunist, Jaruzelski, udhëheqësi legjendar i opozitës polake kundër komunizmit dhe njëkohësisht kryetar i *Solidarnosc-it*, Lech Walesa, u zgjodh President i vendit në 1990-n. Më pas në tetor 1991 u zhvilluan zgjedhjet parlamentare.³⁴ Zgjedhjet e para të lira të tetorit 1991 në Poloni përfunduan me disfatën e kampit të përçarë të *Solidarnosc-it*. Kjo për shkak se *Solidarnosc-i* nuk arriti që të krijonte një parti të fortë politike dhe se partitë ish-komuniste, tanimë të reformuara, ishin shumë mirë të organizuara (Aleanca e së Majtës Demokratike, SLD). Pra, Polonia e pa veten në vigjilje të "restaurimit të kadifenjtë". Pavarësisht fragmentarizimit të parlamentit polak (Sejm), u krijua një qeveri e kampit të qendrës së djathtë, e drejtuar nga Jan Olszewski, i cili premtoi një dekomunistizim radikal, rishikim të proceseve të privatizimit dhe një axhendë sociale katolike të hapur.³⁵

"Në ndryshim nga sa pritej, qeveria dështoi dhe zgjedhjet e treta parlamentare, që u mbajtën në Poloni në shtator 1993, ishin një humbje shkatërruese për të gjitha partitë e lidhura me *Solidarnosc-in*, presidentin Walesa dhe Kishën Katolike."³⁶ Kështu pra në një periudhë prej katër vitesh, pasardhësit e partisë komuniste, Aleanca e së Majtës Demokratike dhe Partia Polake Fshatare, mundën *Solidarnosc-in* dhe fituan një shumicë të konsiderueshme prej 66% të vendeve në parlament (Sejm). Restaurimi u bë i plotë dy vjet më vonë, në 1995-n në zgjedhjet presidenciale, me fitoren e udhëheqësit ish-komunist të SLD-së kundrejt Walesa-s, heroin anti-komunist të *Solidarnosc-it*. Pas "restaurimit të kadifenjtë" besohej se qeveria e re, e krijuar nga një koalicion i partive ish-komuniste në zgjedhjet e 1993-shit dhe e drejtuar nga Pawlak-u, nuk do të vazhdonte me reformat demokratike në vend. Mirëpo, çuditërisht kjo qeveri u angazhua në politika të orientuara nga perëndimi dhe vazhdoi me reformat ekonomike.³⁷ Pas një qeverisje pesë vjeçare, partitë ish-komuniste u mundën në zgjedhjet e 1997-s nga partitë e bashkuara dhe të riorganizuara të *Solidarnosc-it*.

Sfera politike e fragmentarizuar

Pavarësisht faktit se alternimi i pushtetit nga një grup partish në një tjetër u bë në mënyrë demokratike, Polonia u përball me shumë probleme sa i takon spektrit politik. Tipari kryesor ishte fragmentarizimi i thellë i spektrit politik. Udhëheqësit politikë ndryshonin thuhetse çdo muaj; kështu nga 1989-a deri në 1997-n Polonia ndryshoi nëntë kryeministra dhe tre presidentë.³⁸

³³ Cituar në: Berend, Ivan T. *Europa Lindore e Qëndrore 1944-1993: nga periferia në periferi*. Cambridge: Cambridge University Press, 2006. fq. 257.

³⁴ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore 3*. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 28.

³⁵ Ibid, fq. 28.

³⁶ Berend, Ivan T. *Europa Lindore e Qëndrore 1944-1993: nga periferia në periferi*. Cambridge: Cambridge University Press, 2006. fq. 310

³⁷ Kostelecky, Tomáš. *Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore*. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq. 70

³⁸ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore 3*. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 24

Numri i madh i partive politike në parlament në fillimet e tranzicionit në Poloni kushtëzohej edhe nga sistemi elektoral proporcional dhe mungesa e pragut për hyrjen në parlament. Si pasojë e kësaj në 1991-shin njëzetentë parti hynë në parlament me përfaqësues të tyre.³⁹ Në zgjedhjet e vitit 1993 me vendosjen e pragut elektoral numri i partive politike që hynë në parlament u reduktua në gjashtë. Një gjë e tillë çoi drejt një skenë politike më të konsoliduar dhe një funksionim më të mirë të parlamentit dhe qeverisë.

Një problem tjetër ishte edhe përpjekja për një kontroll autoritar të institucioneve gjatë proceseve të tranzicionit. Lidhur me këtë Bugajski mendon se disa nga udhëheqësit e rinj politik në Europën Lindore u përpoqën të ruanin disa elementë autokratikë të qeverisjes dhe madje dobësuan arritjet e para demokratike.⁴⁰ Ky është rasti tipik me Poloninë gjatë presidencës së Walesa-s. Kushtetuta që u miratua në 1992-shin i jepte shumë pushtet presidentit. Ky i fundit kishte të drejtë të emëronte ministrat kyç si ministrin e mbrojtjes, ministrin e brendshëm dhe atë të punëve të jashtme. Gjithashtu presidenti kishte të drejtën e vetos dhe të drejtën e shpërndarjes së parlamentit.⁴¹ Walesa gjatë presidencës së tij në disa raste abuzoi me pushtetin e tij duke ndërhyrë në funksionimin e qeverisë. Në lidhje me tendencat autokratike të Walesa-s, këshilltari i tij më i afërt, Adam Michnik-u, shkruante në *Time Magazine* në 1991-shin se "Walesa po shndërrohet ngadalë në një Çezar".⁴² Me fjalë të tjera mund të themi se marrëdhënia mes institucioneve kryesore politike në Poloni dhe në vendet e tjera të Europës Lindore, reflekton tensionin mes dëshirës për demokraci dhe nevojës për një udhëheqje të fortë.⁴³

Është e qartë se pavarësisht nga specifikat dhe historiku i komunizmit, Polonia është pjesë e modelit të 'restaurimit të kadifenjtë'. Sfidat e vërtetë për Poloninë ishte lufta ndaj trashëgimisë komuniste, pasi rënia e komunizmit u bë shumë shpejt një realitet. Sikurse u vu re edhe gjatë kësaj analize spektri politik i Polonisë ishte i ndarë përgjatë gjithë viteve '90-të dhe u shfaqën tendenca autokratike si rudimente të së shkuarës. I rëndësishëm është fakti se nga fundi i viteve '90-të Polonia u bë një vend me demokraci të konsoliduar, pra demokracia u bë "e vetmja lojë në qytet"⁴⁴, pasi u konsoliduan institucionet, zhvilloheshin zgjedhje të lira e demokratike dhe vet procesi i vendimmarrjes ishte demokratik.

Shqipëria: tranzicioni i vonuar

Shqipëria ishte vendi i fundit i Europës Lindore që u përfshi në proceset post-komuniste të demokratizimit. Edhe pse fillimisht u duk se Shqipëria nuk do të përfshihej në ndryshimet e mëdha të vitit 1989, historia tregoi se në vitin 1991, sistemi super-ortodoks komunist shqiptar do të rrëzohej duke lënë pas një katastrofë ekonomike dhe një vakum politik të përmasave të mëdha.⁴⁵ Në ndryshim nga vendet e tjera të Europës Lindore, në Shqipërinë komuniste kishte munguar një organizim i disidentëve dhe opozitarëve. Kështu që aktorët kryesorë në

³⁹ Kostelecky, Tomáš. Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002. fq.68

⁴⁰ Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komuniste. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002. xv.

⁴¹ ibid, fq. 166

⁴² Cituar në: Berend, Ivan T. Europa Lindore e Qendrore 1944-1993: nga periferia në periferi. Cambridge: Cambridge University Press, 2006. fq.318

⁴³ Holmes, Leslie. Post-komunizmi: Një hyrje. Cambridge: Polity Press, 1997. fq. 142.

⁴⁴ Linz, Juan J. & Alfred Stephan. Probleme të tranzicionit demokratik dhe konsolidimit: Europa Jugore, Amerika Jugore dhe Europa post – komuniste. London: John Hopkins University Press, 1996. fq. 6

⁴⁵ Gasteyer, Curt. Europa: Nga ndarje tek bashkimi – Një përmbledhje e dokumentuar nga 1946 – 2006. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006. 213.

“revolucionin shqiptar” vinin nga masat e mobilizuara rishtazi.⁴⁶ Në zgjedhjet e para të lira në Shqipëri, të mbajtura në fillim të vitit 1991, komunistët morrën 169 nga 250 vende në parlament, ndërkohë që partia opozitare (Partia Demokratike, PD) morri vetëm 75 vende⁴⁷. Një raport i tillë tregon për burimet e kufizuara të opozitës, mungesën e organizimit dhe qasjen e kufizuar të saj në media.

Disfatën përfundimtare komunizmi në Shqipëri e pësoi në zgjedhjet e 22 marsit 1992, kur Partia Demokratike fitoi ndaj Partisë Socialiste, ish-partia komuniste e reformuar. Kështu PD-ja morri 92 nga 140 vende në parlament dhe PS-ja 38.⁴⁸ Si rrjedhojë parlamenti zgjodhi udhëheqësin e opozitës, Sali Berishën, si presidentin e parë jo-komunist në 9 prill 1992. PD-ja pati të njëjtin sukses edhe në zgjedhjet e majit 1996 dhe Sali Berisha fitoi një tjetër mandat pesë vjeçar si President i vendit. Mirëpo, viti 1997 ishte një katastrofë politike me përmasa shumë të mëdha, pati protesta popullore dhe rebelim, të cilat rrezikuan dështimin e shtetit.⁴⁹ Rezultati përfundimtar i këtyre ngjarjeve shkatërruese ishin zgjedhjet e parakohshme dhe restaurimi i ish-komunistëve në zgjedhjet e qershorit 1997. Më poshtë do të analizojmë mënyrën e veçantë të zhvillimit të tranzicionit në Shqipëri dhe ndikimin negativ në demokratizimin e vendit.

Tranzicion shumë i gjatë

Tre janë tiparet që karakterizojnë tranzicionin shumë të gjatë në Shqipëri: (i) ndikimi i trashëgimisë komuniste; (ii) mungesë e stabilitetit politik dhe (iii) situata e vështirë ekonomike. Trashëgimia historike dhe komuniste mbetën ende shumë të fuqishme në tranzicionin shqiptar, ndërkohë që dinamikat politike në post-komunizëm nuk kanë lejuar progresin drejt demokratizimit.⁵⁰ Pë më tepër krahas karakteristikave politike të trashëguara nga komunizmi, Shqipëria trashëgoi edhe një ekonomi tërësisht të shkatërruar. Për shkak të tendencave diktatoriale të shprehura nga presidenti Sali Berisha, i cili kishte qënë anëtar i partisë komuniste për rreth një dekadë, Shqipëria ishte në fazën e asaj që James Pettifer-i e quan “despotizëm demokratik”.⁵¹ Modelet politike të komunizmit po dominonin ende edhe në tranzicion dhe Shqipërisë i mungonte funksionimi demokratik i institucioneve, sistemi gjyqësor dhe shërbimi civil i pavarur. Gjithashtu, tendencat autoritare të presidentit Berisha shkuan aq larg sa ai u akuzua se po cënonte lirinë e medias, po ndërhynte në kompetencat e qeverisë dhe në funksionimin e sistemit gjyqësor.⁵²

Nga ana tjetër, destabiliteti politik kërcënonte seriozisht prirjen e vendit drejt reformave. Problemet më të mëdha në skenën politike filluan me refuzimin që votuesit i bënë draft-kushtetutës së mbështetur nga PD-ja në referendumin e vitit 1994 dhe më pas kontestimi për drejtësinë dhe

⁴⁶ Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komunite. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002, fq.679

⁴⁷ Ibid, fq.679

⁴⁸ Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komunite. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002, fq. 680

⁴⁹ Si pasojë e falimentimit të firmave piramidale – investime mashtruese – në pranverën dhe verën e 1997-s Shqipëria u trondit nga një rebelim i armatosur kundër qeverisë së Berishës. Thuajse gjysma e vendit, sidomos në jug, kontrollohej nga grupe të armatosura luftarake. Meqënëse strukturat e sigurisë dhe rendit në Shqipëri humbën tërësisht pushtetin atëherë për të rivendosur rendin u thirrën forcat e armatosura ndërkombëtare të drejtuara nga italianët. Më shumë se 1500 vetë vdiqën për shkak të rebelimeve të armatosura. Për më tepër shih: Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komunite. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002, fq.688.

⁵⁰ Pettifer, James. “Shqipëria: deficieti demokratik në post-komunizëm”. Eksperimentimi me demokracinë: Ndryshimi i regjimeve në Ballkan. Pridham, Geoffrey & Tom Gallagher (Eds.). London & New York: Routledge Studies of Societies in Transition, 2000. fq. 237.

⁵¹ Ibid, fq. 241.

⁵² Bugajski, Janusz. Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komunite. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002, fq. 680

legjitimitetin e zgjedhjeve në vitin 1996. Kështu që si një kombinim i krizave ekonomike e politike në pranverën e 1997-s, vendi u trondit nga rebelimi i armatosur i popullit kundër qeverisë Berisha, menjëherë pas falimentimit të firmave piramidale.⁵³ Në zgjedhjet parlamentare të atij viti fitoi PS-ja duke shënuar kështu restaurimin në pushtet të ish-komunistëve.

Në përgjithësi, Shqipëria ishte një vend i paqëndrueshëm dhe me një deficit demokratik të konsiderueshëm. Sfera politike ishte e fragmentarizuar mes dy kampeve, socialistëve dhe demokratëve, ndërkohë që bojkoti parlamentar i opozitës u bë një normë. Rruga e vendit drejt demokracisë dhe integritit në Bashkimin Europian vështirësohej për shkak të problemeve ekonomike dhe korrupsionit. Reformat politike ishin ngadalësuar pasi udhëheqja e re po shfaqte gjithmonë e më shumë qëndrime autoritare të së shkuarës komuniste. Shqipëria nën udhëheqjen e Berishës ishte një shembull i tendencës për të barazuar një udhëheqës të caktuar me demokracinë duke supozuar se mbështetja për të është mënyra më e mirë për të promovuar demokracinë.⁵⁴ Megjithatë me kalimin e kohës kultura politike filloi të ndryshojë sikurse u pa edhe me shembullin e refuzimit të draft-kushtetutës në referendumin e vitit 1994, draft i cili parashikonte kompetenca të shumta për presidentin dhe një ekzekutiv të fortë. Për shkak të problemeve me zhvillimin ekonomik dhe me sferën politike të paqëndrueshme, Shqipëria mbeti një vend me "demokraci të mangët".⁵⁵

Në pjesën që vijon do të analizojmë ngjashmëritë dhe ndryshimet në tranzicion mes Shqipërisë dhe Polonisë duke përfshirë edhe kontekstin e proceseve të zgjerimit të Bashkimit Europian dhe ndikimin e tij në demokratizimin dhe reformat ekonomike në këto vende.

Ngjashmëritë dhe ndryshimet në procesin e tranzicionit mes Shqipërisë dhe Polonisë nga pikëpamja e integritit në Bashkimin Europian

Bashkimi Europian pati një ndikim të madh transformues në Europën Lindore, meqenëse vendet e reja që aspironin të bëheshin pjesë e tij duhet të thellonin proceset e reformimit politik e ekonomik. Në samitin e Këshillit Europian në Kopenhagen në vitin 1993, Bashkimi Europian parashtroi kushtet që vendet e Europës Lindore duhet të plotësonin në mënyrë që të bëheshin anëtare të BE-së. Kriteret e Kopenhagenit kërkonin nga vendet candidate që të arrinin stabilitet politik, të vendosnin qeverisjen demokratike, të respektonin të drejtat e njeriut, të funksiononte ekonomia e tregut dhe të synonin bashkimin ekonomik, politik e monetar me BE-në. Këto kriteret u bënë katalizatorë të reformave ekonomike e politike në vendet e Europës Lindore.⁵⁶ Asistenca teknike dhe financiare e BE-së përmes programit PHARE, (një program i komunitetit për të ndihmuar vendet e Europës Lindore e Qendrore) që arriti deri në 6.2 bilion euro⁵⁷ nga viti 1990 deri më 1999-n, ishte shumë e rëndësishme për përshpejtimin e reformave ekonomike në këto vende. Aspekti kryesor i zgjerimit të Bashkimit Europian ishte roli i tij si një ankorë për procesin e reformave në vendet e Europës Lindore, meqë për këto vende shtysa kryesore për reforma ekonomike e politike u bë integrimi në strukturat europiane.⁵⁸ Politikat e zgjerimit të Bashkimit Europian patën një ndikim të madh në rrugën e Polonisë dhe Shqipërisë drejt konsolidimit të demokracisë.

⁵³ Ibid, fq. 688

⁵⁴ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qendrore 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 77.

⁵⁵ Ibid, fq. 209.

⁵⁶ Ibid, fq. 254.

⁵⁷ Neill Nugent (Ed.). Zgjerimi i Bashkimit Europian. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2004. fq. 44.

⁵⁸ White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qendrore 3. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 262.

Në fakt, Polonia dhe Shqipëria janë shumë pak të ngjashme me njëra – tjetrën për shkak të historisë së tyre të ndryshme, histori e cila do të ndikonte më pas edhe hapat e këtyre vendeve drejt demokracisë. Ndërsa Polonia kishte njohur një periudhë relativisht të zhvilluar para vendosjes së komunizmit në aspektin politik e ekonomik, Shqipërisë i mungonte tradita demokratike dhe sistemi partik në periudhën para-komuniste. Jo vetëm që ekonomia shqiptare ishte e pazhvilluar, por edhe shoqëria ishte tërësisht rurale dhe analfabete. Sa i takon vetë regjimit komunist në këto dy vende, shohim se në Poloni ky regjim ishte më i moderuar në krahasim me qeverisjen despotike të udhëheqësit komunist Enver Hoxha. Ndryshimi më i madh mes këtyre dy vendeve të marra në studim është roli i opozitës dhe disidentëve përgjatë regjimit komunist. Në Poloni lëvizjet e disidentëve dhe sindikatat e punëtorëve ishin të fuqishme, sidomos në vitet '80-të. Sikurse e nënvizuar edhe më lart ishin udhëheqësit e *Solidarnosc-it* që e detyruan regjimin komunist të "dorëzohej" duke nisur kështu rrugën drejt tranzicionit post-komunist. Në ndryshim me këtë prirje, Shqipëria ishte vendi i fundit në Europën Lindore që rrëzoi regjimin komunist për shkak të mungesës së grupeve opozitare dhe organizimit të disidentëve.

Në lidhje me trashëgiminë komuniste, si Polonia edhe Shqipëria shfaqën prirje të autoritarizmit në zhvillimet politike post-komuniste. Sikurse e analizuar edhe më lartë, presidentët e zgjedhur të të dy vendeve, Walesa dhe Berisha, prireshin drejt ushtrimit të një kontrolli të fortë mbi politikën duke cënuar shpesh procedurat demokratike. Në të dy këto vende sfera politike ishte e fragmentarizuar dhe i mungonte një orientim i qartë ideologjik. Thuhet të gjitha partitë politike, qofshin ato të majta apo të djathta, nuk ishin në gjendje që të përfaqësonin ndarjet mes grupeve të ndryshme shoqërore. Polonia pati më pak probleme sa i takon stabilitetit politik, pasi arriti të vendoste rregullat demokratike të qeverisjes që u pranuan nga të gjitha palët si dhe zhvilloi zgjedhje të lira në afatet e duhura pa u kontestuar nga palët. Në kundërshtim më këtë, në Shqipëri ndarja mes të ashtuquajturit spektër politik i majtë dhe i djathtë ishte shumë e madhe. Për më tepër kontestimi i zgjedhjeve dhe bojkoti parlamentar u bënë normë.

Si përfundim, Polonia dhe Shqipëria kanë përjetuar "restaurimin e kadifenjhtë" të partive ish-komuniste në një kohë të shkurtër pas rrëzimit të regjimit komunist. Nga ana tjetër, rruga e tyre drejt demokracisë dhe integritetit në Bashkimin Europian morri drejtime të ndryshme. Polonia u bë anëtare e NATO-s në 1999-n dhe më pas u antarësua në BE në 2004-n. Ndërkohë që Shqipëria ende po përpiqet për të fituar anëtarësimin në strukturat euroatlantike.

Përfundime

Pasojat e sundimit të një regjimi komunist për më tepër se pesëdhjetë vjet u ndjenë gjatë periudhës post-komuniste në shoqëritë e vendeve të Europës Lindore. Midis viteve 1989 dhe 1991 regjimet komuniste u rrëzuan në të gjitha vendet e Europës Lindore duke lënë pas trashëgiminë e tyre, e cila do të ishte karakteristika kryesore e zhvillimeve politike e sociale në periudhën e tranzicionit. Disa aspekte të kësaj trashëgimie komuniste janë prirjet autoritare të udhëheqësve politikë, mbizotërimi i një kulture politike që ushqente qëndrimet refuzuese ndaj politikës dhe kthimi në pushtet i ish-partive komuniste, i njohur si "restaurimi i kadifenjhtë".

Pjesa e parë analizoi fillimin e tranzicionit, fillim i cili ishte një periudhë e transformimeve institucionale dhe e vendosjes së rregullave demokratike të qeverisjes. Të gjitha vendet e Europës Lindore arritën që të krijonin institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe filluan një program reformash ekonomike të thella, duke ndjekur shembullin polak të "terapisë së shokut". Kjo mund të konsiderohet si faza e demokracisë formale ose procedurale. Për më tepër ishte e vështirë dhe problematike realizimi i reformave demokratike pasi këto shoqëri nuk kishin traditën e duhur demokratike dhe nuk njihnin mënyrat e funksionimit të saj. Si pasojë, një nga rezultatet më befasisëse të tranzicionit ishte kthimi në pushtet i partive ish-komuniste.

Më pas u analizuan tiparet, specifikat dhe sfidat e tranzicionit në Poloni dhe në Shqipëri

duke përfshirë edhe çështjet e integritit të tyre në Bashkimin Europian. Si Polonia dhe Shqipëria u ndeshën me të njëjtat probleme të trashëgimisë komuniste si prirjet autoritare të kryetarëve të shteteve, Walesa dhe Berisha, si dhe me "restaurimin e kadifenjtë". Ajo çka i dallon këto vende është konsolidimi demokratik, zhvillimi ekonomik dhe integrimi europian. Ndërsa Polonia ka arritur të gjitha këto, Shqipëria është ende rrugës drejt arritjes së tyre.

Si përfundim, rruga e vendeve të Europës Lindore nga "revolucioni i kadifenjtë" për tek "restaurimi i kadifenjtë" përfaqëson nga njëra anë luftën kundër trashëgimisë komuniste dhe nostalgjisë për "të shkuarën e lavdishme"; dhe nga ana tjetër përfaqëson kursin e reformave dhe përplasjeve politike mes alternativave të ndryshme si ato liberale apo të majta. Megjithatë këto procese nuk ishin tërësisht të paparashikueshme. Ralf Dahrendorf- i e kishte parashikuar në fillim të 1990-s kur shkruante se "dyshoj që, në Europën Lindore e Qendrore, lavjerrësi i politikës do të lëkundet në drejtim të liberalizmit dhe socializmit para se të stabilizohet përfundimisht. Drejtimi liberal ka të bëjë me ngritjen ekonomike. Kundërshtimi ndaj këtij procesi do të jetë gati të ndodhë për shkak të kostos sociale të rritjes ekonomike. Pas katër apo tetë vjetësh grupe të tjerë do të vijnë në pushtet. Ata mund të quhen Socialdemokratë."⁵⁹

Bibliografia

- Berend, Ivan T. *Europa Lindore e Qëndrore 1944-1993: nga periferia në periferi*. Cambridge: Cambridge University Press, 2006.
- Bugajski, Janusz. *Hyrje. Partitë Politike të Europës Lindore: një guidë në politikën post-komuniste*. Nga: Bugajski. London & New York: Qendra për Studimet ndërkombëtare dhe strategjike, 2002.
- Curry, Jane Leftwich and Joan Barth Urban, Joan Barth. "E majta post-komuniste: Trajektore të ndryshme, trashëgimi e përbashkët". *E majta e transformuar në shoqëritë post-komuniste: rasti i Europës Lindore e Qëndrore, Ruisë dhe Ukrainës*. Curry, Jane Leftwich & Joan Barth Urban (eds.). New York and Oxford: Rowman & Littlefield Publishers, Inc., 2003.
- Gasteyer, Curt. *Europa: Nga ndarje tek bashkimi – Një përmbledhje e dokumentuar nga 1946 – 2006*. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006.
- Holmes, Leslie. *Hyrje në pastkomunizëm*. Cambridge: Polity Press, 1997.
- Inglehard, Roland. *Modernizimi dhe postmodernizimi: ndryshimet ekonomike, politike e kulturore në 43 shoqëri*. Princeton: Princeton University Press, 1997.
- Kaldor, Mary & Ivan Vejvoda. "Demokratizimi në Europën Lindore e Qëndrore" *International Affairs* 73.1 (1997).
- Kostecky, Tomáš. *Partitë politike pas komunizmit: Zhvillimet në Europën Lindore dhe Qendrore*. Washington, D.C: Woodrow Wilson Center Press, 2002.
- Linz, Juan J. & Alfred Stephan. *Probleme të tranzicionit demokratik dhe konsolidimit: Europa Jugore, Amerika Jugore dhe Europa post – komuniste*. London: John Hopkins University Press, 1996.
- Neill Nugent (Ed.). *Zgjerimi i Bashkimit Europian*. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2004.
- Pettifer, James. "Shqipëria: deficit demokratik në post-komunizëm". *Eksperimentimi me demokracinë: Ndryshimi i regjimeve në Ballkan*. Pridham, Geoffrey & Tom Gallagher (Eds.). London & New York: Routledge Studies of Societies in Transition, 2000.
- Pridham, Geoffrey and Tom Gallagher (Eds.). *Eksperimentimi me demokracinë: Ndryshimi i regjimeve në Ballkan*. London & New York: Routledge Studies of Societies in Transition, 2000.
- Privitera, Francesco. *Tranzicioni dhe demokracia në vendet post-komuniste. Qendra për Studimet Pasuniversitare ndërdisiplinore*. Sarajevo, Janar, 9-12. 2007.
- Vejvoda, Ivan. "Largimi nga totalitarizmi në Europën Lindore e Qëndrore". *Transition and Consolidation in Central and Eastern Europe* Vol. 2. (1995).
- White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore 3*. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003.

⁵⁹ Cituar në: White, Stephen, Batt, Judy & Powl G. Lewis (Eds.). *Zhvillimet në politikën e Europës Lindore e Qëndrore 3*. Hampshire: Palgrave Macmillan, 2003. fq. 183.

MIDIS ILUMINIZMIT DHE ROMANTIZMIT: MENDIMI POLITIK I RILINDJES SHQIPTARE*

LEA YPI**

Abstrakt. Shpesh prejardhja konceptuale e së ashtuquajturës *Rilindje Shqiptare* lidhet me ndikimin që patën idetë e Romantizmit perëndimor mbi lëvizjet nacionaliste ballkanike. Në të kundërt, ky studim analizon tiparet kulturore dhe politike të Shqipërisë së asaj kohe dhe sugjeron që kjo fazë e historisë intelektuale shqiptare mund të shpjegohet më mirë me anë të kategorive të Iluminizmit. Ai përqendrohet mbi rolin ideologjik që luante kritika ndaj besimit fetar dhe mbi një projekt kulturor e politik rrënjët e së cilit gjenden në traditën iluministe. Studimi nënvizon që koncepte iluministe të tilla si autokritika racionale dhe teleologjia edukative mund të ndihmojnë për të kuptuar më mirë veçoritë e Rilindjes në krahasim me vendet e tjera ballkanike e për të na dhënë një përshkrim më të saktë të rrethanave të krijimit të shtetit modern shqiptar.

Hyrje

Termi *Rilindje* nuk është më i përshtatshmi për të përkufizuar atë periudhë të historisë intelektuale shqiptare, që shkon nga mesi i shekullit të XIX-të deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912 e që shënon përpjekjen e parë për t'i dhënë trajta intelektuale identitetit kombëtar shqiptar. Huazimi terminologjik nga Rilindja italiane, që ka të bëjë me ripërdorimin e paradigmeve klasike në filozofi, arte dhe shkencë, vetëm e ngatërron veshjen e këtij koncepti rrethanave shqiptare.¹ Narrativa kulturore e Shqipërisë nuk mund të *ri*-lindte ose të lindte për të dytën herë, për arsye se përfytyrimi simbolik i një entiteti të bashkuar, që ndante të njëjtën gjuhë, zakone dhe histori nuk kishte marrë kurrë formë veçse në imagjinatën e përbashkët të njerëzve.² Përmbysjet sociale dhe politike të shekullit të XIX-të në Evropë shfaqën një Shqipëri gati mesjetare, të prapambetur nga ana kulturore dhe të karakterizuar nga përçarjet klanore, zhvillimi i varfër ekonomik dhe nga struktura shumë të dobëta administrative. Kjo shoqëri

* Një version më i hershëm i këtij artikulli është paraqitur në edicionin e 7-të të Kokkalis Graduate Student Workshop, në John Kennedy School of Government, Harvard University. Dëshiroj të falenderoj pjesëmarrësit e këtij edicioni si dhe Renato Caputo-n, Filippo Gonnelli-n, Bo Strath-in, Peter Wagner-in, Zafer Ypin dhe veçanërisht Jonathan White-in për inkurajimin dhe komentet e tyre. I detyrohem veçanërisht Kathleen Imholz-it për disa vërejtje kritike dhe sugjerime shumë të dobishme mbi versionin e parafundit. Do të doja gjithashtu të falenderoj redaktorët e revistës East European Politics and Society që lejuan ribotimin e artikullit dhe Jonida Ballën për përkthimin e tij në shqip.

** Lea Ypi është doktorante në European University Institute në Firence ku ajo bën kërkime mbi drejtësinë globale në raport me dimensionin normativ të kufinjëve politikë. Ajo ka kryer një Master në Filozofi nga Universiteti La Sapienza në Romë, një Master në Gazetari dhe një Master në Shkencat Politike nga European University Institute. Interesat e saj akademik kanë të bëjnë me filozofinë morale dhe politike, drejtësinë globale dhe institucionet trans-nacionale. Ajo ka botuar disa ese në lidhje me këto çështje dhe ka dhënë mësim në Filozofi dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e New York-ut në Tiranë.

patriarkale, ku ligji i privilegjeve të veçanta mbijetonte në rrethana të përditshme anarkie kishte pak cilësi të përbashkëta me shtetet borgjeze fqinje të Evropës Perëndimore dhe me shoqërinë e tyre civile në zhvillim. Sidoqoftë, transformime historike të rëndësishme bënë te domosdoshme shkëputjen nga e kaluara feudale dhe krijuan nevojën për një rol të ri të intelektualëve në hedhjen e themeleve të shtetit modern. Kategoritë filozofike që shoqëruan perceptimin e këtyre ndryshimeve në Evropën Perëndimore dhe që më vonë frymëzuan inteligjencën shqiptare për të mbartur këtë mision moral dhe politik, mbeten akoma për tu qartësuar.

Historiografia bashkëkohore shpesh e lidh këtë episod të historisë ballkanike me ndikimin e ideve romantike mbi lindjen e nacionalizmit në vendet e Evropës Lindore. Megjithatë në rastin shqiptar, manifesti romantik – shpesh i përshkruar si një reagim ndaj të ashtuquajturës frymë abstrakte dhe intelektualiste të Iluminizmit e që vlerëson, në të kundërt, ndjenjat ekzistencialiste dhe fetare bashkë me një rikthim traditës – duket problematik.³ Pa mohuar praninë e disa prej këtyre elementëve në shoqërinë shqiptare dhe ngjashmëritë e tyre me një rrymë të veçantë të Romantizmit ballkanas, kjo ese synon të dëshmojë sesi *Rilindja kombëtare* shfaq një dialektikë më të ndërlikuar ndërmjet Iluminizmit dhe Romantizmit. Duke patur parasysh veçoritë kulturore dhe historike të Shqipërisë, ajo përpiqet të argumentojë se si, pavarësisht afërsisë kohore me Romantizmin evropian, ideale të Iluminizmit si sovraniteti, laicizmi dhe njohuria racionale na lejojnë të kuptojmë më mirë tiparet kulturore dhe sfidat politike me të cilat *Rilindja kombëtare* shqiptare u ndesh.

Në pjesën e parë të këtij artikulli kam paraqitur një përshkrim të shkurtër të kushteve politike dhe historike në të cilat u shfaq *Rilindja* shqiptare. Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të marrë parasysh sqarojnë disa veçori të kontekstit shqiptar dhe pasqyrojnë rëndësinë e modeleve iluministe për konceptualizimin e një shteti sovran të ardhshëm. Në pjesën e dytë, jam përqendruar veçanërisht në përpjekjet intelektuale për të ndërtuar dhe për t'i përshtatur rrethanave politike shqiptare mitin e identitetit kombëtar. Këtu janë parashtruar edhe kategoritë e Iluminizmit në mënyrë që të kuptohet, nga njëra anë, kritika ndaj besimit fetar në emër të deklaratave politike për bashkim kombëtar dhe nga ana tjetër roli që luante rievokimi i historisë shqiptare në tekstet teorike-politike të kohës. Ndarja e elementëve fetarë nga ata etnikë, si tipar dallues i lëvizjes nacionaliste shqiptare, do të ishte e pamundur për t'u kuptuar pa marrë parasysh se si ideja iluministe e tolerancës dhe kritika e tij ndaj obskurantizmit fetar frymëzoi intelektualët shqiptarë. Kjo çon tek pjesa e tretë e studimit, ku analizohen veçoritë politike e kulturore të *Rilindjes* shqiptare dhe ndikimi i idealeve të Iluminizmit mbi një program patriotik që mendohej të realizonte emancipimin popullor nëpërmjet edukimit intelektual. Kjo teleologji pedagogjike përbën pjesën më të rëndësishme dhe sistematike të programit të Rilindjes. Ajo ka të bëjë me vështrësitë e parashikueshme për të shndërruar struktura shoqërore me familjen në qendër, si ato që ekzistonin në Shqipëri, në shoqërinë civile të një shteti modern të karakterizuar nga përdorimi i arsyes publike dhe mendimi pluralist. Së fundi, analiza e kategorive intelektuale që shpjegojnë sesi platforma politike të caktuara ndërthuren me elemente lokalë dhe etnikë hedh dritë mbi rolin e mitit të identitetit kombëtar për themelimin e shtetit modern shqiptar.

Romantizmi në Ballkan dhe në shoqërinë shqiptare

Në kohën kur idealet e Romantizmit filluan të përhapen në Ballkan dhe të ndikojnë në formimin e një kulture që i shërbente ideve nacionaliste, në Evropën Perëndimore kjo estetikë e *mal de vivre* i përkiste të shkuarës.⁴ Ajo mbërriti ende më vonë në Shqipëri dhe sikur ngjarje të caktuara historike të mos kishin ngjallur nevojën për një ndryshim rrënjësor në perceptimin e kulturës së vendit, ndikimi i një rryme letrare romantike mbi letërsinë shqiptare të shekullit të XIX– të sot ndoshta nuk do të shtrohej as si pyetje. Në fund të fundit, lëvizje të tjera filozofike dhe letrare kishin kapërcyer shtegun intelektual të Evropës moderne pa u ndalur aspak në Shqipërinë akoma feudale. Ky territor i varfër filozofik, ku idetë moderne liberale rallë kishin patur ndonjë

ndikim, nuk kishte pse të përbente një forcë tërheqëse për teoritë romantike të antinomive të arsyes dhe qëndrueshmërisë së subjektivitetit. Në ndryshim nga vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore, këtu Romantizmi nuk qe një rrymë mendimi që kundërshtonte një tjetër apo thjesht zëvendësonte modele të mëparshme etike dhe estetike. Përkundrazi, ai përkonte me lindjen për herë të parë të një tradite kombëtare në letërsi. Për këtë arsye, vlen të përmendet fakti që ndërthurja e tij me kulturën vendase krijoi një rrymë intelektuale kombëtare karakteristike e së cilës përngjasin me rivalin ideologjik të Romantizmit: Iluminizmin. Megjithatë më shumë sesa veçoritë abstrakte të ideve kundërshtarë, ajo që shpjegon më qartë gjenezën e lindjes së një lëvizjeje kulturore kaq origjinale janë rrethanat historike që i dhanë jetë *Rilindjes* shqiptare.

Trazirat e Revolucionit Francez dhe kriza e brendshme e perandorisë osmane e detyruan Portën e Lartë që të ndërmerre disa reforma të vonuara për krijimin e strukturave të një shteti modern.⁵ Dekreti perandorak i vitit 1839, i njohur më mirë me emrin Reformat e Tanzimatit⁶, urdhëroi ndryshime rrënjësore në sistemin administrativ dhe juridik të perandorisë, duke përfshirë këtu njohjen formale të disa të drejtave liberale. Ky statut perandorak, që më vonë u shndërrua në një kod penal dhe civil të vërtetë, premtojte të mbronte “jetën, nderin dhe pronën” e individëve “pavarësisht ndarjeve fetare dhe ndryshimeve midis sekteve”.⁷ Sistemi arsimor, që përfshinte krijimin e shkollave fillore të detyrueshme dhe falas, i shpëtoi kontrollit të *mullah-ve* (klerikëve islamikë) dhe u organizua mbi baza laike. Njëkohësisht, një reformë e rëndësishme në strukturat juridike bëri të mundur njohjen formale të të drejtave të pakicave të krishtera. U hapën njësi administrative financiare dhe zyrtarët publikë zëvendësuan *myltez-ët* e mëparshëm (njerëz që blinin te drejtën për të mbledhur taksat për sulltanin). Përmirësime të tjera administrative ndoqën modelin francez; i gjithë territori u nda në entitete më të vogla të quajtura *vilajete* që imitonin prefekturat franceze ndërsa ndryshimet në ushtri përfshinë krijimin e shërbimit ushtarak të detyruar.

Ndonëse teorikisht këto reforma “iluministe” mund të na shfaqen sot si të përshtatshme dhe të domosdoshme, ato u ndërmorrën me vonesë dhe nuk arritën të parandalonin rënien e perandorisë. Për më tepër, osmanët u përballën me vështirësi serioze në zbatimin e tyre. Këto reforma u perceptuan nga popullsia vendase si një lojë e perandorisë që synonte të shkatërronte ekuilibrin e autonomive shekullore. Sidomos në Shqipëri, ku çështjet sociale administroheshin në bazë të marrëdhënieve personale, lidhjeve etnike dhe rivaliteteve vendore, reformat e Tanzimatit u pritën me armiqësi. Funkionarët e perandorisë ishin të huaj për popullsinë, rrallë e njihnin gjuhën e vendit dhe mungesa e familjaritetit të tyre me një sistem të ndërlikuar primitiv për kontrollin e çështjeve administrative krijoi më shumë probleme sesa mund të zgjidhte. Për më tepër, sistemi i ri i taksave dhe shërbimi i detyruar ushtarak shiheshin si një përpjekje e rrezikshme për t'i hequr popullsisë lokale autonomitë që *de facto* kishin ekzistuar ndër shekuj.

Sipas reformave të reja, Shqipëria u nda në katër entitete administrative (vilajete), por lidhjet etnike dhe historike duket sikur i kapërcyen këto ndryshime. Veriu i Shqipërisë, i mbizotëruar nga gegët, asnjëherë nuk i pranoi rregullat e reja legjislative dhe vazhdoi të njohë ligjet që i imponoheshin nga *Kanuni* si të vetmet me forcë detyruese.⁸ Ndryshe nga veriu, jugu i vendit ku politika e mëparshme makiavelike e Ali Pashë Tepelenës kishte mundur të reduktonte disa nga përçarjet rajonale duke përqendruar pushtetin, e pati më të lehtë për tu integruar.⁹ Shpesh aristokracia dhe përfaqësuesit e borgjezisë toske shërbenin si ndërmjetës midis popullsisë shqiptare dhe funksionarëve të huaj perandorakë duke siguruar në këtë mënyrë poste administrative jashtë vendit. Pasardhësit e tyre, të cilët studiuan në shkollat e Stambollit, ishin ndër fillimtarët e Rilindjes shqiptare.

Megjithatë nuk duhet të nxitohemi në mbivlerësimin e rolit të intelektualëve të arsimuar në Perandorinë Osmane për krijimin e nismave politike dhe kulturore që çuan në lindjen e nacionalizmit shqiptar. Një rol shumë i rëndësishëm u luajt edhe nga komunitetet arbëreshe në jug të Italisë lidhjet e të cilëve me vendin i kishin qëndruar shekujve. Aktiviteti politik dhe letrar i Jeronim De Radës është vetëm njëri nga shembujt e ndjenjave patriotike dhe angazhimit të thellë me idealin e pavarësisë kombëtare që frymëzoi betejat e tilla intelektuale. Një rrjet i fortë

emigrantësh shqiptarë në Cosenza, Bukuresht, Sofie, Kairo – për të përmendur vetëm qendrat më të rëndësishme – si kolegët e tyre filozofë një shekull më parë, u përpoq t'i përshtaste modelin e shekullit të XVII –të të *Republique des Lettres* nevojave kulturore specifike të vendit.

Reformat e Tanzimatit synonin t'i jepnin perandorisë osmane trajtat e një despotizmi iluminist që i përgjigjej kërkesave për reforma të një shteti modern në evolucion. Sikur Porta e Lartë t'i kishte ndërmarrë ato më herët, rënia e perandorisë do të kishte qenë ndoshta më e ngadaltë. Por për rrethanat në të cilat ndodhi, kjo vonesë historike përçoi më tepër shenja dobësie sesa force. Rrjedhimisht shumica e popujve ballkanikë luftuan për dekada me radhë midis viteve 1830 dhe 1878 për të arritur pavarësinë nga perandoria osmane. Por Shqipëria jo. Si për ironi, pavarësia e fqinjëve në vend që të frymëzonte solidaritet ose parrulla të ngjashme politike nisi të përbënte një kërcënim. Ndienja e pasigurisë që vinte duke u rritur në përpjestim të drejtë me krizën e perandorisë osmane, shprehet mjaft mirë në fjalët e njërit prej përfaqësuesve më të dalluar të *Rilindjes* shqiptare, Sami Frashërit:

Shqipëria gjer pak kohë më parë ka qenë e rrethuar me vende të Turqisë edhe kufijtë e kësaj mbretërie ishin fort larg Shqipërisë. Shqiptarët [...] mëmëdheun e tyre e shihnin jashtë rreziku. Sot Shqipëria ka mbetur në një cip të largët të Turqisë e është rrethuar me kufij armiqsh. Mali i Zi, Serbia, Greqia dhe Bullgaria e kanë pështjellë e përçarkuar Shqipërinë edhe Austria i ka ardhur mbi krye. Prandaj shqiptarët [...] duhet të jenë të zot të ruajnë vetenë e tyre e të mos presin më prej Turqinë që s'është e zonja për vete të saj. [...] Shqipëria s'ka bërë themel as ka lëshuar rrënjë më vete, rron mbi themelin e gremisur të Turqisë dhe me rrënjët e kalbura të saj. Me të rënë të kësaj stihie të madhe do të bjerë edhe Shqipëria e do të shtypet nën gërmadhat e saj.¹⁰

Vërtet, kongresi i Berlinit i vitit 1878, i ngarkuar me detyrën e rishikimit të ndarjeve territoriale në Ballkan pas luftës ruso-turke dhe traktatit të Shën Stefanit, e kërcënonte seriozisht integritetin territorial të vendit. Si pasojë e këtij kongresi, një pjesë e madhe e tokave në veri (Hoti, Gruda, Plava dhe Gucia) u aneksuan nga Mali i Zi. Jo vetëm që fuqitë e mëdha perëndimore i injoruan plotësisht karakteristikat kulturore dhe historike të Shqipërisë, por kancelari Bismarck shkoi deri aty sa të deklaronte që kombësia shqiptare nuk ekzistonte dhe Shqipëria nuk përfaqësonte gjë tjetër veç një koncept gjeografik.

E gjithë historia kulturore dhe politike e mëvonshme e popullit shqiptar mund të interpretohet si një përpjekje e jashtëzakonshme për të dëshmuar se Bismarck-u gabohej. Nga ana politike, lidhja e Prizrenit - që mbliidhte përfaqësues nga disa komitete vullnetare mbrojtjeje në mbarë Shqipërinë - shënoi hapin e parë të rëndësishëm drejt organizimit të një rezistence të armatosur. Por fuqitë e mëdha evropiane e njihnin aq pak Shqipërinë si entitet i veçantë kulturor sa fillimisht menduan se Lidhja e Prizrenit ishte një lojë politike e perandorisë osmane për të mbrojtur *status quo*-në e para kongresit të Berlinit. Suksesi praktik në mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, varej pra nga aftësia teorike për të dëshmuar se pretendimet shqiptare ishin të drejta. Siç pohonte dhe vetë patrioti polak Pilsudski, nevoja ishte për shtetin të krijonte një komb dhe jo për kombin të krijonte një shtet.¹¹

Ky version i veçantë i nacionalizmit shqiptar jep fillimisht një përshtypje të ngjashme me atë që Eric Hobsbawm-i quan prodhim të Revolucionit Francez dhe atij Amerikan, një nacionalizëm që theksonte integritetin territorial si parim organizues për ushtrimin e sovranitetit të përbashkët.¹² Çdo element tjetër etnik në mbështetje të nacionalizmit mund të konsiderohet pasojë e këtij parimi të rëndësishëm. Pas rënies së parashikueshme të Perandorisë Osmane, shqiptarëve u nevojitej një narrativë kombëtare që mund të bënte të besueshme deklaratat për sovranitet. Çështja e shtetit shqiptar mund të mbrohej pra vetëm me krijimin e një kulture kombëtare të përbashkët. Prandaj mbështetja e rezistencës aktive me anë të një lëvizjeje intelektuale dhe letrare që kërkonte liri dhe vetëvendosje u bë një nga parrullat më të rëndësishme të Rilindjes shqiptare. Sipas fjalëve të Sami Frashërit:

Po veç këtyre rreziqeve që do të duken në kohë të luftës, Shqipëria ka rreziqe më të mëdha të cilat po i nxjerrin rrënjët në kohë të paqes, pa gjak e pa armë. Kjo është lufta e pendës dhe e shkollës, lufta e kombësisë. Grekët, shqehët e të tjera kombe fqinje, s'duan të njohin qenien e kombësisë shqiptare. Sicilido përdor besën e tij e do të heqë mënjanë ata shqiptarë që kanë një besë me të.¹³

Dy elementë vlejné të përmenden ndërsa analizojmë këtë shqetësim të Frashërit. I pari është njehsimi i misionit ushtarak për mbrojtjen e integritetit territorial me atë intelektual. Rezistenca e armatosur konsiderohej një mjet i dobët për të përballuar rreziqet më të mëdha që në ato kohë i kanoseshin një vendi kultura e të cilit nuk e kishte siguruar ende të drejtën historike për të qenë e pavarur. Elementi i dytë është kritika ndaj besimit fetar. Tradicionalisht lëvizjet nazionaliste e kanë përdorur besimin fetar si themel për t'i dhënë baza universale dhe trashendente ndërgegjes kolektive. Në të kundërt, këtu feja paraqitet si kërcënim për bashkimin kombëtar. Të dy këto elemente janë nga më të rëndësishmet e më të veçantat e Rilindjes shqiptare. Ndërthurja midis tyre është ajo që e vesh këtë lëvizje nacionaliste me tipare që e dallojnë nga rrymat e tjera romantike në Ballkan dhe që e lidh me Iluminizmin. Ashtu si reagimi ndaj konflikteve fetare të shekullit të XVII-të midis shteteve evropiano-perëndimore krijoi idealin iluminist të tolerancës dhe racionalizmit, reagimi ndaj parrullës romantike “një Zot, një komb” u kthye në manifestin e rilindasve shqiptarë duke i dhënë formë gjithë programit të tyre intelektual.

Por në qoftë se ndikimi i fesë ishte i parëndësishëm ose negativ për procesin e formimit të mitit identitetar kombëtar, vlera të tjera të përbashkëta themelore duheshin gjetur. Gjuha dhe historia u bënë treguesit më të rëndësishëm të autenticitetit të vendit. Kjo ndarje e pazakontë e besimit fetar nga elementi i pastër etnik është një tregues i rëndësishëm për analizën e parimeve frymëzuese të Rilindjes shqiptare, drejtimin e saj të veçantë kulturor dhe programin politik. Arsyeja e kësaj ndarjeje dhe zhvillimet e saj të mëtejshme përshkruhen më mirë në faqet që vijojnë.

“Feja e shqiptarit është Shqiptaria”

Kur analizon karakteristikat e ndryshme antropologjike dhe konceptuale që shpjegojnë proto-nacionalizmin popullor, Eric Hobsbawm-i arrin në përfundimin se “na mbeten vetëm dy kriteret e Rusisë së Shenjtë siç e shihnin kozakët e shekullit të XVII-të: feja dhe mbretëria ose perandoria”.¹⁴ Por të dy këto kriteret – simbolet e përbashkëta fetare dhe përkatësia në një entitet politik të vazhdueshëm – nuk mund të shërbejnë për të kuptuar drejt nacionalizmin shqiptar. Nga ana tjetër, pikërisht faktorët që Hobsbawm-i nënvlerëson kur merr parasysh rolin e proto-nacionalizmit popullor në formimin e shteteve moderne - gjuha dhe etniciteti - duket sikur kanë luajtur rolin kryesor në programin politik të *Rilindjes* shqiptare. Historia e një të kaluarë mitike dhe shenjat e një gjuhe të përbashkët që kishte ndërmjetësuar komunikimin e njerëzve ndër shekuj ishin pikërisht ato që zëvendësuan mungesën e lidhjeve shoqërore dhe simbolike që besimi fetar ose humanizmi republikan kishin siguruar tjetërkund. Disa komente të shkurtra të Edith Durham-it, banore për një kohë të gjatë në Shqipëri, i përmbledhin shumë mirë përshtypjet e udhëtarëve të huaj për qëndrimin e shqiptarëve ndaj besimit fetar:

Shqiptari mbetet gjithnjë shqiptar. Ai është në radhë të parë shqiptar. Feja vjen gjithmonë në vend të dytë. [...] Por shqiptari, edhe kur duhet t'u nënshtrohet rrethanave, e bën këtë për ti detyruar rrethanat ti nënshtrohen atij. Krishtërimin nuk e ka marre kurrë seriozisht, por edhe islamizmi me ç'është nuk është futur siç duhet. Shumica e njerëzve nuk e vrasin shumë mendjen për fenë [...] Ka popuj që kane prirje për fenë. Kurse shqiptarët, si komb s'duan t'ia dinë.¹⁵

Në mënyrë që të kuptojmë tiparet veçuese të kësaj dukurie, duhet të kemi parasysh që mungesa e forcave moderne të prodhimit nuk krijoi në Shqipëri fenomenin tipik të atomizimit shoqëror që si rrjedhojë ka lindur e individualizimit. Prandaj, familja dhe fisi mund të vazhdonin të vepronin si institucionet më të rëndësishme kolektive, duke siguruar lidhje identiteti të fuqishme brenda komuniteteve të vogla dhe njehsimin simbolik kolektiv në karakteristikë të përbashkëta antropologjike. Në të njëjtën kohë feja nuk arriti të ushqejë në shpirtin shqiptar devotshmërinë dhe admirimin për doktrina të veçanta. Në vend të kësaj, ajo u konsiderua gjithmonë si element përçarës, që nxiste ndarje dhe më vonë rrezikonte themelet e përbashkëta mbi të cilat duhej ndërtuar ideologjia kombëtare.

Gjatë shekullit të XV-të një pjesë e madhe e shqiptarëve që fillimisht kishin përqaftuar krishtërimin, e shkëmbyen besimin fetar me një sërë privilegjesh që Porta e Lartë i dhuronte asaj pjese të popullsisë që ndërronte fe vullnetarisht. Më vonë, gërshetimi i një skepticizmi e pragmatizmi të lindur me indiferencën ndaj frymëzimit mistik, frenuan përqaftimin e trajtave më fanatike fetare dhe e kthyen fenë në një veprimtari të jashtme konformiste që shqiptarëve nuk u erdhi kurrë natyrshëm. Për këtë arsye, ashtu siç theksojnë dhe shumë studiues, beteja përfundimtare që regjimi socialist i Enver Hoxhës ndërmorri ndaj besimit fetar shfaqet si akti i fundit i një procesi që kishte filluar shumë më herët.¹⁶ Suksesi i lehtë i fushatës së mesit të viteve 1960-të, që shpuri në zhdukjen e të gjitha praktikave fetare, vështirë se mund të shpjegohet vetëm me jakobizmin e republikës së vogël socialiste. Shqipëria nuk do ta kishte patur kaq të lehtë të vetë-shpallej “vendi i parë ateist në botë” në qoftë se kësaj ndjenje të përgjithshme indiference ndaj modeleve teologjike do t’i mungonin rrënjët historike.

Natyrisht është e vështirë të jepet një shpjegim i vetëm për faktorët e ndërlikuar që përcaktojnë tiparet dalluese të perceptimit të fesë nga shqiptarët. Ashtu siç vëren në mënyrë të kujdesshme edhe Noel Malcom-i, kjo dukuri përfshin “sinkretizimin e praktikave popullore fetare, tolerancën (dhe sinkretizimin doktrinor) të bektashive, dukurinë e përhapur më rrallë të kripto-krishterimit (si katolik ashtu edhe ortodoks), sistemin shoqëror të krerëve shqiptarë të veriut, (për të cilët besnikëria ndaj fisit kishte përparësi mbi ndarjet e tij në pjesë katolike ose myslimane), dhe praktikës fare normale të burrave myslimanë që martoheshin pa i kërkuar grave që të ktheheshin në fenë islame”.¹⁷ Megjithatë krijimi i një slogani të vetëm ishte pikërisht ajo që ndodhi kur protagonistët e Rilindjes shndërruan një sasi reagimesh heterogjene dhe të turbullta në një program sistematik që më vonë u përputh lehtësisht me thënien marksiste se feja ishte “opium për popullin”. Fjalët e poetit kombëtar Vaso Pasha në poemën e tij më të njohur *Mori Shqypni, e mjera Shqypni*, e shkruar menjëherë pas ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përbën manifestin më të fuqishëm paradigmatic të këtij reagimi intelektual: “*Priftnit e hoxhët ju kan hutue/ për me ju damun, me ju vorfnue*”. Dhe në të njëjtën poemë: *Çoniu shqiptarë, prej gjumit çoniu / të gjithë si vllazën një bese shtrëngoniu / edhe mos shikoni kisha e xhamia / fe e shqiptarit asht Shqyptaria /*”¹⁸

Megjithëse *shqiptarizmi* është një koncept i turbullt, theksi që vihet mbi funksionin obskurantist dhe çorientues të fesë është i qartë. Përveç shkaqeve kulturore që lidhen me zhvillim e veçantë antropologjik të shoqërisë shqiptare, faktorë të tjerë historikë hedhin dritë mbi këtë qëndrim radikal. Në kohën kur kisha ortodokse ruse u vetëshpall mbrojtëse e natyrshme e të gjitha popullsisë sllave dhe ndërhyri në mënyrë aktive për të mbështetur lëvizjet nacionaliste të shekullit të XIX –të në Ballkan, Shqipëria myslimane u njehsua *tout court* me perandorinë osmane. Ndërsa minoritetet e vogla të krishtera në vend lakmoheshin nga shtetet ortodokse fqinje, njohja e islamit si besimi fetar zyrtar i shqiptarëve rrezikonte të kishte pasoja fatale për mbijetesën e vendit pas rënies së perandorisë osmane. Prandaj edhe ato pak përpjekje për të përhapur një rrymë të reformuar të islamit, si *Fletore e Bektashinjve* e Naim Frashërit, zgjodhën të përqendroheshin mbi orientimet anti-sunite dhe pro-shiite të urdhrat bektashi dhe të ndërthurnin anët e tij heretike ndaj perandorisë osmane me deklaratat e sapokrijuara për identitetin shqiptar.¹⁹

Këtu duhet nënvizuar që edhe pse Naim Frashëri, si shumë romantikë të tjerë, zgjodhi gjuhën e poezisë për të përcjellë domosdoshmërinë e një besimi fetar popullor, ai ishte shumë larg nga paradigma poetike romantike e entuziazmit misitik për simbolet fetare që mund të gjejmë, për shembull, në shkrimet e Novalis-it. Bektashizmi i tij përpjeteq të ndërthurte elemente materialistë dhe panteistë dhe mund të interpretohet si një version oriental i deizmit të Dideroit dhe Volterit.²⁰ Lidhja e perëndisë me natyrën dhe marrëdhëniet e saj me qeniet njerëzore përfaqësojnë harmoninë universale që frymëzon një ndjenjë tolerance dhe respekti për të gjithë, pavarësisht nga përkatësia fetare.²¹ Por me gjithë formën moderne që Naim Frashëri i dha programit të tij për përhapjen e një feje kombëtare, përpjekjet e tij nuk arritën të kuptoheshin nga pjesa më e madhe e popullsisë. Kjo sepse, nga njëra anë, urdhri i bektashijve përfaqësonte vetëm një pakicë të shqiptarëve dhe nga ana tjetër sepse kultura e tij e natyrshme ishte shumë larg nga kujtesa historike e vendit.

Prandaj ajo që mbetet si tipar veçues i programit politik të *Rilindjes* është koncepti i paqartë i shqiptarizmit dhe përpjekjet e vazhdueshme për ta shndërruar atë në diçka të ngjashme me modelin rousseau-ian të fesë civile. Domosdoshmëria për të lidhur strukturat politike të vendit me zakonet dhe traditat e tij, që shprehet në veprën e Monteskjës [Montesquieu], *Fryma e Ligjeve*, ishte e qartë por mungonte aftësia për ta mbështetur këtë përpjekje në më shumë sesa të dhëna legjendare për të shkuarën e vendit. Kjo situatë të drejton tek elementi i dytë i përmendur nga Hobsbawm-i kur përshkruan nacionalizmin e Ruisë së Shenjtë: ndienja e përkatësisë në një entitet politik të qëndrueshëm.²² Po të përjashtojmë periudhën mitike të ilirëve dhe stinën e shkurtër të qëndrësës anti-osmane nën heroin kombëtar Skënderbe, shqiptarëve u mungonte plotësisht përvoja e qytetarisë së përbashkët në një komunitet politik të pavarur. Kështu, dy elementë të tjerë u bënë jashtëzakonisht të rëndësishëm për të vërtetuar autenticitetin e vendit: gjuha dhe etniciteti kolektiv.

Interesi gjithnjë në rritje i studiuesve perëndimorë për gjuhën dhe historinë shqiptare, sigurisht i ndikuar edhe nga studimet e Herderit mbi Volk –un, çuan në komente entuziaste që “nuk jemi as bullgarë dhe as grekë”. Por tendenca romantike për evokimin e mitit të së shkuarës këtu mori një funksion të veçantë. Kur intelektualët e *Rilindjes* filluan të reflektonin politikisht mbi çështjen e kombësisë shqiptare, u ndjenë të detyruar t’i fillonin shkrimet e tyre me argumenta historikë mbi shqiptarët bashkëkohorë si pasardhës të pellazgëve, të mblidhnin të dhëna filologjike mbi etimologjitë shqiptare të greqishtes së lashtë apo të theksonin orgjinën shqiptare të udhëheqësve të mëdhenj ushtarakë të tillë si Aleksandri ose Pirro.²³ Megjithatë, evokimi i historisë shqiptare të mesjetës së vonë dhe i mitit të Skënderbeut në një numër të madh esesh ose krijimesh poetike kishte pak të bënte me rolin që historia mesjetare luan në letërsinë romantike. Heroi kombëtar shqiptar portretizohej më shumë si një ligjvënës rousseau-ian që arrin të kapërcejë përçarjet rajonale në një etos të përbashkët kombëtar duke mundur kështu t’i kundërvihet kërcënimit të jashtëm osman.

Kjo veprimtari intelektuale u shërbente dy qëllimeve. Nga njëra anë, i jepte shqiptarëve një shembull konkret të arritjeve të përbashkëta historike pavarësisht ndarjeve lokale dhe fetare. Nga ana tjetër, i kujtonte fuqive të mëdha evropiane ekzistencën historike të Shqipërisë si entitet politik më vete që madje kishte mbrojtur Evropën kristiane nga sulmet turke. Siç theksonte Sami Frashëri, kjo kohë “sado që shkoi e tëra me luftëra e me gjak është më e bekuara e të gjitha kohërave për vendin tonë, se vetëm atëherë u mblodh i tërë kombi me një qeveri të dliërë e iu dëgjua emri në gjithë botën”.²⁴ Por intelektualët protagonistë të *Rilindjes* ngulnin këmbë në autenticitetin e kombësisë shqiptare pa harruar të theksonin edhe prapambetjen kulturore, shoqërore dhe politike të vendit. Përkrah vrullit patriotik dhe komenteve krenare për shqiptarët si “banorët më të vjetër të Ballkanit” këto shkrime politike përcjellin edhe shqetësimin për prapambetjen e strukturave shoqërore të Shqipërisë. Në vend që të zgjonte vetë-lavdërimin me kulm në shovinizëm, miti romantik i së kaluarës synonte t’i kujtonte shqiptarëve mjerimin e jetës së përditshme dhe të përcillte një reagim tipik për Iluminizmin: autokritikën racionale.

Nevoja për tu mbështetur në një kujtesë të përbashkët historike lindte kështu pikërisht në mungesë të dëshmimeve të tjera të kulturës kombëtare, në letërsi, histori apo arte figurative. Vaso Pasha në fillimin e shkrimit të tij *Shqipëria dhe shqiptarët* na jep një përshkrim të saktë dhe realist të perceptimit të kësaj dukurie nga elitat kulturore shqiptare. Bashkë me dy kategoritë e kombeve, atyre që “u ka rënë në pjesë lavdia, pasuria dhe fuqia” dhe atyre që “janë shuar fare e janë fshirë nga skena e botës pa lënë asnjë tragë nga ekzistenca e tyre”, ai deklaroi se është edhe një kategori e tretë që u përket popujve:

Origjina e të cilëve humbet në erësirën e kohëve përrallore dhe vazhdojnë jetën e tyre vetjake me gjithë vargun e ndodhive të papritura që kanë kaluar detyrimisht. Historia e tyre, ngaqë u ka munguar qytetërimi i përparuar ose nga rrethana që si kap dot mendja jonë, ka mbetur një problem që nuk ka gjetur zgjidhje. Kësaj kategorie i përket padyshim populli shqiptar. Nga vjen ai? Cili është? Si jeton? ²⁵

Prandaj, kur mbërrin në përshkrimin e jetës dhe të zakoneve të këtij grupimi misterioz shqiptar, Vaso Pasha nuk ngurron t'i përkufizojë kushtet e tij si “fare primitive dhe patriarkale”, një vend ku “mbizotëron ligji i talionit dhe organizimi i shoqërisë me fise”. Veç historisë dhe gjuhës së përbashkët, çfarë kanë vendet perëndimore të zhvilluara e u mungon shqiptarëve? Kjo është pyetja që rilindasit shqiptarë ngrinin njëzëri ndërsa përgjigja jehonte e thjeshtë po aq sa dramatike: civilizimi.

Miti romantik i ekzistencës ndër shekuj mund të mbështeste argumentin historik në favor të integritetit territorial, por nuk mjaftonte për të provuar se qeverisja e një komuniteti politik të tillë ishte gjithashtu e realizueshme. Kjo diagnozë e rreptë e situatës na drejton tek platforma politike rilindase e emancipimit kulturor nëpërmjet arsimit intelektual. Për këtë ideologjia iluministe e diturisë racionale dhe përparimit kulturor tingëllonte më bindëse sesa idealet romantike të heroizmit individual, fuqisë shpirtërore, gjenialitetit krijues dhe autenticitetit primitiv. Prandaj edhe programi iluminist i zhvillimit intelektual nëpërmjet edukimit mori përparësi mbi pasionin romantik e thirrjet për nisma politike të menjëhershme. Megjithëse siç dëshmojnë edhe ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit këto veprimtari nuk munguan, influenca e mendimit iluminist më tepër sesa atij romantik mbi Rilindjen shqiptare shpjegon tiparet e moderuara të deklaratave nacionaliste në fazat e para të kësaj lëvizjeje. Prania e disa elementëve të programit ideologjik të Iluminizmit dhe ndikimi i tyre mbi ngurrimin rilindas për të kërkuar pavarësinë e plotë analizohen në pjesën në vazhdim.

“Dhe dritë e diturisë përpara do të na prijë”

Iluminizëm quhet çlirimi i njeriut nga papjekuria e tij e vetëmbartur. Papjekuri është paaftësia për të kuptuar pa ndihmën e dikujt tjetër. Kjo papjekuri është e vetëmbartur në qoftë se ajo është shkaktuar jo nga mungesa e intelektit por nga mungesa e vendosmërisë dhe kurajës për ta përdorur atë pa ndihmën e dikujt tjetër. Prandaj moto e Iluminizmit është: Sapere aude! Kini kurajo të përdorni intelektin tuaj. ²⁶

Çlirimi nga obskurantizmi i injorancës e supersticioni irracional si dhe domosdoshmëria e emancipimit kulturor të përbashkët që gjejmë në përkufizimin kantian të Iluminizmit, ishte edhe një nga temat më të përsëritura të *Rilindjes* shqiptare. Ideja se një deklaratë e fortë për pavarësi politike duhet të shoqërohej nga një revolucioni i rëndësishëm në *Denkungsart* –in (mënyrën e të menduarit) shqiptar u shfaq nëpërmjet dy tipareve dalluese, që të dyja tipike të filozofisë iluministe: kritikimi i vetvetes dhe teleologjia racionale. Elementi i kritikimit të vetvetes, përmbledhur qartë në akuzën e Kantit mbi papjekurinë e mbartur, shprehet nga Sami Frashëri si më poshtë: “në ka mbetur pas kombi ynë, s’është faji i tij por është faji ynë; në ka

mbetur gjuha shqipe e pashkruar, s'ka mbetur se është gjuhë e ligë dhe e metë, po vetëm se s'jemi kujdesur ne ta shkruajmë".²⁷

Kjo *mea culpa* që buronte nga një analizë realiste e pasivitetit historik të shqiptarëve, është larg çdo ekzaltimi nacionalist të së kaluarës, element ky që studiuesit që analizojnë nacionalizmin nga perspektiva romantike shpesh nuk arrijnë të kuptojnë. Por ky gjykim kritik i pasivitetit të kaluar na drejton tek elementi i dytë: teleologjia racionale. Ajo sjell me vete një projekt kulturor që synon të kapërcejë prapambetjen intelektuale duke i përgatitur njerëzit të përdorin aftësitë e tyre racionale pa u udhëhequr nga institucione autoritare. Ky fakt theksohet mjaft mirë nga Kanti në moton "sapere aude" dhe u interpretua nga Rilindja shqiptare si një detyrim qytetar për të ndërmarrë misionin pedagogjik të përhapjes së rolit publik të arsyes. "Në ka gjë për të cilën shqiptarët duhet të kujdesen sot", deklaroi Sami Frashëri, "është dituria".²⁸ Megjithatë, elitat shqiptare, ishin të ndërgjegjshme se emancipimi kulturor në shkallë të gjerë mund të arrihej vetëm pas zhvillimit të një sfere publike dhe të strukturave të shoqërisë civile. Kjo shpjegon vendosmërinë e pazakontë për të krijuar shoqata patriotike dhe kulturore, që synonin të përhapnin gjuhën e shkruar dhe të propagandonin idenë e një lufte intelektuale kundër obskurantizimit dhe supersticionit.

Shqipëria, me dy shekuj vonesë, po jetonte në rrethanat më dramatike ndryshimet rrënjësore që revolucionin kopernikan dhe shpikja e shtypit kishin sjellë në Evropën Perëndimore. Për të krijuar një ide të qartë të influencës së ideve iluministe mbi ideologjinë kombëtare shqiptare, edhe nga ana metaforike, mjafton të ndalesh mbi emrat e shoqatave kulturore patriotike të themeluara gjatë këtyre viteve. Figura konceptuale të tilla si "drita e diturisë" dhe "dalja nga errësira dhe turbullimi i së kaluarës" gjenden shpesh edhe në emrat e revistave të ndryshme letrare, mjaft të përmenden vetëm disa nga ato më të rëndësishmet: "Drita" e themeluar në vitin 1879 në Stamboll nga vëllezërit Frashëri dhe që më vonë e ndërroi emrin në "Dituria", "Dëshirë" e themeluar në vitin 1898 në Sofie nga Jani Vreto, dhe "Drita" e themeluar po në Sofie në 1901 nga Shahin Kolonja. I njëjti arsyetim i shkon për shtat edhe një numri botimeve të tjera letrare të *Rilindjes*, ku poema e famshme e Naim Frashërit *Fjalët e Qiririt* përbën vetëm njërin nga shembujt më të suksesshëm. Në këtë poemë, një qiri, i cili simbolizon dritën e arsyes në errësirën e gabimit dhe supersticionit, thekson në mënyrë dramatike epërsinë e diturisë dhe rolin e saj në përkrahje të idealit humanist të mirëkuptimit reciprok dhe bashkëjetesës në paqe: "Në mes tuaj kam qëndruar/ e jam duke përvëlur/ që t'ua ap pakëzë dritë/ natënë t'ua bëj ditë/ do të digjem, të kullohem/ të digjem të përvëlohem/ që t'u ndrinj mirë e të shihni/ njer tjetërin ta njihni. [...] Unë dua njerëzinë, mirësinë, diturinë."²⁹

Një tjetër element që vlen të përmendet ndërsa analizojmë idealet që fshihen pas letërsisë kombëtare shqiptare është lidhja midis etikës dhe estetikës. Romantizmi e zgjidhi këtë dialektikë duke i dhënë përparësi të dytës si shprehja më e natyrshme dhe autentike e aspiratave njerëzore. Përkufizimi i Wordsworth-it për poezinë si një "vërshim spontan ndjenjash të fuqishme" e përmbledh shumë qartë këtë tipar.³⁰ Në të kundërt, Rilindja shqiptare, ashtu si edhe iluminizmi, e përmbys këtë rregull duke ia nënshtuar artin etikës dhe politikës. Ideali i bukurisë që arti i rilindasve përmban të kujton idenë estetike të Kantit e cila përfaqëson simbolin e të mirës morale duke ngritur lart misionin fisnikëruar të artit.³¹ Ky element lidhet me përkushtimin pedagogjik të Rilindjes shqiptare si dhe me domosdoshmërinë për të përhapur gjuhën e shkruar dhe një letërsi kombëtare. Ndërsa lexon vepra të kësaj periudhe të krijohet përshtypja se ajo që i shqetëson më tepër artistët shqiptarë nuk është rezultati estetik i veprimtarisë së tyre por nevoja për të krijuar prodhime intelektuale në gjendje të përshkruanin ndryshimet rrënjësore në ndërgjegjen kombëtare politike. Në një nivel të pastër estetik do të ishte pamundur të gjenim këtu gjurmë të tërheqjes për idealin e *art pour l'art* të trashëguar nga shkolla romantike në shkrimtarë si Baudelaire-i e që po përhapej me shpejtësi në Evropën perëndimore.

Kjo nuk do të thotë që modelet estetike romantike nuk arritën fare ta ndikojnë poezinë shqiptare gjatë shekullit të XIX –të. Një arsyetim i tillë nuk do t'i përshtatej veçanërisht asaj dege të letërsisë shqipe që u zhvillua nga intelektualët e minoritetit shqiptar në Itali si Jeronim

De Rada ose Gavril Dara i Riu.³² Megjithatë, përparësia e koncepteve morale ndaj parimeve estetike dhe hapësira që zënë parrullat politike në krijimtarinë poetike është një nga tiparet dalluese kryesore të rilindjes kombëtare shqiptare.³³

Këto parrulla politike shfaqen disi të kufizuara kur krahasohen me furinë nacionaliste të shteteve të tjera ballkanike gjatë kësaj periudhe. Si për ironi të fatit, është pikërisht ndërgjegjësimi mbi rrethanat dramatike në të cilat Shqipërisë i duhej të emancipohet që frenoi deklaratat politike më ekstremiste. Këtu kritika e vetvetes ishte aq rrënjësore sa të kufizonte çdo nismë radikale politike. Ky qëndrim dëshmon njëfarë mungese besimi në qeverisjen e një entiteti politik plotësisht të pavarur. Siç vëren edhe Vaso Pasha: “Shqiptarët e dinë gjithashtu se kështu siç janë ndarë, në tre besime dhe me një arsim në gjendje embrionale, nuk do të merreshin vesh më lehtësi për tu vetqeverisur pa një dorë të fortë që t’i drejtonte dhe t’i sundonte [...] Si Shqipëri ajo nuk mund të vazhdojë të jetojë veçse në një sundim që respekton ekzistencën e saj, doket, traditat e kombësinë, dhe Perandoria Osmane është ajo që deri më sot i ka përmbushur të gjitha këto kushte”.³⁴

Megjithatë perandorisë osmane po i afrohej fundi dhe shqiptarëve u duhej urgjentisht të provonin aftësinë e tyre për vetëvendosje ose të zhdukeshin fare si komb. Nevoja për të hedhur themelet e përshtatshme mbi të cilat mund të krijohet dhe zhvillohet shteti i ardhshëm modern u perceptua qartë nga intelektualët e Rilindjes. Kështu, kur Sami Frashëri hartoi pikat udhëzuese të programit politik të *Rilindjes* ai u mbështet në argumenta të njohura iluministe mbi faktorët ndihmës në përforcimin e strukturave të shtetit modern. Çështjet e marra në shqyrtim radhitnin rëndësinë e zhvillimit të industrisë dhe tregtisë, laicizmin e besimit fetar, garancitë liberale të së drejtës të pronës dhe, së fundi, domosdoshmërinë e një sistemi arsimor të pavarur.

Megjithatë, këto deklarata u shprehën brenda kornizës së autonomive rajonale të garantuara nga sunduesit osmanë dhe nuk duhet të ngatërrohen me një thirrje për pavarësi të plotë. “Shqiptarët” shkruante Frashëri “kanë pesëqind vjet që po derdhin gjak për këtë mbretëri e nuk do të duan kurrë humbjen e saj”. Por ai kërkonte që Shqipëria të njihej si bashkësi e vetme gjeografike, që ndarjet rajonale të vendosura nga reformat e Tanzimatit të anulloheshin dhe që të njiheshin trajtat dalluese të shqiptarëve si një etnicitet i përbashkët me të drejtën e tij të veçantë për të ekzistuar.

Sigurisht nuk është e lehtë të përcaktosh sesa shumë kjo analizë ka të bëjë me prirjen iluministe për beteja intelektuale që kërkonin të rrënonin së brendshmi themelet e despotizmit më tepër sesa përbalimin e menjëhershëm fizik me të. Por është interesant kontrasti midis kësaj ideologjie dhe stereotipit të shqiptarëve si njerëz të gatshëm për luftë deri në vdekje. Kjo çështje ngrihet kalimthi në një poemë tjetër të njohur të Naim Frashërit, *Gjuha Jonë*, ku shkruhet. “*Ajo ish koh’ e zjarrtë/ Dhe kish mudnime tepër/ po sot pendë dhe kartë/ na duhet, nukë tjetër/.*”³⁵ Ndonëse i përshtatshëm për ti kënduar bëmave patriotike të së kaluarës, miti romantik i rebelëve të përjetshëm nuk mjaftonte për t’u përbaluar me sfida konkrete historike dhe politike.

Përfundim

Tiparet e veçanta kulturore dhe filozofike të Rilindjes shqiptare së shpejti të XIX– të shfaqen të pazakonta dhe të vështira për tu kuptuar, në qoftë se përdorim në mënyrë skematike kategoritë filozofike tradicionale të Evropës Perëndimore. Por një ndërthurje e ideve kryesore të Iluminizmit dhe Romantizimit me një analizë të kujdesshme të ngjarjeve historike na jep një analizë më të sofistikuar të lindjes së mitit të identitetit kombëtar shqiptar dhe marrëdhënieve të tij me krijimin e strukturave të shtetit modern. Duke u përqendruar në terrenin historik, kulturor dhe filozofik në të cilin morën jetë disa nga idetë më të rëndësishme të historisë intelektuale shqiptare, qëllimi i këtij shkrimi ishte të zbulojë sesi koncepte themelore të Iluminizmit si: laicizmi, arsyeja kritike dhe teleologjia pedagogjike ndikuan hapat e para intelektuale për krijimin e identitetit kombëtar shqiptar. Nga ana metodologjike, u përpoqa që për këtë të merrem

me një analizë krahasuese idesh më shumë se me hulumtimin e dëshmime filologjike. Sigurisht që kjo ese nuk është shteruese dhe një numër pyetjesh mbeten të hapura. Megjithatë, në qoftë se ajo ia ka dalë të skicojë një përshkrim pa stereotipe të krijimit të kulturës kombëtare shqiptare, do të përbëjë të paktën një pikë fillimi për kërkime më të thella në të ardhmen.

Shënime

¹ Disa elementë të paktë panteistë të pranishëm në Weltanschauung-un e Rilindjes si shqiptare dhe evropiane përbëjnë evidencë shumë të dobët të ngjashmërive në qoftë se ndalemi tek origjina e tyre e ndryshme kulturore: metafizika islamike dhe ndikimi i poezisë persiane në rastin shqiptar dhe rigjallërimi i platonizmit në rastin evropian.

² Gjuha shqipe ishte gjuha e fundit e shkruar në Evropë. Përveç disa fragmenteve fetare si Meshari (1555) i Gjon Buzukut, një letërsi posaçërisht shqiptare filloi të lindë vetëm gjatë Rilindjes. Kjo dukuri njihej mirë nga intelektualët e Rilindjes. Për një analizë më të thellë të këtij evolucioni të letërsisë shqiptare shih R. Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare* (New York: Columbia University Press, 1995).

³ Është shumë e vështirë të gjesh një përkufizim të përbashkët për të gjitha versionet e Romantizmit perëndimor evropian. Çka diskutojmë këtu vlen me siguri për romantizmin gjerman, që identifikohet me rrethin e Jenës e që ishte edhe nga nismëtarët e lëvizjes romantike. Për një analizë teorike më të thellë të Romantizmit evropian, shih I. Berlin, *The crooked timber of humanity: chapters in the history of ideas* (London: John Murray, 1990).

⁴ Shih, E. Çabej, *Romantizmi në Evropën lindore dhe juglindore dhe në literaturën shqipe në Shqiptarët mes Perëndimit dhe Lindjes*, (Tiranë: Çabej, 1994). Kjo ese është shkruajtur në vitin 1945 dhe është botuar për herë të parë në vitin 1994.

⁵ Përshtypja e madhe që i bëri revolucionin francez sulltan Selimit, i cili qeverisi perandorinë osmane nga viti 1789 deri në vitin 1807, varej më shumë nga sukseset ushtarake të Francës sesa nga admirimi që ai mund të kishte për fuqinë ndryshuese të ideve. Gjithsesi nevoja për reforma kulturore dhe administrative ndjehej nga sulltanët osmanë që përpara periudhës së Tanzimatit. Sulltan Selimi kishte ndarë disa projekte të tilla me të atin, Mustafain e III-të, por duke u penguar nga forca të tjera të brendshme konservatore. Për të kuptuar më mirë këtë fazë të perandorisë osmane në lidhje me lindjen e nacionalizmit në Ballkan, shih G. Castellan, *Histoire des Balkans* (Paris: Fayard, 1991).

⁶ Në turqisht “tanzimat” do të thotë reformë.

⁷ Shih T. Zavalani, *Histori e Shqipnis* (1966) (Tiranë: Phoenix, 1998), 163. Libri u botua për herë të parë në vitin 1966, në Londër, nga Botimet Drini.

⁸ Disa argumentojnë që megjithëse dallimi midis dy dialekteve shqiptare (“geg” dhe “toskë”) është i përshtatshëm për studimin e gjuhës shqipe, ai nuk mund të përdoret për të gjurmuar ndarjet kulturore dhe historike midis grupeve. I jam mirënjohëse Kathleen Imholz-it që e solli këtë në vëmendjen time. Ndonëse jam dakort që ndarje të tilla nuk duhet të keqpërdoren për të përcaktuar tipare të veçanta etnike; është e vështirë t’i quash plotësisht pavend kur diskutojmë ngjarje historike të rëndësishme. Rreziku i përçarjeve midis “toskëve” të jugut dhe “gegëve” të veriut për bashkimin kombëtar vihej re qartë nga intelektualët shqiptarë. Një nga shembujt e shumtë është Gjergj Fishta me poemën e tij epike Lahuta e Malcis (1937) ku një nga rekomandimet për të ruajtur është: “Lsho kushtrimin n’Tosk e n’Geg / Mblidhuni tok si kokrrat n’shegë”. Cilësuar nga T. Zavalani, *Histori e Shqipnis* (1996), 188.

⁹ Për një përmbledhje më të mirë të rolit të Ali Pashë Tepelenës gjatë kësaj periudhe shih biografinë e shkëlqyer të S. Godos, *Ali Pashë Tepelena*, Tirana: Artemida 1993.

¹⁰ S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të jetë*, (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980), 69. Fillimisht, kjo ese u botua në Bukuresht, në vitin 1899.

¹¹ H. Roos, *Historia moderne e Polonisë*, Londër 1966, 48 cituar nga E. Hobsbawm në *Kombet dhe Nacionalizmi që nga viti 1780: Programi, Miti, Realiteti*, (London: Cambridge University Press, 1990), 44 – 45.

¹² E. Hobsbawm, *Kombet dhe Nacionalizmi që nga viti 1780: Programi, Miti, Realiteti*, 18 – 20.

¹³ S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të jetë* (1899), 70.

¹⁴ E. Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi që nga viti 1780: Programi, Miti dhe Realiteti*, 67.

¹⁵ Shih. E. Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët e përkthyer në shqip nga V. Shtylla*, (Tirana: Naum Veqilharxhi), 45.

¹⁶ Shih F. Lubonja, *Between the glory of a virtual world and the misery of a real world në Albanian Identities*, ed. S. Schwandner – Sievers dhe B. J. Fischer, (London: Hurst & Company, 2002), 91 – 103.

¹⁷ Shih N. Malcom, *Myths os Albanian national identity: some key elements, as expressed in the works of Albanian writers in America in the early twentieth century* (Mite të identitetit kombëtar shqiptar: disa elemente kryesore siç shprehen në veprat e shkrimtarëve shqiptarë në Amerikë në fillim të shekullit të 20) në *Albanian Identities*, 70 – 90.

¹⁸ P. Vasa, *Mori Shqypni, e mjera Shqypni në Vepra Letrare*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1987), 37 – 38. Poema është

botuar për herë të parë në vitin 1880.

¹⁹ Tek Qerbelaja e Naim Frashërit gjejmë një tjetër pasqyrë propozimesh të ngjashme, ku tema Shi-ite e vuajtjes dhe shpërblimit i drejtohet shqiptarëve, si myslimanë ashtu edhe të krishterë, dhe jepet më shumë si model epik rezistence për të frymëzuar fushatën nacionaliste shqiptare sesa për bazat e saj fetare. Shih Ger Duijzings, Religion and the politics of Albanianism (Besimi fetar dhe politika e shqiptarizmit) në Albanian Identities, 60 – 69.

²⁰ Gjurmë të këtij qëndrimi mund të gjenden në shumë poema, veçanërisht tek Zemëra (1890), Perëndia (1890), Gjithësia (1895) etj. Shih N. Frashëri, Vepra të zgjedhura, (Tiranë: Naim Frashëri, 1981).

²¹ Një shembull ndërmjet të shumtëve gjendet në disa vargje nga poema Gjithësia (1859). Një që njeh veten e tija / edhe merr vesh gjithësinë / e di ç'është perëndia / dhe ka udhë njerëzine [...]. Një trup është gjithësia / dhe të sosur s'ka gjëkund / me ç'do an është perëndia / një det që si gjendet fundi. Shih. N. Frashëri, Vepra të zgjedhura, p. 97-98.

²² Shih më sipër fq. 5

²³ Sigurisht, ndër këto ese vlen të përmenden nga V. Pasha, E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, e botuar për herë të parë në Londër në vitin 1879 dhe S. Frashëri, Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të jetë, e botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1899.

²⁴ S. Frashëri, Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të jetë (1899), 42.

²⁵ V. Pasha, E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, 115. Versioni anglisht i këtij shkrimi është ribotuar kohët e fundit, shih Eëssa Effendi, The Truth on Albania and the Albanians. Historical and critical issues by Wassa Effendi, me një parathënie të R. Elsie (Centre for Albanian Studies, London 1999).

²⁶ I. Kant, An answer to the question: "What is Enlightenment" (Çfarë është iluminizmi, (1784) në Political Writings, përkth. dhe bot. nga H. Reiss, (New York: Cambridge University Press, 1970), 54.

²⁷ S. Frashëri, Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të jetë (1899), 121

²⁸ S. Frashëri, Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të jetë (1899), 107 – 109.

²⁹ Shih N. Frashëri, Fjalët e Qiririt (18860 në Vepra të Zgjedhura.

³⁰ Shih Wordsworth Hyrje në baladat lirike. Për një analizë konceptuale të modeleve estetike të Romantizmit evropian, shih M. H. Abrams, The Mirror and the Lamp (Oxford: Oxford University Press, 1971).

³¹ Shih I. Kant, Kritika e arsyes (1790), 59, On beauty as a symbol of morality (Mbi bukurinë si një simbol moraliteti), (New York: Barnes & Noble, 2005), 154 – 157.

³² Një poetikë qartësisht romantike si në përshkrimin natyror ashtu edhe në atë njerëzor të personazheve, ka ndikuar disa nga veprat më të rëndësishme të De Radës si Këngët e Milosao-s, botuar në Itali në 1936, Serafina Topia dhe Skanderbeu i pafan. Një shembull tjetër i mirë është Kenka e sprasme e Balës nga Gavril Dara i Riu. Shih E. Çabej, Romantizimi në Evropën lindore dhe juglindore dhe në literaturën shqipe, 97 – 105.

³³ Sërish, me disa përjashtime të pakta individuale që vinin nga emigrantët shqiptarë në Itali, duke përfshirë dhe poetin më romantik shqiptar, Zef Seremben.

³⁴ Shih, V. Pasha, E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët, 123.

³⁵ Shih N. Frashëri, Gjuha Jonë në Vepra të Zgjedhura, 148 – 150.

PËRDORIMI INSTRUMENTAL I KUFIJVE MIDIS KATEGORIVE FETARE DHE METAFORAVE GJINORE NË BALLKAN*

ALBERT DOJA**

Abstrakti. Në këtë artikull shqyrtoj mënyrat e identifikimit dhe përkatësisë fetare në Ballkan si instrumente politike që aplikohen për të konsoliduar strukturat hierarkike midis grupeve shoqërore dhe individëve, të cilët shumë shpesh përdorin metafora gjinore që përshkruajnë kategori të ndryshme njerëzish ose si të feminizuar ose si vërtet burrërorë si dhe të përdorimit të grave si njësi shkëmbimi.¹

Një ideologji etno-fetare me nuanca gjinore

Mbi të gjitha, Ballkani është një vend kalimesh, takimesh dhe kontaktesh, i mahnitshëm në aftësinë e tij të hibridizimit të Ortodoksisë Lindore, Katolicizmit dhe Myslimanizmit. Megjithatë, në një këndvështrim përgjithësues të kulturave dhe shoqërive të Europës juglindore, sidomos Shqipërisë, bien menjëherë në sy dallimet rajonale midis malësisë dhe fushës, midis mënyrave të jetesës të ndikuara nga kultura të ndryshme fetare, midis situatave të ndryshme sociale dhe ekonomike, sidomos për sa i përket ndikimit të tyre ndaj raporteve gjinore.

Në Ballkan, si kudo tjetër, ndërrimi i fesë dhe politika e saj normalisht kanë të bëjnë me një histori kolektive që ka përfshirë komunitetet sociale dhe kulturore, ose më saktë, pjesëtarët e familjeve, fiseve, fshatrave apo të grupimeve më të mëdha. Në kohët më të hershme, para dhe pas kulmit të islamizimit në shekullin e shtatëmbëdhjetë, njerëzit konvertoheshin në myslimanë apo të krishterë me qëllim që t'i përkisnin një grupi të caktuar shoqëror. Ndryshimi i fesë dhe

*Një version më i hershëm i kësaj eseje është prezantuar në konferencën Feja në Kufij: Sfida të Reja në Studimet Akademike të Fesë, Soderton University College, Stokholm, Suedi, 19-22 Prill, 2007, dhe në konferencën e Kotor Network mbi Minoritet e Reja Fetare, Sarajevë, Bosnje Hercegovinë, 25-26 Maj 2007. Përgatitja për këtë ese si dhe prezantimi i saj u mundësuan nga Programi i Kthimit të Trurit (Brain Gain Programme) i PNUD-it dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze.

**Albert Doja është profesor i Sociologjisë dhe Antropologjisë në New York University në Tiranë dhe në Universitetin European të Tiranës, është Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Humane dhe Sociale dhe Dekan i Programeve Pasuniversitare në New York University në Tiranë, Bashkëpunëtor Nderi (Honorary Fellow) pranë Departamentit të Antropologjisë në University College Londër, si dhe ka qenë në shërbim të Programit të PNUD-it mbi Tërheqjen e Trurit si Zëvendës Rektor i Universitetit të sapo formuar të Durrësit. Ai ka mbrojtur Doktoraturën në Antropologji Sociale në 1993-shin në Ecole des Hautes Etudes en Sciences Sociales në Paris dhe një Akreditim Profesorati (Habilitation à Diriger des Recherches) në sociologji dhe antropologji në 2004-ën nga Universiteti i Parisit-5, Sorbonne. Profesor Doja ka mbajtur një sërë pozicionesh akademike në Francë, Britaninë e Madhe, Irlandë dhe Shqipëri. Ai ka botuar rreth gjashtëdhjetë artikuj në revista akademike ndërkombëtare të recensuara me bord redaktorial. Kërkimet e tij akademike përqendrohen në përdorimin e identitetit, gjinisë dhe marrëdhënieve fisnore, përdorimin e fesë, etnisë dhe nacionalizmit, antropologjinë e historisë, teoritë antropologjike dhe kulturore, strukturalizmin dhe post-strukturalizmin.

¹ Përkthyer nga anglishtja, Smoki Musaraj, Ph.D. Candidate, New School University, New York, USA.

Botimi origjinal: "Instrumental borders of gender and religious conversions in the Balkans", Religion, State & Society, vol. 36 (1), 2008, pp. 55–63. DOI <http://dx.doi.org/10.1080/09637490701809738>. © Routledge Taylors & Francis.

përkatësia fetare janë rrjedhimisht pjesë e procesit të socializimit që vjen nga përpjekja drejt një identiteti kolektiv. Simbolet dhe besimet kolektive, risitë dhe ceremonitë konsiderohen si pjesë e fesë zyrtare—përkatësisht fesë së krishtere dhe myslimane—së një komuniteti apo një rrjeti shoqëror vendas, pavarësisht nëse tipare të tyre kulturore i përkasin apo jo këtyre feve në përgjithësi. Ato kategorizohen kolektivisht jo si veçori fetare të një sistemi besimesh në nivel universal, por si ‘trashëgimia prej paraardhësve në tradita dhe zakone.’ T’i përkasësh një feje do të thotë t’i përkasësh një grupi të caktuar shoqëror.

Në rastin e dallimeve fetare, gjithsesi, ka një mospërputhje midis organizimit social ekzistues dhe praktikës ligjërimore të pjesëtarëve të tij rreth shoqërisë dhe sjelljeve sociale. Ligjërimet e këtij lloji në Shqipëri, për shembull, krijojnë përshtypjen se kjo mospërputhjeje është tejet e madhe dhe duket si një hendek i pakapërcyeshëm midis të krishterëve dhe myslimanëve. Nga ana tjetër, vrotimet empirike në terrenin e cilitdo komuniteti vendas dëshmojnë jo vetëm ekzistencën e një komuniteti gjuhësor me gjithëpërfshirje të plotë të të krishterëve dhe myslimanëve, por gjithashtu edhe të një komuniteti shumë të hapur ndaj mënyrave të ndryshme të jetesës dhe dokeve kulturore. Edhe pse një individ mund të mbartë të njëjtat paragjykime si grupi i tij kundrejt grupeve të tjera fetare, vlerat thelbësore të një grupi përcaktohen nga sistemi farefisnor dhe i aleancave martesore, nga linjat e solidaritetit apo armiqësisë, nga statusi dhe pozicioni shoqëror, të cilat janë të përbashkëta në shumë komunitete pavarësisht nga përkatësia fetare. Të qenët mysliman apo i krishterë bazohet në familjen, farefisnin, grupin territorial apo shoqëror përkatës, që sipas traditës ka të bëjë me “përkatësinë” ose praktikën fetare. Nuk bazohet në një sistem të caktuar besimi apo bindjeje fetare; në realitet kjo i ka rrënjët në kulturën sociale. Feja në këtë rast është një konformizëm që transmetohet përgjatë komunitetit (Doja, 2000).

Si pasojë, ndërsa shumëkush e sheh kundërvënien e grupeve fetare ndaj njëra tjetrës si një shkak apo arsye të disa zhvillimeve historike në Ballkan, në të kundërtën, kjo duhet parë pikërisht si një rrjedhojë e këtyre zhvillimeve. Konceptimi i kategorive ‘i krishterë’ apo ‘mysliman’ është natyrisht i lidhur me identifikime të ndryshme sociale, politike, territoriale, etnike, gjinore dhe të tjera si këto. Një tipar i rëndësishëm i këtij lloji konceptualizimi është logjika populiste dikotomike në ligjërimin politik dhe kulturor që përshkon krejt Ballkanin dhe shpesh përmban një arsyetim të gabuar përfytyrimi metonimik. Konceptimi kundërvënës midis ‘të krishterëve’ dhe ‘myslimanëve’ është pjesë e një serie çiftesh antitetike si malësor/fusharak, malok/fushor, qytetar/fshatar, verior/jugor, pushtues/i pushtuar, shtypës/i shtypur, autokton/i ardhur, i ndershëm/i pandershëm, i pastër/i ndotur, të cilave shpesh u mbivendosen qartazi kategoritë mashkullore/femërore apo mashkull/femër (Sofos 1996; Zhivkovic, 1997). Këto çifte antitetike, pasojë e elementëve kulturorë seksistë dhe maskilistë, u vishen në mënyrë të dukshme grupeve të ndryshme njerëzish pavarësisht tipareve të tyre reale, qoftë për t’i ngritur ata në qiell, qoftë për të poshtëruar identitetin e tyre. Ky karakterizim i të gjitha grupeve territoriale apo fetare si bartësit e një mentaliteti të caktuar njihet edhe si “Ballkanizim” (Todorova, 1997) dhe merr pjesë në logjikën e një serie orientalizmesh të vendosura mbi njëra tjetrën (Bakic-Hayden, 1995).

Çdo dikotomi, për më tepër, mund të degëzohet rishtazi dhe përmbajtja e tyre të shumëfishohet e të përdoret në konflikte sa vjen e më të përgjakura, siç shihet për shembull, në perceptimin e konvertimeve në myslimanizëm si tradhëti ndaj gjakut dhe qumështit të krishterë, që presupozohet të vijë me transformimin nga gjaku dhe raca Sllave në atë Turke. Konvertimi në myslimanizëm ka qenë gjithmonë një çështje delikate, e shtjelluar gjerësisht në letërsi, sidomos në poezinë epike. Disa nga kryeveprat më me zë të letërsisë ballkanase, që nga shkrimet e hershme të poetit dhe peshkopit malazez të shekullit të nëntëmbëdhjetë Petar Njegos deri tek Jugosllavi i shekullit të njëzetë, fitues i çmimit Nobel Ivo Andric, kanë ndikuar jashtë mase në këtë drejtim. Siç është paraqitur në këto vepra, kjo ideologji etno-fetare përjashton të gjithë sllavët myslimanë nga “njerëzia” dhe tregon se çfarë mund t’u bëhet atyre që konsiderohen si jo-njerëzorë, dhe se çfarë mund të jetë, brenda konditave të caktuara, një detyrë fetare dhe një akt spastrimi. Një ligjërim i tillë nacionalist fetar, drejtuar kundër qumështit të nënës së

muslimanëve sllavë dhe kundër aftësive të tyre riprodhuese, i mallkon ata të zhduken, jo vetëm si ‘burracakë dhe lakmitarë’ dhe si ‘elementet e pafe të një race të re,’ por përfundimisht si ‘Orienti’ i korruptuar që e ka shkëputur racën sllave nga ‘rrymat civilizuese’ të perëndimit (Sells, 1996).

Shumë studime kanë eksploruar sesi është përfytyruar dhe ligjëruar komuniteti etno-fetar ndër shumë kultura në bazë të metaforave gjinore të riprodhimit dhe farefnisës, si dhe mënyrat sesi politika nacionaliste dhe fetare strukturohet nëpërmjet gjinisë (Mosse, 1985; Yuval-Davis, 1997; Goldstein, 2001; Nagel, 2003). Nacionalizmi populist serb në veçanti ka theksuar disa dikotomi me nuanca gjinore që ndërtojnë marrëdhëniet shoqërore duke ua kundërvënë ‘serbët e pastër’ jo vetëm boshnjakëve ‘tradhtarë’ që janë konvertuar në muslimanë, por edhe fantazive të shqiptarëve burrorë, por ‘kafshërorë’ dhe ‘të ligj,’ burokratëve dhe komunistëve serbë ‘të shburrëruar’, aktivistëve serb ‘të feminizuar,’ ose oponentëve të linjës së Milosheviçit ‘me probleme hormonale’ (Salecl, 1994). Duke u mbështetur në një përkufizim maskilist të kombit, është aplikuar një strategji e rëndësishme ligjërimore sipas së cilës kategoritë ‘femërore’ dhe ‘të shburrëruar’ përfshijnë pothuajse cilindo që nuk i përmbahet versioneve të pranueshme ‘nacionaliste’ të burrisë ose versioneve ‘gjinore’ të identitetit kombëtar.

Është pikërisht roli në rritje i praktikave ligjërimore tradicionaliste dhe nacionaliste që bën të mundur si pasojë që feja të konvertohet në ndërgjegje nacionaliste, që ndërgjegjia nacionaliste të organizohet dhe që nacionalizmi i organizuar të bëhet më luftarak, më maskilist, më mizogjin, më racist dhe më i dhunshëm. Projektet nacionaliste mundet faktikisht të mobilizojnë një praktikë ligjërimore tradicionaliste që lidhet me formimin e imazhit social të gjinisë dhe fesë, rezultati i së cilës është që të gjenerojë luftë mbi bazën e një rendi moral të ngurtësuar dhe të një ideologjie etno-fetare me simbole gjinore.

Instrumentalizimi i kategorive gjinore dhe fetare

Një fenomen i mëtejshëm është se valencat ligjërimore dhe polet e kundërta të një çifti termash shpesh kthehen anasjelltas; faktikisht, një gamë e gjerë çiftesh termash të kundërt mund të marrin një spektër vlerash me nuanca të ndryshme. Në varësi të kujt flet dhe me kë, kur, në ç’kondita, dhe për çfarë qëllimi, ndërrimet e renditjes dhe kombinimet e dallimeve etno-psikologjike territoriale, fetare apo gjinore, shpesh në dukje logjikisht inkonsistente, mund të marrin kompleksitet marramendës. Fushorët dhe qytetarët mund të perceptohen si racionalë, pragmatikë dhe të kultivuar, ose në të kundërt si të degjeneruar, të butë dhe të nënshtruar; malësorët dhe fshatarët mund të perceptohen si trima, krenarë, guximtarë, ose në të kundërt si të dhunshëm, primitivë dhe arrogantë. Në këtë proces të ndërtimit të identitetit kufij të hapësirorë, fetarë dhe gjinorë vazhdimisht etnicizohen dhe politizohen për të shprehur kufij kulturorë, një proces i cili shumëfishohet sidomos në periudha ndryshimesh sociale të menjëhershme dhe përçarëse ashtu si luftërat etnike në ish-Jugosllavi ose trazirat postkomuniste në Shqipëri.

Përgjithësisht, në Shqipëri shpesh ndeshen perceptime reciproke të shprehura në dikotomitë ‘primitiv’ kundër ‘i civilizuar’, dhe ‘besnik’ apo ‘i ndershëm’ kundër ‘i pabesë’ dhe ‘tradhtar’. Shqiptarët jugorë i mendojnë ata veriorë dhe malësorë si ‘primitivë’ dhe veten e tyre si ‘të qytetëruar’. Nga ana tjetër, Shqiptarët veriorë, sidomos katolikë, i mendojnë Shqiptarët muslimanë si ‘të pabesë,’ gjë që i referohet dukshëm konvertimeve fetare të këtyre të fundit gjatë historisë. Ata kanë edhe tendencë t’i quajnë të gjithë Shqiptarët e fesë ortodokse si potencialisht ‘të pabesë’ për arsye të teorive të përhapura konspiruese ku identifikimi me planet ekspansioniste greke i bën këta potencialisht tradhtarë (shiko Schwandner-Sievers, 2002).

Më saktësisht, përkundër ‘delikatesës’ dhe ‘kulturës së qytetëruar’ të disa kategorive njerëzish, mënyrat e të sjellurit të njerëzve të kategorive të kundërta shpesh konsiderohen si ‘fanatike’ dhe si një shenjë e prapambetjes së tyre. Simbolet e fanatizmit shpesh janë të lidhura me çështje fetare, por pikësepari ato kanë të bëjnë me kontekstin e marrëdhënieve familjare, ku

nënshtrimi i spikator i grave ndaj autoritetit mashkullor konsiderohet si një tregues fanatizmi. Pa dyshim që këto përfytyrime mund të mos kenë asnjë raport me praktikatat reale dhe në komunitetet lokale të përziera krishterë dhe myslimanët mund të krijojnë të njëjtat imazhe mbi njëri-tjetrin, gjithmonë me njëfarë shtrembërimi në raport me realitetin. Komunitete të ndryshme brenda të njëjtës fe mundet gjithashtu ta përfytyrojnë njëra-tjetrën si fanatike. Myslimanët e Shqipërisë jugore, për shembull, janë gjithmonë të gatshëm të kritikojnë fanatizmin e disa grupeve të tjera myslimanësh të cilët ata i perceptojnë si ‘të kundërt’ në bazë të një kriteri të caktuar. Ata shpesh perceptojnë bashkëjetesën e tyre me të krishterët e Shqipërisë së jugut, për shembull, si një tregues dhe pikësynim të ‘finesës së tyre kulturore’ krahasuar me myslimanët e zonave rurale ose malore të Shqipërisë veriore (Rapper, 2002). Një superioritet të tillë ata e konsiderojnë detyrimisht të nënkuptohet edhe në raportet e tyre gjinore.

Marrëdhëniet martesore ndërmjet të krishterëve dhe myslimanëve shpesh përcaktohen nga martesat brenda komunitetit fetar. Në komunitete lokale me shumicë myslimane, të krishterët mund të duan t’u përmbahen rregullave të endogamisë fetare, por ata janë të kufizuar gjithashtu edhe nga rregullat e ekzogamisë (martesës jashtë grupit fisnor) që i ndalojnë martesat me kushërinjtë e largët, qoftë nga ana e atit, qoftë nga ajo e nënës. Për këtë arsye, shumë gra të krishtera kanë një shans shumë të vogël të gjejnë një bashkëshort të pranueshëm në fshatin e tyre, ato martohen në qytet, që përgjithësisht mbahet si më ‘i krishterë’. Gjithashtu, gratë e reja që largohen për të vazhduar studimet universitare në qytet kanë tendencë të qëndrojnë aty dhe të mos kthehen në fshat për të gjetur bashkëshort. E gjithë kjo përforcon lidhjet që të krishterët mbajnë me qytetet dhe imazhin e tyre të ‘kulturës’ dhe ‘modernizmit’; cilësi të cilat i përkasin, si kudo, qendrave të mëdha urbane.

Shprehur në terma antropologjike endogamia fetare manifestohet kryesisht në refuzimin e dhënies së grave sesa në refuzimin e marrjes së tyre. Në këtë kuptim, endogamia e krishtere në Shqipëri është më strikte se endogamia myslimane për sa kohë që të krishterët janë akoma më rezistentë sesa myslimanët në dhënien e grave, ndërkohë që pranojnë të jenë marrës, gjë kjo që tregon superioritetin relativ të të krishterëve ndaj myslimanëve. Në shumicën e martesave të përziera burri është i krishterë dhe gruaja myslimane. E kundërta ndodh shumë më rrallë, dhe gratë e krishtere të martuara me myslimanë janë përgjithësisht nga zona të largëta malore dhe ndodhen kështu larg konflikteve lokale midis të krishterëve dhe myslimanëve. Në këtë situatë, marrësit e grave vlerësohen më tepër sesa dhënësit. Burrat e krishterë janë krenarë për faktin që ata mund të marrin gra myslimane, kurse myslimanët ankohen që të krishterët marrin vajzat e tyre, por refuzojnë t’ua japin të tyret atyre (Rapper, 2002).

Megjithatë, situata e tanishme është e kundërta e situatës që mbizotëronte para pavarësisë, periudhë kjo e parësisë institucionale të myslimanëve brenda kornizave të shoqërisë osmane. Praktika e marrjes së grave të krishtera nga burra myslimanë ishte më se e zakonshme. Sipas ligjit islamik i lejohet një burri mysliman të martohet me një grua të krishterë, por nuk i lejohet një gruaje myslimane të martohet me një jo-mysliman. Sidoqoftë, të tilla aspekte legalistike fetare nuk kanë qenë asnjëherë dhe nuk janë aktualisht shumë të rëndësishme në botëkuptimin fetar shqiptar. Në zonat gjysmë-autonome të Shqipërisë veriore, për shembull, raportohet se katolikë të betuar gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë martoheshin rregullisht me gra myslimane të cilat presupozoheshin të hiqnin dorë nga feja myslimane pas martesës (Whitaker, 1968).

Në malësinë para-moderne ballkanase, si burrat e pamartuar ashtu edhe femrat e pamartuara kanë rënë po aq pre e politikave familjare sa edhe pjesëtarët e pafat të shtëpive mbretërore perëndimore gjatë Mesjetës. Çështja e përfitimit familjar—jo përkatësia fetare per se—ishte një nga diskutimet kryesore kur i vinte koha një burri për t’u martuar dhe më të vjetrit e familjes e shqyrtonin këtë situatë me synim që të kryej lidhja më me përfitim për të gjithë grupin familjar. Të drejtat dhe interesat e grave nuk merreshin parasysh. Shumë gra ende i përshkruajnë martesat e tyre me mblesëri dhe i pranojnë ato si norma sociale (shiko Post, 1998). Ndër aspektet e tjera që negocioheshin, më pak problematikja ishte fakti që gruas në përgjithësi i kërkohej të ndërrohte fenë e saj për t’iu përshtatur asaj të burrit që po merrte.

Është e arsyeshme të supozojmë që orientimi i sotëm i strategjive martesore është zhvillim i kohëve të fundit që korrespondon me një situatë të re politike dhe bën pjesë e konceptit të ‘kulturës’ që e mbështet atë. Në fillim të shekullit të njëzetë, pak pas pavarësisë, këto tendenca ishin kthyer në të kundërt. Edhe pse ende kishte një numër të vogël martesash ndër-fetare, evidenca demografike nga analiza e një kampioni marrë nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 1918 në zonat shqiptare të pushtuara nga Perandoria Austriake tregon se, në shumicën e rasteve të asaj kohe, burri ishte katolik dhe gruaja myslimane dhe vetëm në rreth 10 përqind të rasteve ishte burri mysliman dhe gruaja katolike (Gruber & Pichler, 2002). Në të njëjtën mënyrë, konvertimet në myslimanizëm ishin më të shpeshta sesa konvertimet në fenë e krishtere deri në vitet e para të shekullit të njëzetë, ndërsa tendencat e mëvonshme kanë ndjekur drejtimin e kundërt. Statusi relativ i myslimanëve dhe të krishterëve është kthyer në të anasjellën. Të krishterët konsiderohen si elita dhe doket martesore kanë ndjekur po këtë zhvillim. Me një fjalë, identifikimi dhe përkatësia fetare nuk mund të jenë kritere objektive që përcaktojnë veçoritë e grupeve shoqërore, por kategori që ndihmojnë analizën e tyre. Ato janë në thelb instrumente politike që përdoren për të vendosur marrëdhëniet hierarkike ndërmjet grupeve sociale dhe individëve, ku gratë shpesh përdoren si monedhë shkëmbimi.

Roli aktiv i grave

Po ta marrim seriozisht Claude Lévi-Strauss-in, duhet të pajtohemi se gratë presupozohet të jenë jo vetëm mjete shkëmbimi në një strukturë formale pushteti, por edhe subjekte aktive në histori si edhe në jetën e përditshme shoqërore. Sipas teorisë së tij mbi marrëdhëniet farefisnore dhe lidhjet martesore gratë shkëmbehen ndërmjet burrave në bazë të rregullave të ekzogamisë (martesës jashtë grupit) dhe ndalimit të incestit. Kjo formë aleance martesore presupozohet të sigurojë komunikim ndërmjet grupeve të ndryshme sociale dhe integrimin e shoqërisë njerëzore në tërësi. Sipas kësaj strukture elementare farefisnore gratë konsiderohen pjesë e një mënyre të caktuar komunikimi, si një ‘e folur’ që shpërdorohet kur nuk shkëmbehet dhe nuk ‘komunikohet.’ Edhe pse Lévi-Strauss-i nuk denoncon dëmet që shkaktojnë sistemet farefisnore ndaj grave, këtu mund të dallojmë një kontradiktë që arrin deri në pranimin e një roli aktiv apo aftësie të grave për të marrë vendime, përderisa gratë ‘flasin’ në të njëjtën kohë që ‘flitet’ për to, përderisa ato ‘komunikohen’ në rolin e tyre si ‘shenja’ dhe ‘komunikojnë’ në rolin e tyre si prodhuese shenjash. Duke cituar Lévi-Strauss-in,

...një grua nuk mundet kurrë të jetë një shenjë dhe asgjë më tepër, pasi edhe në botën e burrave ajo prapëseprapë është ende një person dhe përderisa ajo përkufizohet si një shenjë ajo duhet të njihet njëkohësisht edhe si prodhuese shenjash. Në dialogun martesor të burrave, një grua nuk është kurrë ajo për të cilën flitet; nëse gratë në përgjithësi paraqesin një kategori të caktuar shenjash, të destinuara për një lloj të caktuar komunikimi, çdo grua ruan një vlerë të veçantë që buron nga talentet e saj, si para edhe mbas martese, për të marrë pjesën e saj në duet. Përkundër fjalës që është shndërruar tërësisht në shenjë, gruaja ka mbetur njëkohësisht edhe shenjë edhe vlerë. Kjo shpjegon arsyen pse raportet midis sekseve kanë ruajtur atë pasuri ndjenjash, atë afsh e atë mister që pa dyshim përshkojnë prej fillimit tërë universin e komunikimit njerëzor. (Lévi-Strauss, 1967, p. 569)

Në Ballkan gjatë periudhës osmane, gratë e martuara me myslimanë shpesh ruanin fenë e tyre të krishtere dhe ndikonin në krijimin e ndjenjave të ngrohta midis pjesëtarëve të të dyja feve. Në Shqipëri në veçanti, gratë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e krishtëritimit të fshehtë (Skendi, 1967; Malcolm, 2001). Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur popullata katolike filloi të zvogëlohej shpejt si pasojë e konvertimeve masive në myslimanizëm, kripto-krishterimi në

mes të Shqiptarëve u rrit përpjesëtimisht. Shënimet e misionarëve shpesh përshkruajnë raste kur komunitete të tëra katolike ndërmerrnin vetëm konvertimin e burrave. Shpesh shtytja për konvertim nuk ishte vetëm financiare, ekonomike apo sociale, por edhe thjesht mbijetesa.² Në disa raste të konvertuarit e rinj raportohet të kenë marrë gra të krishtera dhe jo myslimane, me qëllim që shtëpia e tyre të mos humbiste fenë e krishtere.

Të gjitha sistemet farefisnore i organizojnë marrëdhëniet e të afërmeve nga të dyja anët e atit dhe ëmës, kurse anëtarësimi në grup, emrat dhe burimet simbolike të identitetit, përfshirë këtu edhe feja, shpesh i japin prioritet vetëm njëerës anë. Sidoqoftë, duke ndjekur një farë parimi të prejardhjes paralele për trashëgiminë e anëtarësisë në grup dhe të burimeve të tjera nga prindërit tek fëmijët, gjatë asaj kohe një mjet tjetër i përhapur ndër shqiptarët ka qenë edhe edukimi i djemve si myslimanë, me kërkesën e të atit, dhe të vajzave si të krishtere, me kërkesën e nënës. Me sa duket ky sistem dallimesh fetare në bazë të gjinisë ka vazhduar nëpër shekuj dhe duhet të ketë qenë një mekanizëm i rëndësishëm në ruajtjen e krishterimit të fshehtë. Nëse gratë në një familje të caktuar e shpallnin publikisht se ndiqnin fenë e krishtere, kjo mundësonte që prifti të hynte lirshëm në shtëpitë e tyre dhe aty prifti mundet t'u ketë shërbyer edhe burrave. Nëse bashkëpunimi i priftërinjve ka qenë një mekanizëm kryesor në zhvillimin e krishterimit të fshehtë, atëherë mekanizmi tjetër shumë i rëndësishëm ishin dallimet gjinore.

Roli aktiv i grave në mënjanimin e martesave citohet gjithashtu si një efekt anësor i padashur i përkatësisë etno-fetare. Fenomeni relativisht i përhapur i beqarisë së grave në malet veriore shqiptare konsiderohet të jetë përhapur në pjesën e parë të shekullit të shtatëmbëdhjetë nga misionarët Françeskanë (Zamputi, 1961; Dojaka, 1986; Gremaux, 1992). Raporti i vitit 1638 i një nga themeluesve të urdhrit Françeskan në Shqipërinë veriore shpreh entuziazmin e misionarëve rreth çka ishte arritur që nga mbërritja e tyre në vitin 1635 për sa i përket martesave të pastra ose të përmbajtura dhe virgjërisë si mënyrë jetese për popullsinë vendase.

Nuk është e pamundur që sukcesi i misionarëve që i bindën femra t'i përkushtoheshin virgjërisë së krishtere dhe të mbeteshin të palidhura dhe të pastra gjatë gjithë jetës së tyre të ketë qenë paraprirë nga një sistem ekzistues i martesave të vonuara, të cilat i lejonin femrat të jetonin vite të tëra lirie jashtë kornizave të familjes dhe martesave (Gremaux 1992, p. 363). Në një burim tjetër të hershëm të vitit 1617 që ka të bëjë me klanet katolike në Shqipërinë veriore, raportohet se disa burra nuk martoheshin para moshës 30 vjeç, dhe gratë jo para 25 vjeç. Në fakt, vajzat e reja nuk dalloheshin nga djemtë, ato mbanin flokët e prera shkurt dhe merrnin pjesë aktive në luftë dhe sulmime ashtu sikurse burrat (Zamputi, 1961, p. 119). Në këtë kontekst, virgjëria si një gjendje e përhershme do ketë humbur karakterin e saj asketik dhe do ketë marrë një karakter laik aktiv. 'Virgjëresha e përbetuar' që hasim në të drejtën zakonore, e cila pritej deri diku të ishte e barabartë me burrat (Young, 2000), nuk haset aspak vetëm tek katolikët shqiptarë dhe malazezë, por gjithashtu edhe ndër myslimanët shqiptarë dhe ortodoksët serbë.

Thuhet se ligjet kanunore që i japin trashëgiminë dhe të drejtën e pronësisë burrave kanë qenë arsyet kryesore për shndërrimin e grave në 'virgjëresha të përbetuara' nëpër Ballkan. Pa hyrë kësaj radhe në këtë diskutim, mund të themi se kthimi në 'virgjëreshë të përbetuar' ishte e vetmja mundësi e respektueshme për një vajzë që refuzonte të martohej, si dhe mënyra e vetme për të evituar gjakmarrjen ndërmjet familjeve në fjalë. Ka shumë mundësi që nëpër Ballkan, sidomos në zonat malore, ka pasur gjithmonë një pakicë femrash që kanë refuzuar t'i nënshtrohen martesave të detyruara. Ato që nuk mundën të mënjanonin një martesë të imponuar

² Në fakt, siç përmendi edhe një recensues anonim i këtij artikulli, ka pasur edhe dy valë të tjera konvertimesh në vijim të luftërave. Kur Rusia i shpalli lufte perandorisë Osmane, në periudhën kur Porta e Lartë mbizotëronte, shqiptarëve ortodoksë vendas që ishin ngritur kundër çifligarëve osmanë iu dha mundësia e zgjedhjes ndërmjet konvertimit në myslimanizëm dhe ekzekutimit. Gjithashtu, kur gjatë fundit të shekullit të shtatëmbëdhjetë, shqiptarë katolikë u ngritën kundër Stambollit kur Austria hyri në luftë me perandorinë Osmane, ata u vunë përpara të njëjtave zgjedhje kur osmanët e rivendosën rendin e tyre.

shpesh kishin lidhje jashtë-martesore. Gjakderdhja që rezultonte sidomos nga hasmëritë e shqiptarëve veriore dhe malazezëve, ku përfshiheshin burrat e familjeve dhe njësisve sociale më të mëdha, ishte shpesh efekt anësor i padashur i praktikave mbizotëruese martesore që nuk linin vend për rolin aktiv të grave për të vendosur vetë për fatin e tyre (Gremaux, 1992). Shumica e kësaj dhune të brendshme provokohej nga femra që refuzonin t'i nënshtroheshin zakoneve të ngurta mbi fejesën dhe martesën. Në fakt, ishte pikërisht në çështje martesore që gratë konsideroheshin, sipas burrave në Shqipërinë e Veriut, si shumë të rrezikshme ndaj rendit social, dhe vlerësimet negative ndaj grave janë detyrimisht edhe tregues të frikës me të cilën burrat hynin në marrëdhënie krushqie (Shryock, 1988).

Beqaria femërore ndër shqiptarët veriorë dhe malazezëve ka mundësi të ketë lindur si rrjedhim i ndërhyrjes françeskane në praktikën zakonore me qëllim që t'i jepte një farë pushteti gruas, ndërkohë që ajo ka marrë karakterin e saj të veçantë duke iu adaptuar zakoneve të vendit të përbetimit të virgjërisë dhe mënyrës së veshjes në imitim të seksit të kundërt. Në kontekstin tradicional, çfarëdo ndryshimi veshjeje e vendoste individin në fjalë nën një presion të jashtëzakonshëm që t'i përmbahej roleve gjinore konvencionale bazuar në seksin e vet. Përcaktimi gjinor i detyrave të caktuara apo i mënyrave të sjelljes dhe pamjes së jashtme ishte kaq i ngurtë sa që kushdo që lëvizte sadopak midis këtyre dy sferave të përcaktuara përkufizohej menjëherë si pjesëtar i gjinisë së kundërt. Gruaja, me një fjalë, hidhte poshtë rolin e saj të përcaktuar gjinor nëse ajo vendoste të kryente punët e burrave, të mbante shtëpinë e saj, dhe të lëvizte pa havale, domethënë pa vellon sociale që e mbyllte atë brenda shtëpisë dhe oborrit (Backer, 2003), një izolim që ende pritej deri vonë nga gratë e zakonshme shtëpiake pavarësisht ndryshimit të pozitive të tyre.

Ndër myslimanët shqiptarë që prej pavarësisë në 1912-ën perçja myslimane mbahej rrallëherë vetëm nga gratë e qytetit, edhe pse mbahet më shumë nga gratë në fshatrat e Kosovës krahasuar me ato të Shqipërisë, mbase ngaqë kosovarët myslimanë ndjekin më tepër fenë islame sesa myslimanet në Shqipëri. Megjithatë, që nga 1990-ta, transformimet e trazura të tranzicionit postkomunist kanë sjellë edhe një rimëkëmbje të fesë në Shqipëri, përfshirë këtu edhe praktikën e fesë islame dhe kthimit të perçes, sidomos ndër vajza të reja. Sidoqoftë, fjala havale, etimologjikisht e lidhur me fjalën 'vello,' nuk perceptohet si e tillë në shqip, por përdoret më shumë me kuptimin 'shqetësim, telash'. Ky dallim është i rëndësishëm në shprehjen nuk kam havale, që do të thotë 'nuk e çaj kokën' në kuptimin shoqëror dhe përdoret në mënyrë demonstrative nga femrat e reja, nga shqiptarët e krishterë ashtu si edhe myslimanë, në Kosovë si dhe në Shqipëri, si deklarata jo-zyrtare e çlirimit të grave.

Bashkë me transformimet e shpejta shoqërore nga mesi i shekullit të njëzetë e këtej, jeta e përditshme e shqiptarëve ka kaluar ndryshime drastike, sidomos në ambiente urbane ku familje më tendenca perëndimore i kanë ndryshuar shumë shpejt vlerat e tyre. Në veçanti pozita e grave po ndryshon shumë shpejt, edhe pse për disa kategori grash zakonet e vjetra mund të vazhdojnë të praktikohen. Ndërkohë që shoqëria e sotme shqiptare është një përzierje praktikash moderne dhe zakonesh tradicionale, çmimi për dhënien e të drejtave grave është gjithsesi shumë më i vogël, dhe sot të drejtat e grave sa vjen e njihen më tepër.

Bibliografia

- Backer, Berit. 2003 [1979]. Behind stone walls: changing household organization among the Albanians of Kosova, (eds) Antonia Young & Robert Elsie. Peja: Dukagjini Books. [Teza e Masterit: Institute of Social Anthropology, University of Oslo, Norway, 1979].
- Bakic-Hayden, Milica. 1995. "Nesting Orientalisms: The case of Former Yugoslavia", *Slavic Review*, 54 (4), 917–931.
- Doja, Albert. 2000. "The politics of religion in the reconstruction of identities: the Albanian situation", *Critique of Anthropology*, 20 (4), 421–438. Përkthyer në shqip në format libri si: Përdorimi politik i fesë në Rindërtimin e Identiteteve: Rasti Shqiptar, Tirana: Botime të Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, 2001.
- Dojaka, Abaz. 1986. *Martesa në Shqipëri*. Tirana: 8-Nentori.
- Goldstein, Joshua S. 2001. *War and gender: how gender shapes the war system and vice versa*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Gremaux, René. 1992. "Franciscan friars and the sworn virgins of the North Albanian tribes", *Religion, State and Society*, 20 (3-4), 361–374.
- Gruber, Siegfried & Robert Pichler. 2002. "Household structures in Albania in the early 20th century", *History of the Family*, 7 (3), 351–374.
- Lévi-Strauss, Claude. 1967 [1949]. *Les structures élémentaires de la parenté*. 2e edition. Paris/Hague: Mouton. Reprint: 2002.
- Malcolm, Noel. 2001. «Crypto-Christianity and religious amphibianism in the Ottoman Balkans: the case of Kosovo», In: Celia Hawkesworth, Muriel Heppell & Harry T. Norris (eds), *Religious quest and national identity in the Balkans*. New York: Palgrave (School of Slavonic and East European Studies, University College London), pp. 91–109.
- Mosse, George L. 1985. *Nationalism and sexuality: middle-class morality and sexual norms in Modern Europe*. Madison, Wis.: University of Wisconsin Press.
- Nagel, Joane. 2003. *Race, ethnicity, and sexuality: intimate intersections, forbidden frontiers*. Oxford/New York: Oxford University Press.
- Post, Susan-Pritchett. 1998. *Women in modern Albania: firsthand accounts of culture and conditions from over 200 interviews*. Jefferson, N.C.: McFarland.
- Rapper, Gilles. 2002. "Espace et religion: chrétiens et musulmans en Albanie du Sud", *Études Balkaniques: Cahiers Pierre Belon*, 9, 17–39.
- Salecl, Renata. 1994. *The spoils of freedom: psychoanalysis and feminism after the fall of socialism*. London: Routledge.
- Schwandner-Sievers, Stephanie. 2002. "Dawn for a Sleeping Beauty Nation: Aromanian identity politics and conflicts in post-communist Albania", In: Frank Kressing & Karl Kaser (eds), *Albania, a country in transition: aspects of changing identities in a South-East European country*. Baden-Baden: Nomos, pp. 147–165.
- Sells, Michael A. 1996. *The bridge betrayed: religion and genocide in Bosnia (Comparative studies in religion and society, 11)*. Berkeley: University of California Press.
- Shryock, Andrew J. 1988. "Autonomy, entanglement, and the feud: prestige structures and gender value in Highland Albania", *Anthropological Quarterly*, 61 (3), 113–118.
- Skendi, Stavro. 1967. "Crypto-Christianity in the Balkan area under the Ottomans", *Slavic Review*, 26 (2), 227–246.
- Sofos, Spyros A. 1996. "Inter-ethnic violence and gendered constructions of ethnicity in former Yugoslavia", *Social Identities*, 2 (1), 73–92.
- Todorova, Maria. 1997. *Imagining the Balkans*. New York: Oxford University Press.
- Whitaker, Ian. 1968. "Tribal structure and national politics in Albania", In: Ioan M. Lewis (ed.), *History and social anthropology*. London: Tavistock (A.S.A. monographs, 7), pp. 253–293.
- Young, Antonia. 2000. *Women who become men: Albanian sworn virgins*. Oxford: Berg Publishers.
- Yuval-Davis, Nira. 1997. *Gender and Nation*. London: Sage.
- Zamputi, Injac. 1961. "Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas Kanunit", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkenca Shoqërore*, 15 (2), 101–132.
- Zhivkovic, Marko. 1997. "Violent highlanders and peaceful lowlanders: uses and abuses of ethno-geography in the Balkans from Versailles to Dayton", *Replika: Hungarian Social Science Quarterly (Special Issue)*, 107–119.

RISHIKIMI I IRREDENTIZIMIT: NDIKIMI I FAKTORËVE SHOQËRORË DHE NDËRHJRJA E JASHTME NË RASTIN E IRREDENTIZIMIT SERB

ILIR KALEMAJ*

Abstrakt. Irredentizmi apo shovinizmi në politikën e jashtme përbën një fushë studimore tejet interesante, megjithëse jo plotësisht të zhvilluar, si në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ashtu edhe në atë të shkencave politike krahasuese. Qëllimi i këtij punimi është studimi i kushteve dhe burimeve që prodhojnë kësi-lloj politikash të jashtme agresive. Kjo është edhe pjesa teorike e esesë, e cila synon të adresojë një problematikë të caktuar dhe specifike, siç është irredentizmi (apo mungesa e tij), në fushën më të gjerë të studimit të shkaqeve të shpalljes së luftës nga një shtet në drejtim të një shteti tjetër apo retorikës ekstreme që për arsye të ndryshme nuk materializohet apo përshkallëzohet drejt luftës së hapur. Gjithashtu, punimi studion thelbin e politikave etnike të sendërtuara dhe stimuluar nga sisteme elektorale të ndryshme, më konkretisht duke u fokusuar në rastin serb. Thelbi argumentativ i esesë ndërtohet rreth një logjike që parasheh rolin e ideve ndërmjetësuese, grupeve të interesit dhe disa institucioneve të caktuara, si katalizatorë të zhvillimit të politikave të jashtme agresive, duke përkthyer ndjenjat nacionaliste në irredentizëm të pastër. Në këtë linjë pyetja kryesore së cilës kjo ese synon t'i përgjigjet është: si arrijnë idetë, institucionet dhe grupet e interesit t'i japin formë politikës së jashtme në lidhje me bashkë-kombësit etnikë matanë kufijve dhe pse kjo ndodh vetëm në disa periudha të caktuara, por jo në të tjerat?

HYRJA

Qëllimi kryesor i punimit është të diskutojë sjelljet e ndryshme drejt bashkë-‘patriotëve’ matanë kufijve të shtetit zyrtar në kontekstin ballkanik dhe më konkretisht, të fokusohet në studimin e politikës së jashtme serbe përgjatë viteve 1986-1993. Këto dy dekada janë tejet domethënëse pasi janë evidencë e një ndryshimi dhe metamorfoze politike, juridike dhe social-ekonomike në shtetin serb. Punimi bazohet në filozofinë racionaliste dhe kryesisht në empiricizmin logjik, që vë theksin te lidhja shkak-pasojë, ku nacionalizmi i prezumuar prezent në nivel elektorati apo në nivelin e segmenteve të caktuara të shoqërisë civile, arriti të shndërrohej në irredentizëm dhe shovinizëm në Serbi. Akoma më interesant bëhet ky punim

* Ilir Kalemaj është diplomuar për Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Empire State College. Më pas ka përfunduar Masterin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane në Universitetin e Evropës Juglindore (CEU), Budapest, ku aktualisht është duke kryer edhe doktoraturën për Shkenca Politike. Fushat e tij të kërkimit janë: politikat dhe konfliktet etnike, irredentizmi në politikën e jashtme, multikulturalizmi dhe çështjet e identitetit (kombëtar, kulturor etj). Adresa për korrespondencë: ilirkalemaj@gmail.com ose kalemaj_ilir@phd.ceu.hu

po të kemi parasysh që politika e jashtme paskomuniste shqiptare për shembull asnjëherë nuk artikuloi ide apo qëllime që qoftë edhe indirekt synonin krijimin e një 'Shqipërie të Madhe'. Përse ndodhi kjo, kush qenë faktorët dhe aktorët kryesorë që ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e irredentizmit serb, si dhe roli i komunitetit ndërkombëtar, përbëjnë dhe thelbin e këtij studimi. Ky punim ofron një kontribut të veçantë për rastin serb, pasi autori synon të shkoj tej teorive që janë shkruar për rolin e irredentizmit serb në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe të demonstroj hipotezën se një kombinim i ideve nacionaliste, së bashku me rolin e institucioneve, të tilla si Kisha Ortodokse Serbe apo Akademia e Shkencave dhe Arteve e Serbisë, si dhe grupet e interesit, sidomos diaspora dhe grupet e Mafies (apo Krimin të Organizuar), kanë luajtur një rol të qenësishëm, për mos të thënë kyç në zhvillimin dhe nxitjen e politikave shoviniste serbe. Gjithashtu ato kanë shërbyer si katalizatorë ndërmjet elitave dhe masës (apo elektoratit), duke bërë të mundur homogjenizimin e shoqërisë serbe dhe dominimin e ligjëritimit nationalist që i dha jetë irredentizmit në politikën e jashtme serbe përkundrejt Kroacisë dhe Bosnjës përgjatë gjysmës së parë të viteve '90-të dhe irredentizmin *de facto* ndaj Kosovës¹ gjatë gjysmës së dytë të kësaj dekade.

Ky punim synon të sjellë në vëmendjen e studjuesve shqiptarë dhe të huaj një prej faktorëve të nënçmuar në literaturën ekzistuese: burimin e irredentizmit serb që u shkaktua nga një nacionalizëm i ri dhe dominant në diskurin zyrtar të Beogradit që pasoi atë komunisto-federalist, i promovuar fort nga Tito dhe pasuesit e tij. Kuptimi sa më i mirë i shkaqeve dhe burimeve të politikave irredentiste dhe shoviniste ka edhe implikime praktike, pasi çon në analizimin, parandalimin dhe kurimin e efekteve të tij në politikën e jashtme dhe të brendshme të një shteti. Kontributi teorik është gjithashtu i rëndësishëm në analizën që i bën ndërveprimit të shkaqeve të brendshme me atë të faktorit ndërkombëtar dhe kur njëra merr prioritet mbi tjetrën në konsideratën e lidhshimit vendas.

Nga pikëpamja metodologjike punimi është një 'N e vogël' (small-N) kërkim kualitativ, që përfshin një analizë të rastit serb, me mundësinë për t'u zgjeruar në të ardhmen, për të përfshirë edhe raste studimore të tjera. Aplikimi i teorisë së Imre Lakatos-it të "fakteve me tre qoshe" (the three cornered fact theory) që arrihet duke testuar propozimet tona me ato të teorive rivale, ashtu sikundër edhe përkundrejt fakteve empirike, mundëson gjetjen e një shpjegimi që duke u nisur nga një shkallë e lartë abstraksioni, mund të siguroj përgjigje të njëjta për raste dhe situata të ngjashme. Gjëgjëza teorike përshin një prej debateve më përshirëse në kryqëzimin e fushës së nacionalizmit dhe shkencave politike krahasuese. Po ashtu ky debat teorik synon të gjej një rrugë të ndërmjetme ndërmjet shkollës së elitave politike dhe asaj të lëvizjeve sociale, e parë nga këndi i faktorëve dhe aktorëve shoqërorë të cilët luajnë një rol aspak të neglizhueshëm në fushën e sendërtimit të politikës së jashtme të një shteti.

Instrumentalizimi i politikës së jashtme, në lidhje me rritjen e agresivitetit të saj të justifikuar me mbrojtjen e bashkë-kombasëve jashtë kufijve zyrtarë të një shteti, shpesh i shërben vetëm konsolidimit të pozicionit të brendshëm të elitës politike në pushtet dhe nga ky këndvështrim, kjo ese sheh edhe rolin e Milosheviçit dhe klasës politike serbe. Pra, një nga argumentat kryesorë që trajtohet në këtë punim është se Milosheviçi dhe lidhshimi politik serb i periudhës paskomuniste, më tepër se të interesuar në mbrojtjen e bashkë-kombasëve të tyre të cilët pas shpërbërjes së Jugosllavisë ngelën jashtë kufijve zyrtarë serb (rasti i Kroacisë dhe i Bosnjës), ishin të interesuar të forconin dominimin e tyre në jetën publike të vetë Serbisë dhe të shmangnin konkurrencën duke përdorur kartën etnike si mjetin më të mirë për t'iu marrë

¹ Në rastin e Kosovës, kjo formë irredentizmi që kulminoi me spastrimin etnik ka qenë prezente *de facto* sidomos në vitet 1997-99, megjithëse *de jure*, Kosova deri në këtë periudhë ka qenë pjesë integrale e ish-Republikës së Jugosllavisë, si subjekt juridik, i njohur në të drejtën ndërkombëtare. Pas kësaj periudhe, me anë të rezolutës 1244, statusi i Kosovës u njoh zyrtarisht nga OKB-ja si nën administrim ndërkombëtar, megjithë pretendimet e serbëve që statusi i saj juridik nuk ka ndryshuar, ndërsa këto ditë pritet dhe shpallja e pavarësisë prej saj dhe e njohur nga faktori ndërkombëtar.

kundërshtarëve politikë armën më të fortë politike që ata mund të përdornin. Në këtë kuptim, ndodhi ajo që Donald Horovitz në një kontekst tjetër e ka quajtur “ethnic outbidding,” përbrenda klasës politike serbe.

Artikulli është i ndarë në katër pjesë kryesore. Në pjesën e parë shqyrtohet literatura mbi irredentizmin. Në pjesën e dytë, eseja përqëndrohet në shtjellimin e modelit teorik që autori synon të sjellë në vëmendjen e lexuesit, ndërsa në pjesën e tretë të artikullit, sillet rasti serb dhe roli që aktorët shoqërorë, si Akademia e Shkencave, intelektualët, Kisha Ortodokse, diaspora apo grupet mafioze luajtën në nxitjen e irredentizmit. Në pjesën e katërt, vihet theksi mbi rolin e faktorit ndërkombëtar dhe impaktit që ai pati në influencimin e politikave të Beogradit. Ndërsa së fundmi bëhet dhe mbyllja e artikullit ku nënvizohen aspektet kryesore të artikuluara në këtë punim.

Irredentizmi: Një vështrim i literaturës

Irredentizmi, i cili është një karakteristikë e identitetit dhe politikave etnike, e merr kuptimin e vetë nga fjala italiane *irredenta* që dikur i është referuar politikës italiane për ri-marrjen e territorit italian të Trentos, e cila në kohën e perandorisë Austro-Hungareze, u pushtua nga kjo e fundit. Sot ky territor gjendet nën administrimin e shtetit italian, megjithëse si rajon autonom dhe i banuar nga popullsia me etni italiane, sikundër edhe gjermane. Përsa i përket një përkufizimi të këtij termi, këtu i referohem Stiven Saideman-it, i cili e ka përkufizuar fenomenin si: “mbështetje shtetërore për aneksimin e territoreve fqinjë të banuara nga bashkë-kombas etnikë.”² Irredentizmi serb ka qenë selektiv dhe jo konsistent,³ duke bërë që studjues të ndryshëm të përdorin qasje po të ndryshme për të shpjeguar arsyet që nxitën atë. Disa nga këta autorë i kanë dhënë prioritet faktorëve të brendshëm që prodhojnë një politikë të jashtme agresive në lidhje me bashkë-kombasit e tyre jashtë kufijve zyrtarë; të tjerët ndërkohë u kanë dhënë prioritet faktorëve të jashtëm. Studjuesi amerikan, V. P. Gagnon e ka shpjeguar agresivitetin serb si pjesë e një strategjie konspirative nga ana e elitës serbe për të mbajtur pushtetin politik, kur ky pushtet u rrezikua nga ndërrimi i sistemeve me të cilin Jugosllavisë i duhej të ballafaqohej sikundër gjithë vendeve të tjera të ish-Lindjes komuniste.⁴ Por problemi në rastin jugosllav ishte më i mpërtë se kaq pasi ishte një sistem federativ dhe ndërrimi i sistemeve prekte gjithashtu logjikën ekonomike të shpërndarjes së të ardhurave ku natyrisht shtetet më të pasura si Sllovenia, por edhe Kroacia e quanin të palogjikshëm asimetrinë e ndarjes së pushtetit politik ku dominonte Serbia.⁵ Gjithashtu, sikundër argumenton Gagnon-i me të drejtë, elitat serbe të cilat përbënin mazhorancën në qeverisjen, ushtrinë federale dhe administratën qendrore, ishin thjesht të interesuar të ruanin pozicionin e tyre qendror dhe pavarësinë ekonomike pavarësisht ndryshimit të sistemeve dhe kalimi nga dogma komuniste në atë nacionaliste justifikonte pikërisht këtë dëshirë të fshehur. Milosheviçi ishte thjesht përgjigja e kërkesave të tyre për një lider që do të plotësonte këtë ritual. Në këtë mënyrë, sikundër autori vazhdon në shpjegimin e tij, klasa konservatore serbe u përpoq të ri-përpunonte interesat dhe kërkesat e elektoratit serb duke e larguar atë nga problemet ekonomike që po vinin si pasojë e

² Shih Stephen M. Saideman, “Inconsistent Irredentism? Political Competition, Ethnic Ties, and the Foreign Policies of Somalia and Serbia,” *Security Studies*, Vol.7, No.3, 1998. p.53

³ Saideman and Ayres, manuskript i papublikuar, 56. Saideman-i përdor këto terma për të trajtuar ndryshueshmërinë që pësojnë politikat e jashtme të shteteve. “Shtetet irredentiste shpesh kërkojnë disa territore, por injorojnë të tjerë dhe variojnë në agresivitet në kohë të ndryshme duke sugjeruar se në vetvete identiteti etnik apo nacionalizmi, nuk mund të shpjegojnë irredentizmin (një konstante nuk mund të shpjegojë dot diçka që varion).” Shih për një trajtim më të hollësishëm, Saideman “Inconsistent Irredentism...,” 54.

⁴ V. P. Gagnon, Jr. *The Myth of Ethnic War: Serbia and Croatia in the 1990s* [Miti i Luftës Etnike: Serbia dhe Kroacia në vitet ‘90-të]. Ithaca, NY: Cornell University Press, 2004. f. 87

⁵ Gagnon, 88

tranzicionit dhe ta kanalizimin atë drejt çështjes kombëtare me qëllim kryesorë de-mobilizimin e popullatës. Ky de-mobilizim është përshkruar nga Gagnon-i si “një proces në të cilin njerëzit që më parë kishin qenë të mobilizuar politikisht, ose që ishin gati për t’u mobilizuar, u heshtën, marginalizuan dhe përjashtuan nga sfera publike.”⁶ Në këtë mënyrë, Gagnon-i merr një pozicion që i sheh gjërat nga *lart-poshtë* dhe argumenton se elitat influencojnë masat duke i udhëhequr apo keqduhëhequr ato sipas interesave të tyre personale.

Qasja e Gagnon-it është në të njëjtën gjatësi vale me tezat kryesisht të pranuar që i parasheh elitat si racionale, aktorë përlllogaritës që marrin avantazhe nga pozicioni i tyre në lidhshimin e vendit për të instrumentalizuar elektoratin apo masat me një qëllim të vetëm në kokë: mbajtjen e pushtetit të tyre dhe/ose vënies së pasurisë. Në këtë mënyrë, ai beson se elitat serbe provokuan një konflikt etnik për të rregulluar pozitat e tyre në një kohë që ballafaqoheshin me kundërshtitë të brendshme.⁷ Megjithatë, ai nuk eksploron nëse një variabël i tretë mund ose jo të ketë ndikim edhe irredentizmin, edhe sjelljen e elitave; variabla të tilla si sjellja e pavarur e një pjese të elektoratit, ndërhyja e faktorit të jashtëm apo e palëve të treta ose aktorët e tjerë shoqërorë. Një tjetër mungesë në teorinë e Gagnon-it, është theksuar nga Stiven Saideman-i, i cili vë re se autori në rrëfimin e tij për irredentizmin nuk ndalet te fakti i rëndësishëm që ky fenomen në fund të fundit varion, pra është i ndryshueshëm, si në kohë ashtu dhe në hapësirë. Në këtë sens nuk ka vend për përgjithësime.⁸

Stjuart Kaufman-i gjithashtu merr një pozicion instrumentalist, çka në vetvete është po racionalist, kur ai argumenton që politikanët gjejnë një ‘tokë pjellore’ në emocinet e njerëzve të cilat ata më pas i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre politike.⁹ Në fakt, Kaufman-i duket se ndan shumë nga pikëpamjet dhe presupozimet e tij me Gagnon-in, duke zhvilluar një argument krejt racionalist. Të dy autorët, theksojnë impaktin e elitave që kërkojnë pushtet duke u bazuar në artikullimin e ideve nacionaliste dhe vënë theksin mbi nxitjen e irredentizmit në politikën e jashtme. Për më tepër, te të dy autorët, elitat ndjekin qëllimet e tyre në mënyrë instrumentale nëpërmjet apelit emocional ndaj masave.

Ndërsa biem dakord me Kaufman-in përse i përket rëndësisë që mitet dhe simbolet kanë në zhvillimin e nacionalizmit dhe irredentizmit, ndahemi nga ai kur argumenton që elitat politike nuk ndikohen aspak nga roli i institucioneve apo aktorëve shoqërorë të ndërmjetëm. Mendimi ynë është se disa institucione të caktuara luajnë një rol qëndror në transmetimin e këtyre ‘ideve’ në arenën politike dhe e kundërta. Në rastin e Serbisë, institucione të tilla përfshijnë Akademinë e Shkencave ose Kishën Ortodokse. Pa të parën, Milosheviçit ndoshta do i mungonte një axhendë politike që do i bënte atij të mundur të hipte në pushtet, ndërsa mbështetja e së dytës i dha atij legjitimitetin e nevojshëm për të ndjekur me fanatizëm idetë nacionaliste. Ndërkohë, grupet e fuqishme të interesit, si diaspora serbe, ndihmuan në sigurimin e mbështetjes së jashtme për rregjimin e tij në periudha kritike.¹⁰

Teoria e *vulnerabilitetit* në fushën e marrëdhënieve/politikave etnike vë theksin ndërkohë te fakti që shtetet të cilat janë objekt i një irredentizmi të jashtëm në vetvete, i druhen përfshirjes në irredentizëm, pasi kjo gjë mund të kthehet kundër tyre nga ana e shteteve fqinjë. Por kjo teori ndonëse ka shpjeguar sjelljen e disa shteteve afrikanë apo të ngjashëm, nuk mund të aplikohet përse i përket rastit serb, pikërisht për faktin se megjithëse Serbia normalisht mund të rrezikohet

⁶ Shih për këtë pjesën e Hyrjes te Gagnon.

⁷ V. P. Gagnon jr., “Ethnic nationalism and International Conflict: The Case of Serbia,” *International Security* 19, no.3 (Winter 1994/95): 135-137. f.135

⁸ Stephen M. Saideman. *The Ties That Divide: Ethnic Politics, Foreign Policy, and International Conflict*. New York: Columbia University Press, 2001. f.22-25

⁹ Stuart J. Kaufman. *Modern Hatreds: The Symbolic Politics of Ethnic War* [Urrejtje Moderne: Politikat Simbolike të Luftës Etnike]. Ithaca and London: Cornell University Press, 2001. f.179

¹⁰ Në mënyrë të ngjashme, mungesa e institucioneve të tilla të ndërmjetme, si një institucion fetar unik me influencë në vendimmarrje, apo pafuqishmëria e tyre— si në rastin e Akademisë Shqiptare të Shkencave—mund të shpjegojë mungesën e përkthimit të nacionalizmit shqiptar në irredentizëm.

nga sjelljet irredentiste të Shqipërisë ndaj Kosovës, përsëri nuk pati kurfarë droje për të ushtruar politika shoviniste ndaj vendeve fqinjë.

Stiven Saideman-i nga ana tjetër, thekson rolin e lidhjeve etnike (ethnic ties) në përcaktimin e axhendave të vendim-marrësve. Këto lidhje etnike që bashkë-kombasit në të dy anët e kufirit ndajnë me njëri-tjetrin, kanë një ndjesi primordialiste e cila vihet re dhe merret në konsideratë nga politikanët në ndërtimin e politikave të tyre të jashtme.¹¹ Logjika mbrapa kësaj është se elektorati është ai që përcaton axhendën politike të liderëve politikë duke i shtyrë këta të fundit të adaptojnë axhenda politike që përfaqësojnë dëshirat (shpesh edhe vetëm të motivuara nga 'lidhje gjaku') dhe politikanët kanë pak apo aspak zgjedhje në këtë proces, vetëm të ndjekin dëshirat e votuesve të tyre, përndryshe shpejt e shohin veten jashtë pushtetit. Në këtë mënyrë, sipas Saideman-it, politikanët përkrahin politika ndërhyrëse në shtete të tjera për të 'mbrojtur' bashkë-kombasit e tyre, pasi kjo shërben si "një test përse i përket sinqeritetit të politikanëve në çështjet etnike në vend [pra në shtetet e tyre]."¹²

Argumenti i Saideman-it që elektorati vlerëson lidhjet etnike më tepër se gjithçka tjetër, është problematik të paktën për dy arsye kryesore. Së pari, lidhjet etnike nuk mund të shpjegojnë pse votuesit në Serbi interesohen më tepër për bashkë-kombasit e tyre jashtë kufinjve sesa fjala vjen, shqiptarët për të tyret - duke supozuar se grupet etnike të të dyja shteteve janë ndjerë të kërcënuara në momentin që e kanë gjetur veten nën hegjemoninë kërcënuese të shtetit të ri që u ka rënë për hise. Shqiptarët e Kosovës janë ndjerë po aq pa mbrojtje, në mos më tepër kur papritmas panë që iu hoq autonomia e zgjeruar që kishin në sistemin federal jugosllav dhe u vunë nën hyqmin serb, sa dhe serbët e Krajnës në Kroaci apo ata të Bosnjes, megjithatë Shqipëria nuk ndërhyri agresivisht për t'i shpëtuar ata, madje edhe në nivelin thjesht retorik u kufizua së tepërmi, duke e trajtuar çështjen më tepër si mbrojtje të të drejtave të njeriut, sesa si akt të pastër shovinizmi *de facto* nga ana e Serbisë. Së dyti, duke i trajtuar ndjenjat e elektoratit vendas për bashkë-kombasit e tyre jashtë si të pandryshueshme, Saideman-i përjashton rolin që mund të luajnë variablat ndërhyrëse si për shembull, influenza e ideve të ndryshme apo interesave që mund të ndikojnë dhe transformojnë pikëpamjet e elektoratit.

Në kontrast me Gagnon-in, Saideman-i ndërmerret një qasje *poshtë-lart* (bottom-up approach) kur ai argumenton që elektorati, pra masat influencojnë veprimet e elitave dhe jo e kundërta siç theksonte Gagnon-i, Kaufman-i dhe të tjerë. Këtu, sipas Saideman-it një rol të veçantë luajnë të ashtuquajturat 'selektorate'¹³ të cilët në shumë demokraci formale përbëjnë bazën elektorale të partisë në pushtet. Saideman-i argumenton që interesat e këtyre elektorateve me rëndësi influencojnë vendim-marrjen e elitave dhe politikën irredentiste kësajsoj ndërmerren sepse ato reflektojnë preferencat e këtij elektorati. Qëllimi kryesor i politikanëve bëhet në këtë mënyrë, prevenimi (ndalimi) i elektoratit për të kaluar te kampi i kundërshtarëve dhe prandaj ata përshtasin axhendën e tyre politike, për t'iu përshtatur më së miri problematikës kryesore që shqetëson këtë pjesë të 'përzgjedhur' të elektoratit. Sipas Saideman-it, politikanët tentojnë të bëhen më agresivë nëse pjesa më radikale e elektoratit kërcënon me tërheqje. Ndërsa, në rast se "pjesa më e butë e mbështetësve kërcënon që t'i braktisë politikanët, politika e jashtme bëhet më bashkëpunuese."¹⁴ Por pavarësisht diferencave të shumta të tyre, ajo çka bashkon Saideman-in me Gagnon-in është që se të dy fokusohen në rolin që shkaktohet e brendshme kanë luajtur në shkaktimin e irredentizmit serb, megjithëse Saideman-i gjithashtu vë re rëndësinë e faktorëve të jashtëm (por pa i elaboruar ato), të tilla si ndërhyrja nga të tretët.

¹¹ Shih për shembull, Jeffrey Herbst. "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa," *International Organization* 43 (4), 1989. f. 673-692

¹² Stephen M. Saideman. *The Ties That Divide: Ethnic Politics, Foreign Policy, and International Conflict*. New York: Columbia University Press, 2001. f.22-25

¹³ Saideman and Ayres, manuskript i pabotuar, f.3-4. Për një trajtim më të detajuar të konceptit të 'selektoratit' shih Bruce Bueno de Mesquita et al. *The Logic of Political Survival*. Cambridge, Mass.: MIT Press, 2003.

¹⁴ Saideman, "Inconsistent Irredentism," f.63.

Ndërsa e parë nga një qasje e jashtme, pra një analizë që mbithekson rolin e ndërkombëtarëve si decizivë në shpërbërjen e Jugosllavisë, autorë si Carment-i dhe Harvey-i kanë hedhur teza se ndërhyrja e ndërkombëtarëve ishte elementi kryesor që pati impaktin më të madh, duke tejkaluar dukshëm faktorët e brendshëm. Kur niveli i detyrimit nga jashtë rritej, duke u mbështetur nga kërcënime të besueshme nga ana e aktorëve ndërkombëtarë, dukej se Beogradi bëhej më pak mbështetës i politikave irredentiste dhe të paktën në ligjërimin publik, dukej se toni bëhej më i moderuar drejt minoriteteve serbe jashtë, argumentojnë dy autorët e sipërmendur. Ata gjithashtu vënë re se “që nga plasja e konfliktit në Bosnje, ka patur gjithnjë e më tepër mbështetje për të përdorur sulmet ajrore si një mjet negociues për t’i bindur serbët që të ulëshin në tavolinën negociuese.”¹⁵ Kjo do të thotë që komuniteti ndërkombëtar, ka vepruar në premisën që dikush mund ta trajtonte Serbinë vetëm duke folur gjuhën e forcës dhe kështu që të mbronte ndërmarrjen e sulmeve ajrore si të vetmen mënyrë që do t’i bënte serbët ta merrnin tavolinën e negociatave seriozisht dhe t’i detyronte ata të arrinin një marrëveshje për arritjen e paqes. Për më tepër, autorët theksojnë se nëse nuk do ishte për ndërhyrjen e NATO-s në Bosnje, “gjendja e ngrirë nuk do të mund të zhbloktohej dhe për pasojë, kompromisi i Dejtonit, nuk do arrihej.”¹⁶ Prandaj, ata konkludojnë se ndërhyrja nga të tretët është një nga kushtet kryesore që vendos limite në politikën e jashtme etnike të një shteti.

Carment-i dhe Harvey-i identifikojnë në mënyrë korrekte rolin që ndërhyrja ndërkombëtare luan në detyrimin e palëve ndërluftuese për t’u ulur në tavolinën e bisedimeve. Pa një kërcënim të besueshëm të mbështetur nga sanksione reale dhe që kulminoi me bombardimin e ushtrisë dhe forcave paramilitare serbe, është utopike të mendohet se serbët do binin dakord me një kompromis të ndërmjetësuar nga të tretët. Megjithatë, autorët nuk arrijnë të shpjegojnë sesi formulohen politikat irredentiste në fillim. Kush i motivon ato dhe si arrihet deri te politika e jashtme tejet agresive që mund të kulminojë në sulm të hapur nga një shtet drejt një shteti tjetër sovran? Po ashtu, këta autorë nuk shpjegojnë diferencat ndërmjet rasteve ku megjithë faktorët për të prodhuar irredentizëm kanë qenë prezent, por megjithatë edhe ndërhyrja e butë ndërkombëtare, e kombinuar me faktorët vendas, bëri të mundur një politikë të jashtme mëse të moderuar dhe që prodhoi stabilitet në gjithë rajonin, si rasti i Shqipërisë.

Ajo çka kjo ese argumenton është se irredentizmi serb nuk është as prodhim i një lideri apo grupi oligarik vendim-marrësish, ashtu sikundër nuk varet as nga ‘diktati’ i masave, nëpërmjet ‘detyrimit’ të klasës politike që të ndjekin një kurs të caktuar në politikën e jashtme, përndryshe i pret ndëshkimi i votës popullore. Përkundrazi, kjo ese synon të demonstroj rëndësinë që kanë disa *katalizatorë* shoqërorë të cilët shpesh ose janë nënçmuar në literaturën ekzistuese, ose nuk janë analizuar në mënyrë sintetike dhe në simbiozë me njëri-tjetrin. Duke u bazuar në rëndësinë e rolit të ideve, institucioneve dhe grupeve të interesit, efekti i të cilave më parë është studiuar në fushën e ekonomisë politike ndërkombëtare, si dhe në atë të marrëdhënieve ndërkombëtare, ky punim synon një qasje të ngjashme në fushën e studimit të politikës së jashtme, sidomos në lidhje me atë të politikave etnike. Është bindja e autorit që kjo qasje do ndihmojë në hulumtimin e mëtejshëm të një prej çështjeve mjaft të ‘rrahura’ në literaturën bashkëkohore, atë të shpërbërjes së Jugosllavisë, por kjo e parë tashmë nën një dritë tjetër dhe për më tepër, e krahasuar me fqinjën e saj jugor, Shqipërinë.

¹⁵ David Carment and Frank Harvey. Using Force to Prevent Ethnic Conflict [Përdorimi i forcës për të parandaluar konfliktin etnik]. London: Praeger, 2001.

¹⁶ Ibid

Kuadri teorik: Irredentizmi 'shoqërisht i informuar' dhe ndërhyrja e jashtme

Duke u bazuar kryesisht në teorinë e 'liberalizmit ndër-qeveritar' të Andriju Moravcik-ut (Andrew Moravcik's liberal intergovernmentalism),¹⁷ ky studim argumenton rolin që idetë nacionaliste, disa grupe interesi me ndikim në vendim-marrje dhe institucione të caktuara kanë apo ushtrojnë në nxitjen e variacioneve në irredentizmin në politikën e jashtme, si në kohë ashtu dhe në hapësirë. Roli i tyre varion prej të qënurit informues të politikave të veçanta shtetërore që arrihet me anë të formulimit ideologjik të linjës politike të partisë në pushtet, te influenca që ushtrohet mbi të gjithë klasën politike që tenton të shkojë drejt 'ethnic outbidding' në përpjekje për të marrë votat e elektoratit, deri të 'përkthimi' në një gjuhë të kuptueshme për elektoratin të politikave shtetërore që megjithëse mund të bëhen nisur nga qëllime thjesht instrumentale nga politikanë të caktuar, paraqiten si politika në mbrojtje të interesit kombëtar. Roli i Kishës Ortodokse në Serbi është domethënës vençarisht për të demonstruar pikën e fundit, duke patur parasysh statusin dhe kredibilitetin e saj në shoqërinë serbe. Ndërkohë ato shërbejnë edhe si *katalistë* në shndërrimin e pakënaqësisë popullore me gjendjen ekonomike për shembull, drejt politikave etnike. Këtu roli i tyre shihet si i pandarë nga njëri-tjetri, duke qenë se zakonisht idetë dhe institucionet shpesh ndihmojnë në krijimin e institucioneve apo duke ndjekur evoluimin nëpër të cilin idetë që kanë një vijimësi historike shpesh e gjejnë veten të institucionalizuara pas njëfarë kohe, ose institucionet thjesht formësohen nga idetë dhe interesat e grupeve të caktuara.¹⁸

Në politikën serbe, idetë nacionaliste që përbëjnë edhe thelbin e ideologjisë për një Serbi të Madhe përfshijnë *inter alia*, draftin e *Nacertanjes* të shekullit të 19-të,¹⁹ i propozuar për herë të parë nga ministri i Jashtëm i kohës, Ilija Garashanin, si dhe Memorandumit i 1987-s,²⁰ dalë nga Akademia e Arteve dhe Shkencave të Serbisë. Përsa i përket institucioneve, Akademia ishte një prej institucioneve kryesore të periudhës moderne që ka patur një influencë të konsiderueshme në politikën e Beogradit dhe që ka marrë përgjithësisht një pozicion më radikal në çështjet etnike sesa zyrtarët qeveritarë në pjesën më të madhe të kohës. Kisha Ortodokse ka qenë një

¹⁷ Këtu bazohem te prezumimet bazë të teorisë së Moravcik-ut. Premisa e parë ku ky autor bazohet vë theksin te roli i aktorëve shoqërorë në formësimin e politikës së jashtme të një shteti të caktuar: "aktorët kryesorë në marrëdhëniet ndërkombëtare janë individët apo grupet private, të cilët janë në përgjithësi racionalë dhe të gatshëm të ndërmarrin rreziqe dhe të cilët organizohen në një aksion kolektiv për të promovuar interesa të ndryshme nën kufizimet me të cilat ata ballafaqohen nga pamjaftueshmëria materiale, vlerat konfliktuale dhe variacionet në influencën shoqërore." Premisa e dytë e Moravcik-ut thotë se "shtetet (ose institucionet e tjera politike) përfaqësojnë disa nivele të caktuara të shoqërisë, dhe mbi bazën e tyre shpesh zyrtarët shtetërorë ndërtojnë politika dhe veprojnë në mënyra qëllimsore në politikën botërore." Ndërsa premisa e tretë ku Moravcik-u bazon teorinë e tij lexon: "Konfigurimi i preferencave të shteteve të ndërvarura nga njëri-tjetri, përcakton sjelljen e shteteve." Për më gjerë shih Moravcsik, f.517-520. Megjithatë për qëllimet e këtij punimi, ne mbështetemi vetëm në dy premisat e para, të cilat hapin 'kutinë e zezë' të shtetit dhe na ndihmojnë të shohim ndërveprimin e aktorëve shoqërorë dhe influencën e tyre në politikën e jashtme të një shteti.

¹⁸ Interesat këtu mund të shihen si të mbështjella në aktorët e ndryshëm shoqërorë të cilët ushtrojnë një influencë të caktuar në vendim-marrjen shtetërore.

¹⁹ Shih ndërmjet të tjerësh, Tim Judah. *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia* [Serbët: Historia, Miti dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë]. New Haven: Yale University Press, 1997, f.59; Misha Glenny. *The Fall Of Yugoslavia* [Rënia e Jugosllavisë]. London: Penguin Books: 1992; Paulin Kola. *The Myth of Greater Albania* [Miti i Shqipërisë së Madhe]. New York: New York University Press, 2003, f.11.

²⁰ Për një shikim më në detaje të Memorandumit dhe efektin e tij në axhendën politike serbe shih *inter alia*: Judah, 160; Stuart J. Kaufman. *Modern Hatreds: The Symbolic Politics of Ethnic War* [Urrejtje Moderne: Politikën Simbolike të Luftës Etnike]. Ithaca and London: Cornell University Press, 2001. p.179. Norman M. Naimark and Holly Case (eds.) *Yugoslavia and Its Historians: Understanding the Balkan Wars of the 1990s* [Jugosllavia dhe historianët e saj: Të kuptuarit e Luftërave Ballkanike të viteve 90-të]. Stanford: Stanford University Press, 2003. f.174-175; Carole Roger. *The Breakup of Yugoslavia and its Aftermath* [Shpërbërja e Jugosllavisë dhe historia që vijoi]. London: Greenwood Press, 2004. f.16-17

tjetër institucion i tillë që ka influencuar fuqishëm vendim-marrjen serbe duke e shtyrë atë shpesh drejt qëndrimeve nacionaliste ekstreme. Ndërsa përta iu përket grupeve të interesit në rastin serb, këtu i referohem grupeve të afërta me qendrat e pushtetit, megjithë mungesën e pjesëmarrjes aktive në politikë-bërje. Ajo çka nënkuptoj këtu është influenca që këto grupe kanë ushtruar në axhendat e politikave, pa qenë formalisht pjesë e strukturave apo mekanizmave qeverisës. Për qëllimet e këtij punimi, në këtë ese i referohem kryesisht dy grupeve të tilla: diasporës dhe Mafias apo grupeve të krimit të organizuar.

Kjo ese argumenton që janë dy mekanizma kryesorë me anë të të cilave institucionet, idetë nacionaliste dhe grupet e interesit prodhojnë irredentizmin. Mekanizmi i parë, i cili është dhe i brendshëm për shtetin, është roli i ndërtimit dhe influencimit të axhendave shtetërore që prodhojnë apo i japin drejtim kryesor politikës së jashtme të një shteti. Duke u bazuar në teorinë e 'liberalizmit ndër-qeveritar', këtu propozojmë se: aktorët shoqërorë (individë, lobe apo institucione të caktuara dhe të interesuara), influencojnë politikën shtetërore drejt bashkë-kombasve etnikë jashtë kufijve shtetërorë, duke ushtruar trysni të drejtëpërdrejtë ndaj lidershit apo klasës politike të vendit. Elitat politike si rrjedhojë, kanë pak zgjidhje përveçse të ndjekin dhe zbatojnë ato zotime që ata publikisht i kanë mbështetur (qoftë edhe vetëm për efekte elektorale), pasi dështimi për të ndjekur këtë kurs mund të rezultojë në një zhgënjim nga ana e zgjedhëzve të tyre, apo grupeve të interesit dhe institucioneve kyë që kanë pushtet të formësojnë opinionin publik. Bazuar në këtë logjikë, seti i parë i hipotezave mund të prezantohet si vijon:

Hipoteza 1a: Qeverisja e një shteti tenton të bëhet më irredentiste nëse idetë nacionaliste, institucione specifike dhe grupet e interesit që kanë kthyer artikullimin e qëllimeve nacionaliste në qëllimin kryesor të aktivitetit të tyre politik apo publik, kanë një ndikim direkt apo indirekt në vendim-marrje dhe janë të perceptuar si të pazëvendësueshëm në politikën elektorale të brendshme.

Hipoteza 1b: Një shtet tenton të bëhet më pak irredentist/shovinist nëse përgjithësisht këto ide nacionaliste, institucione apo grupe interesi që promovojnë shkaqe nacionaliste ose janë të dobëta, ose mungojnë.

Ndërsa mekanizmi tjetër shkakësor është i jashtëm për shtetin dhe ka të bëjë me shkallën e ndërhyrjes apo presionit ndërkombëtar në axhendën e një shteti; ky presion mund të jetë bashkëpunues (përdorimi i incentivave apo 'karrotave'), ose detyrues (përdorimi i forcës apo 'shkopinjve'), ose që i përfshin të dyja. Përdorimi eficient i këtyre dy formave të presionit përkthehet në një shtysë të fuqishme për elitën politike të një vendi për të ndryshuar kursin e politikës së tij të jashtme, e cila varet nga grada e përfitimeve apo kërcënimeve që vijnë nga ndërhyrësit. Kjo ese argumenton që ka ekzistuar një shkallë e konsiderueshme *detyrimi të butë*²¹ nga ana e ndërkombëtarëve, si në rastin serb, ashtu edhe në atë shqiptar. E vetmja diferencë kyçe ndërmjet këtyre vendeve është që ndërsa ndaj Serbisë ky lloj presioni i butë u përdor gjatë fazave fillestare të ndërhyrjes së saj në Bosnje dhe Kroaci por nuk dha rezultat, (ndërsa në rastin e Kosovës, ndërhyrja ndërkombëtare u përshkallëzua deri në bombardimin nga ana e NATO-s, pra u kthye në ndërhyrje mëse të fortë), në rastin e Shqipërisë, kjo ndërhyrje e butë, duket se ka funksionuar më së miri, ku qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare janë përkulur pa shumë mund para faktorit ndërkombëtar duke zbatuar porositë dhe rekomandimet e tij. Në këtë mënyrë, mund të arsyetojmë që shkalla e ndërhyrjes ndërkombëtare ka një rol të qenësishëm në

²¹ Ky lloj detyrimi mund të përkufizohet si një presion retorik tek i cili nuk gjejmë mekanizmat përforcues. Këto mekanizma mund të përshijnë sanksione ekonomike apo ushtarake, ose të paktën një kërcënim të besueshëm të përdorimit të tyre, nëse palët nuk mund të arrijnë në një pikë të përbashkët përgjatë kursit të negociatave mes vedi.

influencimin e politikës së jashtme në shtetet e Ballkanit Perëndimor, megjithëse kjo ndërhyrje ka luhatur nga njëri shtet në tjetrin dhe shkalla e reflektimit nga ana e këtyre shteteve po ashtu ka qenë e ndryshme. Bazuar në këtë premisë, arrijmë te seti i dytë i hipotezave:

Hipoteza 2a: Nëse politikanët përballohen me kërcënime të jashtme 'të dobëta' ose iu mungojnë shtysat e forta për të moderuar qëndrimin e tyre, ata do të jenë më lehtë të influencuar nga presionet e aktorëve të brendshëm shoqërorë dhe më të vëmendshëm ndaj kërkesave të tyre.

Hipoteza 2b: Nëse politikanët përballohen me kërcënime të besueshme ose shtysa të fuqishme për të moderuar sjelljen e tyre nga ana e faktorit ndërkombëtar, është më e mundshme që ata të tërhiqen nga politikat e jashtme ekstreme, me bazë irredentiste dhe të përqafojnë qëndrime të moderuara në politikën e jashtme, megjithëse këto politika mund të reflektojnë pozicionimet e grupeve të interesit dhe institucioneve të fuqishme brenda vendit.

Irredentizmi serb në politikën e jashtme

Në rastin e Serbisë, roli i ideve ka qenë kryesisht i lidhur me variacionet e idesë së Nacertanijes që ka përbërë gjithmonë një karakteristikë të politikave të identitetit serb, duke filluar që nga mbretërimi i Stefan Mugoshës. Sikundër shkruan Tim Judah: “në pragun e shkatërrimit të lënë pas nga nacionalizmi bashkëkohor serb, Nacertanija është një gur themelor në kuptimin e zhvillimit të idesë nacionaliste. Është dokumenti që sintetizon shekuj të ëndrrave serbe të ruajtura nga kisha dhe poemat epike dhe të formuluar në formën e një nacionalizmi modern.”²²

Në kohëra më të afërta, ide të njëjta me Nacertanijen arritën të artikuloreshin nga fundi i viteve '80-të, kryesisht nga intelektualë të margjinalizuar, si Dobrica Cosic dhe kulminuan me përmbledhjen e tyre në Memorandumin famëkeq të 1986-s, i cili shërbeu si metodikë e politikanëve nacionalistë dhe ekstremistë në vitet në vijim. Memorandumi, drafti i të cilit ju prezantua qeverisë serbe fillimisht në 1985-n dhe arriti të zbulohej nga mediat në 1986-n, bëri të mundur zhvendosjen ideologjike nga komunizmi jugosllav drejt nacionalizmit serb.²³ Memorandumi argumentonte që Serbët kanë qenë të viktimizuar gjatë historisë së tyre dhe kjo është kthyer në refrenin politik të ditës që atëherë. Ndërmjet të tjerash, Memorandumi theksonte që “ka patur një konspiraci anti-Serbe që ka shkaktuar gjenocid të popullsisë serbe në Kosovë,” dhe që “me përjashtim të periudhës së ekzistencës së regjimit të Ustashas në Kroaci, Serbët e Kroacisë nuk janë ndjerë asnjëherë më të kërcënuar sesa ata janë tani.”²⁴ Çfarë e bëri Memorandumin të besueshëm në sytë e publikut serb ishte “fakti që Akademia e respektuar bënte akuza të tilla..”²⁵ duke i dhënë kësaj legjitimitet automatik. Një nga figurat që shërbeu si burim inspirimi për përgatitjen e Memorandumit, duke marrë në të njëjtën kohë pjesë aktive

²² Tim Judah. *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia*. New Haven: Yale University Press, 1997. p.59

²³ Robert Stallaerts, “The Disintegration of the Yugoslav Intellectual Community,” in *Secession, History and the Social Sciences*. Bruno Coppetiers and Michel Huysseune eds., Brussels: VUB Brussels University Press, 2002. Retrieved from: poli.vub.ac.be/publi/orderbooks/secession/secession-05.pdf

²⁴ Stuart J. Kaufman. *Modern Hatreds: The Symbolic Politics of Ethnic War*. Ithaca and London: Cornell University Press, 2001. p.179

²⁵ Ibid

në të, ishte Vasa Cubrilovic, një nga nacionalistët më të vjetër dhe këmbëngulës serbë.²⁶ Cubrilovic, një “konspirator i hershëm i vrasjes së Arkdukës Franc Ferdinand në 1914., ridoli [në skenë] si një këshilltar i qeverisë mbretërore jugosllave. Nga ky pozicion, ai shkruajti memorandumun zyrtar të 1937-s, ‘Përjashtimi i Shqiptarëve,’ i cili citonte sukseset e Hitlerit dhe Stalinit në përndjekjen e çifutëve dhe të tjerëve si një shembull të denjë për t’u ndjekur nga serbët.”²⁷ Cubrilovici pati disa funksione të rëndësishme qeveritare gjatë qeverisjes së Titos, çka tregon një fleksibilitet të lartë të regjimit komunist të Titos.

Krahas Cubriloviçit, një antar tjetër i famshëm i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Serbisë, sikundër edhe disident i vonë i rregjimit të Titos,²⁸ ishte Dobrisa Cosic, i cili në vitet 1960-të ishte ndër të parët që artikuloi vuajtjen shekullore të serbëve dhe se “Serbët po shfrytëzoheshin dhe denigroheshin nga kombësitë e tjera jugosllave.”²⁹ Duke qenë se Cosic, sidomos nën ndikimin e miqve të vetë, Mihiz dhe Popoviç,³⁰ arriti të besonte se regjimi titoist ishte i predispozuar dhe në thelb diskriminues kundër serbëve, Cosic “iu kthye theksimit për nevojshmërinë e bashkimit të kulturës serbe me kombin serb.”³¹ Në këtë kontekst, ai ju bëri thirrje serbëve “të ngriheshin dhe shkatërronin shtetin shumë-kombësh jugosllav për të përmbushur qëllimin e vjetër historik dhe idealin kombëtar.”³² Çfarë është vençarisht e habitshme në këtë lloj retorike, është fakti se megjithëse Serbët kanë qenë të përfaqësuar në mënyrë jo proporcionale në pozitë më të larta të pushtetit në Jugosllavinë federative, pra kanë patur më shumë vende në krahasim me numrin e popullsisë nga kombet e tjera, përsëri intelektualë si Cubrilovici dhe Cosic ankoheshin për diskriminim të padrejtë në dëm të serbëve. Por akoma më i çuditshëm është fakti se ata nuk u dënuan as me burgim, as me persekutim, megjithë dallimet e thella me thelbin internacionalist të Marksizmit të kohës.³³ Pra, thelbi i diskurit nacionalist, sidomos në qarqet intelektuale, i ka fillesat e tij që gjatë kohës së Titos, por për shkak të mungesës së mediatizimit dhe monopolit të informacionit nga regjimi komunist, mundësia për të përhapur idetë e tyre nacionaliste dhe influencuar opinionin publik, ka qenë e limituar. Gjithçka ndryshoi me vdekjen e Titos dhe me fillimin e një liberalizimi të mëtejshëm si rrjedhojë e paqëndrueshmërisë relative të një lidërshipi të fortë në krye të federatës jugosllave.

Memorandumi ishte sidomos i rëndësishëm në krijimin e një programi politik që projektonte “një Jugosllavi të dominuar nga Serbët që do përfshinte Serbinë, Malin e Zi, pjesën më të madhe të Bosnje-Hercegovinës, rajonet me popullsi serbe të Kroacisë, por do përjashtonte

²⁶ Philip J. Cohen, “The Complicity of Serbian Intellectuals,” in *This Time We Knew*, in Thomas Cushman and Stepan G. Mestrovic (eds), New York: New York University Press, 1996. pp.39-40

²⁷ Ibid

²⁸ Kjo për arsye se në fazën e parë të këtij regjimi, Cosic gëzonte gjithë privilegjet e mundshme të një komunisti të devotshëm. Madje edhe kur u kthye në disident, ndryshe nga fati i shumë kolegëve të tjerë, të cilët minimalisht provuan burgun apo internimin, Cosic nuk i hyri gjemb në këmbë.

²⁹ E cituar te Sabrina P. Ramet. *Balkan Babel*. Cambridge: Westview Press, 2002. p.19

³⁰ Cosic, Popovic dhe Mihiz qenë ndër disidentët e parë nacionalistë që dolën kundër politikave federaliste të Titos me tezën e diskriminimit serb nën këtë sistem. Për më tepër ata argumentuan se serbët ishin diskriminuar historikisht dhe janë humbësit e mëdhenj nga ngjarjet historike në Ballkan. Çka i bën paradoksale thëniet e tyre, është se ndërsa Popovic dhe Mihiz vërtetë besonin në këto ide dhe kanë qenë të marginalizuar që në fillim prej regjimit të Titos, Cosic ishte një nga figurat udhëheqëse komuniste të kohës dhe ka gëzuar përkrahjen e Titos deri vonë. Për më tepër shih: Nicolas J. Miller, “The Nonconformists: Dobrica Cosic and Mica Popovic Envision Serbia,” *Slavic Review*, Vol. 58, No. 3. (Autumn, 1999), pp. 515-536. p.516, si dhe Nick Miller. *The Nonconformists: Culture, Politics, and Nationalism in a Serbian Intellectual Circle, 1944-1991*. Budapest: Central European University, 2007.

³¹ Thomas A. Emmert, “A Crisis of Identity,” in Norman M. Naimark and Holly Case (eds.) *Yugoslavia and Its Historians: Understanding the Balkan Wars of the 1990s*. Stanford: Stanford University Press, 2003. p.174

³² Cituar te Cohen, 40.

³³ Kjo në fakt qe një anomali dhe jo rregull i përgjithshëm në Jugosllavinë e Titos. Mjafton të përmendim Gutmanin, kur ai shkruan se “edhe posedimi i një fjalori Kroat në vend të një Serbo-Kroat” ishte shkak i mjaftueshëm për burgim në Jugosllavi. Shih për më gjerë Roy Gutman, “Serb Author Lit Balkan Powder Keg,” *Newsday*, June 28, 1992, 1.

Maqedoninë, Slloveninë, pjesën më të madhe të Kroacisë dhe gjithashtu do i ofronte një pjesë të Bosnjes, Kroacisë si kompesim.”³⁴ Pra, Memorandumi famëkeq krijoi një klimë të re politike, që filloi të influenconte vendim-marrjen politike të Beogradit zyrtar. Mbi të gjitha, i serviri një axhendë të bërë gati Milosheviçit, i cili bazoi retorikën e tij politike dhe karrierën e mëpasshme pikërisht në idetë e elaboruara fillimisht në këtë dokument. Memorandumi arriti të krijoj “një rol që pret një lider, një program që pret një ekzekutor,” dhe pothuajse një vit më vonë, Milosheviçi do arrinte të vinte në pushtet nëpërmjet këtij programi paraprak që atij ju servir gati. Ai arriti të shmangte nga drejtimi i partisë, protektorin e vetë që nga koha kur kishte qenë një sekretar i thjeshtë rinie, Ivan Stamboliçin duke përdorur kartën e politikës etnike,³⁵ dhe fitoi me anë të një votimi të papritur dhe thuajse spektakolar drejtimin e partisë dhe shumë shpejt edhe të qeverisë.

Ndërkohë, sjellja e elitave serbe dhe segmenteve të ndryshëm të shoqërisë ishin duke u rritur në mënyrë përpjestimore në mbështetje të politikave irredentiste serbe, në mbrojtje të bashkë-kombasve të tyre, jashtë kufijve zyrtarë, duke i dhënë Milosheviçit një dritë jeshile për të ndjekur një politikë të jashtme edhe më agresive. Një shembull që ilustron veprimtarinë dhe qëllimet e një institucioni tjetër me peshë—krahas Akademisë që u përmend më sipër—është ai i Kishës Ortodokse Serbe. Në të njëjtën datë, 28 Qershor 1989, tre ndodhi të shkëputura, por njëkohësisht (të paktën në pamje) dukshëm të koordinuara, lënë vend për një dyshim të bazuar në lidhje me rolin që ka luajtur ky institucion në nxitjen e irredentizmit serb. Ndodhia e parë ishte festa përkujtimore e 600 vjetorit të humbjes së serbëve në fushë-Kosovë në luftë me ushtrinë osmane. Në këtë datë, Milosheviçi deklaroi para simpatizantëve serbë të Kosovës se “serbët gjatë historisë së tyre asnjëherë nuk kanë pushtuar apo shfrytëzuar të tjerët.”³⁶ Po në të njëjtën ditë, serbët e Krajinës kërkuan “një krahinë autonome..., me nxitjen e qeverisë serbe.”³⁷ Në të njëjtën ditë, Kisha Ortodokse Serbe:

Lëshoi programin e saj zyrtar, i cili ishte një eko e Memorandumit të 1986-ës të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, sikundër edhe i dokumentave zyrtarë të partisë komuniste dhe aparatit shtetëror jugosllav. Ky manifesto, i njohur si “Propozim i Programit Kombëtar Serb,” i thurte lavde vendimit të Serbisë që në mënyrë të njëanshme të përfundonte autonominë e Vojvodinës dhe Kosovës. Duke ritheksuar temën qëndrore të memorandumit të Akademisë, dokumenti i Kishës portretizoi një Serbi të nënshtruar dhe përgëzonte Slobodan Milosheviçin që filloi të korrigjonte padrejtësitë historike ndaj serbëve.³⁸

Megjithëse mund të duket spekulante, është e pamundur që të tre këto ngjarje apo deklaratat, në dukje të palidhura, por që u bënë publike në të njëjtën ditë, mos të jenë sinkronizuar më parë. Konvergjenca e tyre duket se ka qenë një përpjekje e sinkronizuar nga strata të ndryshme shoqërore për të kanalizuar pakënaqësitë popullore drejt politikave agresive në drejtim të ‘çështjes kombëtare’. Liderë politikë, si Milosheviçi në mënyrë diabolike më pas i instrumentalizuan në favor të tyre këto ide dhe i kthyen në program zyrtar të qeverisjes së tyre.

³⁴ Saideman, forthcoming. P.56

³⁵ Horowitz e quan këtë proces ‘ethnic outbidding’, pra mundja e kundërshtarit politik duke përdorur më fortë kartën etnike.

³⁶ Cohen, 41

³⁷ Ibid

³⁸ Ibid

Roli i Kishës Ortodokse në fillim-vitet '90-të ishte qendror. Pavarësisht tonit nacionalist që Kisha ka artikuluar herë pas here gjatë historisë së saj, më tepër është përpjekur të demonizojë Perëndimin,³⁹ sesa të artikuloj fortë në sferën publike ide që çojnë drejt irredentizmit. Për më tepër, dekada të gjata nën komunizmin, ndihmuan në krijimin e një klime anti-klerikale që e neutralizuan pothuajse rolin e Kishës. Kisha Ortodokse gjatë komunizmit ishte në përpjekje për mbijetesë dhe as që mund të mendoj të influenconte vendim-marrje zyrtare. Por në fillim të viteve '90-të, kur serbët, “të udhëhequr nga një Kishë Ortodokse Serbe e vëmendshme dhe intelektualët e saj, u nxitën që në vend që të vazhdonin të ndiqnin ‘traditën romano-perëndimore’ drejt asaj epike me epiqendër Kosovën.”⁴⁰ Sikundër Thomas Emmert nënvizon:

Duke përdorur krizën në Kosovë si një temë për rigjenerimin e saj si një forcë efektive në shoqërinë serbe, Kisha prezantoi vetveten si një mbrojtëse e serbëve të Kosovës, duke rivizituar ‘martirizimin’ e Serbëve në Luftën e Dytë Botërore dhe së fundmi ndihmoi në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe krijimin e Serbisë së Madhe.⁴¹

E parë në këtë dritë, Kisha duket të ketë krijuar një ‘strukturë diskursi oportune,’⁴² që e ndihmoi atë të transferonte debatin nga çështjet ekonomike drejt atyre etnike. Fokusi kryesor i Kishës, filloi të bëhej një “ri-interpretim i historisë së Serbisë në terma të vuajtjes, eksploitimit, dhimbjes dhe drejtësisë.”⁴³ Pra Kisha, nëpërmjet ‘diversionit ideologjik’ bëri të mundur ri-katapultimin e saj si një influencë me peshë në shoqërinë serbe dhe njëkohësisht pa irredentizmin si mjetin më efektiv për stabilitetin e brendshëm.⁴⁴ Interesat e grupeve të ndryshme në shoqërinë serbe janë të dukshme në influencimin e një politike të jashtme irredentiste. Interesat mund të lidhen ngushtë me ide dhe institucione që influencojnë politika nacionaliste dhe irredentiste.

Për shembull, në 1987-n, memorandumimi u qarkullua në mbarë botën në komunitete emigrantësh serbë. Ai mobilizoi mbështetjen e tyre për qëllime nacionaliste e territoriale serbe, të cilat u justifikuan me pretendimet e viktimizimit serb në Jugosllavi, pa përmendur këtu vuajtjet e kombeve të tjerë nën diktatin serb. Në terma praktikë, memorandumimi ndihmoi në standartizimin e retorikës nga e cila emigrimi serb do të mbronte Serbinë në rastin më të parë të fillimit të luftës.⁴⁵

³⁹ Branimir Anzulovic. *Heavenly Serbia: From Myth to Genocide*. New York: New York University Press, 1999. pp.125-126

⁴⁰ Emmert, 173

⁴¹ Ibid

⁴² Erin K. Jenne e ka përkufizuar këtë shprehje si “struktura që kanë vazhdimësi, përputhshmëri dhe janë të adaptueshme ndaj një sërë ambjentesh, dhe që informojnë jo vetëm format legjitime të organizimit politik, por gjithashtu mjetet me të cilat këta ‘aktorë’ mund të ndjekin ‘qëllimet’ e tyre.” Shih për më tepër: Erin K. Jenne. *Ethnic bargaining: the paradox of minority empowerment*. Ithaca: Cornell University Press, 2007. Kuptimi që merr kjo lloj strukture në kontekstin e kësaj eseje është në fakt disi i ndryshëm. Përdorimi i tij këtu bëhet për t’ju referuar krijimit të një strukture totalisht të re që krijon mundësi për institucione të tilla si Kisha Ortodokse, për të kapur momentin dhe dhënë formë apo trajtë ligjërimit politik, sidomos në lidhje me irredentizmin, i cili na intereson vençarisht këtu. Politikanët rrjedhimisht janë në njëfarë mënyre të ‘detyruar’ që të veprojnë në përputhje me këtë ligjërim shoqëror të ri dhe ta adaptojnë atë për t’iu shërbyer interesave të tyre elektorale.

⁴³ Sabrina Ramet, “the Serbian Church and the Serbian Nation,” in *Beyond Yugoslavia: Politics, Economics, and Culture in a Shattered Community*. Boulder: Westview Press, 1995. p.103

⁴⁴ Ndërmjet disa hapave konkretë që Kisha ndërmori gjatë kësaj periudhe vlen të përmendet dhënia e medaljes ‘Majka Jugovica’ të cilësdo mamaje serbe që lindte katër apo më shumë fëmijë në Kosovë. Shih për më gjerë: Mark Almond. *Europe’s Backyard War*. London: Mandarin Paperbacks, 1994. p. 198

⁴⁵ Cohen, 39

Theksoj se ekzistonin disa grupe te caktuara të mbyllura (angl. "cluster groups,")⁴⁶ në brendësi të shoqërisë serbe të cilat tentuan të parashtronë interesat e tyre si të pandara nga ato të shtetit serb. Per shkak të këtij artikulli, veçoj dy grupime të tilla: diaspora dhe grupet e mafies.⁴⁷ Këto grupe prodhuan një mbështetje kritike ndaj elitave të caktuara politike dhe përgjithësisht shtynë radikalët në politika të jashtme të tilla. Diaspora serbe në fillim u tregua e përmbajtur, por në kontekstin e agresionit në Bosnje dhe Kroaci, u rigjallërua shpejt, vençanërisht në SHBA.⁴⁸ Brad K. Blitz jep një portret të gjallë dhe shumëngjyrësh të diasporës serbe dhe influencës së saj gjatë krijimit të lobingjeve. Edhe pse para agresionit serb në Jugosllavi ajo kishte një traditë të vakët në organizimet politike, diaspora serbe u organizua shpejt përreth lidershit të senatorit Helen Delich Bentley.⁴⁹ Blitz vizaton një paralelizëm ndërmjet radikalizmit të gjuhës së diasporës në njërën anë dhe rritjes së vullshme të irredentizmit serb nga ana tjetër.

Ultranacionalizmi dhe ksenofobia e liderëve serbë në Pale (Bosnje) dhe Beograd u eksportua në SHBA nëpërmjet dy mbartësve kryesorë: të parët ishin politikanët dhe emisarët që udhëtonin në Amerikën veriore dhe ish-Jugosllavinë. E dyta ishte kisha ortodokse serbe. Në fakt, diaspora serbe u mobilizua në komunitete të ngjashme dhe struktura institucionale të cilat kishin mobilizuar publikun serb pas axhendës nacionaliste të Millosheviçit.⁵⁰

Një element tjetër i rëndësishëm ishte rirforcimi i rolit të institucioneve ekzistuese si kisha ortodokse mbi diasporën, duke bekuar aktivitetet e tyre dhe duke legjitimuar regjimin nacionalist të Millosheviçit. Kështu, "kisha ortodokse serbe dhe politika e saj në ish-Jugosllavi dhe në diasporë u gjendën të bashkuara."⁵¹ Krimi dhe sigurimi shtetëror shpesh herë ishin të lidhur gjatë periudhës së 'regjimit të terrorit' millosheviçian dhe ishte e vështirë t'i dalloje dhe t'i ndaje nga njëri tjetri." Banda e famshme e Zemunit besohet të ketë qenë pas vrasjes së kryeministrit Zoran Xhinxhiç, kur ai u përpoq të thyente pushtetin e tyre.⁵² Ky klan kriminal "përfshin shumë paramilitarë të cilët luftuan për ultranacionalistin Millosheviç në luftat e Ballkanit, në Kroaci, në Bosnje e Kosove."⁵³ Atyre ju dha "një dorë e lirë në trafikimin e drogës nga Millosheviçi. Krimet dhe aktivitetet e tyre të paligjshme përfshijnë: rrëmbime, vrasje, kontrabandë cigaresh armësh dhe njerëzish."⁵⁴ Ata influencuan në masë politikën e Beogradit, duke angazhuar anëtarë të njohur të tyre në poste qeveritare si Arkan apo Legija, të cilët ishin pjesë e qeverisjes, por ndërkohë punonin dhe për interesat e tyre. Me pak fjalë, pushteti i këtyre grupeve kriminale ishte i konsiderueshëm dhe ata ndiqnin lirisht interesat e tyre nën krahun e ngrohtë të shtetit. Ndodhi që interesat e tyre për të rritur fitimet prej veprimtarive ilegjitime i

⁴⁶ Me këtë nënkuptoj grupime njerëzish që kishin interesa të përbashkëta dhe të lidhura me pushtetin, duke patur njëkohësisht dhe një modus operandi që i dallonte nga pjesa tjetër e shoqërisë.

⁴⁷ Grupet e mafias ishin shpesh ose pjesë integrale e pushtetit në Beograd (ku shpesh figurat qendrore të krimit të organizuar serb, si punë të parë mund të kishin atë të punonjësit të sigurimit), ose kishin themeluar njëkohësisht lëvizje paramilitare dhe ndiqnin paralelisht edhe një jetë politike aktive. Rastet e famëkeqit Arkan, të ashtuquajturit 'Legija' apo Vojislav Sheshelit janë vetëm disa prej këtyre figurave.

⁴⁸ Kjo sipas mendimit tim, ndodhi edhe për shkak të lehtësive që ofron sistemi amerikan në drejtim të lobimit nga grupe të mirëorganizuara interesi.

⁴⁹ Kjo senatore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në atë kohë, ishte njëkohësisht dhe liderja kryesore e diasporës serbe në SH.B.A. See for more, Brad K. Blitz. "Serbia's War Lobby," in *This Time We Knew*, in Thomas Cushman and Stepjan G. Mestrovic (eds), New York: New York University Press, 1996. p.196

⁵⁰ Ibid

⁵¹ Blitz, 202

⁵² Për më gjerë shih John Philips, "In Serbia, prime minister's slaying triggers mafia roundup," *The Christian Science Monitor*, March 25, 2003. <<http://www.csmonitor.com/2003/0325/p07s02-woeu.html>> (accessed April 3, 2007).

⁵³ Ibid

⁵⁴ Ibid

shkonin për shtat Millosheviçit dhe elitave drejtuese, kështuqë shpejt liderë të bandave kriminale si Arkan dhe Vojislav Sesejl u gjendën në pozita dominuese pushteti. Gjithsesi, lidhjet midis tyre nuk kanë qenë asnjëherë në vijë të drejtë, lineare. Millosheviçi i përndoqi dhe i denoncoi vetëm atëherë kur krimet dhe masakrat e tyre u bënë tepër të dukshme dhe e vunë atë në pozitë të vështirë, sidomos para faktorit ndërkombëtar.⁵⁵

Por, kur Millosheviçi i frikësuar prej konsolidimit të këtyre grupeve të krimit, të cilët në njëfarë mënyre e kufizonin pushtetin e tij duke u ligjëruar, vendosi t'i jepte fund influencës së tyre duke i intimiduar, ata e kthyen besnikërinë e tyre kundrejt opozitës duke i dhënë asaj një mbështetje kritike.⁵⁶ Kur opozita erdhi në pushtet në 2000-shin dhe u mundua t'u përgjigjej kërkesave të perëndimit për dorëzimin e kriminelëve të luftës si dhe fillimin e luftës kundër krimit të organizuar, këta ish-oficerë ushtarakë të shndërruar në lordë krimesh rezistuan egërsisht aksionet e qeverisë, duke kërcënuar, frikësuar dhe madje duke vlarë figura të njohura politike si kryeministri serb Zoran Xhinxhiç. Gjithsesi, qeveria pasuese u mundua të merrte masa vendimtare kundër këtyre "lobeve të mundshëm të luftës,"⁵⁷ të cilët dikur konsideroheshin si aleatët kryesorë të Millosheviçit dhe që në 12 mars vranë Xhinxhiçin në një përpjekje të dëshpëruar për të shkatërruar demokatin e vendit dhe politikën e bashkëpunimit me gjykatën e krimeve për ish-Jugosllavinë në Hagë. Fundi i influencës direkte të këtyre grupeve të interesit ka konciduar jo çuditërisht edhe me fundin e politikës irredentiste të Serbisë.

Ndërrhyrja e Jashtme: 'Shkopinj apo Karrota'?

Ndërrhyrja e jashtme mund të ketë një impakt direkt apo indirekt në politikën e jashtme të një shteti, duke u varur në kohën, interesat apo këmbënguljen e palës së tretë të përfshirë. Dy nga mjetet më të rëndomtë që përdorin shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, janë mekanizmat bashkëpunues apo shtrëngues për të influencuar politika të caktuara. Carment dhe Harvey vënë theksin mbi 'diplomacinë shtrënguese', e cila përfshin instrumenta diplomatikë, politikë dhe militarë.⁵⁸ Përpara se të vazhdojmë më tej, vlen të ndalemi këtu te dallimi midis sanksioneve ekonomike dhe militare, ku sipas Clifto Morgan-it: "sanksionet ekonomike i japin një avantazh negociator sanksionuesit duke e udhëhequr rezultatin final drejt një përfundimi të kënaqshëm, pa qenë nevoja për të përdorur forcë."⁵⁹ Gjithsesi, rasti serb nuk ndjek këtë logjikë, pasi sanksionet ekonomike, sidomos ato të Kombeve të Bashkuara, nuk ishin të mjaftueshme për të ndalur Millosheviçin dhe bashkëpunorët e tij, të tipit Karaxhiç dhe Milladiç në Bosnje dhe Kroaci. Nëse diskutojmë sjelljen e komunitetit ndërkombëtar në luftërat irredentiste serbe në Krajinë apo Bosnje, duke theksuar se shtrëngesa e imponuar nga serbët ka qenë shumë më e butë nga ç'pritej, prandaj edhe efektivshmëria që më e vogël. Vetëm në 1995-n, arriti NATO-ja të bombardojë fortifikimet paramilitare serbe në Bosnje dhe siç dihet në 1999-n në Kosovë, çka shënoi dhe fundin e agresionit serb në këtë të fundit.

Në fakt ka patur tre ndërrhyrje sinjifikative ndaj Beogradit nga ana e komunitetit ndërkombëtar gjatë viteve '90-të. Njëra ka qenë e Bashkimit Evropian, sidomos e nxitur nga interesat e forta të Gjermanisë në rajon, çka rezultoi në njohjen e hershme të Sllovenisë dhe

⁵⁵ Për një argument të ngjashëm shih gjithashtu Kaufman, 192

⁵⁶ Shih ndërmjet të tjerësh, Gagnon, 130; Dragan Bujosevic and Ivan Radonavic. *The Fall of Milosevic: The October 5th Revolution*. New York: PALGRAVE MACMILLAN, 2003. pp.27-30

⁵⁷ Bojan Dimitrijevic and Daniel Sunter, "Serbia: Red Berets Disbanded," *International War and Peace Reporting Balkans Crisis Report*, March 27, 2003. http://www.iwpr.net/index.pl?archive/bcr3/bcr3_200303_418_2_eng.txt (aksesuar April 4, 2007).

⁵⁸ Carment and Harvey, 25

⁵⁹ T. Clifton Morgan and Valerie L. Schwebach. "Fools Suffer Gladly: The Use of Economic Sanctions in International Crises," *International Studies Quarterly*, Vol.41, No.1. (March., 1997). P.30

Kroacisë si shtete sovrane nga ana e BE-së. Një tjetër ndërhyrje ka qenë ajo e rusëve, e cila ka qenë konstante dhe vazhdimisht pro-serbe, por edhe mjaft e rëndësishme, po të kemi parasysh peshën e Rusisë në forumet ndërkombëtare. Së treti, kemi ndërhyrjen e Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s, nën lidhshpimin e Shteteve të Bashkuara për t'u dhënë fund këtyre konflikteve të nxituara prej Serbisë, me anë të mjeteve të ndryshme.

Konflikti jugosllav filloi të fitonte rëndësi në sytë e ndërkombëtarëve vetëm në 1991-shin, pasi Milosheviçi radikalizoi retorikën e tij politike në “përdorimin [prej tij] të identiteteve etnike për të fituar dhe mbajtur pozicionin e tij.”⁶⁰ Së pari, politika evropiane ishte bazuar në afrimin e incentivave për bashkëpunim Jugosllavisë nëse federata do respektonte disa kushte bazë si: “demokracia, reformat e tregut të lirë, të drejtat e njeriut dhe uniteti.”⁶¹ Në këmbim, Komuniteti Evropian premtoi benefice ekonomike dhe gjithashtu një premtim për një ‘asosacion më të ngushtë’.⁶² Megjithëse në dukje ky premtim ishte i mjaftueshëm për të bindur Jugosllavinë për të ndenjur e bashkuar, momenti që i tejkaluar, pasi tashmë nuk që më në përputhje me realitetin që po çonte drejt shpërbërjes graduale të Jugosllavisë, si pasojë e përqendrimit gjithnjë e më të madh të pushtetit në duart e serbëve.

Retorika e Milosheviçit për një pushtet gjithnjë e më të centralizuar në Beograd dhe predominimi i serbëve në administratë, frikësoi me të drejtë republikat e tjera dhe sidomos Slloveninë dhe Kroacinë që qenë të parat që u shkëputën. Duke qenë se në rrugën e tyre drejt pavarësisë ato u mbështetën fort nga Bashkimi Evropian në përgjithësi dhe Gjermania në veçanti, kjo e fundit u pa sidomos me dyshim nga serbët, pasi edhe historikisht janë parë si më protektorë nga sllovenëve dhe kroatëve katolikë sesa ortodoksëve serbë.⁶³ Shtetet e Bashkuara ndërkohë, kanë mbajtur një qëndrim ambivalent, duke mbështetur fillimisht mbajtjen e një sistemi federal dhe duke u spostuar me kalimin e kohës drejt një dënimi vokal të serbëve dhe mbështetjeje për republikat e reja të pavarura. Në udhëtimin e tij të vitit 1991 në Jugosllavi, James Baker-i, Sekretari i atëhershëm i Shtetit në SH.B.A., e bëri të qartë që “Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të njohin dhe mbështesin integritetin territorial të Jugosllavisë.”⁶⁴

Edhe kur SH.B.A-ja hapur dënoi krimet serbe, të kyera kryesisht nga paramilitarë dhe mbështetjen e hapur të qeverisë serbe për to, akoma ishte e pavendosur për të dërguar trupa në terren, çka bëri Britaninë e Madhe dhe Francën jo vetëm kritike ndaj politikës amerikane, por i nxiti njëkohësisht edhe ato të tërhiqnin trupat e tyre prej konfliktit.⁶⁵ Për më tepër, NATO-ja e bëri të qartë që nuk do ndërhynte në asnjë mënyrë në “asnjë luftë civile jugosllave.”⁶⁶ Dështimi i Perëndimit për të vepruar si një mekanizëm i vetëm kapet mirë nga Jean Baudrillard-i kur ai shkruan se: “paaftësia e Perëndimit për t’iu përgjigjur militarisht agresionit serb është e barabartë me paaftësinë për të rrezikuar jetën e një ushtari të vetëm.”⁶⁷ Ndërsa OKB-ja, e cila ishte e përkushtuar për të garantuar siguri për njerëzit, akoma operonte në terma që vërtiteshin rreth prezervimit të shteteve aktualë, çka do të thoshte që për të arritur sigurimin e njerëzve do të thoshte “të shpëtoje shtete të dështuara.”⁶⁸

Pozicioni rus kundrejt serbëve që kishin nën mbrojtje ishte fillimisht mëdyshës,

⁶⁰ Saideman, “Explaining the International Relations...,” 741.

⁶¹ Kaufman, 195

⁶² Ibid

⁶³ Stephen M. Saideman. *The Ties That Divide: Ethnic Politics, Foreign Policy & International Conflict*. New York: Columbia University Press, 2001. pp. 122-123.

⁶⁴ Almond, 49

⁶⁵ Për më tepër në lidhje me këtë pikë, shih Ramet, 214.

⁶⁶ Almond, 48

⁶⁷ Jean Baudrillard. “When the West Stands In for the Dead,” in *This Time We Knew: Western Responses to Genocide in Bosnia*, Thomas Cushman and Stepjan G. Mestrovic (eds.), New York: New York University Press, 1996. p.87

⁶⁸ Për një diskutim më të gjerë, shih Gerald Halman and Steven Ratner, “Saving Failed States,” *Foreign Policy* 89 (winter 1992-93): 3-20.

vençanërisht në lidhje me luftën në Bosnjë. Në rastin kroat ata në fakt u treguan kritik kundrejt serbëve. Politika e jashtme ruse në këtë periudhë ishte thellësisht e ndarë midis “dëshirës për të rforcuar marrëdhëniet fitimprurëse me perëndimin dhe tërheqjes së vjetër ndaj serbëve.”⁶⁹ Në këtë kontekst, mund të interpretohet mbështetja ruse për vendosjen e sanksioneve ekonomike ndaj Serbisë në '92-shin dhe “rezolutës sipas së cilës Rusia do të përdorte veton në Këshillin e Sigurimit për të bllokuar çdo propozim të Kombeve të Bashkuara për një sulm militar ndaj serbëve të Bosnjes.”⁷⁰ Mëdyshja e perëndimit në imponimin e sanksioneve, dhe përdorimi i një politike shtrënguese në fillimet e luftës, ndikuan në fakt te Millosheviçi për të injoruar fare kërkesat e perëndimit duke ju kthyer tërësisht politikave të brendshme, duke u bërë kështu më i ndjeshëm ndaj influencave të brendshme. Për më tepër, mungesa e shtrëngimit nga ana e Perëndimit dhe mbështetja materiale nga përkatësit tradicionalë si Rusia⁷¹ e bindën Millosheviçin që të vazhdonte axhendën e tij irredentiste. Bogdan Denitch-i thekson se: “vetëm protestat nuk do të mundin kurrë të ndalonin represionin serb në Kosovë ose agresionin kundër Kroacisë dhe Bosnjes: [nëse] ato nuk mbështeteshin nga kërcënime konkrete e të besueshme për sanksione.”⁷²

Për më tepër, ekzistonte një mëdyshje ndërmjet republikave, sepse “Kucan, Tudjman dhe Miloshevic preferonin luftën ndaj kompromisit,”⁷³ ngaqë ky i fundit do t'i tregonte të dobët në sy të elektoratit duke i bërë të varur nga axhenda e brendshme. Kështu, siç analizon Kaufman-i, “përpjekjet perëndimore për një kompromis u gjendën përballë një barrierë të patejkalueshme”⁷⁴ duke lidhur duart e tyre, ata bënë gabimin e një ‘shtrëngimi të butë’ të paevitueshëm. Kaufman-i konkludon: “duke parë këto pengesa fundamentale, është e qartë se politika perëndimore e një nxitjeje verbale dhe ekonomike nuk do të kishte ndihmuar.”⁷⁵ Nga ana tjetër, kur kërcënimet për një ndërhyrje me forcë u mbështetën nga komuniteti ndërkombëtar, i cili vepronte tashmë në mënyrë koherente, lidhshmi serb tentoi të ulte ritmin e retorikës irredentiste dhe të minimizonte mbështetjen e tij ndaj etnisë serbe në Kroaci dhe Bosnje.

Kur kostoja e opozitës ndaj ndërhyrjes ndërkombëtare u bë e padurueshme “Millosheviçi sanksionoi madje dhe serbët e Bosnjes për t'i ulur në tavolinë.”⁷⁶ Kjo u bë e mundur “ngaqë NATO-ja bombardoi qendrat e komunikimit të serbëve të Bosnjes, çka sinjalizoi se ditët e bllofit kishin mbaruar”⁷⁷ duke ndihmuar kundër ofensivën boshnjako-kroate ndaj trupave serbe. “NATO-ja nuk pati pothuajse asnjë humbje dhe mund të bombardonte sipas dëshirës. Në këtë mënyrë, retorika e fryrë e qëndrimet për një komunitet anti-serb kishin marrë fund.”⁷⁸ Ngjarjet e mëvonshme si ndërhyrja 78 ditëshe në '99-n në Kosovë, tregojnë se Millosheviçi u tërhoq nga pozicioni i tij irredentist vetëm kur pa se s'kishte asnjë mënyrë shpëtimi. Në fillim, kur lideri serb nuk po përballlej më me një kërcënim konkret prej fuqisë së NATO-s, dukej i gatshëm të sfidonte komunitetin ndërkombëtar. Për më tepër, bombardimet dukeshin në anën e tij, të paktën në fazën fillestare, çka e forcoi Millosheviçin dhe nxitë pastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës e më tej. Vetëm kur kostoja e madhe e bombardimeve të vazhdueshme u bë e padurueshme, Millosheviçi u tërhoq dhe pranoi tërheqjen e ushtrisë duke dhënë dritën jeshile të nisjes së negociatave.

⁶⁹ Ibid

⁷⁰ Ibid

⁷¹ Për të patur një ides a më të saktë sesa dhe ku konstistonte konkretisht ndihma ruse, shih për shembull Ramet, 215

⁷² Denitch, 210

⁷³ Kaufman, 196

⁷⁴ Ibid

⁷⁵ Ibid

⁷⁶ Saideman and Ayres, 58

⁷⁷ Bogdan Denitch. *Ethnic Nationalism: the Tragic Death of Yugoslavia*. Minneapolis: University of Minnesota Press: 1997. p.208

⁷⁸ Ibid

Kjo tregon se “Milosheviçi mund të kuptonte vetëm gjuhën e forcës,”⁷⁹ ashtu sikundër u shpreh dikur Sekretarja e Shtetit, Madlein Allbright-i. Kjo është arsyeja që goditjet ajrore shpesh shiheshin si një “mjet negociimi për të ulur serbët në tavolinën e marrëveshjes.”⁸⁰ Saideman-i dhe Ayres-i theksojnë se presioni ndërkombëtar merr rëndësi vetëm kur ai ka një kosto të caktuar.⁸¹ Kërcënimet në vetvete ishin të pamjaftueshme të ‘tundnin’ prej vendit Millosheviçin: në fakt, ishin sanksionet që gjatë gjithë atij kursi e prapësuan. Në këtë kontekst, mund të theksohet se ndërkohë që ‘shtrëngimi i butë’ dështoi në funksionimin e tij në Serbi, impakti i sanksioneve të qëndrueshme ishte i mjaftueshëm për ta detyruar Millosheviçin dhe elitën drejtuese të Serbisë të bënin pas nga politika e vjetër agresive, edhe pse subjekte të brendshme në shoqërinë serbe ishin në favor të vazhdimit të politikave irredentiste.

Ky kapitull demonstroi se pavarësisht mendimit të përgjithshëm se ishte Millosheviçi ai që nisi politikën irredentiste dhe luftën ndaj fqinjëve, duke u imponuar atyre vullnetin e tij, ose se ai vepronte në atë mënyrë për të kënaqur pasuesit e vet, ekziston dhe një perspektivë tjetër e ngjarjeve. Siç shkruan dhe shkrimtari serb, William Jovanovich-i “të huajt që prej fillimit e kanë lexuar keq historinë e Millosheviçit, si historinë e një ekspansionisti nacionalist.”⁸² Në fakt, ishte Akademia ajo që e shtyu atë në një ekspansion nationalist që më vonë degradoi në irredentizëm, “por kjo ju faturua gabimisht Millosheviçit.”⁸³ Një analizë më e saktë e zinxhirit të ngjarjeve duhet të theksoj gjithashtu rolin e institucioneve, si akademia e shkencës dhe e arteve, kisha ortodokse, ide nacionaliste si Memorandumi i ’87-s dhe organizata shoqërore si diaspora dhe mafia të cilat ndikuan në irredentizmin serb.

Konkluzion

Qëllimi i këtij artikulli ishte studimi i një fenomeni kryesisht problematik për vendet e Ballkanik, atë të irredentizmit, duke studiuar burimet/shkaqet që çojnë drejt politikave të tilla të jashtme agresive. Si rast studimorë u mor rasti serb dhe synohet të argumentohet se pse nacionalizmi arriti të zëvendësonte komunizmin si ligjërim dhe ideologji dominante në Serbi, duke bërë të mundur dhe përshpejtimin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Argumenti që kjo ese artikulon është se në literaturën ekzistuese ka një boshllëk (gap) që nënvleftëson rolin e aktorëve shoqëror në formësimin dhe influencimin e politikave etnike që kulminuan me irredentizëm në rastin serb, çka solli dhe shpërbërjen e parakohshme të Jugosllavisë dhe e çoi rajonin në një prej luftërave më të përgjakshme të shekullit të 20-të.

Marrja në konsideratë e rolit të ideve, institucioneve të caktuara që kanë interes dhe influencë të ndikojnë në vendim-marrje, si dhe grupeve të interesit, të para nga këndvështrimi i bashkëveprimit me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar, do ndihmonte që të plotësonim një boshllëk të rëndësishëm në literaturën ekzistuese. Për më tepër, do kishte dhe implikime praktike, pasi do bënte të mundur një analizë me të plotë dhe objektive të shkaqeve të luftërave në Ballkanin Perëndimor, të nxitura kryesisht si rezultat i irredentizmit serb dhe kësaj do mundësonte edhe gjetjen e rrugëve apo mekanizmave që do ndalonte një përsëritje të luftërave të nxitura prej irredentizmit.

Rishikimi i irredentizmit serb nga këndvështrimi i rolit të aktorëve dhe faktorëve shoqërore si burim apo katalizatorë të tij, si dhe lidhja me impaktin e faktorit ndërkombëtar për të kuptuar më mirë se kur elementi i brendshëm dominon ndërhyrjen e jashtme dhe anasjelltas,

⁷⁹ E cituar te Carment and Harvey, 32.

⁸⁰ Ibid, 30

⁸¹ Saideman and Ayres, 76.

⁸² Shih pjesën e hyrjes të William Jovanovich in Alex N. Dragnich. Serbia and Yugoslavia. New York: Columbia University Press, 1998.

⁸³ Ibid

përveç se një qasje jo-ortodokse, sjell dhe implikime të tjera, edhe në rafshin teorik. Kjo sepse, nëse do përpiqeshim të ngjiteshim lart në shkallën e abstraksionit dhe të bënim përgjithësime teorike, do të na duhej ta testonim modelin tonë teorik edhe në raste kryekëput të kundërta me atë serb, pra në raste ku irredentizmi nuk ka ndodhur, megjithëse kushtet fillestare kanë qenë të pranishme. Një rast i tillë është ai shqiptar, ku pavarësisht karakteristikash të ngjashme, si dekada të tëra nën një rregjim komunist, përqindje e lartë e bashkë-kombasve etnike të shtrirë në rajonet kufitare dhe që zyrtarisht janë përfshirë si minoritete të vendeve fqinjë, historia e shkruar në mënyrë të tillë që nënkupton një territor shqiptar pothuajse sa dyfishi i këtij aktualitet dhe lojërat gjeopolitike nga Fuqitë e Mëdha (pra ndërhyrja ndërkombëtare) që ka injoruar kufijtë natyralë, *normalisht* do prodhonin irredentizëm edhe në Shqipëri. Përse kjo nuk ka ndodhur në rastin shqiptar, është në përputhje me hipotezat 1b dhe 2b të parashtruara në këtë artikull, por elaborimi më i hollësishëm, sikundër dhe testimi i tyre empirik, do jenë nën fokusin e një artikulli tjetër.

Bibliografia

- Saideman, Stephen M. "Inconsistent Irredentism? Political Competition, Ethnic Ties, and the Foreign Policies of Somalia and Serbia," *Security Studies*, Vol.7, No.3, 1998. p.53
- Saideman, Stephen M. "Irredentism and its absence: International Pressures versus Domestic Dynamics," in Stephen M. Saideman and R. William Ayres, *War and Peace in the Aftermath of Communism*, forthcoming.
- Gagnon Jr., V. P. *The Myth of Ethnic War: Serbia and Croatia in the 1990s* [Miti i Luftës Etnike: Serbia dhe Kroacia në vitet 90-të]. Ithaca, NY: Cornell University Press, 2004.
- Kaufman, Stuart J. *Modern Hatreds: The Symbolic Politics of Ethnic War* [Urrejje Moderne: Politikat Simbolike të Luftës Etnike]. Ithaca and London: Cornell University Press, 2001.
- Jenne, Erin K. *Ethnic bargaining: the paradox of minority empowerment*. Ithaca: Cornell University Press, 2007.
- Chazan, Naomi (ed.), *Irredentism and International Politics*, Boulder, CO: L. Rienner Publishers; London: Admantine Press, 1991.
- Horowitz, Donald L. *Ethnic groups in conflict* [Grupet Etnike ne Konflikt]. London: University of California Press, 2000.
- Saideman, Stephen M. and R. William Ayres, "Determining the Causes of Irredentism: Logit Analyses from the 1980s and 1990s," *The Journal of Politics*, Vol.62, No.4. (Nov., 2000), 0 pp.1126-1144.
- Carment, David and Frank Harvey. *Using Force to Prevent Ethnic Conflict* [Përdorimi i forcës për të parandaluar konfliktin etnik]. London: Praeger, 2001.
- Herbst, Jeffrey. "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa," *International Organization* 43 (4), 1989.
- Moravcsik, Andrew. *Taking Preferences Seriously: A Liberal Theory of International Politics*, *International Organization*, Vol.51, No.4. (Autumn, 1997), p.514.
- Judah, Tim. *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia* [Serbët: Historia, Miti dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë]. New Haven: Yale University press, 1997.
- Glenny, Misha. *The Fall Of Yugoslavia* [Rënia e Jugosllavisë]. London: Penguin Books: 1992.
- Bueno de Mesquita, Bruce et al. *The Logic of Political Survival*. Cambridge, Mass.: MIT Press, 2003.
- Naimark, Norman M. and Holly Case (eds.) *Yugoslavia and Its Historians: Understanding the Balkan Wars of the 1990s* [Jugosllavia dhe historianët e saj: Të kuptuarit e Luftërave Ballkanike të viteve 90-të]. Stanford: Stanford University Press, 2003.
- Roger, Carole. *The Breakup of Yugoslavia and its Aftermath* [Shpërbërja e Jugosllavisë dhe historia që vijoi]. London: Greenwood Press, 2004.

PËRFAQËSIMI POLITIK*

HANNA FENICHEL PITKIN

Abstrakt. Ky artikull është kapitulli i fundit i njërit prej librave më të njohur të Hanna Pitkin-it, *Koncepti i Përfaqësimit*. Ky libër është bërë tashmë një nga klasikët e literaturës së përfaqësimit dhe është ndoshta libri që përdoret më gjerësisht nga teoricienët e fushës. Në këtë kapitull Pitkin-i bën një sintezë të mënyrës se si mund të kuptohet koncepti i përfaqësimit pasi ka analizuar pikëpamje dhe këndvështrime të ndryshme në lidhje me të. Sipas saj, shumë teoricienë janë përpjekur të ofrojnë një përkufizim final të përfaqësimit duke theksuar një aspekt të veçantë të tij dhe duke injoruar dimensione të tjera. Për Pitkin-in koncepti i përfaqësimit nuk mund të kuptohet vetëm në nivelin teorik apo abstrakt, por duhet kuptuar në kontekstin e gjuhës, praktikave dhe institucioneve nga ku buron dhe mbi të cilat ndikon. Përfaqësimi për Pitkin-in duhet kuptuar si tension i pashmangëshëm dhe i domosdoshëm midis një ideali abstrakt dhe realizimit të tij praktik.

Teoritë Burkeane dhe liberale mund t'i vijjnë në ndihmë në shumë mënyra pikëpamjes sonë për përfaqësimin si të vepruarit mirëfilli për të tjerët. Ato jo vetëm që duhet të pasurojnë dhe ilustrojnë çfarë është thënë për rolin e përfaqësuesit; por, meqenëse këta autorë janë qartazi të interesuar për përfaqësimin politik, idetë e tyre mund të shërbejnë për të lidhur një diskutim deri diku abstrakt me realitetin e jetës politike. Kështu, tani ne duhet të jemi në gjendje të përmbledhim çfarë kemi mësuar nga pikëpamja e fundit e përfaqësimit të cilën mund ta lidhim dhe ta vlerësojmë në raport me atë që dimë për mekanizmat e politikës. Formulimi i pikëpamjes ku kemi mbërritur paraqitet pak a shumë i tillë: të përfaqësosh do të thotë të veprosh në interes të të përfaqësuarve, duke iu përgjigjur atyre. Përfaqësuesi duhet të veprojë i pavarur; sjellja e tij duhet të paraqesë maturi dhe gjykim; duhet të jetë ai personi që vepron. Të përfaqësuarit duhet gjithashtu të jenë (duhen konceptuar si) të aftë për veprim dhe gjykim të pavarur, jo të jenë thjesht nën përkujdesje. Dhe pavarësisht potencialit që ekziston për konflikt mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarve në lidhje me atë që duhet bërë, konflikti normalisht nuk duhet të ndodhë. Përfaqësuesi duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të mos ketë konflikt me të përfaqësuarit, ose nëse kjo ndodh duhet të ketë një shpjegim. Ai nuk duhet të gjendet vazhdimisht në kontradiktë me dëshirat e të përfaqësuarve pa arsye të vlefshme që kanë të bëjnë me dëshirën e përfaqësuesit për të ndjekur interesat e të përfaqësuarve, pa një shpjegim të mirë se përse dëshirat e tyre nuk janë në përputhje me interesat e tyre.

Kjo pikëpamje relativisht komplekse vetëm sa vendos kufijtë e jashtëm të asaj që do të pranohet si përfaqësim në kuptimin e mirëfilltë. Brenda atyre kufijve mund të ketë një variacion

* Pitkin, Hanna Fenichel., "Political Representation," in *The Concept of Representation*, University of California Press, Berkeley dhe Los Angeles, 1967, f. 209-240. Përktheu nga origjinali Elda Papa, Universiteti European i Tiranës (UET).

të gjerë situatash në varësi të pikëpamjeve të autorit në lidhje me atë që përfaqësohet; natyrën e interesave, mirëqenies, apo dëshirave; kapacitetin relativ të përfaqësuesit dhe të të përfaqësuarve; dhe për natyrën e çështjeve me ta cilat duhet të merret përfaqësuesi. I pari nga këto kritere është edhe më i thjeshti. Aty ku përfaqësimi perceptohet si abstragim pa ndonjë lidhje konkrete me realitete të caktuara, konsultimi i dëshirave ose i opinionëve të dikujt ka më pak të ngjarë të shihet si pjesë e rëndësishme e përfaqësimit. Burke nuk mendonte se përfaqësimi kishte të bënte dhe aq me konsultimin e të përfaqësuarve, apo bërjen e asaj që ata donin; kjo sepse ai fliste për përfaqësimin e interesave pa përkatësi - interesa pas të cilave nuk kishte persona të caktuar, të lidhur me to në mënyrë aq të veçantë sa të mund të pretendonin se gëzonin privilegjin për ta përkufizuar interesin. Por kur njerëzit përfaqësohen, pretendimi i tyre për tu shprehur në lidhje me interesin e tyre ka vend. Në këtë pikë, edhe konceptimi i autorit për interesin – ose mirëqenien, ose dëshirat, ose çfarëdo termi të këtij lloji që ai përdor – ndikon në qëndrimin e tij. Sa më shumë ai i sheh interesat (ose mirëqenien, ose çfarëdo) si objektive, si të përcaktuara nga njerëz të tjerë, jo nga ata që e kanë atë interes, aq më shumë një përfaqësues mund të promovojë interesin e zgjedhësve të tij, pa u konsultuar me dëshirat e tyre. Në rast se ata kanë një interes “të vërtetë,” për të cilin dinë shumë pak, përfaqësuesi është i justifikuar ta ndjekë atë edhe kundër dëshirës së të përfaqësuarve. Teoria e Burke-s është më ekstremja në këtë aspekt. Por nëse me këtë pikëpamje ekzagjerohet, ne largohemi plotësisht nga fusha e përfaqësimit dhe përfundojmë tek një ekspert që vendos për çështje teknike dhe kujdeset për masat injorante sikurse një prind kujdeset për një fëmijë.

Në të kundërt, sa më shumë një autor e sheh interesin, nevojat e të tjera, si të përcaktueshme vetëm nga personi që i ndjen ose i ka, aq më shumë ka të ngjarë që ai të kërkojë që përfaqësuesi të konsultohet me zgjedhësit e tij dhe të veprojë në përputhje me atë çfarë ata kërkojnë prej tij. Në rastet ekstreme, sërish, të vepruarit tërësisht sipas dëshirave të të tjerëve bëhet i pamundur dhe një teoricien duhet ose të mbështetet në pikëpamje të tjera të përfaqësimit, ose ta shpallë konceptin një iluzion.

Ky variacion mundësisht lidhet ngushtë me konceptimin e aftësive dhe kapaciteteve relative të përfaqësuesit dhe të të përfaqësuarve. Sa më shumë një teoricien e sheh përfaqësuesin si pjesëtar të një elite sipërore të dijes dhe arsyes, ashtu siç bënte Burke, aq më pak kuptim ka për të që përfaqësuesit t'i kërkohej të konsultohet me opinionet apo dëshirat e atyre në emër të të cilëve vepron. Nëse dija dhe aftësia sipërore i përket përfaqësuesit, atëherë ai nuk duhet t'ua nënshtrojë ato opinionëve të zgjedhësve të tij injorantë dhe inferiorë. Nga ana tjetër, për aq sa një teoricien e sheh përfaqësuesin dhe zgjedhësit e tij si relativisht të barabartë në kapacitet, dije e informacion, ai pritet të kërkojë që pikëpamjet e zgjedhësve të tij të merren në konsideratë. Nëse përfaqësuesi është një njeri i zakonshëm, i gabueshëm, pa ndonjë dituri ose aftësi të veçantë, do të ishte autokratike dhe e pajustificueshme nga ana e tij që të shpërfillte zgjedhësit e tij. Sërish, ekstremet qëndrojnë plotësisht jashtë konceptit: një ekspert i vërtetë që kujdeset për një fëmijë të paaftë nuk është përfaqësues, dhe një njeri, i cili thjesht konsulton dhe reflekton pa vepruar nuk është duke përfaqësuar në kuptimin e të vepruarit mirëfilli për të tjerët. Por zona e ndërmjetme është e gjerë.

Këto konsiderata, nga ana tjetër, lidhen me mënyrën si teoricienti e mendon çështjen e përfaqësuesit – llojet e çështjeve dhe problemeve me të cilat atij i duhet të merret. Sa më shumë një teoricien i sheh problemet politike si çështje diturie, për të cilat është e mundur të gjenden përgjigje të sakta, objektivisht të vlefshme, aq më shumë ai priret ta konsiderojë përfaqësuesin si ekspert dhe ta shohë opinionin e zgjedhësve të pavend. Nëse çështjet politike janë si problemet shkencore, apo edhe matematikore, është budallallëk të përpiqesh t'i zgjidhësh ato duke numëruar individët në zonën zgjedhore. Nga ana tjetër, sa më shumë një teoricien i sheh çështjet politike si zgjedhje arbitrare dhe irracionale, çështje të tekave apo shijes, aq më pak do të kishte kuptim që një përfaqësues të bëjë përpara vetëm, pa marrë në konsideratë shijet e atyre për të cilët presupozohet se po vepron. Nëse zgjedhjet politike janë si zgjedhja midis, le të themi, dy llojeve të ushqimit, përfaqësuesi do të mund të kënaqte ose shijen e tij ose të tyre, dhe kjo e

fundit duket zgjedhja e vetme e justifikueshme. Në rastet ekstreme përfaqësimi humbet sërish. Shkencëtari ekspert duke zgjidhur një problem teknik nuk është aspak përfaqësues, nuk vendos për ndonjë gjë, nuk ndjek interesin e askujt. Njeriu që vendos për të tjerët lidhur me çështje shijesh arbitrare gjithashtu nuk po vepron për ta në kuptimin e mirëfilltë; ai thjesht zëvendëson vullnetin e tij me vullnetin e tyre, ai thjesht duhet të konsultohet me ta dhe të veprojë ashtu si ata duan. Ai nuk mund të vendosë në mënyrë të pavarur në interes të tyre, pasi kur zgjedhja është çështje shijeje nuk ka interesa të përfshira.

Përgjithësisht, çështjet politike gjenden në zonën e ndërmjetme ku zbatohet ideja e përfaqësimit si të vepruarit mirëfilli për të tjerët. Çështjet politike nuk ka të ngjarë të jenë aq arbitrare sa zgjedhja mes dy ushqimeve; ato nuk mund të jenë as thjesht çështje ekspertize, për të cilat vetëm një ekspert do të mund të jepte një përgjigje të saktë. Ato janë çështje që kanë të bëjnë me veprimin, me çfarë duhet bërë; si rrjedhim ato përmbajnë edhe fakte edhe përkushtim ndaj vlerave, edhe qëllime edhe mjete. E natyrisht, gjykimet faktike, përkushtimi ndaj vlerave, qëllimet dhe mjetet janë ngushtësisht të ndërlidhura në jetën politike. Shpesh përkushtimi ndaj vlerave politike është i thellë dhe domethënëse, ndryshe nga preferencat e parëndësishme të shijes. Politika është plot me çështje, të cilave njerëzit u përkushtohen në një mënyrë që nuk mund të kuptohet lehtë përmes arsytimit racional, që formëson perceptimin e argumenteve. Politika është plot me vlera që njerëzit mund t'i ruajnë pa i ndryshuar përgjatë gjithë jetës. Është një fushë ku racionaliteti nuk përbën garanci për rënien dakort. Megjithatë, shpesh argumentet racionale janë me vend dhe shpesh në politikë ka marrëveshje. Jeta politike nuk është thjesht marrje vendimesh arbitrare dhe as thjesht rezultante e interesave të veçanta private. Ajo është gjithmonë një kombinim i negociimit të bindjeve të palëkundura dhe konfliktuale dhe i shqyrtimit të përbashkët të politikave publike, ku kanë vend edhe faktet dhe argumentat racionale.

Por është pikërisht ky konteksti ku përfaqësimi si veprimtari e mirëfilltë ka kuptim. Pasi përfaqësimi nuk nevojitet aty ku ne presim përgjigje shkencërisht të vërteta, ku nuk ka devotshmëri ndaj vlerave, vendimeve, gjykimeve. Dhe përfaqësimi është i pamundur (përfshijtur në kuptimin formal, ose simbolik, ose përshkrues) aty ku kërkohet një zgjedhje plotësisht arbitrare, ku nuk ka vend për diskutim dhe argumente. Përfaqësimi nevojitet pikërisht aty ku nuk mjafton gjykimi i ekspertit; përfaqësimi i mirëfilltë ekziston vetëm aty ku ka interesa, pra aty ku vendimet nuk janë thjesht zgjedhje arbitrare.

Por, nëse çështjet politike janë pjesërisht përkushtim ndaj vlerave të qëndrueshme, të thella dhe pjesërisht irracionale, a është e mundur që konceptimi ynë i përfaqësimit si një veprimtari e mirëfilltë të vlejë për të gjitha ato? Ne kemi thënë se përfaqësuesi duhet të ndjekë interesin e zgjedhësve të tij, të paktën potencialisht, dhe se konflikti mes tyre duhet të jetë i justifikueshëm, bazuar tek ky interes. Por çfarë ndodh me terma të tillë si “interes” dhe “i justifikueshëm” nëse mund të ketë mosmarrëveshje të thellë, të qëndrueshme mes njerëzve lidhur me përcaktimin e interesit të tyre – mosmarrëveshje që mbetet përtej shqyrtimit, justifikimit dhe argumentimit? Për aq sa ndodh kjo, nuk është e mundur të veprosh mirëfilli për të tjerët dhe ky dimension i konceptit të përfaqësimit nuk ka vlerë në politikë. Në praktikë nëse diçka e tillë ndodh atëherë ne kthehemi sërish tek përfaqësimi përshkrues; zgjedhim një përfaqësues, i cili ndan me ne të njëjtat vlera dhe të njëjtin motivim, dhe kështu parandalojmë një konflikt të pazgjithshëm me përfaqësuesin. Nëse nuk e arrijmë këtë, mund t'i drejtohem përfaqësimit simbolik; ne mund ta lejojmë veten të ndikohemi nga lidhje emocionale pavarësisht dyshimeve që kemi nëse përfaqësuesi po i shërben apo jo interesave tona. Ose, nëse nuk arrijmë as këtë, mund të mbetemi të lidhur me rendin tonë përfaqësues, formal dhe institucional, edhe kur ai duket pa përmbajtje të mirëfilltë. Ne mund të vazhdojmë t'i bindemi këtij rendi megjithëse ndihemi të abuzuar, ose mund të vazhdojmë të ndërrojmë përfaqësuesit, megjithëse asnjëri prej tyre nuk i shërben interesit tonë.

Por nëse një teoricien i përmbahet aktivitetit të mirëfilltë të përfaqësimit, ai ka të ngjarë ta kuptojë atë në kuadrin e konceptimit të tij për politikën dhe jetën politike. Në fakt mund të argumentohet se marrëdhëniet mes koncepteve të ndryshme të përfaqësimit që kemi parë deri

tani nuk kanë vlerë thjesht në nivelin konceptual, por mund të na ndihmojnë konkretisht për të kuptuar se si funksionon një sistem politik. Kështu mund të mendohet se sa më barazitar (egalitarian) të jetë një komb i caktuar aq më shumë njerëzit do t'i shikojë pushtetarët si të barabartë me vetveten duke u ndjerë të aftë t'i gjykojë ata, dhe për pasojë aq më pak do të jenë të prirur t'u japin atyre një shkallë të gjerë lirie veprimi. Po ashtu, nëse në shoqëri ka ndasi të mprehta, të rrënjësura në raport me vlera të caktuara, një numër gjithnjë e më i madh çështjesh nuk do të mund të zgjidhen përmes debatit racional. Rrjedhimisht, në një shoqëri të tillë mund të presim një dëshirë në rritje për përfaqësueshmëri të ligjvënësve të saj, një dëshirë për t'i zgjedhur ata nga një grup i caktuar, si garancia e vetme e sigurtë për veprimin në interes të atij grupi. Në këto kushte shumë e shumë çështje do duken po aq arbitrare sa zgjedhja e një ëmbëlsire, ndonëse jo po kaq të parëndësishme. Friedrich-u ka treguar se shpesh pikërisht vendet për të cilët përfaqësimi proporcional është më i rrezikshëm janë ato që këmbëngulin për ta mbajtur atë.¹ Edhe pse ai (proporcionali) paraqet në legjislaturë antagonizmat e papajtueshme që mbizotërojnë në shoqëri, ata këmbëngulin në mbështetje të tij pasi ndjejnë se vetëm një anëtar i zgjedhur nga grupi i tyre mund të veprojë në interes të tij. Dhe ndonjëherë mund të kenë të drejtë.

Brenda një sistemi përfaqësues funksionues, e njëjta llogjikë vlen për personalitetin e ligjvënësit dhe për çështjet më të cilat ai përballet. Një përfaqësues i cili ndihet përgjithësisht i sigurtë për dijen dhe besimet e tij, ka më shumë të ngjarë të veprojë bazuar në to; një që priret të jetë skeptik dhe i kujdesshëm për pikëpajmet e veta ka më shumë të ngjarë të kërkojë të marrë vesh çfarë mendojnë zgjedhësit e tij. Për disa çështje është më e thjeshtë të përcaktosh çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar; të tjera duken arbitrare, përshtjelluese, ose çështje opinionit. Sërisht, sa më i pasigurtë të jetë një përfaqësues për atë që duhet të bëjë, aq më shumë mundësi ka që ai ta shohë atë si çështje të ndjenjave ose opinioneve të zgjedhësve.² Për çështje të tilla, dhe për të tillë njerëz politika duket se ka të bëjë më tepër me vullnetin sesa me atë që është e drejtë apo e gabuar. Kjo shpjegon edhe një nga vështirësitë e studimit të përfaqësimit empirikisht. Prandaj studimi i përfaqësimit bazuar në një çështje të vetme nuk mjafton; herët ose vonë diçka e tillë duhet parë me vëmendje.³ Nga sa më sipër mund të kuptojmë se përse një zgjedhje e thjeshtë: “A duhet përfaqësuesi të bëjë çfarë shih me vend, apo çfarë kërkon zgjedhësi?” është e destinuar të prodhojë përgjigje ekuivoqe.

Të gjithë këta elementë – çfarë duhet të përfaqësohet, nëse mund të përcaktohet objektivisht, cilat janë kapacitetet relative të përfaqësuesit dhe zgjedhësve, natyra e çështjeve për të cilat duhet marrë vendim, e kështu me rradhë – ndihmojnë për të përcaktuar pozicionin e teoricienit në një spektër që shtrihet midis dy ekstremeve. Në njërin ekstrem qëndron një përfaqësues që ‘kujdeset’ aq shumë për interesat e elektoratit edhe në kundërshtim me dëshirat e këtij të fundit sa që përfaqësuesi kthehet në kujdestar të të përfaqësuarit dhe kështu humbet përfaqësimi. Në ekstremin tjetër qëndron një përfaqësues që ‘dërgon votën’ e elektoratit në parlament thjesht si një zëdhënës i elektoratit, duke e reduktuar kështu konceptin e përfaqësimit thjesht në një term përshkrues, por pa përmbajtje. Por përveçse ilustrimit të këtij vëzhgimi, analiza jonë e teorive Burkeane dhe liberale na ka hedhur në një tjetër dimension të të vepruarit mirëfilli për të tjerët – tiparet dhe problemet e veçanta të përfaqësimit politik: dallimi mes përfaqësimit privat dhe publik, mes të vepruarit për një prijës të vetëm ose një organizatë, dhe të vepruarit për një zonë zgjedhore. Tani ka ardhur koha t'i kthehemi atyre ndërlikimeve politike që gjenden në përplasjen mandat – pavarësi** që e lamë mënjanë më parë, edhe thjesht për të treguar se si dhe përse argumenti ynë konceptual ka të bëjë edhe me politikën.

** Përplasia mandat – pavarësi ka të bëjë me faktin që përfaqësuesi nga njëra anë duhet t'i bindet elektoratit që i ka dhënë mandatin në mënyrë që të mos bjerë në kundërshtim me interesat e zgjedhësve, nga ana tjetër duhet të respektojë edhe gjykimin dhe pavarësinë e tij në mënyrë që të mos jetë thjesht një kukull e zgjedhësve në legjislaturë. Përndryshe ai/ajo do ta ketë të pamundur të negociojë apo diskutojë me përfaqësues të tjerë. (shënim i redaktorit)

Përfaqësimi si një aktivitet i mirëfilltë siç e kemi trajtuar deri tani mund të jetë dukur larg realiteteve të jetës politike. Një përfaqësues politik – të paktën një anëtar tipik i një legjislature të zgjedhur – ka të bëjë me një zonë elektorale dhe jo me një individ të vetëm; dhe kjo ngre pikëpyetje mbi mundësinë që një grup i tillë, i paorganizuar, të ketë një interes që të ndiqet prej përfaqësuesit, pa folur për një vullnet ndaj të cilit ai të mund të ishte përgjegjës, ose një opinion para të cilit ai të mund të përpiqej të justifikonte çfarë ka bërë. Këto probleme bëhen edhe më të mëdha po të marrim parasysh gjetjet e shkencave politike në lidhje me zgjedhësit, të paktën në një demokraci moderne të masave – ata janë apatik, të painformuar dhe të manipulueshëm. Për më tepër, përfaqësuesi që është një ligjvënës i zgjedhur, nuk i përfaqëson zgjedhësit e tij për çdo çështje dhe i vetëm, i shkëputur nga gjithçka. Ai punon me përfaqësues të tjerë në një kontekst institucional për një detyrë të caktuar – qeverisjen e një kombi ose një shteti. Kjo nxjerr sërish problemin e njohur të interesave lokalë ose të pjesshëm *versus* interesit kombëtar dhe çështjen e rolit të përfaqësuesit politik në raport me secilin.

Përfaqësimi politik në vetvete jo domosdoshmërisht e ngre problemin e interesit kombëtar; kombin mund ta përfaqësojë një kryetar simbolik shteti, duke e bërë të parëndësishëm shtrimin e kësaj çështjeje. Ose konteksti institucional mund të jetë i tillë që një person ose trup të mund të veprojë për kombin, ndërkohë që një tjetër trup është e përbërë nga përfaqësues lokalë, të cilët nuk qeverisin apo veprojnë për kombin në tërësi.⁴ Çështja e interesit kombëtar ngrihet vetëm në rastin e një legjislature përfaqësuese, një trup i përbërë nga persona që përfaqësojnë zona të ndryshme zgjedhore dhe në të njëjtën kohë, mendohet të qeverisin kombin dhe të ndjekin interesin kombëtar. Ky kontekst i ka bërë teoricienët të formulojnë dilemën klasike: Nëse dikush përfaqëson një zonë të caktuar zgjedhore në legjislaturë, a është detyrë e tij të përfaqësojë interesin e saj apo interesin e kombit si i tërë?

Sikurse me kundërshtinë mandat-pavarësi, teoricienët duken shumë të gatshëm ta pranojnë këtë si një dilemë të vërtetë, me alternativa reciprokisht përjashtuese. Por, ashtu si me kundërshtinë mandat-pavarësi, ka diçka për të thënë për të dy krahet. Nëse një njeri përfaqëson një zonë zgjedhore të caktuar, atëherë bazuar në argumentimin e katër kapitujve të fundit, detyrimi i tij është ndaj interesit të asaj zone zgjedhore. Dhe në një sens praktik, është e rëndësishme në terma politikë dhe socialë që interesat lokale ose të pjesshme të mos shtypen dhe sakrifikohen pa mëshirë në emër të kombit. Nga ana tjetër, dikush duhet të qeverisë dhe qeveria kombëtare duhet të ndjekë interesin kombëtar. Nëse kjo detyrë u ngarkohet përfaqësuesve si grup, atëherë ata duhet të kujdesen edhe për interesin kombëtar. Dhe në një sens praktik është e rëndësishme në terma politikë dhe socialë që interesat lokalë dhe të pjesshëm të mos lejohen të marrin më tepër përparësi se interesat e kombit në tërësi.

Mund të shmangim një nga presat e kësaj dileme duke ndryshuar bazën e argumentit tek kush ose çfarë përfaqësohet. Nëse ligjvënësi përfaqëson zonën e tij zgjedhore, pikëpamja e përfaqësimit të mirëfilltë sipas konceptit ‘në emër të’ na thotë se ai duhet të ndjekë interesin e zonës. Kështu, nëse duam të tregojmë se detyrimi i tij është ndaj interesit kombëtar, ne themi se në të vërtetë ai përfaqëson kombin. Për ilustrim mund të citohen një numër kushtetutash evropiane:

Anëtarët e Raishtagut janë përfaqësuesit e të gjithë popullit dhe nuk duhet të detyrohen nga urdhra ose udhëzime.

Anëtarët e Kongresit janë përfaqësues të kombit dhe jo të kolegjeve të cilat i zgjedhin.

Anëtarët e të dy Dhomave duhet të përfaqësojnë kombin dhe jo vetëm provincën, apo nëndarjen e provincës që i zgjedh.

Deputetët duhet të përfaqësojnë kombin si të tërë dhe jo provincat e ndryshme nga të cilat zgjidhen.⁵

Por të tilla formulime nuk i japin zgjidhje dilemës tonë teorike; ato thjesht hedhin poshtë një nga alternativat, duke i dhënë përparësi interesit kombëtar në vend të interesit të zonës

zgjedhore. Përfaqësues të tillë thjesht mund të zgjidheshin në nivel kombëtar.⁶ Ky qëndrim është e kundërta e mbrojtjes kokëfortë të interesit të zonës zgjedhore; të dy qëndrimet priren të errësojnë marrëdhënien mes zonës zgjedhore dhe kombit, mes pjesës dhe të tërës. Ata e shohin zgjedhjen si të ishte vërtetë ose-ose, sikur zona zgjedhore dhe kombi të ishin reciprokisht përjashtuese dhe njësi pa lidhje. Ata thonë se për një përfaqësues të zgjedhur në Kaliforni pasja e detyrës për “të përfaqësuar” interesin e të gjithë kombit është e njëjloj sikur ai të kishte detyrën për “të përfaqësuar” interesin e New Yorkut. Por sigurisht nuk është kështu; Kalifornia është pjesë e kombit. Nëse pranojmë se kombi dhe pjesët e tij përballen me njëri-tjetrin si dy kombe armiq, problemi është vërtetë i pazgjidhshëm. Ndaj, të pranosh se mirëqenia kombëtare është parësore do të thotë të përjashtosh përfaqësimin e lokales. Dhe nga ana tjetër, lokalja nuk do të mund të fajësohej se kundërshton vendosjen e theksit tek interesi kombëtar nëse ky interes do të ishte domosdoshmërisht në kundërshtim me të sajën.⁷ Por, në fakt, një nga tiparet më të rëndësishme të qeverisë përfaqësuese është kapaciteti i saj për të zgjidhur kërkesat konfliktuale të pjesëve, bazuar në interesin e tyre të përbashkët për mirëqenien e së tërës.

Një argument pak më ambicioz që shfaqet në literaturë e mënjanon këtë dobësi duke supozuar një harmoni të vetvetishme mes interesit lokal dhe kombëtar. Një farë “dore e padukshme” politike mendohet se parandalon çdo konflikt real. Kombi përbëhet nga pjesët e tij; kështu interesi kombëtar duhet të jetë shumë e interesave lokalë ose pjesorë. Problemi me këtë argument është se ai është fals. Të gjithë dimë raste kur interesi i disa lokaliteteve është në kundërshtim me mirëqenien e kombit. Për më tepër, ky argument nuk do të përmbushë atë që mbështetësit e tij presin, pasi mund të përdoret në mënyra diametrikisht të kundërta. Një anëtar i Kongresit mund të thotë “Unë jam këtu për të përfaqësuar zonën time elektorale. Ajo që është e mirë për shumicën e zonave elektorale është e mirë për vendin,”⁸ dhe kështu të justifikojë ndjekjen e interesit të zonës së tij. Por në të njëjtën mënyrë Burke mund të pohojë se çdo lokalitet, duke qenë pjesë e së tërës, ndan një pjesë të interesit kombëtar; dhe ai mund ta përdorë këtë për të justifikuar përkushtimin e përfaqësuesit ndaj mirëqenies kombëtare e jo ndaj kërkesave të zonës elektorale.

Sfida këtu është formulimi i saktë verbal i fakteve të qarta: në një kuptim kombi është shumë e pjesëve të tij, por në një tjetër kuptim një komb ndonjëherë duhet t’u kërkojë disave prej pjesëve të tij të sakrifikojnë mirëqenien e tyre për hir të mirëqenies së tij. Që një komunitet të ekzistojë dhe mbijetojë duhet që anëtarët dhe nëndarjet e tij të përfitojnë nga ekzistenca e tij, t’u interesojë vazhdimësisht e tij. Në atë kuptim, çdo zonë është pjesë e së tërës dhe interesi kombëtar nuk është një interes i veçantë, armiqësor ndaj saj. Nga ana tjetër, interesi kombëtar nuk mund të mos marrë në konsideratë mirëqenien e pjesëve të kombit, dhe madje të individëve. Në asamblatë përfaqësuese interesi kombëtar shpesh është produkt i rivalitetit të kërkesave dhe lokaliteteve brenda shtetit. E megjithatë ndonjëherë thjeshtë agregimi i këtyre kërkesave do të ishte i pamjaftueshme për të përcaktuar interesin kombëtar; ndonjëherë kërkohet një vëmendje e drejtpërdrejtë, në shërbim të publikut në përgjithësi, ndaj vetë mirëqenies kombëtare.

Do të ishte me vend të bënim dallimin mes asaj që mund ta quajmë ‘interesi fillestar’, nga njëra anë, dhe ‘interesi objektiv përfundimtar’, nga ana tjetër. Interesi fillestar i një lokaliteti ose grupi mund të jetë dhe shpesh është në kundërshtim me interesin fillestar të kombit. Por kombit gjithashtu i intereson mirëqenia e pjesëve apo anëtarëve të tij, të cilëve nga ana tjetër u intereson mirëqenia e kombit. Kështu, teorikisht, në çdo rast duhet të ekzistojë një zgjidhje ideale e interesit-objektiv-përfundimtar (pavarësisht nëse mundemi apo jo ta gjejmë, ose të biem dakort për të) që përcakton raportin e drejtë mes interesave lokale dhe kombëtare. Një përfitim i vogël për kombin nga një sakrificë e madhe prej një pjese të tij nuk mund të justifikohet. Një përfitim i vogël për një pjesë që buron nga një sakrificë e madhe e kombit gjithashtu vështirë të justifikohet. Dikush mund të thotë për interesin-objektiv-përfundimtar se shuma e interesit të pjesëve na jep interesin e të tërës, por kjo formulë optimiste nuk duhet lejuar të errësojë konfliktet e qarta mes interesave fillestare. Politika ka të bëjë me pajtimin e kërkesave konfliktuale, ku secila palë zakonisht ka një farë të drejtë; harmonia e interesave-objektivë -

përfundimtarë duhet të *krijohet*.⁹

Uniteti kombëtar që i bën lokalitetet të kenë interes në mirqënien e së tërës, nuk buron direkt nga procesi i përfaqësimit; ai gjithashtu ri-krijohet vazhdimisht përmes veprimtarive të përfaqësuesve. Sikurse e ka thënë edhe Charles E. Merriam-i “Interesat e veçanta duhen vizatuar si pjesë e intersit të përgjithshëm në tablonë” e interesit kombëtar.¹⁰ Mund të ketë sisteme institucionale ku kjo detyrë nuk kryhet nga një trup përfaqësues, ku përfaqësuesit e mbrojnë çështjen e zonës së tyre përpara një monarku ose një tjetër ekzekutivi ose gjykatësi kombëtar, i cili merr vendimet përfundimtare. Por kjo nuk është normale në qeveritë përfaqësuese moderne.

Përfaqësuesi është, përgjithësisht, edhe avokat edhe gjykatës, një agjent i lokalitetit të tij sikurse edhe një qeverisës i vendit. Detyra e tij është të ndjekë edhe interesin lokal edhe atë kombëtar, të parin si përfaqësues, të dytin si pasi detyra e tij si përfaqësues është të qeverisë vendin. Detyra e dyfishtë është e vështirë, por nuk është as teorikisht as praktikisht e pamundur.

Por ka edhe realitete të tjera politike që duhen shqyrtuar krahas problemit të interesit kombëtar. Qytetari, votuesi, i cili duhet të përfaqësohet nuk është, sigurisht, qytetari racional, i informuar, i interesuar, politikisht aktiv që me sa duket kërkon formula jonë.¹¹ Shumica e njerëzve janë apatikë ndaj politikës dhe shumë as nuk e marrin mundimin të votojnë. Nga ata që votojnë, shumica votojnë bazuar në një besnikëri partiake tradicionale; ndonjëherë ndikojnë edhe karakteristikat personale të kandidatit. Por përgjithësisht edhe karakteristikat personale edhe politikat që përkrah kandidati përdoren më shumë për të justifikuar një preferencë të formuar më parë, sesa si bazë për të bërë një zgjedhje. Votuesit kanë prirje t'i atribuojnë kandidatit çdolloj politike që ata preferojnë; pak prej tyre dinë ndonjë gjë për mënyrën si ka votuar anëtar i Kongresit. Duket se vendimet motivohen kryesisht nga kontaktet me grupet parësore; njerëzit votojnë ashtu si voton familja, miqtë dhe shoqëria e tyre. Kështu vendimet për të votuar varen gjerësisht nga zakonet, ndjenjat dhe temperamentit, sesa nga shqyrtimet racionale, të informuara, të qëndrimit të kandidatit apo partisë për çështje të caktuara.

Shikoni sa i panatyrshëm do të tingëllonte një dialog racional mes votuesit dhe përfaqësuesit: “Pse votove në këtë mënyrë kur ne të kërkuam të votoje ndryshe?” “Po sepse une di disa fakte që ju nuk i dini, ju nuk keni marrë parasysh që...?” “E po kjo i ndryshoka gjërat...”. Sigurisht asgjë nuk do të mund të ishte më larg asaj çfarë ndodh në të vërtetë në një proces zgjedhor.

Probleme të ngjashme dalin me përfaqësuesin dhe realitetin e sjelljes legjislative. A i dëgjon përfaqësuesi vazhdimisht dëshirat e zgjedhësve, ose nëse jo, a e përdor ai dijen e tij të specializuar për një vlerësim racional, gjakftohtë, të asaj që është më e mirë për ta dhe kombin? Sërish, nëse supozimet do të ishin këto, faktet do të ishin shumë zhgënjyese. Pasi pozita e ligjvënësit është shumë më komplekse sesa e paraqet një model i tillë. Përfaqësuesi modern vepron në një rrjet të ndërlikuar presionesh, kërkesash dhe detyrimesh; dhe ka mosmarrëveshje të konsiderueshme mes ligjvënësve lidhur me mënyrën e duhur për të përmbushur rolin e tyre.¹²

Në rradhë të parë, përfaqësuesi politik përfaqëson zgjedhësit në shumës dhe jo elektoratin në njëjës. Ai zgjidhet nga një numër i madh njerëzish; dhe ndërsa mund të jetë e vështirë të përcaktosh interesat apo dëshirat e një individi të caktuar, është pafundësisht më e vështirë ta bësh këtë për një zonë prej mijëra zgjedhësish. Për shumë çështje një zonë mund të mos ketë asnjë interes, ose pjesëtarët e saj mund të kenë një shumësi interesash në konflikt me njëra-tjetrën.¹³ Dhe përfaqësuesi është në dijeni të injorancës, apatisë dhe irracionalitetit të votuesve, diversitetit të pikëpamjeve dhe të interesave të tyre. Për më tepër, ai rrallë ndodh të ketë informacion të saktë për pikëpamjet dhe interesat që ata kanë.¹⁴

Së dyti, ai është një politikan profesionist në kuadrin e institucioneve politike,¹⁵ një anëtar partie që dëshiron të rizgjidhet dhe një nga shumë anëtarët e të tjerë të legjislaturës. Ai duhet të kujdeset për interesat e partisë së tij politike (në nivelin vendor dhe atë kombëtar)

dhe për grupe dhe interesa të ndryshme private dhe publike. Si anëtar i legjislaturës ai ka një pozicion nga ku burojnë detyrime dhe pritshmëri të caktuara.¹⁶ Ai duhet t'i bindet traditës së saj dhe të punojë brenda traditës së punës së trupit legjislativ. Ai duhet të ketë marrëdhënie të mira me kolegët, në veçanti me më të rëndësishmit ndër ta.¹⁷ Që të punojë me efektivitet ai duhet të mbajë parasysh jo vetëm rregullat formale dhe joformale të legjislativit, por dhe vendin e këtij organi në tërë strukturën e qeverisë.

Së treti, ai do të ketë gjithashtu pikëpamje dhe opinione, të paktën për disa çështje. Ai do të ndjejë se disa masa janë thelbësisht të pabazuara, imorale, ose të padëshirueshme. Në të njëjtën kohë, opinionet e tij mund të ndikohen nga ata që i qëndrojnë pranë dhe burimet e tij të informacionit. Opinioni i tij mund të ndikohet edhe nga liderët partiakë ose të tjerë kolegë, nga miq ose lobues efektivë, ose madje edhe nga letrat që merr. Ai vetë mund të mos jetë një burim i besueshëm informacioni lidhur me çfarë e ndikon opinionin e tij për një çështje, ose madje çfarë përcakton votën e tij.¹⁸ Dhe çështjet nuk shtrohen para tij të shkëputura; çështjet janë të ndërlydhura dhe ai mund të dëshirojë të lëshojë pe në disa, me qëllim që të fitojë në disa të tjera.¹⁹ Një masë e caktuar mund të ketë disa aspekte, të cilave ai u përgjigjet në mënyra të ndryshme.²⁰ Gjithashtu ai mund t'i konsiderojë masat me një rëndësi përtej përmbajtjes së tyre të drejtpërdrejtë, për shembull si pjesë e një programi partiak në tërësi.²¹

Kështu në sjelljen legjislative vepron një kompleksitet dhe pluralitet i madh faktorësh që mund të luajnë rol në një vendim legjislativ. Ligjvënësi nuk përfaqëson as thjesht duke iu përgjigjur dëshirave të zonës së tij, as përmes një gjykimi Olimpik, nga lart, mbi një çështje të caktuar. Prandaj marrëdhënia mes përfaqësuesit politik dhe zgjedhësve të tij nuk mund të shpjegohet në mënyrë analoge me të vepruarit për të tjerët në nivelin individual. Përfaqësuesi nuk është as agjent, as kujdestar, as delegat, as komisioner; ai vepron në emër të një grupi njerëzish pa një interes të vetëm, shumica e të cilëve duken të paaftë për të formuar një vullnet të qartë për çështjet politike.

A duhet atëherë ta braktisim idenë e përfaqësimit politik në kuptimin e tij më të zakonshëm të “të vepruarit për”? Ka patur raste që një mundësi e tillë është sugjeruar; ndoshta përfaqësimi në politikë është vetëm një trillim, një mit që bën pjesë në folklorin e shoqërisë sonë. Ose ndoshta përfaqësimi duhet të ripërkufizohet për t'iu përshtatur politikës sonë; ndoshta thjesht duhet të pranojmë faktin se ajo çfarë kemi quajtur qeveri përfaqësuese në të vërtetë është thjesht konkurrencë partiake për pushtet. Megjithatë, të “ripërkufizosh” përfaqësimin për ta barazuar me realitetin empirik të qeverisë përfaqësuese edhe nëse ai realitet nuk shfaq asnjë element të atij që zakonisht do ta quanim përfaqësim, duket pa vlerë dhe çorientuese.

Por ndoshta është gabim të përpiqemi ta kuptojmë përfaqësimin politik përmes analogjive me të mandatuarin, delegatin, apo kujdestarin. Ndoshta kjo përjasje, sikurse përfaqësimi përshkrues dhe simbolik, na bën të presim ose të kërkojmë në marrëdhënien përfaqësuese tipare që nuk janë aty dhe nuk ka pse të jenë aty. Ndoshta kur zakonisht flasim për përfaqësimin politik, qeverinë përfaqësuese, koncepte të ngjashme nuk duam të themi, ose nuk kërkojmë që përfaqësuesi të qëndrojë në një lloj marrëdhënieje një me një, person për person me zonën e tij, ose secilin prej zgjedhësve, ashtu si përfaqësuesi privat qëndron përballë klientit të tij.²² Ndoshta kur e quajmë një trup, ose një sistem qeverisës “përfaqësues” jemi duke thënë diçka më të gjerë e më të përgjithshme për mënyrën si ai funksionon si marrëveshje e institucionalizuar. E ndoshta edhe përfaqësimi i kryer nga një ligjvënës individual duhet të shihet në një kontekst të tillë, si pjesë e gjithë sistemit politik.

Përfaqësimi politik është mbi të gjitha një organizim publik, i institucionalizuar që përfshin shumë njerëz dhe grupe dhe që operon sipas mënyrave komplekse të organizimeve të mëdha sociale. Ajo që e bën atë përfaqësim nuk është ndonjë veprim i caktuar i ndonjë pjesëmarrësi, por struktura dhe funksionimi i përgjithshëm i sistemit, modelet e krijuara nga veprimtaritë e shumëllojshme të shumë njerëzve. Përfaqësimi ekziston nëse njerëzit (ose një zonë) janë të pranishëm në një veprim qeverisës, edhe pse ata nuk veprojnë për veten e tyre në kuptimin e mirefilltë të fjalës. Veprimi i pavaruar në interes të të qeverisurve është i nevojshëm

për sa kohë që përfaqësimi nënkupton të vepruarit mirëfilli për të tjerët, në atë mënyrë që të paktën u përgjigjet potencialisht atyre, ose jo në konflikt me dëshirat e tyre. Ndoshta diçka e tillë mund të ketë kuptim dhe të jetë e mundur edhe në politikë, nëse dimë si dhe ku të kërkojmë.

Edhe nëse përfaqësuesi nuk mendon gjithmonë me vetëdije për interesin kombëtar, ai mund megjithatë të ndjekë atë kurs veprimi që promovon atë interes. Ai mund të luajë rolin e tij të ndërlikuar në sistemin e insitucionalizuar politik në atë mënyrë që na duket si – ose që është – përfaqësim. Thjesht fakti që ai po vepron brenda një sistemi përfaqësues nuk përbën garanci që ai po përfaqëson në të vërtetë. Megjithatë të qenurit brenda një sistemi të tillë krijon mundësi për lloje më të ndërlikuara dhe më të gjera përfaqësimi, se sa ato që mund të realizojë një individ i vetëm.

Po ashtu, edhe pse përfaqësuesi politik mund të mos marrë parasysh, ose edhe të hedhë poshtë mendimin e zonës së tij, ai mund të japë justifikime, arsye, pse veproi kështu, njësoj si një përfaqësuesi i mirëfilltë. Nëse pyesim një ligjvënës amerikan përse vepron pa marrë për bazë dëshirat e zgjedhësve të tij, ai ka të ngjarë që t'i justifikojë veprimet e veta duke argumentuar se zgjedhësit janë të painformuar, se ai është shumë më i informuar se zgjedhësit dhe se ai mbron interesin e tyre të vërtetë dhe jo kapriçot elektorale të çastit. Pra, justifikimi përsëri buron nga koncepti i përfaqësimit të mirëfilltë.

Shumica e zgjedhësve të mi ndonjëherë nuk kanë dijeni për të dhëna dhe rrethana të rëndësishme. Për mua, të mos merrja në konsideratë këtë do të ishte shkelje e premtimit tim si ligjvënës, pa përmendur detyrimin tim ndaj ndërgjegjes sime, gjykimit tim dhe ndjenjës së detyrës.

E dija shumë mirë dhe pa më të voglin dyshim se nëse pesëmijë njerëzit që më shkruan do të kishin në dispozicion të gjithë të dhënat që unë kisha, të paktën shumica e tyre do të kishte mbajtur qëndrimin [tim].

Ka shumë emocion edhe rezultat i një keqinformimi të madh.

...ai u përgjigj se dinte vetëm një mënyrë për të zbuluar opinionin publik të Konektikatit; ajo ishte të gjente çfarë ishte e drejtë. Kur ta zbulonte këtë, ai ishte mjaft i sigurt se ajo do të kishte miratimin e Konektikatit.

... ata nuk e kuptojnë me të vërtetë çështjen.

... ata nuk dinë as çfarë është një tarifë... Sigurisht ata nuk e dinë se për çfarë janë duke folur.

Unë i kuptoj problemet në atë fushë. Unë e di çfarë është më mirë për sektorin e fermave... Unë mbështetem në bindjet e mia dhe shpresoj që zgjedhësit të bien dakort me to. Ata këtë presin – me përjashtim të rastit kur një grup i organizuar vërtetë është i entuziazmuar për diçka. Përgjithësisht ata presin që të kesh më shumë informacion se ata kanë... Unë përpiqem të shkoj pas zgjedhësve të mi – të mos i merrja në konsideratë do të ishte thyerje besimi – por unë e përdor shpesh gjykimin tim pasi ata janë të keqinformuar. E di se ata do të votonin si unë nëse do të kishin faktet që unë kam. ... Mendoj se nëse do të dinin atë që unë di... ata do të kuptonin votimin tim.²³

Këto deklarata nuk përbëjnë evidencë, por ilustrim. Në të vërtetë, ato nuk mund të shërbejnë si evidencë pasi ligjvënësit bëjnë shumë deklarata lidhur me pse ata votojnë, si votojnë, deklarata të cilat mund të jenë të gjitha të pasakta. Por deklaratat tregojnë se pikëpamja e përfaqësimit si aktivitet i mirëfilltë mund, në fund të fundit, të mos jetë aq abstrakte dhe e idealizuar sa që të mos përdoret në realitetin e jetës politike.

Madje mund të ketë kuptim të flasësh për njerëzit – injorantët, apatikët, qytetarët jopolitikë – si të ishin të aftë për veprim dhe gjykim kolektiv, si të kishin, me raste, një vullnet ose opinion me të cilin duhet të ballafaqohet përfaqësuesi. Por nuk duhet t'i nënshtrohemi një portreti tepër të thjeshtëzuar të opinionit publik dhe vullnetit popullor. Shkencëtarët politikë e dinë prej kohësh që “të votuarit është thelbësisht një eksperiencë kolektive.”²⁴ Ne votojmë, në

të vërtetë ne e perceptojnë realitetin politik, përmes njerëzve me të cilët kemi lidhje. Shumë prej nesh bien në kontakt me masmedian vetëm përmes një procesi me dy hapa, përmes perceptimeve të njerëzve të tjerë për të dhe reagimit të tyre ndaj saj. Mund të ketë një masë të madhe opinionit latent në sjelljen e individëve, të cilët mund të mos jenë fare të aftë të artikulojnë opinionet e tyre. Ashtu sikurse është thënë në një studim të kohëve të fundit:

Marrëdhënia mes anëtarit të Kongresit dhe votuesit nuk është thjesht një marrëdhënie bilaterale, por ndërlikohet nga prezenca e një sërë ndërmjetësish: partia vendore, interesat ekonomike, mediat që japin lajmet, organizatat racore dhe kombëtare, e kështu me rradhë... Shumë shpesh përfaqësuesi e vendos kontaktin me publikun masiv përmes këtyre agjensive ndërmjetësuese, dhe informacioni dhe të dhënat për të mund të transformohen në mënyrë të konsiderueshme ndërsa shpërndahen në elektorat përmes dy ose më shumë fazave. Si rezultat, publiku – ose pjesë të tij – mund të marrin thjesht sinjale pozitive ose negative për anëtarin e Kongresit, të cilat u shkaktuan nga veprimi legjislativ, *por të cilat nuk kanë më një përmbajtje të identifikueshme të çështjes.*²⁵

Gatishmëria e qytetarit A për të votuar për një kandidat të caktuar erdhi si rezultat i bashkëbisedimit rastësor me B-në, të cilit i kapi veshi diskutimin e C-së për një artikull të publikuar në D – kjo gatishmëri është, në një farë mase, pjesë e opinionit publik, edhe pse A-ja mund të mos jetë në gjendje të rendisë asnjë arsye të vetme për votën e hedhur, dhe mund të mos i interesojnë çështjet imediate. Ndoshta përfaqësuesi duhet dhe mund t'i përgjigjet pikërisht këtij lloji të opinionit publik.

Nuk po sugjeroj se grupi ka një mendje organike. Ajo çfarë publiku bën ose mendon duhet (teorikisht) të përkthehet në sjellje ose qëndrime individuale. Thjesht po them se ky përkthim nuk është i thjeshtë ose i qartë. Sjellja e përgjithëshme elektorale e njerëzve në një demokraci përfaqësuese mund të reagojë ndaj çështjeve dhe politikave të caktuara edhe nëse disa votues individualë nuk reagojnë drejtpërdrejtë ndaj tyre. Prosesi mund të jetë kompleks, të përfshijë një ndërveprim mes organizatave, mediave të lajmeve dhe marrëdhënieve personale. Edhe nëse shumica e njerëzve votojnë në mënyrë irracionale dhe të painformuar si pasojë e presionit të grupeve parësore kjo nuk pengon që sistemi si i tërë të reagojë në një farë mase “racionalisht”.

Sa më sipër shërben thjesht për të skicuar një kuadër në të cilin mund të argumentojmë atë që për mendimin tim ndodh realisht që përfaqësimi politik është në fakt përfaqësim para së gjithash në kuptimin e “të vepruarit për” çka duhet kuptuar në nivelin publik. Sistemi përfaqësues duhet të kujdeset për interesin publik dhe t'i përgjigjet opinionit publik, me përjashtim të rasteve kur mungesa e përgjigjes mund të përlligjet në bazë të interesit publik. Në të dy rastet, procesi është publik dhe institucional. Ligjvënësi individual nuk vepron i vetëm, por si anëtar i një trupe përfaqësuese. Ndaj, ndjekja prej tij e interesit publik dhe përgjegjshmëria ndaj opinionit publik nuk ka pse të jetë gjithmonë e ndërgjegjshme dhe e menduar, më shumë se sa roli i votuesit individual. Përfaqësimi mund të shfaqet në një sistem politik ku shumë individë, si votues ashtu edhe ligjvënës, janë duke ndjekur synime mjaft të ndryshme. Nuk them se duhet të shfaqet në ndonjë sistem të veçantë; nuk ka garanci që ai do të shfaqet. Por ai mund të shfaqet, dhe për aq sa shfaqet në një sistem të caktuar, ne e konsiderojmë këtë sistem një qeveri përfaqësuese.

Mungesën e racionalitetit individual në ndjekjen e interesit publik duhet ta trajtojmë me kujdes. Nuk dua të them që kjo mungesë mund të shtrihet pafundësisht pasi nuk besoj se ndonjë kuadër institucional mund të bëhet përfaqësues pa përpjekje të ndërgjegjshme, racionale dhe kreative nga të paktën disa individë. Por në një sistem politik ka hapësirë për apati, injorancë dhe egoizëm. Në nivelin e votuesit, në krahasim me ligjvënësit, është më e lehtë të besohet që institucioni social mund të prodhojë një “racionalitet” që shumicës së anëtarëve individualë duket se u mungon. Dhe kjo mund të vijë si rezultat i faktit se në sistemin legjislativ kërkohet një shkallë më e lartë e racionalitetit individual, e përfaqësimit të ndërgjegjshëm dhe ndjekjes

së interesit publik, sesa në publik. Pa dyshim, lidershipi krijues nevojitet në çdo sistem politik dhe një lidhshmëri i tillë nuk ndodh vetvetiu. Por kur flasim për përfaqësim politik, ne flasim pothuajse gjithmonë për individë që veprojnë në një sistem përfaqësues të institucionalizuar dhe vetëm në kuadër të këtij sistemi në tërësi veprimet e tyre prodhojnë përfaqësim, nëse e prodhojnë.

Tashmë jemi në pozitë për t'iu rikthyer "pikëpamjeve" të ndryshme për kuptimin e natyrës së përfaqësimit. Secila nga këto pikëpamje qëndron dhe është e mundshme pasi bazohet tek përdorime të zakonshme, joproblematike dhe të vlefshme të ndonjëfjale që buron nga koncepti bazë 'të përfaqësosh'. Pavarësisht se në thelb të vërteta, këto pikëpamje janë në të njëjtën kohë të papërputhshme dhe në analizën e fundit të gabuara, pasi duke u nisur nga disa raste ato bëjnë përgjithësime që nuk marrin parasysh raste të tjera po aq të vlefshme. Një pikëpamje e saktë dhe e plotë e përfaqësimit, e asaj që përfaqësimi është, varet nga kuptimi i saktë dhe i plotë i "përfaqësimit" (fjalës, sëbashku me fjalët e tjera të kësaj familjeje), i asaj çfarë do të thotë "përfaqësim". E ndërsa ne patjetër mund të ripërkufizojmë dhe rishikojmë konceptin, na duhet si fillim të jemi të qartë se çfarë ai nënkupton për ne si anglishtfolës. Dhe çfarë ai nënkupton në anglisht është shumë e ngjashme me çfarë do të thotë për ne, çfarë është për ne, në botën tonë.

Secila prej pikëpamjeve të ndryshme të përfaqësimit ka njëfarë kuptimi kur përdoret në jetën politike dhe aspekte të caktuara të jetës politike mund të interpretohen nëpërmjet tyre. Krrerët e shtetit, ose përfaqësuesit e legjislativit të zgjedhur, ose agjentët qeveritarë, për qëllime të caktuara dhe në rrethana të caktuara, janë përfaqësues të autoritetit shtetëror dhe rrjedhimisht të autorizuar për t'iu imponuar pikërisht qytetarëve në emër të të cilëve ata veprojnë. Përfaqësuesit e zgjedhur politikë, në rrethana të caktuara, janë përfaqësues "të vërtetë" vetëm nëse për veprimet e tyre përgjigjen përpara atyre për të cilët veprojnë. Një trupë legjislative mund të shihet si një imazh ose pasqyrim i kombit në përgjithësi, ose si një kampion përfaqësues. Kur flasim për ceremonialin politik, ose për rolin e liderëve politikë si përfaqësues të unitetit kombëtar përmes vetë personit të tyre, atëherë është e llogjikshme që këtë lloj përfaqësimi ta quajmë përfaqësim simbolik. Në këtë rast liderët politik ngjasojnë me simbolet e pa jetë politike si flamuri ose stema kombëtare. Në kushte të tjera, në rrethana të tjera, përfaqësimi si një veprimtari e mirëfilltë do të shihej si thelbi i vërtetë i asaj çfarë ndodh në të vërtetë politikisht.

Por fakti që secila nga këto pikëpamje përshkruan një aspekt të jetës politike nuk mjafton. Nuk mjafton të themi se përfaqësimi herë ka një kuptim, herë një kuptim tjetër; as nuk rezultojnë prej kësaj se çdo autor ka të drejtë të ketë pikëpamjen e tij dhe se të gjitha teoritë ose përfaqësimet janë njëlloj të vlefshme. Kjo sepse secila pikëpamje ka supozimet dhe implikimet e saj të veçanta dhe karakteristike, të cilat rrjedhin nga shembuj të përdorimit tonë të zakonshëm të fjalëve të familjes "përfaqësim" ku ajo bazohet. Kështu nëse e mendoni legjislativin si një kampion përfaqësues të kombit, pothuajse në mënyrë të pashmangshme do të përqëndrohemi më shumë tek përbërja e cila duhet të pasqyrojë kombin, sesa tek veprimtaria e tij. Mendojeni të njëjtin trup si një simbol dhe pothuajse në mënyrë të pashmangshme do të interesoheni kryesisht për ndikimin e tij psikologjik në mendjen e njerëzve sesa për një saktësi të përputhjes mes tij dhe kombit. Nga ana tjetër, mendojeni atë si një aktor politik ose një bashkim aktorësh politik dhe interesi juaj do të drejtohet në të tjera çështje. Ndaj është e domosdoshme të dimë çfarë nënkupton dhe supozon secila pikëpamje dhe cila pikëpamje është e duhura në rrethanat ku ndodhemi.

Sepse, të thuash se të gjitha pikëpamjet kanë lidhje me politikën dhe se të gjitha lidhen duke qenë pikëpamje të të njëjtit koncept të veçantë, nuk do të thotë se ato janë ekuivalente, ose se i përshtaten jetës politike në të njëjtën pikë dhe në të njëjtën mënyrë. Diçka që mungon mund të përfaqësohet në mënyra të ndryshme, në varësi të asja që është; por jo gjithçka mund të përfaqësohet në çdo mënyrë. Ndonëse edhe përfaqësimi përshkruet edhe ai simbolik janë përfaqësime, nuk do të thotë se përfaqësuesi më i mirë përshkruet është përfaqësuesi më i mirë simbolik, apo se secili do të bënte punën më të mirë të përfaqësimit si veprimtari. Në të vërtetë,

perfeksioni i një lloji të përfaqësimit, “të bërit prezent,” mund të pengojë perfeksionimin e llojeve të tjera në raste të caktuara. Dhe madje jo çdo lloj do të ishte i mundur në çdo kontekst.

Aspektet e jetës politike që duket se mishërojnë përfaqësim janë jashtëzakonisht të ndryshme dhe të shumëllojshme. Një qeveri si e tërë mund të thuhet se përfaqëson shtetin, kombin, vendin ose popullin e saj. Ky pohim mund të bëhet për të gjitha qeveritë, ose mund të përdoret për të dalluar atë që e quajmë qeveri “përfaqësuese” nga forma të tjera. Brenda një shteti, përfaqësimi në të shumtën e rasteve i takon legjislativit; por një teoricien mund të vërë re se secili prej anëtarëve përfaqëson kombin, ose zonën e tij zgjedhore, ose partinë e tij politike. Në rastin e përfaqësimit proporcional ai mund të thotë se secili nga anëtarët përfaqëson ata që e zgjedhën; në rastin e përfaqësimit profesional se ai përfaqëson profesionin e tij; në rastin e zonës zgjedhore gjeografike se ai përfaqëson atë, ose banorët e saj, ose interesin e tyre. Nuk është e nevojshme që një trup përfaqësues kolegjal të jetë një legjislativ ose të ketë pushtet sovran; ai mund të jetë një trup këshillues. Por, mund të flasim edhe për përfaqësim prej ekzekutivit, qoftë ai një president i zgjedhur drejtpërdrejtë, qoftë një kryeministër i zgjedhur jo drejtpërdrejtë. Ne flasim për përfaqësim prej monarkëve dhe krerëve titullarë të qeverive. Gjykatat, gjykatësit dhe trupat gjykues janë parë si organe përfaqësuese të shtetit dhe në mënyrë të ngjashme ne pranojmë përfaqësimin administrativ. Ambasadorët përfaqësojnë një shtet jashtë. Për çdo zyrtar ose punonjës qeveritar ndonjëherë mund të thuhet se përfaqëson, në kuptimin që veprimet e tij janë veprime zyrtare të shtetit. Ne gjithashtu pranojmë si përfaqësim politik veprimtarinë e disa personave të caktuar “përballë” organizmave të shtetit. Kështu themi se një lobist përfaqëson një grup ose interes të caktuar në Kongres, ose në një komitet të Kongresit. Një agjent ose ekspert mund të përfaqësojë një interes përpara një gjykate administrative. Dhe një avokat përfaqëson klientin e tij përpara gjykatës, pavarësisht se ky zakonisht nuk shihet si përfaqësim politik.

Por këta persona dhe institucione të shumtë nuk përfaqësojnë të gjithë në të njëjtin kuptim apo në të njëjtën mënyrë. Përfaqësimi politik është po aq i gjerë dhe divers sa vetë fenomeni i përfaqësimit në përgjithësi. Përballë këtij diversiteti e shumta që mund të bëjmë është të jemi të qartë për pikëpamjen e përfaqësimit që përdoret nga autori dhe nëse supozimet dhe implikimet e saj i përshtaten vërtet rastit në të cilin ai po i zbaton ato pikëpamje. Shikoni për shembull një nga shprehjet më domethënëse në fushën e përfaqësimit politik – “qeveria përfaqësuese.” Një qeveri mund të përfaqësojë në shumë mënyra, por jo të gjitha përkojnë me idenë e qeverisë përfaqësuese. Një numër teoricienësh kanë gabuar në këtë aspekt, duke shquar vetëm një aspekt në të cilin një qeveri mund të thuhet se përfaqëson. Më pas ky aspekt është përgjithësuar duke dalë menjëherë në përfundimin se kjo duhet të jetë ajo çfarë “qeveria përfaqësuese” nënkupton në të vërtetë.

Ndonjëherë argumentohet, veçanërisht nga teoricienët e autorizimit^{***}, se çdo qeveri përfaqëson subjektet pasi ajo ka autoritet mbi ta dhe bën ligje në emër të tyre.²⁶ Qeveritë e kanë këtë autoritet; qeverisja nënkupton bërjen e ligjeve. Megjithatë autoriteti nuk është ekuivalent me përfaqësimin; dikush që ka autoritetin të lëshojë urdhra nuk ka nevojë të jetë përfaqësues. Ndonëse qeveria vepron edhe në emër të subjekteve të saj. Kështu një qëndrim paksa i modifikuar do të ishte se në kuptimin formal të gjitha qeveritë përfaqësojnë për sa kohë veprimet e tyre jo vetëm janë të detyrueshme për qytetarët por edhe bëhen në emër të qytetarëve.²⁷ Kur vepron qeveria në themi se veprimi kombi. Ama, ky lloj i përfaqësimit nuk do të na jepte mundësi të dallonim formën e qeverisë përfaqësuese nga format e tjera të qeverisjes, pasi sipas tij çdo qeveri

^{***} Teoricientët e autorizimit janë ata teoricienë që përfaqësimin e shikojnë kryesisht si aktin nëpërmjet të cilit individi, qytetari apo elektorati autorizon një person të caktuar të veprojë në emër të tyre. Pikënisja e kësaj pikëpamje është tek Thomas Hobbes-i, sipas të cilit në momentin që individët ia delegojnë garantimin e mirëqenies së tyre një organizmi më të lartë atëherë ky organizëm është autorizuar të veprojë në emër të tyre dhe për pasojë qytetarët nuk kanë të drejtë t'i kundërvihen atij. Në këtë pikëpamje theksi vendoset tek e drejta e përfaqësuesit për të vepruar në emër të të përfaqësuarve më shumë sesa tek e drejta e të përfaqësuarve për t'i kërkuar llogari përfaqësuesit. (shënim i redaktorit)

është përfaqësuese *a priori*; ai do ta bënte konceptin e “qeverisë përfaqësuese” të tepërt.

Teoricienë të tjerë i shtojnë autoritetit *de jure* të një qeverie për të vepruar në emër të subjekteve të saj si komb, kapacitetin *de facto* të saj për të fituar mbështetjen dhe bindjen e tyre.²⁸ Kështu ata mund të argumentojnë se një qeveri përfaqëson për aq sa dekretet e saj zbatohen dhe pranohen nga subjektet e saj. Kjo doktrinë është e afërt me idenë se përfaqësim do të thotë të kënaqësh atë që përfaqësohet, një pikëpamje kjo e shprehur nga De Grazia dhe Gosnell. Sipas kësaj pikëpamjeje një qeveri përfaqësuese dallohet nga format e tjera të qeverisjes, nga shkalla e lartë e bindjes, ose pëlqimit, ose mbështetjes që gëzon në raport me subjektet e saj. Dhe, sikurse vëren edhe De Grazia-s dhe Gosnell-i, nuk ka rëndësi se si qeveria e arrin mbështetjen apo pëlqimin e popullatës: mund të jetë udhëheqësi ai/ajo që i përshtatet dëshirave të të udhëhequrve, por në të njëjtën mënyrë mund të jenë të udhëhequrit ata që i përshtaten dëshirave të udhëheqësit. Qeveritë përfaqësuese të përcaktuara nga shkalla e popullaritetit të tyre nuk ka nevojë të kenë zgjedhje ose institucione të tjera demokratike.

*Vullneti në të cilin bazohet qeveria mund të jetë demokratik, edhe nëse ai krijohet nëpërmjet influencave oligarkike ose plutokratike. Është mjaft e mundur që një pakicë e interesuar të bindë shumicën në kundërshtim me interesat e saj nëpërmjet kontrollit të rrugëve të informacionit dhe mundësisë për të bërë propozime. Vendimi i një lideri mund të shtyjë miliona persona të mbështesin masa, të cilat do t'i kishin kundërshtuar nëse nuk do të mbështeteshin nga prestigji i liderit.*²⁹

Dhe e gjithë kjo duket plotësisht në përputhje me përfaqësimin dhe qeverinë përfaqësuese.

Së fundi, disa autorë argumentojnë se një qeveri është përfaqësuese jo thjesht në raport me popullaritetin që gëzon, por në masën që ndjek interesin e subjekteve të veta dhe kujdeset për mirëqenien e tyre. “Çdo qeveri është deri diku përfaqësuese” na thotë një autor, “për sa kohë e identifikon veten me interesat e popullit...”³⁰ Megjithatë, një qeveri përfaqësuese mund të dallohet, bazuar në këtë përqasje, si një qeveri që i ndjek interesat e subjekteve të saj në një shkallë shumë të lartë.

Megjithatë kur flasim për qeveri përfaqësuese nuk kemi parasysh ndonjë nga këto kuptime. Nëse një qeveri ka apo jo autoritet legjitim për të detyruar subjektet e veta, nëse subjektet janë të detyruar t'i binden apo jo qeverisë, janë përgjithësisht pyetje filozofesh. Këto nuk janë çështje që shqetësojnë qytetarin e thjeshtë apo politikanin. Për ta ligji është diçka që të shtrëngon apo që të krijon detyrime, ashtu si premtimi është diçka që duhet mbajtur. Për këdo, me përjashtim të filozofit politik spekulues, e drejta e qeverisë për të detyruar subjektet e saj është problematike vetëm në kohë kryengritjesh ose revolucioni. Revolucionarët e ardhshëm mund të përpiqen të justifikojnë veten duke argumentuar se qeveria nuk i përfaqëson më ata. Ndërsa një jurist ndërkombëtar duhet të vendosë cila qeveri është zëdhënësja legjitime e në kombi, çka shpesh varet nga kush ushtron kontroll efektiv mbi popullatën dhe territorin.

Gjithashtu ka raste kur na intereson “përgjegjësia” e subjekteve për veprimet e qeverisë, që është diçka tjetër nga detyrimi për të zbatuar ligjet e saj. Në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë Gjyqit të Nurembergut u diskutua shumë mbi fajin e popullit gjerman për luftën. A ishin ata fajtorë për masakrat e bëra në emër të tyre nga qeveria e Hitlerit? Lloji i argumenteve që u përdorën janë padyshim të njohura: Sa mbështetje popullore gëzonte Hitleri? Sa rezistencë kishte ndaj tij në Gjermani? Sa dinin njerëzit për sa po ndodhte? A ishin ata dakort me aq sa dinin? Por këto pyetje nuk na thonë se sa përfaqësuese ishte qeveria e Gjermanisë naziste. Mund të biem dakort që nuk ishte. Maksimalisht mund të marrim ndonjë infomacion në lidhje me këtë çështje nëse shtrojmë pyetjen; a do ta kishte mbështetur populli gjerman një qeveri përfaqësuese që do të ndiqte të njëjtat politika? Por edhe nëse qeveria Naziste konsiderohet si jo përfaqësuese, përsëri shumë njerëz mund të japin argumenta për përgjegjësinë e popullit. Megjithatë është e qartë që në rastin e një qeverie përfaqësuese përgjegjësia do të ishte më e qartë.³¹

Megjithatë këto nuk janë të gjithë llojet e argumenteve që normalisht do të merrnim në shqyrtim për të përcaktuar nëse një qeveri e caktuar është ose jo përfaqësuese. Me qeveri përfaqësuese kërkojmë të specifikojmë qeveri të caktuara, por jo disa të tjera. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Zvicra zakonisht shihen si qeveri përfaqësuese. Diktaturat, monarkitë e vërteta dhe administratat koloniale të vendosura me forcë zakonisht nuk shihen kështu. Por a është Bashkimi Sovjetik një qeveri përfaqësuese? A është Bashkimi i Afrikës së Jugut? A është Gana? A janë Shtetet e Bashkuara “në të vërtetë”? Në përgjithësi ne kemi një farë ideje se cilat argumente mund të përdoren për t’iu përgjigjur pyetjeve të tilla. Normalisht këto argumente fillojnë duke shqyrtuar mënyrën sesi zgjidhen liderët, por shumë shpejt shkojnë përtej kësaj çështjeje. Ne duam të dimë sa të vërteta janë zgjedhjet, kush ka të drejtën e votës, nëse zyrtarët e zgjedhur kanë pushtet të vërtetë qeverisës dhe sa opozitë lejohet.

Si fillim, vini re çështjet që nuk preken nga pyetje të tilla. Për të përcaktuar nëse një qeveri është përfaqësuese, ne nuk pyesim nëse ajo ka autoritetin për të bërë ligje shtrënguese në emër të qytetarëve të vet. Çdo qeveri legjitime e ka këtë autoritet. Nuk pyesim as sa efektiv është ky autoritet; një vend nuk ka domosdoshmërisht një qeveri përfaqësuese meqë niveli i krimeve në të është i ulët dhe mosbindja ndaj ligjit ndodh rrallë. A mund të themi se një qeveri është përfaqësuese nëse politikat e saj janë të dobishme dhe promovojnë mirëqenien e subjekteve të saj? Të paktën ky kriter duket më tundues. Por politikat e një diktature dashamirëse mundet të synojnë mirëqenien e popullatës, por të mos lejojnë asgjë të ngjashme me pjesëmarrjen demokratike. Sigurisht kjo nuk mund të jetë një qeveri përfaqësuese. Ne presim që një qeveri përfaqësuese të promovojë mirëqenien e popullit dhe ndoshta e mendojmë të vështirë që kjo të arrihet nga lloje të tjera qeverish. Por fakti që një qeveri kujdeset për interesat e subjekteve të saj është në rastin më të mirë një nga të dhënat, një kriter i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm për ta quajtur atë përfaqësuese.

Po një qeveri që i bën të lumtur subjektet e saj, politikat e së cilës pranoen gjerësisht nga ata? A mund të themi se një qeveri është përfaqësuese duke iu referuar popullaritetit që ajo gëzon tek subjektet e saj? Mendoj se këtu tundimi për të thënë “po” është shumë i madh, por duhet të tregohemi të matur. A nuk do të mund të imagjinonim raste që flasin për të kundërtën? Supozojmë që një ishull i fjetur tropikal (përpara Luftës së Dytë Botërore) administrohet shkëlqyeshëm nga një despot dashamirës i një fuqie koloniale dhe që duhet nga vendasit. Sigurisht në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një qeveri përfaqësuese. Ose një diktator mund të perfeksionojë një drogë qetësuese të re dhe t’i ushqejë gjithë subjektet e tij me “pilula lumturie” që ata të miratojnë me gjithë zemër gjithçka që ai bën. Sigurisht nuk kemi një qeveri përfaqësuese. Sërish, kënaqja e subjekteve nuk është e mjaftueshme për të përkufizuar përfaqësimin.

Ashtu sikurse në nivelin individual nuk mund të konkludojmë se përfaqësuesi që kënaq zgjedhësit është ai/ajo që i përfaqëson ata më mirë, në nivelin e qeverisë nuk do të mund ta përkufizonim përfaqësimin thjesht nëpërmjet pëlqimit të subjekteve. Njerëzit ndonjëherë mund të mbështesin një monark trashëgimtar; ata mund të mos kenë veçse gjëra të mira për të thënë për një diktator (pasi të jenë hequr anëtarët kritikë të popullsisë). Një diktaturë mund të gëzojë pëlqim “aktiv dhe mbizotërues”, por kjo nuk e bën atë një qeveri përfaqësuese.

Nëse mbështetja për regjimin prodhohet përmes monopolit të kontrollit mbi median e komunikimit masiv, shoqëruar me shtypje të ashpër të elementëve opozitarë... Nëse regjimi politik mbështetet fuqishëm në monopolin e një propagande shumë të organizuar... dhe shtyp pa mëshirë të gjithë disidentët politikë, kushdo duhet të dalë në përfundimin se asnjë sasi e mbështetjes popullore për regjimin nuk do të arrihte të provonte se interesat e vërteta të popullit nuk po shfrytëzohen në interes të pakicës sunduese.³²

Sipas të njëjtës llogjikë, asnjë sasi e mbështetjes së publikut nuk mund të provojë se qeveria është përfaqësuese. Kur një sundues manipulon një masë inerte pasuesish për t’iu bashkuar vullnetit të tij, ne hezitojmë të themi se ai i përfaqëson ata. Në të njëjtën mënyrë, nëse një grup

interesi përfshihet në një fushatë të gjerë propagandistike për të bindur publikun të përkrahë një masë të caktuar, ne nuk e shohim këtë veprimtari si përfaqësim të publikut.

Për mendimin tim, ne themi se një qeveri është përfaqësuese jo duke treguar se ajo ka kontroll mbi subjektet e saj, por përkundrazi, duke treguar se subjektet ushtrojnë kontroll mbi atë që bën qeveria. Veprimet e çdo qeverie i atribuohen subjekteve të saj formalisht, ligjërisht. Por në një qeveri përfaqësuese ky atribuim ka përmbajtje të mirëfilltë: njerëzit vërtetë veprojnë përmes qeverisë së tyre dhe nuk janë thjesht pësues pasivë të veprimeve të saj. Një qeveri përfaqësuese nuk duhet të ketë thjesht kontroll, të promovojë thjesht interesin publik, por duhet gjithashtu t'u përgjigjet njerëzve. Nocioni lidhet ngushtë me pikëpamjen e përfaqësimit si një veprimtari e mirëfilltë. Pasi në një qeveri përfaqësuese të qeverisurit duhet të jenë të aftë për të vepruar dhe gjykuar, të aftë për tu përfshirë në aktivitete qeverisëse, në mënyrë që të mendohet se qeveria u përgjigjet të qeverisurve. Ashtu si në përfaqësimin jopolitik, i përfaqësuarit nuk ka pse të shprehë dëshirat e tij dhe madje as të mos ketë formuluar ndonjë dëshirë, por në parim ai duhet të jetë i aftë ta bëjë këtë; kur e bën, dëshirat e tij duhet të përmbushen për sa kohë nuk ka arsye të forta (për sa i takon interesit të tij) për të kundërtën. Njëlloj, një qeveri përfaqësuese ka nevojë për një makineri për shprehjen e dëshirave të të përfaqësuarve që qeveria t'u përgjigjet këtyre dëshirave për sa kohë nuk ka arsye të forta për të kundërtën. Kjo nuk kërkon një situatë ku përfaqësuesit të përgjigjen në mënyrë konstante, por kërkon një situatë konstante *përgjegjshmërie*. Nuk është se një qeveri përfaqëson vetëm kur vepron në përgjigje të një dëshirë të shprehur popullore; qeveri përfaqësuese është ajo që i përgjigjet dëshirave popullore kur ka të tilla. Ndaj duhet të ketë rregullime institucionale për t'u përgjigjur këtyre dëshirave. Sërish, idea që qeveria të frustrtojë ose të kundërshtojë vullnetin e popullit pa arsye të forta, ose ta kundërshtojë atë sistematikisht për një periudhë të gjatë kohe, bie ndesh me konceptin e përfaqësimit. Ne mund t'i mendojmë njerëzit sikur "veprojnë përmes" qeverisë, edhe nëse në të shumtën e kohës ata janë të pavetëdijshëm për çfarë ajo bën, për sa kohë që mendojmë se ata kanë mundësinë të veprojnë nëse do të dëshironin ta bënin këtë.³³

Fakti që ky lloj përfaqësimi politik thekson që përfaqësuesit duhet të jenë potencialisht të përgjegjshëm, që të përfaqësuarit kanë mundësinë të ushtrojnë pushtet pavarësisht nëse e bëjnë diçka të tillë realisht, krijon hapsirë për leadership dhe për aksion përballë risive apo situatave emergjente. Nga ana tjetër ky lloj përfaqësimi bie ndesh me manipulimin apo shtrëngimin e publikut. Natyrisht, vija ndarëse mes udhëheqjes dhe manipulimit është mjaft e hollë dhe mund të jetë vështirë për t'u përcaktuar. Por pa diskutim *ka* një ndryshim dhe ky ndryshim e bën udhëheqjen të pajtueshme me përfaqësimin dhe jo me manipulimin.³⁴ Kjo pasi udhëheqja është, në një kuptim, në dorë të të udhëhequrve. Ajo ka sukses për sa kohë që ata janë të gatshëm të ndjekin. Kjo nuk është e papajtueshme me kërkesën tonë që të përfaqësuarit të jenë në gjendje të arrijnë atë që duan kur kanë një vullnet të qartë. Manipulimi nga një sundues, nga ana tjetër, u imponohet të sunduarve dhe kërcënon kapacitetin e tyre për të refuzuar një politikë të caktuar ose për të ndërmarrë një politikë të re. Një person mund të udhëhiqet dhe sërish të veprojë sipas vullnetit të tij të lirë; diçka që manipulohet nuk lëviz dot vetë. Një objekt i pajetë mund të manipulohet dhe transformohet, por nuk mund të udhëhiqet. Sërish, këtu nuk kemi të bëjmë me lojra fjalësh, por me termat e saktë për të emërtuar një dallim në realitet: ndryshimin mes marrëdhënieve demokratike dhe diktatoriale, mes sunduesit dhe të sunduarve. Mund të flasim për qeveri përfaqësuese vetëm nëse mund t'i atribuojmë njerëzve aftësinë për të ndërmarrë aksion qeverisës në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.³⁵

Por e gjithë kjo e bën nocionin e qeverisë përfaqësuese të duket shumë më i zbehtë, intuitiv dhe i përkohshëm sesa është në të vërtetë kur e përdorim. Gjykimi nëse një qeveri është përfaqësuese ose jo nuk është çështje e një përshtypje të përgjithshme estetike. Ndonëse në disa raste është e vështirë të gjykosh me siguri nëse një regjim është përfaqësues ose jo, jo të gjitha rastet janë në këtë kategori. Nga ana tjetër përfaqësueshmëria si atribut nuk është diçka që shfaqet e zhduket në mënyrë periodike. Ne nuk themi se një qeveri është përfaqësuese sot sepse po kënaq dëshirat e popullit dhe pushon së qeni përfaqësuese në ditët në vijim sepse po e

mërzit popullin. Qeveria përfaqësuese nuk përcaktohet nga veprime të caktuara në momente të caktuara, por nga rregulla sistematike afatgjata – nga institucione dhe mënyra si ata funksionojnë. Asnjë akt i veçantë pajtimi me kërkesat e popullit nuk përbën provë për një qeveri përfaqësuese, ndonëse një numër i vogël rastesh serioze të frustrimit të kërkesave legjitime të popullit do të shërbenin si kundërevidencë. John Plamenatz-i tregon se një diktator mund të vendosë të bëjë atë që subjektet e tij duan dhe megjithatë të mos jetë përfaqësues. Ai mund të bëhet përfaqësues vetëm kur vendimi i tij për t’iu përgjigjur dëshirave të popullit të mos jetë një akt i rastësishëm sipas dëshirës së tij, por të institucionalizohet si reagim i rregullt dhe sistematik. Dhe ne priremi të mendojmë se për këtë duhen zgjedhjet. Shqetësimi ynë lidhur me zgjedhjet dhe makinerinë elektorale, dhe veçanërisht nëse zgjedhjet janë të lira dhe të ndershme, rrjedh nga bindja jonë se kjo makineri është e domosdoshme për të siguruar reagim sistematik. Arsyeja se përse ne i kushtojmë vëmendje popullartitetit të qeverisë buron nga dëshira për të identifikuar një instrument nëpërmjet të cilit të masin se sa ekziston potenciali reagues (pra potenciali që ka qeveria për t’iu përgjigjur dëshirave të të qeverisurve, shën. red.) Fakti se njerëzit nuk kanë kërkesa të paplotësuara është një e dhënë se ata mund t’i plotësojnë kërkesat e tyre kur të duan, por jo përgjithmonë. Ja pse nuk na kënaq aprovimi i manipuluar ose i detyruar.

Dhe këtu pikëpamja e përgjegjësisë formaliste, pikëpamja deskriptive**** dhe ndoshta të tjerat gjithashtu marrin rëndësi për qeverinë përfaqësuese. Sepse vetëm lloje të caktuara rregullimesh institucionale mund të kënaqin kërkesën tonë. Një monark absolut ose diktator që zgjedh, për arsye të tija, të bëjë sondazhe të opinionit publik dhe të bëjë atë që populli duket se do, sërish nuk është një qeveri përfaqësuese. Na duhen institucione funksionale që janë krijuar për të siguruar dhe realisht prodhojnë një qeveri që i përgjigjet interesit dhe opinionit publik. Një sistem i tillë mund të ketë një president, mund të drejtohet nga një kryeministër, ose mund të jetë një qeveri kuvendore. Ai mund të ketë zona zgjedhore gjeografike, përfaqësim proporcional, ose ndonjë sistem tjetër përpjestimi. Ai mund të mos ketë parti politike, të ketë parti të dobëta, parti të forta, shumë ose pak parti. Të gjitha këto forma mund të jenë qeveri përfaqësuese; disa janë më të suksesshme se të tjerat.

Për diçka të tillë duket se mjaftojnë vetëm pak kushte bazë. Ne do të hezitonim ta konsideronim një sistem qeveri përfaqësuese nëse nuk do të mbante zgjedhje të rregullta, të cilat të ishin “reale” ose të “ndershme.”³⁶ Ne do të hezitonim më tej ta konsideronim përfaqësuese një qeveri nëse nuk do të përmbante një lloj trupi kolegjal, përfaqësues, me një kapacitet më shumë se këshillues.³⁷ Ne nuk do ta pranionim sakaq si përfaqësues një sistem ku e gjithë qeveria të ishte në duart e një sunduesi të vetëm, edhe nëse ai do t’i nënshtronte rizgjedhjes në intervale të rregullta kohore. Ekzistenca e një trupe kolegjiale të përbërë nga përfaqësues të “pjesëve” të ndryshme të shoqërisë mbase është thjesht pasojë e një traditë historike. Ndoshta ka të bëjë me elementin e qëndrueshëm të izomorfizmit ose korrespondencës një-me-një në përfaqësimin përshkrues (dmth ku çdo pjesë në realitet - popullatë, territor, shtresë sociale, etj - të korrespondojë me një pjesë në trupën përfaqësuese, shën. red.). Ose ndoshta thjesht nuk mund të perceptojmë që një sistem politik mund të jetë vërtetë reagues pa një numër pikëpamjesh zyrtarisht aktive të pakicës ose opozitës në gjiri e tij.

Nocioni ynë për qeverinë përfaqësuese duket se nga njëra anë përmbledh një ide shumë të përgjithshme, abstrakte, thuajse metaforike – se njerëzit e një kombi janë të pranishëm në veprimet e qeverisë së tyre në rrugë komplekse – dhe nga ana tjetër ai nënkupton disa institucione konkrete, praktikë dhe historikisht tradicionale që synojnë të prodhojnë këtë rezultat. Nocioni ka si elementë formal ashtu edhe përmbajtësor. Në këtë mënyrë qeveria përfaqësuese

**** Pikëpamja e përgjegjësisë formaliste (formalistic accountability) thekson se përfaqësimi në thelb ka të bëjë me llogaridhënien. Prandaj duhen ngritur institucione që formalisht e garantojnë procesin e llogaridhënies. Pikëpamja deskriptive thekson dimensionin përshkrues të përfaqësimit, faktin që një asamble përfaqësuese duhet të ngjasojë sa më shumë me popullatën që përfaqëson, ashtu sikurse një tablo përshkruan në miniaturë një peisazh. (shënim i redaktorit)

është një shembull shumë i mirë i një fenomeni mesa duket të zakonshëm mes praktikave humane dhe koncepteve që u korrespondojnë atyre: dualiteti dhe tensioni mes qëllimit dhe institucionalizimit.

Ngjarjet mund të rrjedhin si vijon: në fillim njerëzit kanë një qëllim ose synim në mendje, thelbin e të cilit ata duan ta arrijnë. Për ta arritur qëllimi ata ndërtojnë institucione, sidomos nëse ai kërkon kohë dhe përfshin shumë njerëz, ndoshta disa breza, – shkruajnë ligje, ngrënë trupa administrativë, organizojnë programe trajnimi e kështu me rradhë. Por institucionet zhvillojnë një llogjikë ose inerci të vetën; ata nuk funksionojnë gjithmonë ashtu sikurse ishte menduar dhe mund të mos japin rezultatet për të cilat u ndërtuan. Kështu njerëzit e gjejnë veten të ndarë mes përkushtimit ndaj qëllimit fillestar dhe përkushtimit ndaj procedurave dhe mjeteve që janë miratuar dhe vendosur për ta arritur atë. Ngjarjet mund të rrjedhin edhe në kah krejt të kundërt. Gradualisht njerëzit mund të zhvillojnë një mënyrë të caktuar të bërit të gjërave që institucionalizohet si një sjellje që kthehet në zakon, pa pasur një mendim apo qëllim të përbashkët fillestar. Nisur nga kjo sjellje e modeluar ata mund të fillojnë të shprehin ide abstrakte se për çfarë ajo shërben, si duhet bërë, çfarë principesh dhe qëllimesh qëndrojnë në themel të saj. Dhe në momentin e përshtatshëm, po ato principe mund të fillojnë të përdoren si qëllime të reja për të rishikuar institucionin, si standarde kritike për të vlerësuar mënyrën si ai funksionon dhe për ta përmirësuar atë. Sërish mund të lindë një tension mes praktikës dhe parimit.

Ky lloj tensioni shpesh bëhet pjesë e koncepteve, duke bërë që kuptimi i tyre të përbëhet njëkohësisht nga aspekte “të jashtme” institucionale formale, dhe nga aspekte “të brendshme” qëllimore, përmbajtësore. Meqenëse kjo është disi e paqartë, dy skenarët shkakësorë të dhëna më sipër mund të ilustrohen më konkretisht. Për modelin e parë (nga parimi tek institucioni) le të shohim një praktikë, ose institucion njerëzor, për shembull ndëshkimin.³⁸ Filozofët i ka shqetësuar prej shumë kohësh kuptimi i ndëshkimit. Nga njëra anë, duket se ai nënkupton dëm të bërë ndaj një personi si shpagim ndaj një shkelje të ligjit apo ndaj theyrjes së një norme. Sipas këtij kuptimi është llogjikisht e pamundur të ndëshkohet dikë nëse ai nuk është fajtor për një veprim të gabuar, pasi ndëshkimi si koncept nënkupton shkelje nga personi që ndëshkohet. Ndëshkim nuk mund të kosiderohet çdo lloj dhune në çdo lloj situatë; kemi ndëshkim vetëm nëse ai zbatohet për shkak të një shkeljeje të bërë. Por, nga ana tjetër, ne ndërtojmë institucione zyrtare për të ndëshkuar kriminelët dhe norma sociale më pak formale për të ndëshkuar, le të themi, fëmijët tanë. Ndërkohë ne themi se institucione të tilla ndëshkojnë individin, pavarësisht nëse personi që po ndëshkohet në rastin konkret është fajtor ose jo. Prandaj për ne është e arsyeshme që pas një ekzekutimi të padrejtë të shpreheshim: “Ata kanë ndëshkuar një njeri të pafajshëm!” Kështu, koncepti i ndëshkimit duket të ketë një aspekt përmbajtësor që na bën të themi se dikush nuk mund të ndëshkojë një të pafajshëm dhe një aspekt formal ose institucional që na bën të themi se, sigurisht që dikush mundet, pavarësisht se nuk duhet.

Për të ilustruar modelin tjetër shkakësor (nga institucionet tek parimi) që çon në të njëjtin lloj tensioni, le të shohim idenë e paanësisë. Piaget ka sugjeruar se fëmijët e zhvillojnë një pjesë të mirë të nocionit të tyre të drejtësisë ndërsa luajnë me shokët e tyre.³⁹ Ai ka studiuar mënyrën si djemtë luajnë me zara në Zvicër, duke ndjekur njohjen e tyre graduale me lojën. Ata mësojnë, pak a shumë njëkohësisht (ndonëse Piaget argumenton në faza të përcaktuara kronologjike) si të luajnë lojën, cilat janë rregullat e lojës, çfarë është një lojë dhe çfarë janë rregullat, që rregullat nuk mund të thyhen, që rregullat mund të ndryshohen, cilat janë rrugët e duhura për të ndryshuar rregullat e kështu me rradhë. Ata me sa duket zhvillojnë edhe kritere për t'i gjykuar vetë rregullat – nocione të asaj çka është e drejtë nga njëra anë dhe atë që Piaget e quan “shpirt të lojës” nga ana tjetër.⁴⁰ Kështu, kur ata i dinë rregullat dhe dinë se ligjet janë të krijuara nga njerëzit (nga fëmijët në këtë rast) dhe se si mund të ndryshohen, ata janë të aftë të gjykojnë rrishtë e propozuara nëse janë të drejta dhe në harmoni me shpirtin e lojës. Mund të mendohej se njerëzit që kuptimin e konceptit “e drejtë” e mësojnë nëpërmjet një loje, rregullave dhe mënyre të caktuar të bërit të gjërave do t'i qëndrojnë gjithmonë besnikë asaj

loje, atyre rregullave dhe mënyrave; këto janë ato që i japin kuptim konceptit ‘e drejtë’ për ta. Por nuk ndodh kështu. Fëmijët e Piaget-së nxjerrin nga rregullat e vjetra kritere dhe principe përmes të cilave të gjykojnë risitë dhe kështu edhe për të gjykuar vetë rregullat e vjetra (pasi ata ndonjëherë modifikojnë rregullat e vjetra dhe pranojnë risitë). Më përgjithësisht, edhe pse të gjitha kriteret tona të gjykimit i mësojmë duke u bazuar në modele ekzistuese sociale, ne mund dhe i përdorim ato për të kritikuar dhe ndryshuar këto modele. Po ajo praktikë që në një kuptim duket se përcakton thelbin dhe kuptimin e konceptit “e drejtë” (ose e ‘lojës me zare’) mundet megjithatë të rezultojë e mangët si mishërimi institucional i drejtësisë (ose i shpirtit të lojës me zare).

Që ky lloj dualiteti ose tensioni ekziston në praktikën dhe konceptin e përfaqësimit duhet të jetë e qartë, pasi kjo është pjesë e gjithë argumentit tonë që nga pikëpamjet formaliste të përfaqësimit deri në kuptimin e përfaqësimit si të vepruarit mirëfilli për të tjerët.⁴¹ Atë e ndeshëm edhe në dallimin e Burke-s mes virtytit ose esencës së përfaqësimit dhe aktualizimit të tij. Në thelb ose në virtyt ose në esencë, përfaqësimi nënkupton bërjen të pranishme të diçkaje që megjithatë mungon dhe kurdo që ndodhemi në rrethana të tilla, pra kur diçka që mungon bëhet prezente, mund të flasim për përfaqësim. Sa herë që rrethanat duken ndryshe, mund të mohojmë se ka përfaqësim. Por ka edhe disa mënyra të konvencionalizuara dhe të institucionalizuara të përfaqësimit (të themi, politik). Ashtu si me ndëshkimin, ne e përdorim termin “përfaqësim” për institucione për shkak të strukturës së tyre të përgjithshme dhe qëllimit fillestar që ata supozohet se mishërojnë, pavarësisht nëse nxjerrin ose jo në pah përmbajtjen e përfaqësimit në një rast të veçantë.

Sipas Tussman-it, ne mund t’i quajmë këto dy aspekte (formën dhe përmbajtjen) “dy gjendjet e mëdha shpirtërore” të jetës politike dhe sociale. Shumica e teoricienëve të shoqërisë e kanë vënë theksin tek njëra ose tek tjetra.⁴² Realisti gjakftohtë, shkencëtari social i sjelljes, konstitucionalisti priret të vërë theksin tek institucionet, sjellja dhe performanca së jashtmi. Nëse do t’i kërkohej të përcaktonte përfaqësimin ai do të kërkonte një përkufizim operacional dhe do të shikonte se “çfarë bëjnë përfaqësuesit në të vërtetë.” Nëse do t’i kërkohej ta reformonte atë, ai do të ndërtonte institucione që vendosin rregulla për sjelljen e dëshiruar. Bazuar në pikëpamjet e përfaqësimit që kemi diskutuar, ai ka të ngjarë të jetë një teoricien formalist ose përshtues. Idealisti, reformatori moral, mësuesi, nga ana tjetër ka më shumë të ngjarë të theksojë përmbajtjen dhe qëllimin, synimin ose edhe motivin, “esencën e brendshme, të vërtetë” sesa “thjesht shëmbëllimin e jashtëm.” Nëse do t’i kërkohej të përcaktonte përfaqësimin, ai do t’i referohej rolit të idealizuar, standardit përmes të cilit ne gjykojmë përfaqësuesit, çfarë ata duhet të bëjnë më shumë se sa çfarë bëjnë në të vërtetë. Nëse do t’i kërkohej ta reformonte atë, ai do t’u mësonte njerëzve altruizmin dhe kujdesin për interesat e të tjerëve ose interesin publik, për t’i bërë ata përfaqësues të mirë. Ndër pikëpamjet që kemi diskutuar ai ka të ngjarë të përqafojë idenë e përfaqësimit si të vepruarit mirëfilli për të tjerët.

Ne kemi nevojë për të dy këto gjendje shpirtërore dhe për të dyja sëbashku. Të përcaktosh përfaqësimin institucionalisht, operacionalisht do të thotë të braktisësh të gjitha shpresat për ta gjykuar, vlerësuar, përmirësuar ose reformuar atë, ose madje për t’i mësuar dikujt rolin e përfaqësuesit – ose të paktën do të thotë të braktisësh të gjitha shpresat për t’i bërë këto gjëra në mënyrë racionale, joarbitrare. Kështu, nëse përfaqësimi është “ajo që përfaqësuesit bëjnë realisht”, asnjë veprim i tyre nuk do të mund të mos ishte përfaqësim. Të përcaktosh përfaqësimin idealisht, nga ana tjetër, të përqëndrohesh tek virtyti ose esenca e tij deri në përjashtim të institucioneve, ka të ngjarë të shënojë braktisjen e gjithë shpresave për implementimin praktik të tij. Kjo mund të na bëjë, ashtu sikurse bëri Burke-n, të pranojmë padrejtësi të mëdha në një sistem institucional, sepse në çdo moment sistemi do shihej sikur prodhon esencën e përfaqësimit pavarësisht padrejtësive konkrete. Mund të na shtyjë që të përdorim si kriter performancën momentale apo afatshkurtër çka do ta bënte të pamundur implementimin afatgjatë, sistematik, dmth institucionalizimin e idealit tonë. Ajo çfarë përfaqësuesit bëjnë realisht do na dukej si diçka që nuk na përket dhe kështu konceptimi unë do të mbetej përgjithmonë i pafuqishëm në

mbretërinë e formave platonike.

Asnjë sistem institucional nuk mund të garantojë esencën, përmbajtjen e përfaqësimit. Nuk duhet të jemi shumë optimistë as për kapacitetin e institucioneve për të prodhuar produktin e dëshiruar; edhe institucionet më të mira përfaqësuese nuk mund të pritët të prodhojnë përfaqësim në mënyrë magjike, mekanike, pa ose pavarësisht nga besimet, qëndrimet e njerëzve që vënë në lëvizje sistemin.⁴³ Thënia e Madison-it se “të drejtat kushtetuese të vendit duhen lidhur me interesin e njeriut” ka vlerë, por vlerë ka edhe thënia e Tussman-it se në kapacitetin e tij si qytetar një njeri duhet “të kujdeset për interesin publik, jo për të mirat e tij private,” atij “i shtrohen pyetje publike jo private: ‘A kemi nevojë për më shumë shkolla publike?’ jo ‘A do doja të paguaja më shumë taksa?’”⁴⁴ Për këtë arsye ne duhet të mbajmë idealin e përmbajtjes së përfaqësimit krahas institucionalizimit të tij. Si do të mund t’u mësonim atyre që pritët të vënë në lëvizje institucionet çfarë kërkojmë prej tyre pa iu referuar një ideali të tillë? Në të vërtetë, si do të mund ta mbanim mend ne vetë?⁴⁵

Pa institucionalizim, sikurse ka treguar Martin Drath-i, ideali i përfaqësimit do të mbetet një ëndërr boshe, ose më së shumti do të ndodhte rastësisht si një bekim sporadik, i pashpjegueshëm, të cilin nuk kemi pushtet ta prodhojmë ose ta bëjmë të zgjasë.⁴⁶ Format institucionale të zhvilluara historikisht, standardet e sjelljes të ingranuara përmes kulturës, janë ato që i japin formë idealit abstrakt, i japin atij rëndësi praktike dhe kuptim efektiv.⁴⁷ Ndaj zhvillimi dhe përmirësimi i institucioneve përfaqësuese, kultivimi i njerëzve të aftë për t’u kujdesur për interesat e të tjerëve në mënyrë të përgjegjshme, janë esenciale që vizioni i ndritshëm që përbën idenë e përfaqësimit të ketë efekt në jetën tonë reale. Në të njëjtën kohë, ne nuk mund të lejojmë kurrë që institucionet, zakonet, sjellja e përfaqësuesve të bëhet standardi dhe ideali ynë. Nëse qeveritë që ne zakonisht i quajmë “përfaqësuese” prodhojnë përfaqësim të vërtetë mbetet gjithmonë një çështje e hapur. Nëse ajo që ne projektojmë në realitet si përfaqësim është në të vërtetë (ajo që nënkuptojmë me) përfaqësim do të varet gjithmonë nga mënyra se si struktura dhe funksionimi i tij materializohen në praktikë.⁴⁸

Institucionet e duhura kanë qënë të ndryshëm në kohë të ndryshme të historisë.⁴⁹ Por njerëzit gjithmonë kanë luftuar për institucione që prodhojnë realisht atë që synon ideali; dhe institucionet ose individët që pretendojnë se përfaqësojnë gjithmonë janë përballur me akuzën se ata nuk përfaqësojnë në të vërtetë. Etiketa “përfaqësues” duket se lë vend për një vlerësim kritik: A është një element fiktiv, një formulë boshe, apo është në të vërtetë përmbajtja e përfaqësimit? Kështu është argumentuar “se qeveria përfaqësuese është idealisht forma më e mirë e qeverisë, për arsye se nuk do të ishte vërtetë përfaqësuese në karakter nëse nuk është organizuar dhe përshtatur ashtu siç duhet. Në esencë ajo është një sistem mirëbesimi. Institucionet që pretendojnë të jenë përfaqësuese mund ta justifikojnë karakterin e tyre si të tillë vetëm në atë masë që vendosin dhe ruajnë këtë mirëbesim.”⁵⁰

Koncepti i përfaqësimit është kështu një tension i vazhdueshëm mes idealit dhe arritjes. Ky tension nuk duhet të na bëjë as të braktisim idealin, duke u kufizuar në një përcaktim operacional që pranon gjithçka që bëjnë ata që emërohen përfaqësues; as të braktisim institucionalizimin e tij dhe të tërhiqemi prej realitetit politik. Përkundrazi, ai duhet të shpalosë një sfidë të vazhdueshme, por jo të pashpresë: për ndërtimin e institucioneve dhe trajnimin e individëve që angazhohen në kërkimin e interesit publik, në përfaqësimin e vërtetë të publikut; dhe që në të njëjtën kohë mbeten kritikë ndaj po këtyre institucioneve dhe trainimit që marrin, pasi kështu ato mbeten të hapura për tu reformuar dhe interpretuar edhe më tej.

Shënime

¹ Carl J. Friedrich, "Representation and Constitutional Reform in Europe," *Western Political Quarterly*, I (Qershor, 1948), 128-129.

² Lewis Anthony Dexter, "The Representative and his District," *Human Organization*, XVI (Pranverë, 1957), 3-4; George W. Hartmann, "Judgments," *Journal of Social Psychology*, XXI (Shkurt, 1945), 105, 113; Harold Foote Gosnell, *Democracy* (New York, 1948), f. 203.

³ Kjo është parë më qartë nga Warren E. Miller dhe Donald E. Stokes, "Constituency Influence in Congress," *American Political Science Review*, LVII (Mars, 1963), 45-56, dhe nga Dexter, "The Representative," f. 3-4; por edhe nga L.E. Gleck, "96 Congressman Make Up Their Minds," *Public Opinion Quarterly*, IV (Mars, 1940); Heinz Eulau *et al.*, "The Role of the Representative," *American Political Science Review*, LIII (Shtator, 1959), 745, 749; dhe Julius Turner, *Party and Constituency* (Baltimore, 1951), f. 70, 79. Nuk është marrë në konsideratë nga studime si ai i Wilder W. Crane që merret vetëm me një masë të vetme legjislative. Crane vuri re se "vetëm një" ligjvënës "votoi me vetëdije për meritat" e çështjes. Por cila ishte çështja? Vendosi e ndryshimit të orës për shfrytëzimin e ditës gjatë periudhës së verës! "Do Representatives Represent?" *Journal of Politics*, XXII (Maj, 1960).

⁴ Kështu përfaqësuesit në Kongresin amerikan ndonjëherë e mbrojnë vëmendjen që tregojnë ndaj nevojave lokale duke thënë se interesi kombëtar në të vërtetë është çështje e Senatit dhe presidentit. "Çfarë e bën lëmsh sistemin janë të ashtuquajturit burra shteti – përfaqësues në Kongres, të cilët votojnë për atë që mendojnë se është interesi i vendit... lërinë senatorët ta bëjnë këtë ... ata paguhen për të qenë burra shteti; ne nuk jemi," thotë një përfaqësues në Kongres i cituar tek Dexter, "The Representative," f. 3. Cf. Gerhard Leibholz, *Das Wesen der Repräsentation* (Berlin, 1929), f. 188.

⁵ Kushtetutat e Gjermanisë, Portugalisë, Belgjikës dhe Italisë, të cituara në Robert Luce, *Legislative Principles* (Boston, 1930), f. 446-447; cf. Carl Schmitt, *The Necessity of Politics* (London, 1931), f. 69. Martin Drath tregon se klauzola të tilla nuk nisën si paralajmërim moral për përfaqësuesit, por kishte një domethënie politike të vërtetë dhe praktike. *Die Entwicklung der Volksrepräsentation* (Bad Homburg, 1954), f. 7-10.

⁶ Siç është arriti deri aty sa të argumentonte se edhe përfaqësuesit e zgjedhur në zona të caktuara, në të vërtetë zgjidhet nga i gjithë kombi, ndaj e përfaqëson atë. Fjalimi i tij në Asamblenë Kombëtare të 1789-ës është cituar tek Karl Loewenstein, *Volk und Parlament* (Mynih, 1922), f. 199. Samuel Bailey, *The Rationale of Political Representation* (Londër, 1835), f. 137, argumenton se përfaqësuesit duhet të zgjidhen në nivel mbarëkombëtar, nëse kjo do të ishte praktike.

⁷ Keqkuptimi i këtij dallimi është i zakonshëm në literaturë. Kështu, Luce citon pasazhin në vijim nga një fjalim i një delegati në konventën e vitit 1902 në New Hampshire *si një ilustrim i mënyrës si njerëzit preferojnë interesin lokal ndaj atij kombëtar*: "Do të doja më mirë të mos përfaqësohesha fare sesa të përfaqësohesha nga një njeri interesat e të cilit i takojnë një tjetër qyteti, dhe i cili nuk ndihmon qytetin tonë." *Op. cit.*, f. 506-507.

⁸ Cituar në Dexter, "The Representative," f. 3.

⁹ Drath, *op. cit.*, f. 14; shih edhe Sheldon S. Wolin *Politics and Vision* (Boston, 1960), f. 63-66.

¹⁰ *Systematic Politics* (Çikago, 1945), f. 140; edhe f. 145; Leibholz, *Das Wesen der Repräsentation*, f. 47-58; Rudolf Smend, *Verfassung und Verfassungsrecht* (Mynih, 1928), f. 39-40.

¹¹ Për sjelljen elektorale shih Joseph A. Schumpeter, *Capitalism, Socialism and Democracy* (New York, 1947), f. 261, dhe këto studime empirike: Paul F. Lazarsfeld *et al.*, *The People's Choice* (New York, 1948), Bernard R. Berelson *et al.*, *Voting* (Çikago, 1954); Angus Campbell *et al.*, *The Voter Decides* (White Plains, N.Y., 1954); Eugene Burdick dhe Arthur J. Brodbeck, red., *American Voting Behavior* (Glencoe, Ill., 1959); Angus Campbell *et al.*, *The American Voter* (New York, 1960).

¹² Dexter, "The Representative," f. 3; John C. Wahlke dhe Heinz Eulau, red., *Legislative Behavior* (Glencoe, Ill., 1959), f. 298-304; John C. Wahlke *et al.*, "American State Legislators' Role Orientation," *Journal of Politics*, XXII (Maj, 1960); Eulau, *op. cit.*; Charles O. Jones, "Representation in Congress," *American Political Science Review*, LV (Dhjetor, 1961).

¹³ Sabine, "What is the Matter?" në A. N. Christensen dhe E. M. Kirkpatrick, red., *The People, Politics and the Politician* (New York, 1941); G. D. H. Cole, *Social Theory* (Londër, 1920), f. 103-116; Dexter, "The Representative," f. 4-5; Howard Lee McBain, *The Living Constitution* (New York, 1948), f. 233; Eulau, *op. cit.*, f. 747, 751; Schumpeter, *op. cit.*, f. 358-359, 365.

¹⁴ Dexter, "The Representative"; dhe "What do Congressmen Hear: The Mail," *Public Opinion Quarterly*, XX (Pranverë, 1956), 16-27; Eulau, *op. cit.*, f. 749; Frank Bonilla, "When is Petition 'Pressure'?" *Public Opinion Quarterly*, XX (Pranverë, 1956), 39-48; David B. Truman, *The Governmental Process* (New York, 1959), kap. 11; Jones, *op. cit.*, f. 366-367.

¹⁵ Henry B. Mayo, *An Introduction to Democratic Theory* (New York, 1960), f. 102; Wahlke dhe Eulau, *op. cit.*, f. 117; Jones, *op. cit.*, f. 359.

¹⁶ Robert M. MacIver, *The Modern State* (Oxford, 1926), f. 196; Joseph Tussman, *Obligation and the Body Politic* (New York, 1960), f. 69, 75; Wahlke, *op. cit.*; Wahlke dhe Eulau, *op. cit.*, f. 179-189, 284-293.

¹⁷ Dexter, "The Representative"; Wahlke dhe Eulau, *op. cit.*, f. 204-217.

¹⁸ Gleeck, *op. cit.*, f. 7; Turner, *op. cit.*, f. 12; Dexter, "The Representative"; Truman, *op. cit.*, kap. 11.

¹⁹ Dexter, "The Representative," f. 5.

²⁰ Jones, *op. cit.*, f.363-364.

²¹ Wahlke dhe Eulau, *op. cit.*, f. 298-304.

²² "Është e qartë se ndryshime të rëndësishme ndodhin, të cilat e bëjnë asamblenë zëvendësuese shumë të ndryshme nga takimi i drejtpërdrejtë i njerëzve." Alfred de Grazia, *Public and Republic* (New York, 1951), f. 126.

"Kur një person përfaqëson një grup, edhe më tepër kur një numër personash përfaqësojnë grupe të ndryshme, problemi ndërlikohet edhe më shumë." John A. Fairlie, "The Nature of Political Representation," *American Political Science Review*, XXXIV (Qershor, 1940), 466.

"Përfundimi im nga ky diskutim është se konceptet që lidhen me përfaqësimin e personave individualë nga persona individualë nuk marrin zbatim të thjeshtë në qeverinë përfaqësuese." A. Philips Griffiths dhe Richard Wollheim, "How can one Person Represent Another?", *Aristotelian Society*, Suppl. Vëll. XXXIV (1960), 207.

Shih gjithashtu edhe Peter Laslett, "The Face to Face Society," *Philosophy, Politics and Society*, ed. Peter Laslett (New York, 1956).

²³ Tre pasazhet e para janë shkëputur prej ligjvënësve të shtetit të Nju Yorkut nga Hartmann, *op. cit.*, f. 111; pasazhi i katërt është marrë nga autobiografia e senatorit George F. Hoar, f. 112-113, cituar tek Luce, *op. cit.*, f. 496; pasazhi i pestë është një deklaratë e një përfaqësuesi në Kongresin e Shteteve të Bashkuara, i intervistuar nga Dexter, "The Representative," f. 3; i gjashti është një përfaqësues i Kongresit, i intervistuar nga Bonilla, *op. cit.*, f. 46-47; i fundit është një deklaratë e një anëtarit senior të Komitetit të Dhomës së Bujqësisë, i intervistuar nga Jones, *op. cit.*, f. 365.

²⁴ Lazarsfeld, *op. cit.*, f. 137. Shih edhe Elihu Katz dhe Paul F. Lazarsfeld, *Personal Influence* (Glencoe, Ill., 1955); Edward C. Banfield, *Political Influence* (Glencoe, Ill., 1961).

²⁵ Miller dhe Stokes, *op. cit.*, f. 55; vendosja në italics e imja.

²⁶ Për shembull, Karl Loewenstein, *Political Power and the Governmental Process* (Çikago, 1957), f. 38-39; Eric Voegelin, *The New Science of Politics* (Çikago, 1952), f. 37.

²⁷ Për shembull, Georg Jellinek, *Allgemeine Staatslehre* (Berlin, 1905), kap. 17.

²⁸ Për shembull, James Hogan, *Elections and Representation* (1945), f. 114; John P. Plamenatz, *Consent, Freedom and Political Obligation* (Londër, 1938), f. 12; Eulau, *op. cit.*, f. 743; Fairlie, *op. cit.*, f. 237; Avery Leiserson, *Administrative Regulation* (Çikago, 1942) f. 3-9. Max Weber, *Wirtschaft und Gesellschaft* (Tübingen, 1956), I, 25, 171-176. Gerhard Leibholz është veçanërisht i pavendosur mes përfaqësimit si autoritet dhe si autoritet efektiv: *Das Wesen der Repräsentation*, f. 140-141, 163-164; dhe *Strukturprobleme der modernen Demokratie* (Karlsruhe, 1958), f. 10-12.

²⁹ MacIver, *op. cit.*, f. 197-198.

³⁰ W. D. Handcock "What is Represented in Representative Government?" *Philosophy*, XXII (Korrik, 1947), f. 107; cf. John Dewey, *The Public and its Problems* (New York, 1927), f. 76.

³¹ Për shembull, Plamenatz, *Consent*, f. 16.

³² Christian Bay, *The Structure of Freedom* (Stanford, 1958), f. 322.

³³ Që qeveria përfaqësuese të ekzistojë "mundësia për opozitë duhet të vlerësohet e mjaftueshme." Charles William Cassinelli, Jr., "The Concept of Representative Government" (tezë e pabotuar, 1950), f. 62.

³⁴ Pesë kritere për të dalluar një "proces të rënies dakort" nga një "proces manipulimi" në zgjedhjet politike ofrohen nga Morris Janowitz dhe Dwaine Marvick, "Competitive Pressure and Democratic Consent," *Public Opinion Quarterly*, XIX (Dimër, 1955-1956), 381-400. Shih gjithashtu librin e tyre me të njëjtin titull (Ann Arbor, 1956) për një vënie në zbatim. Një diskutim me vlera për kriteret e zgjedhjeve "të lira" jepet tek W. J. M. Mackenzie, *Free Elections* (New York, 1958), në veçanti Hyrja dhe Pjesa IV.

³⁵ Duhet të jemi të kujdesshëm me teoritë e reja "ekonomike" të demokracisë. Duke filluar me Schumpeterin, një numër autorësh kanë sugjeruar se demokracia mund të shihet si një lloj tregu ekonomik, ku votat janë paratë, dhe kandidatët për përfaqësues përpiqen në konkurrencë me njëri-tjetrin t'ia shesin veten e tyre blerësve. Schumpeter e përcakton demokracinë si "atë rregullim institucional për të arritur tek vendimet politike ku individët marrin pushtet për të vendosur nëpërmjet një lufte konkurruese për votën e popullit." *Op. cit.*, f. 269. Kështu, nuk janë zgjedhësit ata që vendosin për çështjet; votuesit thjesht zgjedhin "njerëzit që duhet të marrin vendimet." Marvick dhe Janowitz sugjerojnë se zgjedhjet nuk duhet të shihen si dhënie e një mandate për veprim të caktuar për çështjet, por si "një proces për të zgjedhur ose refuzuar kandidatët ... në garë për poste publike." "Competitive Pressure," f. 382.

Një trajtim më i plotë teorik i këtij modeli është bërë më së fundmi nga Anthony Downs, për të cilin sërish "qëllimi kryesor i zgjedhjeve në demokraci është zgjedhja e qeverisë." *An Economic Theory of Democracy* (New York, 1957), f. 24. Diskutimi i politikave dhe ideologjitë për këto teori janë koncepte dytësore. Sikurse thotë Downs, në këtë model politikanët "asnjëherë nuk synojnë poste si një mjet për të ndërmarrë politika të caktuara; qëllimi i tyre i vetëm është të përvetësojnë përfitimet që burojnë nga pasja e postit *per se*. Ata i përdorin politikat vetëm si mjet për të arritur synimet e tyre private që mund t'i arrijnë vetëm duke u zgjedhur... Partitë formulojnë politika për të fituar zgjedhjet, e nuk fitojnë zgjedhjet me qëllim që të formulojnë politika." *Ibid.*, f. 28.

Kjo ide buron nga Schumpeter, i cili e krahason konkurrencën e partive politike me luftën; vendosja e çështjeve

politike është si mbajtja e një pozicioni strategjik, jo qëllim, por mjet. “Fitorja ndaj kundërshtarit” është “thelbi i të dyja lojrave.” *Op. cit.*, f. 279. Votuesit shihen si të jenë në mëshirën e asaj që partitë politike u ofrojnë përmes programeve dhe kandidatëve; “Nëse alternativa është një zgjedhje mes demagogësh, elektorati vuan; nëse zgjedhja qëndron mes burrash shteti, elektorati fiton. Cilësia e rezultatit nuk garantohet nga prania e konkurrencës.” Janowitz dhe Marvick, “Competitive Pressure,” f. 382.

Megjithatë, një sistem politik i përcaktuar në këtë mënyrë nuk është e thënë të jetë përfaqësues; nëse politika jonë korrespondon me të vërtetë me këto modele ne nuk do ta quanim atë përfaqësim. Mjafton të imagjinojmë një situatë ku elektorati ka një dëshirë pak a shumë të qartë dhe të artikuluar, por asnjë nga partitë politike nuk ka ndërmend ta vërë në zbatim. Ne mund ta imagjinojmë një situatë të tillë, për shembull, në një shoqëri të ndarë thellësisht në bazë të klasave, ku pak parti, të gjitha të një klase të vetme, monopolizojnë aksesin në legjislativ. Ose mund ta imagjinojmë në një shoqëri koloniale ku jo-të-bardhët lejohet të votojnë, por vetëm të bardhët mund të jenë pjesë e legjislativit. Në këto situata zgjedhja konkurruese e sunduesve mund, vazhdimisht, të mos rezultojë në miratimin e një mase gjerësisht të dëshiruar. Ne do të hezitonim ta quanim një sistem të tillë qeveri përfaqësuese.

Tani për t’u treguar të drejtë ndaj Downs-it dhe Schumpeter-it duhet shtuar se ata gjithashtu duan të përjashtojnë raste të tilla. Ata kërkojnë që kandidati ose partia që kërkon të vijë në pushtet të bëhet pjesë e konkurrencës së lirë, në kuptimin ekonomik. Schumpeter, *op cit.*, f. 272. (Janowitz dhe Marvick me sa duket nuk e kuptojnë përdorimin e termit “konkurrencë e lirë” nga Schumpeter, pasi ata argumentojnë se konkurrenca nuk garanton rezultate të mira politike. Ata vetë kërkojnë shqyrtimin efektiv të çështjeve në fushatat elektorale, por nuk është e qartë nëse ata e shohin këtë si një parakusht për të patur përfaqësim apo thjesht për përfaqësim të mirë, të dëshirueshëm. Shih edhe George Cornwall Lewis, *Remarks on the Use and Abuse of Some Political Terms* (Oxford, 1877), f. 98-99. Downs e bën të qartë se në modelin e tij duhet të shfaqen parti të reja sa herë që partitë e vjetra nuk u ofrojnë njerëzve çfarë ata kërkojnë. Kështu koncepti është analog me konkurrencën e lirë ekonomike, ku prodhuesi duhet të ofrojë atë që kërkojnë konsumatorët pasi druhet mos dalë jashtë biznesit nga ndonjë konkurrent më reagues ndaj tyre. Por një konkurrencë e tillë në skenën politike duket jobindëse sa ngre dyshime për dobinë e modelit. Një tjetër kundërshti, më në zemër të shqetësimeve tona, është se, pavarësisht nëse këto modele japin të dhëna për si demokracia funksionon në të vërtetë, ata janë çorientues kur zbatohen tek kuptimi i përfaqësimit dhe qeverisë përfaqësuese. Pushteti për të zgjedhur sunduesit mund të sjellë përfaqësim, por nuk përbën përfaqësim (përjashtuar ndoshta në kuptimin formal). Ajo çfarë përbën përfaqësim është vetë përgjigjia ndaj çështjeve, të cilën këto modele e vendosin në një rol dytësor. Vetëm zgjedhja e një njeriu nga të tjerët për një detyrë nuk e bën atë përfaqësues të tyre.

³⁶ Cassinelli, “The Concept of Representative Government,” dhe “Representative Government” (i papublikuar, 1953). Shih edhe Bay, *op cit.*; Mackenzie, *Free Elections*; Janowitz dhe Marvick, “Competitive Pressure.”

³⁷ Në këtë kuptim më tradicional monarku nuk është përfaqësues. Ai është një sundues. Presidenti nuk është një përfaqësues... Për të gjetur përfaqësuesin tonë duhet të shohim aty ku një grup njerëzish, formal ose thelbësor, ka anëtarë në një trup të përbashkët, dhe grupe të tjera kanë anëtarët e tyre.” Arthur F. Bentley, *The Process of Government* (Evanston, Ill., 1949), f. 450. Shih edhe Friedrich Glum, *Der deutsche und der französische Reichswirtschaftsrat* (Berlin, 1929), f. 33.

³⁸ Për disa trajtime të mprehta filozofike të problemit të ndëshkimit shih John Rawls, “Two Concepts of Rules,” *Philosophical Review*, LXIV (Janar, 1955), 3-32; Quinton, “On Punishment” tek Laslett, *op cit.*; J. D. Mabbott, “Punishment,” *Mind*, XLVIII (1939), 152-167.

³⁹ Jean Piaget, *The Moral Judgement of the Child* (New York, 1962).

⁴⁰ *Ibid.*, f. 42, 65-76, 98. Kështu, zbulimet e vetë Piaget vënë në dyshim pohimin e tij kategorik se “vetëm procedura është e detyrueshme.” *Ibid.*, f. 71.

⁴¹ Kjo është shprehur qartësisht edhe nga Drath, *op cit.*, f. 3, 15, 19-21.

⁴² *Obligation*, f. 86. Tussman i quan ato “dy gjendjet madhështore të jetës shqyrtuese/deliberative.”

⁴³ Për një kritikë të ngjashme të liberalizmit dhe konstitucionalizmit shih Wolin, *op cit.*, veçanërisht kapitullin 9.

⁴⁴ *The Federalist*, Nr. 51, f. 265; Tussman, *Obligation*, f. 108.

⁴⁵ Hans J. Wolff thotë se përfaqësimi nuk është asnjë “zueinander,” asnjë “miteinander,” por një “für einander,” “und zwar nicht nur des Vertreters für die Vertretenen, sondern ebenso entsprechend der Vertretenen für den Vertreter. Darin liegt der tiefe ethische und soziale Gehalt der Vertretung, die grundsätzlich den Eigennutz überwindet und tiefer als im Versprechen und in der Gemeinsamkeit wurzelt in der gegenseitigen Treue.” *Organschaft und juristische Person* (Berlin, 1934), f. 5-6.

⁴⁶ Drath, *op cit.*, f. 24. Drath ia ul forcën qasjes së tij duke ngatërruar përmbajtjen e përfaqësimit me pranimin-e-qeverisë-nga-njerëzit ose me identifikimin-e-njerëzve-me-qeverinë, të llojit të De Grazia-Gosnellit, *Ibid.*, f. 24-27.

⁴⁷ Ky argument nuk është trajtuar askund më mirë se në shkrimet e Michael Oakeshott, *Rationalism in Politics* (New York, 1962), veçanërisht në faqet. 118-126. Por kjo është vetëm gjysma e së vërtetës; Oakeshott na e heq mundësinë për ta përdorur idealin e shkëputur nga institucionet tona për t’i kritikuar dhe ndryshuar ata.

⁴⁸ Drath, *op cit.*, f. 13; Weber, *Wirtschaft*, II, 675; Merriam, *op cit.*, f. 139; Harold D. Lasswell dhe Abraham Kaplan, *Power and Society* (New Heaven, 1950), f. 165; Glum, *op cit.*, f. 25; Leibholz, *Das Wesen der Repräsentation*, f. 157-158.

⁴⁹ Drath, *op cit.*, f. 7, 27-28. Për një trajtim të Revolucionit Amerikan nën këtë dritë shih Leibholz, *Das Wesen der Repräsentation*, f. 157-158; De Grazia, *Public and Republic*, f. 14, 22. I njëjti lloj konflikti është pikasur në mendimin mesjetar nga Georges de Lagarde, "L'Idée de Représentation," Komiteti Ndërkombëtar i Shkencave Historike, *Bulletin*, IX (Dhjetor, 1937), 426, 435. Është vënë re gjatë periudhës së rëndësishme të Luftës Civile në Angli nga Louise Fargo Brown, "Ideas of Representation from Elizabeth to Charles II," *Journal of Modern History*, XI (Mars, 1939), 23-40. Shih edhe Shtojcën më poshtë; për një rast të kohëve më të fundit shih Mackenzie, *Free Elections*, f. 175.

⁵⁰ Henry J. Ford, *Representative Government* (New York, 1924), f. 145-146. Fordi ia atribuon pikëpamjen John Stuart Millit.

Shtypi u realizua në shtypshkronjën
“KRISTALINA-KH”
Rr. “Lord Bajron”
Tel.: ++ 355 4 356928;
Cel.: 068 20 38373, Cel.: 069 20 38373
Tiranë / Albania